

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave ekonomiko-juridike

Viti IV

2010

Shkodër, 2010

REDAKSIA

Prof. dr. Esmeralda URUÇI (kryeredaktore)
LL. M. Paulina HOTI (sekretare shkencore)
Prof. assoc. dr. Arjeta Troshani, Dr. Ilir Bërhani,
Dr. Elez Osmani, MBA Emirjeta Bejleri,
LL.M. Roland ILIA (anëtarë)

DREJTOR I REVISTËS
Prof.dr. Artan HAXHI

Korrektore: *Arta BAJRAMI*

E drejta e autorit. USH “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë : Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
(Seria e Shkencave ekonomiko-juridike)
Tel fax: ++399 22 43747

PASQYRA E LËNDËS

Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

Përfaqsjë stabilizuese përkundrejt përfaqsjës integruese: Rasti i politikave të BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor

Stabilizing approach towards the integrative approach: The case of EU policies for the Western Balkan Countries..... 7

Arjeta TROSHANI, Marsel FREGJAJ

Impaktet e zhvillimit të sektorit të artizanit mbi turizmin

Artisanry sector development and its impact on

tourism.....21

Sadije BUSHATI, Vilfrida LUANI

Studim për gjendjen dhe shpërndarjen e forcës së punës në rajonin e Shkodrës

Study on the situation and distribution of the labor force in

Shkodra Region.....39

Fatos UKAJ, Elez OSMANI

Turizmi si mundësi e vendit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

Tourism as an opportunity for the country's sustainable economic

development.....59

Esmeralda URUÇI, Nevila KIRI

Ecuria e vlerës së pasurive të patundshme dhe normave të interesit në Shqipëri

Relationship between interest rate and the price of real estate.....71

Blerta DRAGUSHA (Spahia), Zemaida KASTRATI (Mozali)

Flukset e investimeve të huaja direkte në rajonin e Shkodrës

Flows of foreign direct investment in the region of Shkodra.....89

Ylvije KRAJA (Boriçi), Emira SPAHAJ

Sfidat e ekonomisë shqiptare

Challenges of albanian economy.....107

Veli LECAJ, Olda CICO

Roli i tregtisë së jashtme në zhvillimin ekonomik të Kosovës

The role of foreign trade in economic development of Kosovo.....119

Brikenë DIONIZI, Dhurata PERDJA

Përgjegjësia sociale, një kërkesë e kohës

Social responsibility, a requirement in today environment.....143

Fatbardha MOLLA, Blerta DRAGUSHA

Ndikimi i krizës globale mbi sektorin financiar shqiptar dhe cilësia e informacionit në financimin e biznesit

The impact of the global crisis on the Albanian financial sector and the quality of information on business financing..... 155

Belinda MESHINI, Hidajet SHEHU, Ilirjana ZYBERI

Financat personale, jo luks, tashmë një domosdoshmëri për mirëqenien financiare të individit

Personal finances, not a luxury, now a necessity for the welfare individual financial.....169

Shefqet JAKUPI, Skënder KERCUKU

Financimi i aktiviteteve në biznes

Financing of activities in business..... 187

Ilir BËRHANI, Ermal BEQIRI

Humbja e të drejtës së zgjedhjes

Loss of the right of choice..... 197

Florian BJANKU, Anila KAÇUPI

Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri parë në këndvështrimin e Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

The process of restitution and compensation of Former property Owners in Albania from the point of view of the jurisprudence of the European Court of Human Rights..... 209

Vera SHTJEFNI

Sistemi zgjedhor në Shqipëri. Arritjet dhe sfidat

The electoral system in Albania: achievements and future challenges..... 223

Linda DURGAJ

Bashkëpronësia, natyra juridike. Format dhe llojet e saj

Joint ownership, legal nature. Format and its types..... 239

Lulzim LELÇAJ

Agresioni, tashmë një krim ndërkombëtarisht i dënueshëm nga gjykata ndërkombëtare penale

From Rome to Kampala: Aggression, already an internationally punishable crime by the International Criminal Court..... 253

Lavdosha AHMETAJ

E drejta kombëtare shqiptare e shprehur në Paris, prej delegacionit të Kongresit të Lushnjës, Paris, 1920

The Albanian national rights expressed in Paris, by delegation Lushnja Congress, Paris, 1920..... 265

Armand KRASNIQI, Skënder KERÇUKU

E drejta kontraktore si mundësi për zbatimin
e strategjive alternative të investimeve në ekonomitë
e vendeve të tranzicionit

*The right contractor as an opportunity to implement alternative
investment strategies in economies transition countries.....* 279

Aurora SPAHIA, Aurela KASMOLLARI

Bashkimi Evropian (BE) dhe Shqipëria...

European Union and Albania..... 293

Ardian HOTI

Integrimi evropian i shqiptarëve dhe trashëgimia kulturore

European integration of Albanians and cultural heritage..... 301

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010

Përqasja stabilizuese përkundrejt përqasjes integruese: Rasti i politikave të BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor

Jozefina Topalli (Çoba)

Kryetare e Parlamentit Shqiptar

ABSTRACT

**Stabilizing approach towards the integrative approach: The case of
EU policies for the Western Balkan Countries**

After the Fall of the Berlin Wall, the European Union has relied on two approaches to contribute to the stabilization of the former communist countries of the Eastern and Central Europe, including the countries of the Western Balkans. The first is the stabilizing approach, aimed at stabilizing these countries by inciting interregional cooperation; the second is the integrative approach, which at times paralleled the first and is aimed at their integration into the European Union through the establishment of bilateral relations that had to follow a strict course.

The stabilizing approach was implemented in 1993 in the Countries of the Eastern and Central Europe (CECE) including the Balkan countries, through the Stabilization Pact in Europe, known as Baladyr Pact; later, in 1999, the Pact of Stabilization of South-Eastern Europe was implemented. Integrative approaches were reflected in the policies for the widening of the European Union by incorporating countries of the Eastern

and Central Europe.

This study analyzes the two approaches of the EU, focusing on their interaction, solidity, and cohesion. The research question is: Is the stabilizing approach a prerequisite for the successful implementation of the integrative approach, or vice versa? This question leads to another one: Which of the two approaches proved to be more efficient to the stabilization of the post-communist European Countries?

Based on the experience of the Countries of the Eastern and Central Europe, including the Balkan countries, this study reveals that the integrative approach is a prerequisite to the successful implementation of the stabilizing approach.

I. Përqasja stabilizuese

Përqasja e parë që BE-ja ka adoptuar për stabilizimin e vendeve ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore (VEQL), ka qenë përqasja stabilizuese, e cila kishte për objekt *stabilizimin* e vendeve ish-komuniste dhe si *mjet* për arritjen e tij ishte *bashkëpunimi rajonal* ndërmjet vendeve përkatëse.

Përqasja stabilizuese është tentuar të adoptohet fillimisht ndaj ish-Jugosllavisë në vitin 1990, por pa arritur ndonjë sukses. E njëjta përqasje është aplikuar ndaj vendeve të Evropës Qendrore e Lindore dhe ndaj shteteve Balltike, përmes Paktit të Stabilitetit në Evropë (1993). Ky Pakt, përbënte Paktin e Parë të Stabilitetit të adoptuar në Evropë dhe pati njëfarë suksesi në stabilizimin e vendeve të përfshira në këtë iniciativë. Kjo përqasje stabilizuese është adoptuar në vitin 1999 edhe ndaj vendeve të Evropës Juglindore përmes Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, gjithashtu duke arritur njëfarë suksesi për stabilizimin e vendeve të këtij rajoni.

Përqasja stabilizuese ka funksionuar mirë në VEQL dhe në shtetet Balltike, sepse shumë shpejt ajo është harmonizuar me *përqasjen integruese*, përmes vendimit historik që Bashkimi Evropian mori në qershor të vitit 1993 në Kopenhagen, i cili vendosi shprehimisht dhe në mënyrë të qartë një lidhje të drejtëpërdrejtë ndërmjet *Asociimit*

(Marrëveshjeve të Evropës) dhe anëtarësimit (të ardhshëm) të VEQL në Bashkimin Evropian.

Mund të paraqiten shumë argumente për të vërtetuar faktin se në vendet e Evropës Qendore e Lindore *përqasja integrale* ishte një parakusht për një përjasje të suksesshme stabilizuese.

Shumë autorë që marrin pjesë në këtë debat theksojnë se “... *efektiviteti relativ i Paktit të Parë të Stabilitetit në Evropë ishte kryesisht rezultat i “karrotës së artë” të anëtarësimit në BE, që do të thotë, se efektiviteti i përjasjes së parë stabilizuese ishte rezultat i mbivendosjes së hershme të saj me përjasjen e dytë integrale. Me fjalë të tjera, integrimi i plotë dhe kushtëzimi i drejtëpërdrejtë kanë zëvendësuar (për më mirë) fushën më të kufizuar të veprimit që fillimisht kishte përjasja e parë*”¹. Kris Patten, ish-Komisioneri për Marrëdhëniet e Jashtme në Komisionin Evropian, në vitin 2004 është shprehur se “... *pa mundësinë e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, historia e këtij rajoni [VEQL] pas rënies së Murit të Berlinit do të kishte qenë shumë më e ndryshme dhe shumë më e keqe*”².

Këto konsiderata na ndihmojnë të shpjegojmë se përse të gjitha iniciativat e ndërmarra nga BE-ja për të stabilizuar Evropën Juglindore në vitet 1990, patën një impakt kaq modest për vendet e Ballkanit Perëndimor, krahasuar kjo edhe me rezultatet që po arrihen përmes politikave aktuale të BE-së në rajonit tonë (procesit të stabilizim-asociimit-PSA). Motivi kryesor është se të gjitha këtyre iniciativave u mungoi substanca, duke qenë se ato nuk parashikonin asnjë lidhje të drejtëpërdrejtë ndërmjet ndryshimeve politike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe asociimit të tyre me BE-në, pra, duke mos u ofruar vendeve të rajonit asnjë lloj premtimi apo “karrote”.

Vetëm në verën e vitit 1999, pas luftës së Kosovës, BE-ja ndryshoi përjasjen e saj, duke ofruar një kuadër për bashkëpunim ekonomik dhe politik ndërmjet saj dhe vendeve të Evropës Juglindore, pra, duke

¹ MISSIROLI, A., “The EU and its changing neighbourhoods: stabilization, integration and partnerships, in Partners and Neighbours: CFSP for a wider Europe”, Institute for Security Studies, EU, Chaillot paper No. 64, September, 2003, p.12.

² Speech by Rt. Hon. Chris Patten, “The Western Balkans: The road to Europe”, to German Bundestag, “European Affairs Committee”, Berlin, 28 April 2004, p.1, available at the website:

http://europa.eu.int/comm/external_relations/news/patten/speech04_209.htm

vendosur disa “karrota” në tryezën e politikave të saj për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Politika e BE-së për rajonin u bë më koherente dhe proaktive. Megjithatë, edhe kjo përjasje e re nuk krijoi një lidhje të drejtpërdrejtë ose të shprehur ndërmjet plotësimit të kushteve, pra, sjelljes së mirë të vendeve të rajonit dhe procesit të aderimit të tyre në BE.

PSA-ja që BE-ja adoptoi ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor në vitin 1999 nuk parashikonte një lidhje formale ndërmjet PSA-së dhe procesit të paraaderimit ose perspektivës së aderimit në BE. Sipas MSA-ve të lidhura ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, këto vende kanë statusin e “kandidatit të mundshëm”. Kjo do të thotë se fillimisht nuk kishte lidhje të qartë dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet MSA-ve dhe procesit të paraaderimit, prandaj edhe impakti i kësaj përjasje vazhdonte të mbetej mjaft modest.

Këshilli Evropian i Selanikut (i mbajtur më 19 dhe 20 qershor të vitit 2003), konfirmoi perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat do të bëhen pjesë përbërëse e BE-së, sapo vendet e rajonit të plotësojnë kriteret e vendosura.

Komiteti akademik dhe ai politikëbërës argumentojnë se përjasja stabilizuese filloi të funksionojë në Ballkanin Perëndimor për shkak të perspektivës së anëtarësimit (megjithëse e largët), që u hap pas Këshillit Evropian të Selanikut. Studiuesit që marrin pjesë në debat argumentojnë se në vendet e Ballkanit Perëndimor e njëjta përjasje (*përjasja stabilizuese*) solli pak ose aspak frute, derisa ajo u harmonizua me përjasjen e dytë (*përjasjen integruese*), e cila parashikon *integrimin* (megjithëse i largët) si *objektiv* dhe *kushtëzimin* (megjithëse shumë strikt) si *mjet*. Kris Patten në fjalimin mbajtur në vitin 2004 përpara Bundestagut Gjerman argumentoi se me adoptimin e PSA-së, Bashkimi Evropian “... *po përsërit në mënyrë të suksesshme përjasjen e adoptuar ndaj vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore*”.

Megjithëse, parandalimi i konfliktit në Ballkanin Perëndimor ishte në periudhën afatshkurtër elementi qendror në kuadër të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët/Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (CFSP/ESDP) së BE-së, në periudhën afatgjatë vetëm integrimi evropian do të arrijë të stabilizojë në mënyrë të qëndrueshme këtë rajon të trazuar të Evropës. Roberto Toskano argumenton se nuk është e mjaftueshme të flitet vetëm për ndihmë ekonomike dhe rindërtim të Ballkanit, por duhet të jetë e qartë, se jo vetëm për arsye ekonomike,

por, mbi të gjitha, për arsye politike “... zgjidhja e vetme, reale dhe e qëndrueshme për destabilitetin dhe konfliktin në Ballkan, është përfshirja e rajonit në procesin e integrimit evropian”.

Nga analiza e mësipërme rezulton se përfaqset stabilizuese dhe integruese e plotësojnë dhe e përforcojnë njëra-tjetrën në mënyrë reciproke. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ashtu si edhe në vendet e tjera të Evropës Qendrore e Lindore, përfaqsa stabilizuese funksionon dhe arrin rezultat vetëm atëherë kur mbivendoset ose harmonizohet me përfaqsen integruese.

II. Përfaqsa Integruese

Përfaqsa e dytë ajo integruese ka si objektiv vetë integrimin e vendeve përkatëse në Bashkimin Evropian, përmes një procesi marrëdhëniesh bilaterale të bazuara në një kushtëzim strikt. Përfaqsa integruese e BE-së ilustron me politikën e zgjerimit të BE-së.

Kjo përfaqse ka rezultuar shumë më e suksesshme sesa përfaqsa stabilizuese për stabilizimin e vendeve të Evropës Jugore (Greqi, Spanjë dhe Portugali), pas përmbysjes së regjimeve totalitare dhe, sidomos, në stabilizimin e vendeve të ish-bllokut komunist të Evropës Qendrore e Lindore. Zgjerimi i komunitetit evropian me Greqinë, Spanjën dhe Portugalinë në vitet 1980, jo vetëm që i stabilizoi këto vende, por edhe u krijoi atyre kushtet që procesi i tranzicionit post-diktatorial drejt demokracisë të përfundojë me sukses. Edhe zgjerimet e BE-së pas rënies së Murit të Berlinit drejt vendeve të lindjes, respektivisht në vitet 2004 dhe 2007 kanë kontribuar për t’i stabilizuar ato.

Antonio Misioli argumenton se një ndër shkaqet kryesore që *përfaqsa integrim/kushtëzim* mori përparësi, si përfaqsa dominuese në shumicën e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore, është e lidhur me faktin se tensioni dhe kontradiktat potenciale që ajo kishte me *përfaqsen stabilizim/rajonalizim* po dëmtonte objektivin e përgjithshëm të sigurisë (që ishte stabiliteti), duke krijuar një “kontekst të bukur” tek vendet kandidatë për në BE, por duke forcuar ndjenjën e rrezikshme të përjashtimit tek ato vende që mbeteshin pas e që në mënyrë potenciale kjo mund të minonte edhe stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal që ishte arritur deri në atë moment.

Në rastet e Bullgarisë dhe të Rumanisë, duke qenë se ato u përjashtuan nga vala e parë e zgjerimit të Bashkimit Evropian (e cila përfundoi në vitin 2004), BE-ja për të shmangur problemet ose, edhe efektet destabilizuese që një ngjarje e tillë mund të shkaktonte, doli me një “hartë rruge” dhe me një afat kohor të fiksuar (2007) për aderimin e tyre në BE.

Një situatë e ngjashme rezultoi edhe me vendet e Ballkanit Perëndimor, ku disa vende kanë statusin e vendit kandidat (Kroacia dhe Maqedonia) kurse vendet e tjera kanë statusin e kandidatit të mundshëm. Nuk është rastësi që në Ballkanin Perëndimor, ashtu si dhe në VEQL ka pasur dhe ka një perceptim negativ për përfaqësimin/stabilizim/rajonalizim, e cila është perceptuar si një taktikë për të vonuar integrimin e tyre në Bashkimin Evropian.

BE-ja, duke u dhënë Kroacisë³ dhe Maqedonisë⁴ statusin e vendit kandidat, përfundimisht sfidoi përfaqësimin e unifikuar strategjike që kishte ndjekur deri atëherë me vendet e Ballkanit Perëndimor, e cila synonte t'i mbante vendet e këtij rajoni të bashkuara. BE-ja ndryshoi politikën e saj nga përfaqësimi i unifikuar në përfaqësimin e diferencuar. Por përvoja e VEQL vërtetoi se një përfaqësim i diferencuar me vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor mund të nxitë në mënyrë të rrezikshme konkurrencën dhe tensionin mes vendeve të rajonit në dëm të bashkëpunimit rajonal. Prandaj, një rrugë shumë e diferencuar drejt anëtarësimit në BE mund të nxisë ndjenja nacionaliste dhe armiqësi mes vendeve që do të ndiheshin të lëna jashtë⁵. Në analizë të fundit, kjo mund të vëjë në rrezik edhe rezultatet e deritanishme që përfaqësimi/stabilizuesi ka arritur dhe për pasojë mund të sjellë edhe ndryshim të kursit të rajonit nga *stabilizimi* dhe *europianizimi në ballkanizim*. Duke pasur parasysh diferencat dhe mangësitë strukturore historike që ka Ballkani Perëndimor, krahasuar me vendet e Evropës Qendore e Lindore, veçanërisht me trashëgiminë e

³ Kroacia mori statusin e vendit kandidat më 18 qershor të vitit 2004.

⁴ Maqedonia mori statusin e vendit kandidat më 17 Dhjetor 2005 megjithatë, nuk është caktuar ndonjë datë për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit dhe negociatat nuk janë hapur ende.

⁵ World Bank's regional strategy paper: “*The Road to Stability and Prosperity in South Eastern Europe*” on March 1, 2000, p.12, at the website:

<http://www.seecon.org/region.documents/wb/>World Bank's Regional Strategy Paper, p. 12.

konflikteve të viteve 1990 në ish-Jugosllavi, rreziqet e konfliktit në këtë rajon janë potenciale.

Prandaj, situata aktuale që është krijuar në Ballkan, përmes përfaqjes së diferencuar të BE-së ndaj vendeve të rajonit ka provokuar një kritikizëm nga komuniteti akademik dhe politikëbërës. Nga njëra anë, të gjithë mbështesin ndryshimin e paradigmës nga përfaqje stabilizuese në atë integruese për të gjitha vendet e rajonit, por, nga ana tjetër, përmendin edhe pasojat e mundshme që mund të sjellë mosintegrimi i Ballkanit Perëndimor jovetëm për për rajonin, por dhe për vetë BE-në.

Libri për Strategjinë Rajonale i Bankës Botërore “Rruga drejt stabilitetit dhe prosperitetit në Evropën Juglindore” argumenton se është e pamundur që siguria mund të vendoset në Ballkanin Perëndimor, duke u bazuar vetëm në bashkëpunimin rajonal, rajonalizimi është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm. Banka Botërore pasi analizon marrëveshjet për integrimin rajonal” (RIA-s) arrin në përfundimin se ka pak mundësi që bashkëpunimi rajonal ndërmjet vendeve të vogla dhe që janë në zhvillim, sikurse *par excellence* janë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, që të rezultojnë në rritje ekonomike më të madhe, prandaj Banka Botërore argumenton se vetëm integrimi evropian është nxitja kryesore për sukses në këto vende. Vizioni i Bankës Botërore për zhvillimin e Evropës Juglindore nuk fokusohet në bashkëpunimin brenda rajonit, por, në integrimin e rajonit në BE. Ajo argumenton më tej se “*Suksesi do të varet gjithashtu në mënyrë kritike nga krijimi i një rruge të besueshme dhe të parashikueshme për të gjitha vendet e rajonit, për t’u integruar në strukturat europiane dhe globale, veçanërisht në Bashkimin Evropian*”⁶. Argumentet e Bankës Botërore mbështeten gjithashtu, edhe nga kuptimi teorik që aktualisht mbizotëron në lidhje me efektet që *rajonalizimi* dhe RIA-të (Regional Integration Agreements) mund të sjellin për zhvillimin ekonomik të vendeve pjesëmarrëse. Sipas *Teorisë për Integrimin Rajonal* (Viner 1950; Meade 1955 dhe Lipsey 1957)⁷, megjithëse, liberalizimi dhe integrimi rajonal përgjithësisht janë dobiprurës për vendet përkatëse,

⁶ World Bank’s Regional Strategy Paper, po aty f. 2.

⁷ZAHARIADIS, “*The Effects of the Albania-EU Stabilization and Association Agreement: Economic Impact and Social Implications*”, Overseas Development Institute (ODI), Economic and Statistics Analysis Unit, ESAU Working Paper 17, London, February 2007, p. 3, available at the website: <http://www.odi.org.uk/resources/download/1864.pdf>

vendet e varfra nuk mund të përfitojë nga avantazhet që sjelle liberalizimi dhe integrimi rajonal⁸. Kjo teori argumenton se rajonalizimi sjell *krijim të tregut*⁹ dhe *zgjerim të tregut*¹⁰. Të dy këto pasoja janë dobiprurëse dhe, kjo do të thotë se përmirësojnë mirëqenien, por, nga ana tjetër, rajonalizimi sjell edhe *devijim të tregut* që është i dëmshëm dhe redukton mirëqenien sepse importet me çmime më të lira nga pjesa tjetër e botës zëvendësohen nga importe me çmime më të shtrenjta nga vendet partnere të përfshira në bashkëpunimin rajonal. Prandaj, nëse rajonalizimi duhet të mbështet ose jo, kjo varet shumë nga pesha relative e efekteve që sjellin *krijimi i tregut* dhe *devijimi i tregut*.

Sipas kësaj teorie, përfitimet e krijimit të tregut e të zgjerimit të tregut rriten, ndërsa rreziqet e devijimit të tregut ulen nëse përmbushën dy kushte: Së pari, kur vendet që integrohen në bashkëpunim rajonal janë partnerë të mëdhenj tregtarë dhe së dyti, kur vendet e përfshira në bashkëpunim rajonal kanë një integrim të thelluar mes tyre, sipas modelit të BE-së. Duke analizuar se sa vendet e Ballkanit Perëndimor i plotëson këto kritere, arrihet në përfundimin se Ballkani Perëndimor nuk përmbush asnjërin nga kushtet e sipërpermendura: së pari, asnjë vend i Ballkanit Perëndimor nuk mund të konsiderohet partner i madh tregtar, duke qenë se ky rajon prej rreth 25 milionë banorësh është i ndarë në 7 shtete dhe së dyti, trashëgimia e kaluar e konfliktit në rajon është pengesë për një bashkëpunim shumë të ngushtë dhe integrim të thelluar rajonal.

Mund të paraqiten shumë argumente se bashkëpunimi rajonal mund të rritet më tej vetëm nëse vendeve të rajonit u garantohej një rrugë e qartë drejt anatarësimit në BE, duke parashikuar si parakusht strikt pikërisht bashkëpunimin e ngushtë rajonal. Ne mendojmë se nëse për vendet e antëtare të BE-së bashkëpunimi rajonal ka rezultuar një pasojë e integritimit evropian, në rastin e Ballkanit Perëndimor duhet të jetë kushtëzim strikt për integrim.

Gjithashtu, edhe të dhënat empirike vërtetojnë se në rastin e Ballkanit Perëndimor vetëm rajonalizimi nuk mund të sjellë shumë dobi për këtë rajon, nëse ato nuk integrohen sa më shpejt në BE. Këto të dhëna

⁸ ZAHARIADIS, *po aty*, f. 3.

⁹ *Krijimi i tregut* është fitimprurës, sepse bën zëvendësim të prodhimit të brendshëm i cili nuk është me importe më të lira nga vendet partnere.

¹⁰ *Zgjerimi i tregut* është dobiprurës, sepse sjell konsum shtesë të mallrave të importuara, i cili nxitet nga çmimet më të ulëta të mallrave në vendet partnere (*partner country*).

fokusohen në efektet e mirëqenies që zgjerimi i BE-së ka sjellë në lindje dhe tregojnë se integrimi evropian i vendeve të Evropës Qendrore e Lindore ka rezultuar në një përmirësim të ndjeshëm të mirëqenies¹¹ së këtyre vendeve, sidomos krahasuar kjo me përmirësimin e mirëqenies që procesi i stabilizim-asociimit ka sjellë për vendet e Ballkanit Perëndimor. Të dhënat empirike tregojnë se në zgjerimin që u bë në vitet 2004, 2007 përfitimet në mirëqenie variojnë nga 1 % të liberalizimit tarifor në 10 % të liberalizimit jotarifor. Ndërsa, në kontekstin e procesit të stabilizim-asociimit, vendet e Ballkanit perëndimor kanë përfituar nga tregtia e lirë me BE-në dhe me vendet e tjera të Evropës Juglindore nga 0.3% - 0.5 % të produktit të brendshëm bruto (PBB)¹². Nga këto të dhëna rezultojnë qartë edhe diferencat e mëdha në përfitime që përqsja integruese dhe stabilizuese sjellin për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Argumentet e dhëna më sipër tregojnë qartë në terma jo vetëm teorikë, por edhe empirikë diferencën e madhe që ka në avantazhet dhe përfitimet që *përqsja integruese* dhe *përqsja stabilizuese* kanë sjellë për vendet e Evropës Qendrore e Lindore dhe, aktualisht po sjellin për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Aktualisht politikat e BE-së ndaj vendeve të rajonit anojnë më tepër nga *përqsja stabilizuese* (shumica e vendeve të rajonit ende kanë statusin e kandidatit të mundshëm), kurse *dimensioni integrues* ose përqsja integruese nuk ofrohet në mënyrë të mjaftueshme (vetëm 2 vende kanë statusin e vendit kandidat).

Duke pasur parasysh argumentet që sollëm më lart për raportin ndërmjet stabilizimit dhe integritit, do të ishte e mirëpritur dhe shumë dobiprurëse si për BE-në, ashtu edhe për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor një ndryshim i politikës së BE-së ndaj këtyre vendeve, me fjalë të tjera ndryshim i *paradigmës* nga *stabilizim* në *integrim* përmes ofrimit të statusit të vendit kandidat për të gjitha vendet e rajonit.

Nëse përqsja stabilizuese nuk do të harmonizohet me atë integruese për të gjitha vendet e rajonit, atëherë, kjo mund të sjellë disa pasoja qoftë nga perspektivat e përceptimit të elitave politike të vende të rajonit ndaj politikave të BE-së, qoftë edhe nga pikëpamja e efekteve që do të kishte për vendet përkatës, edhe për rajonin në tërësi. Rreziku

¹¹ ZAHARIADIS, *cituar lart në shënimin 9*, f. 7.

¹² *Po aty*, f. 15.

qëndron në faktin se *përqasja stabilizuese* do të vazhdonte të perceptohej nga *elitat politike* e vendeve të Ballkanit Perëndimor si një strategji evropiane e hartuar për të vonuar ose, edhe për të zëvendësuar integrimin e tyre në BE. Kjo do të sillte edhe humbjen e kredibilitetit që vetë *përqasja stabilizuese* kishte deri tani¹³.

Në komunitetin akademik ekziston opinioni se nëse BE-ja nuk do të ndryshojë *përqasjen* e saj nga stabilizimi në integrim, pra duke u ofruar statusin e vendit kandidat të gjitha vendeve të rajonit, kjo mund të ushqejë frikën e tyre të përjashtimit nga “Perëndimi” dhe, mund të sjellë destabilizim të brendshëm të këtyre vendeve ose, edhe më keq, destabilizim rajonal. Kjo gjë do të vinte në rrezik atë progres të rëndësishëm që është bërë deri tani nga *përqasja stabilizuese*¹⁴. Prandaj ilaçi i vetëm që do ta shëronte *përqasjen stabilizuese* nga këto keqperceptime është përmirësimi i kredibilitetit të saj përballë *përqasjes integruese*, që do të thotë, duke u ofruar vendeve të rajonit një perspektivë të qartë të anëtarësimit në strukturat e BE-së sipas politikave të adoptuara ndaj VEQL.

Duke pasur parasysh mësimet e nxjerra nga vendet e Evropës Qendrore e Lindore, si dhe nga përvoja e deritanishme në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, arrijmë në këto konkluzione për sa i takon ndërveprimet, qëndrueshmërisë dhe kohezionit që ekziston ndërmjet *përqasjes integruese* dhe asaj *stabilizuese* të BE-së ndaj vendeve ish-komuniste të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore:

Së pari, është provuar si nga kuadri teorik (teoritë e integritit rajonal), ashtu edhe nga ai praktik (të dhëna empirike) se *përqasja integruese* ka rezultuar më e suksesshme se *përqasja stabilizuese* në rritjen e mirëqenies, në rritjen ekonomike dhe në stabilizimin e qëndrueshëm të Evropës.

Së dyti, në vendet e Ballkanit Perëndimor ashtu si dhe në vendet e tjera të Evropës Qendrore e Lindore ka pak mundësi që stabilizimi dhe integrimi të vazhdojnë sipas një kronologjie dhe rregulli të caktuar (dmth,

¹³ WIM VAN MEURS and ALEXANDROS YANNIS, *The European Union and the Balkans: From Stabilisation Process to Southeastern Enlargement*, Centre for Applied Policy Research (C.A.P), Hellenic Foundation for European & Foreign Policy (ELIAMEP), September 2002, p.11.

¹⁴ MISSIROLI, *cituar lart në shënimin 3*, f. 64.

aty ku mbaron përjasja stabilizuese fillon përjasja integruese), sepse të dy proceset janë të lidhura ngusht dhe duhet të adresohen së bashku dhe jo në mënyrë të ndarë.

Së treti, duke pasur parasysh se siguria në Ballkanin Perëndimor po bëhet e pavarur dhe e vetëmbështetur dhe se stabilizimi po arrin një pikë që nuk mund të ketë kthim pas, në këtë rajon ashtu si dhe në VEQL *përjasja integruese* duhet të marrë përparësi ndaj *përjasjes stabilizuese*. Përveç arsyeve të paraqitura më lart, kjo duhet të bëhet edhe për faktin se ekziston një tension ndërmjet *kushtëzimit bilateral*, që karakterizon *përjasjen integruese*, dhe *rajonalizimit*, që karakterizon *përjasjen stabilizuese*. Tensioni shkaktohet nga fakti se *kushtëzimi* i BE-së, është i lidhur kryesisht me premtimin e integritit të plotë në BE (pra me “karrotën e artë”) dhe për pasojë mbeten pak mundësi për ta lidhur *stabilizimin* qoftë me sanksione që të kenë ndonjë rëndësi për vendet përkatëse ose me ndonjë motivim tjetër atraktiv. Prandaj, për t’i dhënë fund këtij tensioni është e nevojshme që për vendet e Ballkanit Perëndimor përjasja integruese të marrë përparësi ndaj përjasjes stabilizuese.

Politikat e BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor nga viti 1991 deri në vitin 1999

BE-ja gjatë viteve 1990 ndërmori disa iniciativa të cilat synonin stabilizimin e rajonit të Ballkanit. Nga viti 1991 deri në vitin 1995 veprimet e ndërmarra nga BE-ja mund të kualifikohen si politika e kontrollit dhe masa afatshkurtra për të parandaluar ose për të menaxhuar konfliktet në ish-Jugosllavi. Nga mesi i viteve 1990 deri në vitin 1999 ka pasur një ndryshim gradual në favor të një përjasje rajonale në politikën e BE-së ndaj rajonit të Ballkanit. Iniciativat e para rajonale filluan pas mbarimit të luftës në Bosnjë (1995). Këshilli Evropian nisi “Procesin Royaumont”, i cili synonte stabilizimin e Evropës Juglindore. Duke filluar nga viti 1996 BE-ja, nëpërmjet konkluzioneve të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme ose të komunikimeve të komisionit favorizoi politikën e “përafrimit rajonal” për vendet e Evropës Juglindore¹⁵.

¹⁵ Conclusions of the General Affairs Councils of 30 January and 26 February 1996; Report from the Commission to the Council of 14 February 1996 and Report from the

Objektivi kryesor i “përafrimit rajonal” të BE-së ishte promovimi i bashkëpunimit dhe i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit të Ballkanit.

Pavarësisht nga përpjekjet e BE-së për të stabilizuar rajonin e Ballkanit Perëndimor gjatë viteve 1990, të gjitha iniciativat e ndërmarra prej saj për të stabilizuar Evropën Juglindore patën një impakt modest për vendet e Ballkanit Perëndimor. Arsyet kryesore për këtë progres të kufizuar të politikave të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor janë dy:

Së pari, diferencat e mëdha që ekzistojnë ndërmjet tranzicionit të vendeve të Evropës Qendrore e Lindore dhe tranzicionit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Tranzicioni i vendeve të Ballkanit Perëndimor ishte shumë më i vështirë, për shkak të deficiteve strukturore të shkaktuara në rajon, jo vetëm nga e kaluara komuniste, por edhe nga deficitet strukturore historike.

Së dyti, të gjitha iniciativave që ndërmori BE-ja gjatë viteve 1991-1999 u mungonte substanca, duke qenë se ato nuk parashikonin ndonjë lidhje të drejtëpërdrejtë ndërmjet ndryshimeve politike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe asociimit të tyre me BE-në, pra, duke mos u ofruar vendeve të rajonit asnjë lloj premtimi për anëtarësim në BE.

Pika e kthesës për politikën e BE-së në rajon erdhi vetëm në vitin 1999. Në këtë vit politikën e BE-së ndaj rajonit të Ballkanit ndryshuan radikalisht dhe u bënë më koherente dhe proaktive. Në vitin 1999 BE-ja ndërmori një risi substanciale: Paktin e stabilitetit për Evropën Juglindore për të promovuar bashkëpunimin rajonal (*përqasja stabilizuese*) dhe procesin e stabilizim-asociimit për Evropën Juglindore (PSA), që u ofron vendeve të rajonit mundësinë për të nënshkruar marrëveshjen e stabilizim-asociimit me BE-në dhe statusin e “*kandidatit të mundshëm*” për anëtarësim në BE.

Sikurse e analizuam më lart, aktualisht politikën e BE-së në rajonin e Ballkanit anojnë më tepër nga *përqasja stabilizuese* (shumica e vendeve të rajonit kanë statusin e kandidatit të mundshëm), kurse *dimensioni integrues* ose *përqasja integruese* nuk ofrohet në mënyrë të mjaftueshme (vetëm 2 vende kanë statusin e vendit kandidat).

Ky kontribut argumenton se është e nevojshme që BE-ja, të ndryshojë përjasjen e saj nga stabilizim në integrim për vendet e Ballkanit Perëndimor, në linjë me politikat e zgjerimit ndaj VEQL.

PËRFUNDIME:

Ky kontribut analizoi dy përjasjet (*stabilizuese dhe integruese*) që BE-ja ka adoptuar për stabilizimin e vendeve ish-komuniste të Evropës Lindore pas rënies së Murit të Berlinit me një theks të veçantë në ndërveprimin dhe kohezionin ndërmjet tyre.

Përgjigjja Politike e BE-së për Ballkanin Perëndimor (PSA-ja), deri tani ka funksionuar mirë dhe ka arritur sukses në stabilizimin e rajonit. Megjithatë, ekziston një nevojë e ngutshme për të ndryshuar paradigmen e BE-së nga stabilizimi në integrimin duke u ofruar statusin e kandidatit të gjitha vendeve të rajonit. Në favor të ndryshimit të paradigmen së BE-së nga stabilizimi në integrimin për Ballkanin perëndimor mund paraqitën këto argumente:

- Përjasja integruese ka rezultuar më e suksesshme sesa përjasja stabilizuese qoftë për rritjen ekonomike dhe stabilitetin afatgjatë në Evropë,
- Në Ballkanin Perëndimor, ka pak të ngjarë që stabilizimi dhe integrimi të vazhdojnë në mënyrë kronologjike (dmth ku mbaron stabilizimi fillon integrimi), sepse të dy proceset janë të ndërlidhura ngushtë dhe duhet të adresohen së bashku,
- Duke pasur parasysh faktin se aktualisht siguria në Ballkan është e vetëqëndrueshme dhe se stabilizimi ka arritur një pikë të pakthyeshme, përjasjes integruese duhet t'i jepet përparësi ndaj përjasjes stabilizuese. Kjo hipotezë është e bazuar në faktin se ekziston tension ndërmjet kushtëzimit bilateral të integrimin dhe rajonalizimit të stabilizimit. Tensioni është shkaktuar nga fakti se kushtëzimi i BE-së është i lidhur me kriteret e integrimin duke lënë vetëm pak opsione që përjasja stabilizuese të bazohet në sanksione që kanë ndonjë kuptim ose në stimuj që janë tërheqës për vendet pjesëmarrëse. Prandaj, për t'i dhënë fund këtij tensioni, përjasja integruese duhet të marrë përparësi ndaj përjasjes stabilizuese.

Evropianizmi i Ballkanit është një ndërmarrje e përbashkët që kërkon angazhimin e BE-së dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Një përjasje e koordinuar e vendeve të rajonit, për të plotësuar kriteret që

kërkon integrimi në BE, së bashku me përpjekjet e BE-së për integrimin e rajonit në strukturat e saj, ofron shpresën më të mirë për arritjen e paqes së qëndrueshme, stabilitetit dhe prosperitetit në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

BIBLIOGRAFI:

1. Conclusions of the General Affairs Councils of 30 January and 26 February 1996; Report from the Commission to the Council of 14 February 1996 and Report from the Commission to the Council and the European Parliament of 2 October 1996, COM(96)476 final.
2. COM(1999) 235 final, Bull. EU 5-1999, point 1.3.73.
3. MISSIROLI, A., “The EU and its changing neighbourhoods: stabilization, integration and partnerships, in Partners and Neighbours: CFSP for a wider Europe”, Institute for Security Studies, EU, Chaillot paper No. 64, September, 2003.
4. Presidency report on the preventive of Violent conflict, Thessaloniki, 20 June 2003, in Antonio Missiroli *From Copenhagen to Brussels, European Defense Core Documents*, Chaillot Papers No.67, Institute for Security Studies, EU, Paris, December, 2003.
5. Roberto Toscano, (1999), “*Cinque regole per chi vuole aiutare i Balcani*”, Limes, 5.
6. Speech by Rt. Hon. Chris Patten, “*The Western Balkans: The road to Europe*”, to German Bundestag, “European Affairs Committee”, Berlin, 28 April, 2004, available at the website: http://europa.eu.int/comm/external_relations/news/patten/speech04_209.htm
7. World Bank’s regional strategy paper: “*The Road to Stability and Prosperity in South Eastern Europe*” on March 1, 2000, at the website: <http://www.seecon.org/region.documents/wb/>
8. WIM VAN MEURS and ALEXANDROS YANNIS, *The European Union and the Balkans: From Stabilisation Process to Southeastern Enlargement*, Centre for Applied Policy Research (C.A.P), Hellenic Foundation for European & Foreign Policy (ELIAMEP), September 2002.
9. ZAHARIADIS, Y., “*The Effects of the Albania-EU Stabilization and Association Agreement: Economic Impact and Social Implications*”, Overseas

Development Institute (ODI), Economic and Statistics Analysis Unit, ESAU Working Paper 17, London, February, 2007, available at the website: <http://www.odi.org.uk/resources/download/1864.pdf>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010*

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010*

Impaktet e zhvillimit të sektorit të artizantit mbi turizmin

Arjeta Troshani , Marsel Fregjaj

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Administrim-Biznesit,
Agjencia Turistike „Samsel“*

Artisanship sector development and its impact on tourism

ABSTRACT

This study has been focused on the argument that development of artisanship sector has great economic values and positive impacts especially in tourism industry that is developing in Albania. Having historical traditions in artisanship sector the article is an evidence of main problems that hinder development of this sector and analyses all development opportunities. In this article are analyzed impacts of artisanship trade on businesses revenues, tourist expenditures etc.

Key words: artisanship, economic impact, revenues, costs, tourism

1. Kontributi ekonomik i sektorit të artizanatit në Shkodër

1.1. Artizanati

Produktet artizanale janë objekte të prodhuara me dorë duke përdorur një shumëllojshmëri materialeesh, përfshirë baltën, fibrën, qelqin, metalin, lëkurën, gurin dhe drurin. Teknologjia e thjeshtë mund të shtojë punën e duarve; spikasin estetika indigjene për ngjyrat, si dhe motivi e projektimi. Kudo në botë, prodhimi artizanal është më shumë i përqendruar në fshat dhe pikërisht në biznese familjare. Fshatra të tërë ia kushtojnë energjitë e tyre një kategorie të caktuar produkti, si: qeramika, gdhendja e drurit apo endja e qilimit. Kategoritë e produktit artizanal përfshijnë qeramikë, tekstile, stoli, punë metalike, gota me njolla, gdhendje, shportari, mobilje dhe objekte shtëpie. Produktet e artizanatit mund të shërbejnë për qëllime utilitare, rituale ose dekorative. Në shumë shoqëri, zejtarët kanë të bëjnë më shumë me trashëgimitë, me etninë lokale, rajonale apo kombëtare. Njohja e zejtarëve me trashëgiminë kulturore ofron një platformë për produktet si objekte për turizmin, duke çuar në një mori etiketash, arti etnik, suveniresh dhe arti turistik. Prodhimi i artizanatit është i lidhur me marketingun global ose globalizimin, zhvillimin, gjininë, etninë, punësimin dhe traditën.

Studimi i artizanatit dhe lidhja e tij me turizmin përbëhet nga një sërë disiplinash që përfshijnë antropologjinë, artin dhe dizajnin, biznesin, studimet kulturore, studimet mjedisore, zhvillimin ndërkombëtar, marketingun, studimet e muzeut, sociologjinë, tekstilet dhe veshjet, si dhe studimet mbi veshjet e grave. Një vëllim i redaktuar nga Nelson Graburn u konsiderua si një nga koleksionet e para të studimeve shkencore që studionte zejtarinë dhe lidhjen e saj me turizmin. Që nga viti 1970, akademikët i kanë adresuar çështjet artizanale, që fokusohen në pjesëmarrës të ndryshëm, në sistemin e marketingut të prodhuesve, ndërmjetësve dhe konsumatorëve turistikë. U eksploruan aplikimet teorike, si dhe ato të zbatuara. Temat në lidhje me origjinalitetin, etninë, gjininë, traditën, tipologjitë artizanale dhe lidhjet mes konsumit artizanal dhe stileve të turizmit kanë shkaktuar debat duke nxjerrë në pah kompleksitetin që rrethon prodhimin artizanal në mbarë botën.

Tipologjitë artizanale përshkruajnë fazat, se si produktet që janë prodhuar dhe përdorur për një kohë të gjatë për konsum lokal, transformohen në produkte të destinuara për tregjet e jashtme, duke përfshirë edhe turistët. Kur produktet artizanale transformohen për këtë të

fundit, ndryshimi është më shumë i dukshëm tek lëndët e para, mekanizimi, forma, stolisja, ngjyrimi, funksioni, sasia dhe cilësia e prodhimit, si dhe përmbajtja simbolike. Artizanët lokalë shoqërojnë ruajtjen e traditave të tyre artizanale me ruajtjen e proceseve dhe teknologjive të produkteve të përdorura për një kohë të gjatë, pavarësisht nga aplikimi i produkteve të reja të lidhura me turizmin. Në të kundërt, të huajt, të cilët nuk i njohin modelet e prodhimit vendas, shprehen me humbjen e traditave artizanale, kur vënë re ndonjë ndryshim në prodhime për qëllime turistike.

Ndërthurja e prodhimit artizanal me turizmin është një kryqëzim me rëndësi jetike. Duke rritur nivelet e aktivitetit turistik dhe të shpenzimeve në të gjithë botën, prodhimi artizanal siguron mjet të ardhurash për shumë popuj, duke përfshirë një numër të madh grash dhe grupesh etnike minoritare. Prodhimi artizanal shpesh vlerësohet si një mjet për krijimin e të ardhurave, që i bashkangjitet prodhimit bujqësor, përshtatet me stilin e jetës rurale dhe bujqësore, promovohet nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare për zhvillimin, shkëmbimin e huaj dhe ruajtjen e traditave vendase, si dhe ofron objekte të punuara me dorë, që kërkohen nga konsumatorët e vendeve të industrializuara. Për shumë zejtarë të botës, tregjet lokale janë zëvendësuar nga produktet e prodhuara me anë të makinerive. Me anë të zhvillimit të produkteve artizanale, që tërheqin turistët, artizanët mund të ruajnë zanatin e tyre për brezin e ardhshëm.

Një e treta e shpenzimeve të turistëve shkon për blerje. Artizanati përbën një kategori të madhe të blerjeve të suvenireve. Originaliteti i artizanatit shihet në lëndën e parë, në proceset e prodhimit, në mjeshhtërinë e dukshme, në cilësitë estetike, në përdorimin indigjen, dhe në integritetin historik e kulturor. Nëpërmjet blerjes dhe përdorimit të zejtarisë, turistët përjetojnë stilet e jetesës në vend, zgjerojnë njohuritë e tyre, diferencohen nga të tjerët ose integrohen me ta, shprehin kreativitet dhe përjetojnë përvojën e kënaqësisë estetike. Shitësit e turizmit, në përpjekje për të tërhequr klientët, negociojnë rreth tradicionalitetit të punimeve artizanale duke përzier dhe paraqitur tiparet e produktit në tregun e turizmit.

1.2. Punime artizanale që prodhohen në Shkodër, viti 2010

Gjatë periudhës së pas viteve '90, pas një tkurrje të frikshme e të gjatë aq sa vetë periudha e tranzicionit, vërehen shifra më premtuese të sektorit të

artizanatit. Megjithatë pasojat e zhvillimeve sociale, politike, dhe ekonomike shfaqen në artizanat me mungesë të theksuar të gamës së produkteve dhe njëkohësisht me numër më të reduktuar të punonjësve të angazhuar në prodhimin e produkteve artizanale. Më poshtë po listohen të dhënat për periudhën në fjalë:

■ PUNIME TEKSTILE: TË PUNËSUAR m ZONA		
■ Qylyma, torba, mbulesa tavoline Zogaj+Juban	200	F.
■ Sixhade Shkodër	14	
■ Punime qëndistarie Shkodër	192	
■ Punime veshje kombëtare Sh.+fshatrat përreth	12	
■ PUNIMET E KASHTËS Shkodër	50	
■ PUNIME BAKRI DHE ARGJENDI Shkodër	50	
■ PUNIME ARTISTIKE DRURI Shkodër	30	
■ PUNIME MASKA Shkodër	35	
■ Totali	400	

Tabela 1.1. Të punësuarit në sektorin e artizanatit.

Burimi: Kërkime të kryera në terren nga A.Troshani, 2010

1.3.Problemet kryesore që shqetësojnë drejtuesit e bizneseve të artizanatit Nga informacionet e marra në kuadër të këtij studimi si dhe duke iu referuar studimit të mëparshëm monografik të A.Troshanit (2006, Nxitja e punësimit të grave nëpërmjet një analize ekonomike në rajonin e Shkodrës“), u evidentuan problemet e mëposhtme të bizneseve të

artizanatit:

Të përgjithshme

- Mungesa e kontratave që sigurojnë vazhdimësinë e biznesit
- Sigurimi i organizuar i tregjeve
- Trainimi i elementëve të rinj
- Mungesa e organizimit të përqendruar të punës –Zogaj
- Mbrojtja e prodhimeve nga spekulimet
- Mungesa e lidhjeve direkte me tregjet e huaja për të marrë çmimin real të shitjes

Në nivelin e politikave

- Nivel i ulët angazhimi nga qeveria qendrore për të mbështetur sektorin e artizanatit
- Mungesa e një sistemi rregullator dhe ligjor për sektorin e artizanatit
- Mungesa e analizave kombëtare dhe e strategjisë në opsionet politike për aktivitetet artizanale, si dhe kërkimet kritike, që kanë për qëllim vlerësimin dhe zhvillimin e sektorit artizanal
- Mbështetje e pamjaftueshme financiare për sektorin e artizanatit
- Mungesa e përpjekjeve nga qeveria për një turizëm të zhvilluar, trashëgimi kulturore dhe historike me anë të promovimit të sektorit artizanal
- Mbështetje e papërshtatshme nga autoritetet lokale dhe rajonale.

Në nivelin institucional

- Mungesa e koordinimit dhe komunikimit në nivel të ministrisë (sidomos mes Ministrisë së turizmit, Ministrisë së ekonomisë dhe Ministrisë së punës) për mbështetjen e sektorit artizanal.
- Mungesa e angazhimit të dhomave kombëtare dhe lokale të tregtisë dhe të industrisë për të mbështetur sektorin e zejtarisë.
- Aftësi të pamjaftueshme udhëheqjeje dhe manaxhimit të shoqatave vendore të artizanatit.
- Angazhimi i dobët i agjencive për zhvillimin e biznesit për sektorin e artizanatit.
- Mbështetje e ulët financiare nga bankat vendore në rajon.

Në nivelin e ndërmarrjes

- Kushtet e papërshtatshme të punës së artizanëve.
- Fuqia e ulët blerëse e konsumatorëve shqiptarë.

- Aftësi të dobëta biznesi dhe kapacitet i pamjaftueshëm manaxhimi i artizanëve.
- Informim i dobët në lidhje me kërkesat e tregut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Cilësi, projektim dhe ambalazhim i dobët i produktit.
- Mjete dhe fushata promovuese të pamjaftueshme
- Aftësi të dobëta marketingu, veçanërisht aftësitë e ekspozimit të produktit.
- Mostra të dobëta, jo të zgjedhura
- Kanale të papërshtatshme shpërndarjeje
- Konkurrenca e lartë nga prodhimi industrial
- Mungesa e transparencës së çmimeve
- Mungesa e kontakteve me kanalet shpërndarëse të tregut të Evropës Perëndimore.

2. Pasurimi i ofertës turistike nëpërmjet artizanit


Për vendet në zhvillim siç është rasti i vendit tonë me një industri turistike në fillimin e rritjes së saj, diversifikimi i ofertës turistike dhe kombinimi i turizmit me sektorët e tjerë siç është artizanati merr rëndësi tepër të madhe dhe të shpie drejt maksimizimit të të ardhurave për bizneset e kësaj industrie.

2.2. Zhvillim ekonomik si rezultat i prodhimeve “Made in Abania”

Nga zhvillimi i artizanatit dhe produkteve artizanale krijohet përfitim ekonomik për bizneset e përfshira në këtë biznes. Këto produkte kanë potencialet e duhura dhe mund të prezantohen në tregun ndërkombëtar duke siguruar të ardhura direkte nga eksporti.

Me interes të madh do të ishte gjithashtu tërheqja e konsumatorëve vendas.

Fig 1.1 Potencialet e përgjithshme të artizanatit në Shkodër



2.3- Ruajtje dhe vazhdimësi e trashëgimisë kulturore

Duke u zhvilluar bizneset e artizanatit dhe produktet e tyre, ata do të ndjehen më të inkurajuar që t’ia rekomandojnë zanatin brezave të rinj, duke i nxitur ata që të bëhen pjesë e këtij biznesi për të siguruar të ardhmen e tyre. Kjo do të çojë në ruajtjen e vlerave dhe të trashëgimisë kulturore.

2.4. Zhvillimi i artizanatit me impakt në punësim

Deri më tani shumica e artizanëve në Shkodër kanë punuar në informalitet në punishtet e tyre të vendosura nëpër shtëpi apo reparte a kapanone. Siç shihet nga tabela 1.1. aktualisht rezultojnë rreth 400 persona të punësuar në sektorin e artizanatit një shifër e evidentuar nga kërkimet në terren, shifër për të cilën ekzaktësia është e diskutueshme. Një fuqizim ekonomik i bizneseve të artizanatit duke u kthyer drejt formalitetit do të reflektohej në një kërkesë për fuqi punëtore, e cila faktikisht do të zgjonte interesin në tregun e punës.

2.5 Artizanati si atraksion për turistët zhvillimi i turizmit

(vendas/huaj)

Turistët janë në kërkim të elementëve origjinalë, çka do të thotë, se janë ato elementë që e dallojnë një vend nga një tjetër. Në këtë kontekst artizanati na shfaq rëndësinë e madhe që ai ka duke përmbushur pritshmëritë e turistëve dhe duke iu dhuruar atyre elementë e eksperiencë të larmishme sipas kulturave e nënkulturave të ndryshme.

2.6. Rregullimi i një sektori të ekonomisë në “zonën gri”

Duhet të mbajmë parasysh që bizneset artizanale në më të shumtën e rasteve na shfaqen në formën e bizneseve të vogla familjare, të vendosura kryesisht në zona rurale ose përreth qendrave apo qyteteve më të mëdha (në periferi). Pra zhvillimi i përgjithshëm i këtij sektori do të thotë “*frymëmarrje ekonomike*” për zhvillimin e këtyre zonave ku praktikisht biznesi apo aktivitetet private shfaqen jo me ngjyrat e tyre të plota.

Për të krijuar një panoramë të qartë të situatës aktuale dhe parashikimeve për të ardhmen do të na vijë në ndihmë kërkimi primar, i cili fokusohet pikërisht në një pjesë të madhe të çështjeve të sipërpërmendura.

2.7. Artizanati dhe turizmi

Turizmi është industria numër 1 e shekullit të 21-të dhe artizanati është një nga aktivitetet me rritjen më të shpejtë. Së bashku ato formojnë një kombinim të fuqishëm dhe logjik. Artizanati është një pjesë e integruar e eksperiencës totale që një turist merr nga një vend. Një suvenir me cilësi i marrë me vete në shtëpi nga pushuesi pas një eksperiencë pushimesh të këndshme, ka një pushtet të vazhdueshëm ndjellës kujtimesh të mrekullueshme, gjithashtu ngjall interesin e të tjerëve që ta shohin atë produkt duke inkurajuar më shumë njerëz që ta vizitojnë atë destinacion. Por lidhja mes turizmit dhe artizanatit ende nuk është eksploruar, kuptuar, dhe zhvilluar plotësisht. Kjo ka çuar në një humbje të ardhurash të mundshme, dhe humbje të mundësive të krijimit të vendeve të reja të punës. Zejet tradicionale, qofshin për qëllime utilitare apo artistike, paraqesin një formë shumë të çmuar të shprehjes së kulturës, një “*kapital vetëbesimi*” që është i rëndësishëm veçanërisht për vendet në zhvillim. Ritheksimi i vlerës së punëve me dorë është i rëndësishëm edhe për shumë vende të zhvilluara, ku cilësia e jetës shpesh kërcënohet nga standardizimi i tepruar industrial. Zejtarët nuk ruajnë thjesht trashëgiminë kulturore, por gjithashtu pasurojnë dhe e përshtasin këtë trashëgimi për

nevojat bashkëkohore të shoqërive.

Turizmi, që vë në lidhje individët dhe bashkësitë njerëzore, dhe përmes tyre kulturat dhe qytetërimet, ka një rol të rëndësishëm në lehtësimin e dialogut mes kulturave. Turizmi gjithashtu ka aftësinë t'i ndihmojë banorët e botës të jetojnë më mirë së bashku dhe prandaj të japë ndihmesë në ndërtimin e paqes së mendjes së burrave dhe grave, nëse perifrazojmë Kushtetutën e UNESCO-s.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, për ta sjellë afër të gjithëve, i bën më shumë të njohura kulturat dhe qytetërimet, duke përmirësuar kushtet e jetesës së përditshme dhe duke zvogëluar varfërinë, është ajo çka i jep kuptim qëndrueshmërisë së zhvillimit të turizmit.

Impaktet shoqërore dhe kulturore të turizmit në vendet pritëse u shqyrtuan kështu nga bashkësia ndërkombëtare në seminarin e Bankës Botërore-UNESCO-s për politikëbërësit të mbajtur në Uashington në dhjetor 1976. Prej atëherë, industria e turizmit është zhvilluar me ritme fantastike ndërsa rëndësi gjithnjë e më e madhe i është dhënë përmasës kulturore të zhvillimit. Krah për krah me zhvendosjen nga “turizmi masiv” në turizëm kulturor apo ekoturizëm, kemi vërejtur rritjen e nxitjes për të promovuar trashëgiminë kulturore jofizike dhe mbrojtjen e larmisë kulturore siç ilustron miratimi i kohëve të fundit të dy Konventave ndërkombëtare, Konventa I është për mbrojtjen e trashëgimisë jo të prekshme e miratuar nga Konferenca e përgjithshme e UNESCO-s e vitit 2003 dhe e dyta është “Konventa për promovimin e larmisë së shprehjeve kulturore” e vitit 2005.

3. Gjetjet kërkimore

Kërkimi primar është realizuar në disa mënyra, nga observimi, nga intervistimi me anë të pyetësorit, nga intervistat personale me njerëz të interesuar nga të gjitha fushat dhe përkatësitë kombëtare. Janë shpërndarë pyetësorë tek 10 subjekte të fushës së artizanatit, si dhe janë mbledhur informacione nga rreth 12 ekspertë të fushave të ndryshme që kanë lidhje me artizanatin.

3.1. Hipoteza

“Zhvillimi i sektorit të artizanatit do të ketë një impakt pozitiv mbi zhvillimin e turizmit dhe pasurimin e ofertës turistike në rajonin e Shkodrës”.


Burimet e të dhënave

Në shërbim të këtij studimi do të shfrytëzohen të dhënat parësore


dhe ato **dytësore**, ku të dhënat parësore do të mblidhen me anë të anketimit nëpërmjet pyetësorëve drejtuar artizanëve, ndërsa ato dytësore nga burime të tjera si interneti, raste studimi, revista, e literaturë të ndryshme nga biblioteka të ndryshme etj. Është vlerësuar të përdoret metoda induktive e kërkimit.

3.2.Rezultatet nga pyetësi i artizanëve


Grafiku 1.1- Të ardhurat e artizanatit



Pra siç shihet në grafikun 1.1 një pjesë e madhe e artizanëve të vendosur në tregun e artizanatit i sigurojnë të ardhurat kryesore nga shitjet e produkteve artizanale. Ky është një tregues i lidhjes së tyre me këtë aktivitet. Artizanati është një aktivitet primar për 70% të anketuarve.




Grafiku 1.2- Shitjet të realizuara nga artizanët




Grafiku 1.2 na tregon se % më e madhe e shitjeve realizohet direkt tek klienti në një dyqan tjetër përveç tregut (29%). Kjo e dhënë na çon nëpër mend se tregu i artizanatit akoma nuk e ka konsoliduar pozitën e tij në treg dhe se janë artizanët (në mënyrë individuale) ato që me punën e kontaktet e tyre krijojnë e gjejnë tregjet.

Grafiku 1.3- Shpenzimet e turistëve në produktet artizanale, (Euro)



Siç shihet edhe nga grafiku 1.3 artizanët shprehen se përqindja më e madhe e turistëve janë të gatshëm të shpenzojnë deri në 25 euro për person gjatë një turi ditor në qytet. Afërsisht 90% e artizanëve e deklarojnë këtë. Ndërsa 7% besojnë se ata janë të gatshëm të shpenzojnë edhe më shumë, nga 25 euro deri në 40 euro. Një përqindje fare e vogël shprehen se turistët mund të jenë të gatshëm të shpenzojnë më shumë se 40 euro.


Grafiku 1.4 Tendencë e shitjeve tek pazari i artizanatit



Shihet nga grafiku 1.4 se 56% e artizanëve shprehen për një lloj stabiliteti gjatë periudhës së aktivitetit të tyre në këtë pazar. Ndërsa një numër i konsiderueshëm shprehen se ka një tendencë të shitjeve në rënie, kjo e dhënë që na jep grafiku dokumenton gjendjen jo pozitive në këtë treg,

pasi 0% e artizanëve shprehen për rritje të shitjeve në këtë treg. Mendoj se ky rezultat ka të bëjë me ndikimet e krizës globale ekonomike, për arsye se emigrantët janë një treg me rëndësi për artizanët. Komentet kryesore ishin: s'ka reklamim, është larg nga qyteti, menaxhim jo i mirë, nuk ndjehet mbështetje nga ana e bashkisë.

Grafiku 1.5. Faktorët që ndikojnë në rritjen e shitjeve të artizanëve



Artizanët kanë më shumë nevojë për aktivitete, të cilat më pas do çojnë në rritjen e nivelit të shitjeve, pasi siç pamë dhe më lart, nuk është se kishte rritje të shitjeve në këtë treg.

Grafiku tregon një diferencim të madh të % së rritjes së shitjeve sipas impaktit që sjellin aktivitetet e listuara. Aktiviteti me impaktin më të madh në rritjen e shitjeve rezulton të jetë plotësimi i dyqaneve të tjera të tregut të artizanatit duke u përfaqësuar në një numër më të madh të pikave të shitjes me pakicë të produkteve artizanale. Pastaj në vend të dytë për nga rëndësia renditet lidhja me agjencitë turistike me 27% ndikim në rritjen e shitjeve të tyre.

Rezultatet kryesore të rezultuar në lidhje me problemet më imediate që

artizanët kanë:

- mosfunksionimi i tregut
- të reklamojmë sa më shumë
- mbështetje më serioze e artizanatit
- vendosja e një zyre informacioni te tregu i artizanatit
- thithja e klientelës
- njohja e konsumatorëve vendas/huaj me tregun (pikën e shitjes si vendodhje, e më shumë)
- s'ka shitje

Rezultatet kryesore të rezultuara në lidhje me pikat e dobëta të produktit artizanal:

- ska njerëz që prodhojnë modele të reja
- disenjoja
- kosto e lartë prodhimi
- marketingu, ambalazhimi

Rezultatet kryesore të rezultuara në lidhje me pikat e forta të produktit artizanal:

- cilësia
- origjinaliteti
- modelet e reja
- dizenjo
- janë shprehje e traditës, ruajtja e traditës
- përkushtimi ndaj sfidave të punës sjell produkte të pëlqyera
- ndërthurja e traditës me modernen
- lënda e parë cilësore (pambuk)
- garanci për produktin në ruajtjen e ngjyrave
- garanci në përgjithësi për mallin

4. Konkluzione dhe rekomandime

4.1.Konkluzione

1. **Aftësi të vogla për zhvillim të produktit.** Shumë nga bizneset e vogla në sektor fillohen nga ish-punonjës të kooperativave artistike shtetërore që e vazhdojnë profesionin. Shumica e tyre prodhojnë në punëtori të vogla në shtëpi. Në sipërmarrjet shtetërore zhvillimi i

prodhimit bëhej nga dizajnerë në një departament të veçantë të kooperativave zejtare, quajtur zyra teknike. Punëtori mesatar nuk kishte pse mendonte për dizajnin dhe zhvillimin e produktit. Sot artizanët janë të zënë me prodhimin, marketimin dhe problemet e shpërndarjes, prandaj nuk kanë mjaft aftësi të investojnë në zhvillimin e produktit. Tregu vendas (shkodran) është në një farë mënyre pa pretendime sa i përket dizajnit. Për shkak të fuqisë së ulët blerëse, çmimi është kriteri kryesor i blerjes. Disa artizanë mbetën në dizajnin e mëparshëm të prodhimeve që vinte nga kohërat e sipërmarrjeve të shtetit.

2. **Nevojiten lidhje me jashtë për të krijuar prodhime të reja dhe për të hapur tregje të reja.** Tregu turistik në zhvillim është treg interesant shitjesh për artizanët. Ndërsa zhvillohen pikat turistike dhe numri i vizitorëve rritet, administratat e pikave dhe bashkitë në fakt duhet të jenë të interesuar të kenë aksesore shtesë që tërheqin vizitorët. Nëse prodhimet zejtare përmbushin një farë standardi cilësie dhe përfaqësojnë trashëgiminë kulturore të rajonit, me të vërtetë që një pikë artizanati do t'i tërhiqte turistët.
3. **Moshimi i artizanëve dhe mungesa e programeve të trajnimit për brezin e ri.** Shumë mjeshtër po plaken dhe vetëm pak prej tyre po ia kalojnë mjeshtërinë e tyre brezit të ri. Niveli i ulët i të ardhurave e bën sektorin jotërheqës për të rinjtë
4. Në turizëm, duhet të kuptojmë rëndësinë e kulturës si një burim që, me menaxhim të kujdesshëm dhe të gjithanshëm, mund të përdoret në strategjitë e zbutjes së varfërisë dhe largimit të paragjykimeve, si dhe të formojë bazën e dialogut të rëndësishëm ndërkulturor. Turistët kanë një interes të lartë në lidhje me artizanatin si element kulturor.
5. Që ta arrijnë zejet potencialin e tyre të plotë sa i përket turizmit, është e domosdoshme një qasje e organizuar, koherente dhe komplementare. Ndërsa institucionet, organizatat dhe agjencitë e ndryshme publike dhe private munden dhe duhen të luajnë role individuale në procesin e zhvillimit, është e rëndësishme të lidhen veprimtaritë e tyre në një program gjithëpërfshirës të përshtatur ndaj nevojave në ndryshim.

4.2.Rekomandime

1. Ka një nevojë urgjente për të zhvilluar dhe ilustruar lidhjet e tërthorta mes këtyre dy sektorëve (artizanatit dhe turizmit) në shprehje sa

sasiore ashtu edhe cilësore. Kjo do të çonte në diversifikimin e ofertës turistike për rajonin e Shkodërs dhe maksimizimin e të ardhurave për bizneset turistike.

2. Zejtarëve ende iu mungon mbështetja e merituar qoftë për përmirësimin e aftësive të tyre ashtu edhe për përshtatjen dhe mbrojtjen e punëve të tyre. Kjo është në masë të madhe, për shkak të mungesës së të dhënave mbi pasojat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të sektorit të zejtarisë mbi ekonominë kombëtare, domethënë përmes shitjeve të drejtpërdrejta tek turistët. Së dyti, ka mungesë bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes ministrive/departamenteve në ngarkim të zejtarisë dhe turizmit.
3. Zhvillimi turistik kërkon “*prodhime*” novatore, të zhvilluara në mënyrë të tillë që nuk e kompromentojnë integritetin kulturor të bashkësive vendase dhe që maksimalizojnë përfitimet shoqërore, ekonomike dhe mjedisore. Përbashkimi i krijueshmërisë kulturore të bashkësive është një strategji e rëndësishme në nxitjen e pjesëmarrjes sa më të madhe në procesin e zhvillimit të turizmit dhe mund të ndihmojë në shpërndarjen e përfitimeve nga turizmi.
4. Diskutimi mbi zejet dhe turizmin nuk duhet kufizuar në këto objekte që turistët vetë i blejnë dhe i marrin me vete. Mund të ketë edhe raste për prodhimin e artizanatit për përdorim, si nga popullsitë vendase ashtu edhe në hotele, restorante dhe hapësirat e rekreacionit që vizitohen nga turistët.
5. Duke marrë si të mirëqenë që rehatia turistike ruhet, këto zeje përbëjnë orendi të pazakonta dekorative për dhomat turistike. Bashkë me prodhimin bazuar në zejtari që i përshtatet stileve dhe traditave vendore, ato mund të ndihmojnë në krijimin e një atmosfere që do t’i edukojë turistët dhe në vlerësimin e kulturës vendore.
6. Ngaqë sot në treg ka nga të gjitha llojet e artizanatit si pasojë e drejtpërdrejtë e globalizimit, turistët po kërkojnë sende origjinale autentike dhe vendin e tyre të origjinës. Prandaj është nevoja për një dallim më të madh në blerjet turistike mes dhuratave pa autenticitet për t’u shitur (bluza, filxhanë kafeje, varëse çelësash) dhe suvenireve që të ndihmojnë ta mbash mend një udhëtim herë pas here. Turistët po kërkojnë të shohin, të shijojnë, të provojnë dhe të çojnë diçka në shtëpi. Ata duan “*suvenire*” që pasqyrojnë thelbin e vendit që kanë vizituar. Zejtarët janë në mënyrë unike të përshtatshëm për ta dhënë

atë thelb nëse mbështeten nga një politikë kombëtare e zhvillimit të zejtarisë.

Bibliografia:

1. A. Troshani, Merita Kazazi, Ridvan Sokoli, Sabah Djaloshi, “Nxitja e punësimit të grave nëpërmjet një analize ekonomike në rajonin e Shkodrës“, Monografi, Shtëpia botuese “Camaj-Pipaj”, Nëntor, 2006, ISBN: 999275683-7, 240 f.
2. A. Troshani “Rëndësia ekonomike e punimeve artizanale”, Artikull botuar në Buletinin e U.SH. Shkodër, Janar, 2004.
3. Xhyher Cani “Ornamentika në punime të argjendarëve shkodranë”, Revista Etnografia Shqiptare, Kultura Popullore, nr.2, f. 130-142.
4. Hamdi Bushati, Shkodra dhe motet, kreu IV, Pazari Vjetër, f. 127-249.
5. CHF International Training Programs Support, Romanian Traditions and Develop Fair Trade, CHF International hired Emilia Ionescu.
6. Pashallëku i Shkodrës në vitet 1812-1822. Pjesëmarrja e Vezirit Bushatlli në shembjen e pashallëkut të Janinës, kreu V, Tregu shkodran dhe roli i tij kundër bllokadës kontinentale, f. 102-111.
7. www.artizanati.com
8. (Raporti i Krizës së Ballkanit,) <http://www.hl=en&q=artizanati&meta=>
9. <http://tanmarket.com/collectionist/gallery/marubi/marubistudio.html>
10. <http://www.shkoder.net/en/xhubleta.htm>
11. <http://news.webshots.com/album/20265627ëHnaBsngMI>
12. <http://www.zadrima.net/Home.html>
13. http://www.sequa.de/index.php?area=1&p=static&page=projekte_agy...

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010*

Studim për gjendjen dhe shpërndarjen e forcës së punës në rajonin e Shkodrës

Sadije Bushati, Vilfrida Luani,

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Matematikës

ABSTRACT

**Study on the situation and distribution of the labor force in Shkodra
Region**

This paper is aimed to study and predict the labor force for the region of Shkodra, which will be accomplished by presenting information on employment, job vacancies and skills required for their completion. The main purpose of this study is to describe the condition of labor, employment in the Shkodra, to study the demographic and social factors that affect participation in the workforce population, to describe its trends and changes occurring under the influence of economic and political factors and to draw conclusions and make an assessment of labor market needs to make recommendations on the formulation of new

policies and programs that promote the creation of new jobs. The methodology used in this study is based on the method of the survey, which was accomplished through distribution of questionnaires to 120 enterprises of the city of Shkodra, which constitute the sample selected. Also, registration forms used to unemployed job seekers in the Regional Employment Office, Shkoder. The period of study is the year 2010 and short – term marke forecast will include 2011.

Hyrje

Shkodra, qyteti më i madh në Shqipërinë e veriut, me një pozitë të privilegjuar gjeografike dhe strategjike, me pasuritë dhe bukuritë që i ka dhuruar natyra, është dhe vend i kryqëzimit të rrugëve tregtare ndërmjet Ballkanit dhe shteteve të perëndimit, të cilat e kanë bërë qytetin gjithmonë tërheqës dhe interesant.

Popullsia e bashkisë Shkodër është 112539 banorë, prej të cilëve 110985 banorë të qytetit të Shkodrës, 1184 banorë të lagjes Shirokë dhe 370 banorë të lagjes Zogaj. Qyteti i Shkodrës ka 35681 familje, prej të cilave 35214 në qytetin e Shkodrës, 362 në lagjen Shirokë dhe 105 në lagjen Zogaj. Rrethi i Shkodrës në raport me numrin total të ndërmarrjeve aktive që zhvillojnë aktivitet ekonomik në shkallë vendi zë 3% të tij.

Rritja natyrore e popullsisë në Shkodër ka vlera pozitive, që do të thotë se numri i lindjeve është më madh se i vdekjeve. Në raport me numrin e popullsisë nga njëri vit në tjetrin, koeficienti i përgjithshëm i vdekshmërisë ka ruajtur uniformitet.

Nga viti 1945 deri në fillim të viteve 1990, Shqipëria kishte ekonomi socialiste. Prona private ishte e ndaluar plotësisht dhe i gjithë aktiviteti ekonomik ishte i kontrolluar nga shteti.

Mbas ndryshimeve të mëdha demokratike, u shpërbënë pothuajse të gjitha ndërmarrjet shtetërore dhe shumë njerëz humbën vendet e punës. Qeveritë shqiptare njëra mbas tjetrës ndërmorën një sërë reformash dhe u aprovuan ligje për pronën private, aktivitetin privat, konkurrencën, falimentimin, investimet e huaja, privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe shumë elementë të një ekonomie tregu.

Aktualisht rreth 87% e ndërmarrjeve shtetërore janë privatizuar.

Pjesa më e madhe e subjekteve ekonomike të privatizuara nuk e ruajtën destinacionin e tyre. Arsyeja ishte se teknologjitë e tyre ishin vjetëruar dhe kostoja e produktit dilte e madhe, aq sa kalonte vlerën në treg.

Në vitet 1994-1995 është numri më i madh në vite i subjekteve ekonomike. Ky rezultat është rrjedhojë e reformave ekonomike të ndërmarra dhe platformës së privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore të klasifikuara biznese të vogla dhe të mesme.

Në periudhën 1997-1999 kemi një rënie drastike të numrit të tyre si rezultat i bllokimit të kufirit me ish Jugosllavinë. Gjatë viteve 2000 e në vazhdim kemi rritje të vazhdueshme të numrit të bizneseve të regjistruara dhe kjo si rrjedhojë e përmirësimit të klimës së biznesit si dhe masat e marra nga qeveria kundër tregut informal.

Burimi: bashkia e Shkodrës, zyra e zhvillimit ekonomik

Në këtë punim është synuar të studiohet dhe të parashikohet forca e punës për rajonin e Shkodrës, i cili do të realizohet duke paraqitur informacion për punësimin, vendet e lira të punës dhe aftësitë e kërkuara për plotësimin e tyre. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të përshkruajë gjendjen e fuqisë punëtore, punësimin në Shkodër, të studiojë faktorët demografikë e socialë, që ndikojnë në pjesëmarrjen e popullsisë në fuqinë punëtore, të përshkruajë tendencat dhe ndryshimet e saj të ndodhura nën ndikimin e faktorëve ekonomikë e politikë, si dhe të nxjerrë konkluzione dhe të bëjë një vlerësim të nevojave të tregut të punës për të bërë rekomandime në formulimin e politikave të reja dhe programeve që nxisin krijimin e vendeve të reja të punës.

Metodologjia e përdorur e këtij studimi është bazuar në metodën e anketimit, e cila u realizua me anën e shpërndarjes së pyetësorëve në 120 ndërmarrje të qytetit të Shkodrës, të cilat përbëjnë kampionin e zgjedhur. Gjithashtu, janë përdorur formularët e regjistrimit të punëkërkuësve të papunë në zyrën rajonale të punësimit, Shkodër. Në kohën e studimit rezultoi 14078 punëkërkuës të papunë të regjistruar.

Periudha e studimit është viti 2010 dhe parashikimi afatshkurtër i tregut do të përfshijë vitin 2011.

Meqë nuk vrojtohen të gjitha ndërmarrjet, duhet që kampioni të jetë përfaqësues i “*popullimit në studim*”. Për këtë synohet të ndërtohet një kampion studimi që të përfaqësojë të gjithë ekonominë, të përfshijë të gjithë sektorët dhe të jetë mjaftueshëm i gjerë për të lëvizur analiza statistikore të shëndosha me një nivel minimal pasaktësie.

Për kampionin e ndërmarrjeve, kemi përdorur procedurën e “*Kampionimit të rastësishëm të shtresëzuar*” për të pasur përfaqësim proporcional të nëngrupeve të ndërmarrjeve (sipas madhësisë, llojit të ndërmarrjeve, sektorit ekonomik ku ato zhvillojnë aktivitetin e tyre etj.).

Për të ndërtuar kampionin jemi bazuar në fillim tek regjistri i biznesit i zyrës rajonale të punësimit, që detajon ndërmarrjet sipas llojit, madhësisë, fuqisë punëtore, sektorit ekonomik dhe vendodhjes. Rregjistri i biznesit shënon gjithë të dhënat e kompanisë si sektori i aktivitetit, numri i punonjësve (në kohën e regjistrimit) dhe vendin ku operon.

1. Ecuria e punësimit

Punësuesi më i madh nga totali i të punësuarve në Shkodër, në sektorin privat dhe atë publik, është administrata publike dhe në vend të dytë industria përpunuese.

Sipas të dhënave administrative rezultojnë të kenë regjistruar aktivitetin e tyre ekonomik rreth 2444 ndërmarrje në të gjithë rajonin e Shkodrës, në të cilat janë punësuar 19075 vetë.

Sektori shtetëror i përfaqësuar nga 113 subjekte, ka të punësuar 8810 vetë ose 46%. Prej tyre 80% janë buxhetorë. Kryesisht ka të punësuar në fushën e administrimit publik, në fushën e arsimit, shëndetësi, në sektorin energjitik etj. Reformat në këtë sektor, edhe pse në përmasa të vogla, kanë ndikuar duke sjellë një rënie të vazhdueshme të numrit të të punësuarve në shtet.

Burimi: Drejtoria rajonale e punësimit, Shkodër.

Në sektorin buxhetor (në atë të administrimit publik, shëndetësi dhe arsim), ka më shumë qëndrueshmëri në punësime. Pjesa më e ndryshueshme është ajo që ka të bëjë me zëvendësimet për arsye përshtatje të vendit të punës me arsimin përkatës.

Në sektorin jobuxhetor jepet një panoramë e ndryshme.

Sektori privat, i përfaqësuar nga 2331 subjekte, numëron rreth 10265 mijë të punësuar ose 54%. Nëse i referohemi degëve të ekonomisë, vihet re se ndërmarrjet e konfeksioneve kanë një numër të madh të punësuarish.

Të punësuarit, kryesisht ato të sektorit privat, janë përqendruar në shërbime, tregti, industri tekstile, ndërmarrjet Fason (reparte me kapital të përbashkët dhe të huaj që prodhojnë kryesisht veshje për t'u tregtuar

jashtë).

Për sektorin e ndërtimit ka patur investime të konsiderueshme, gjë që do të ndikojë edhe në hapjen e vendeve të lira të punës, por është e vështirë të bëhet një parashikim, mbasi në këtë sektor punohet më shumë në të zehtë se në sektorët e tjerë dhe është e lidhur me faktin se ato kanë tashmë brigadat e tyre të punës, që i marrin kur kanë objekte pune.

Të dhënat për shpërndarjen e këtyre ndërmarrjeve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike jepen si më poshtë:

Subjektet sipas degeve ekonomike




Fig.1

Punësimi sipas degeve ekonomike




Fig.2

Burimi: Drejtoria rajonale e punësimit, Shkodër.

1.1. Lloji i ndërmarrjeve

Për ndërtimin e kampionit, futëm si dimension të nevojshëm shpërndarjen proporcionale sipas tiparit privat apo shtetëror dhe sipas sektorit ekonomik.

Tabela 1.1: Madhësia e kampionit për të arritur saktësinë sipas sektorit ekonomik dhe llojin e ndërmarrjes.

Sektori ekonomik	N.ndërm.	Shpërndarja e popullimit		Shpërndarja e kampionit	
		Shtetëror	Privat	Shtetëror	Privat
Industria përpunuese	277	2	275	0	23
Energjia dhe gazi	12	10	2	1	0
Ndërtimi	136	0	136	0	17
Tregti	1048	0	1048	0	26
Hoteleri	291	0	291	0	14
Transport	115	6	109	0	6
Shëndetësi	72	5	67	0	4
Arsimi	33	13	20	2	4
Aktivitete financiare	22	1	21	0	1
Shërbime	350	11	339	2	15
Administrim publik	74	60	14	3	1
Të tjera	14	5	9	0	1
TOTAL	2444	113	2331	8	112
Kampioni				8 +	112 = 120

Burimi: Drejtoria rajonale e punësimit, Shkodër.

Tab.1

1.2. Struktura e pyetësorit

Pyetësi përmbante rreth 30 pyetje në funksion të kryerjes së studimit dhe është strukturuar në tre drejtime kryesore:

Prezantimi i ndërmarrjes

- Aktiviteti i ndërmarrjes
- Origjina e ndërmarrjes
- Lloji i pronësisë

Punësimi

- Gjendja e punësimit viti 2010
- Bilanci i punësimit për periudhën 1-vjeçare të studimit
- Performanca e punësimit
- Parashikimi i punësimit deri në fund të vitit

Performanca e ndërmarrjes

Të dhënat u përpunuan në tabelat përmbledhëse dhe një pjesë e informacioneve që nuk ishin futur në to, ndihmoi në paraqitjen e gjendjes së tregut të punës dhe zhvillimin e ardhshëm të tij për aspektet e studimit.

1.3.1. Prezantimi i ndërmarrjes.

Aktiviteti kryesor i ndërmarrjeve.

Nga 120 ndërmarrjet që u përzgjedhën rastësisht për t'u intervistuar pjesën më të madhe të ndërmarrjeve të intervistuar, 23% të tyre e përbëjnë ato të tregtisë, të cilat kanë dhe numrin më të madh të të punësuarve në rajonin e Shkodres, më pas janë ato të industrisë përpunuese me 19%, ndërtimi rreth 14%, mjaft aktive në tregun e punës, por që nuk kanë po atë nivel punësimi si të parat. Ndërmarrjet e tregtisë dhe hotelierisë edhe pse përbëjnë numrin më të madh të ndërmarrjeve në total nuk janë përzgjedhur në po këto raporte përfaqësimi, për arsye të numrit të kufizuar të të punësuarve. Këto paraqiten grafikisht:




Fig.3

Lloji i pronësisë së ndërmarrjeve

Duke ditur që ndërmarrjet me pronësi vendase zënë 91% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve private të intervistuar atëherë anketimi është përqendruar në ndërmarrje me pronësi vendase.


1.3.2. Punësimi:

- Situata e punësimit për vitin 2010
- Bilanci punësimit për vitin 2010
- Performanca e punësimit për periudhën në studim
- Parashikimi i punësimit për vitin 2011

▪ Situata e punësimit

Janë përzgjedhur ndërmarrje për intervistë që përbëjnë mbi 4.9% të subjekteve të regjistruara, përzgjedhje kjo, e cila për fusha të veçanta është mjaft përfaqësuese. Për tiparet që do të studiojmë më poshtë, do të gjejmë intervalin e besimit, i cili do të shërbejë për të gjykuar edhe mbi sigurinë dhe saktësinë e vlerësimit.

Të punësuar sipas gjinisë



- Akt financiar
- Arsim
- Shendetesi
- Transport
- Hoteleri
- Tregti
- Ndërtim
- Energji, gaz
- Ind përpunues

Fig.4

Shqyrtojmë ngjarjen $A = \{i \text{ punësuar i është femër}\}$ me probabilitet $p=P(A)$. Kërkohe të ndërtohet intervali i sigurisë për probabilitetin p kur është dhënë koeficienti i sigurisë $\gamma = 0.95$

Duke përdorur metodat statistikore, mbasi llogarisim $d_n = \frac{1046}{2452} = 0.426$

dhe për nivelin $\alpha = 0.05$

Llogarisim kufijtë e intervalit, të cilët dalin: $L_1 = 0.34$; $L_2 = 0.51$ **Këto përfundime na lejojnë të themi se pjesëmarrja e femrave në punë në rajonin e Shkodrës varion nga 34% në 51% .**

Nga intervistimi është studiuar dhe niveli arsimor i të punësuarve në ndërmarrje, i cili rezulton:

Tabela 2. Të punësuar sipas nivelit të arsimit

Emërtimi	Gjendja e vitit						
	Gjith sej	Të punësuar me nivel arsimor					
		Të ulët	%	Të mes	%	Te larte	%
Industria përpunuese	783	470	60%	250	32%	63	8%
Energjia dhe gazi	7	2	29%	5	7%	0	0%
Ndërtimi	232	77	33%	100	43%	55	24%
Tregtia	298	86	29%	143	48%	69	23%
Hoteleri	155	47	30%	78	50%	30	20%
Transport	26	3	11%	10	37%	13	53%
Shëndetësi	81	3	4%	14	17%	64	79%
Arsim	109	4	4%	11	10%	94	86%
Aktiv financiar	8	1	13%	7	87%	0	0%
Shërbime	739	67	9%	354	48%	318	43%
Adm publik	6	1	17%	2	33%	3	50%
Të tjera	8	4	50%	4	50%	0	0%
Totali	2452	765	31 %	978	40%	709	29%

Nga kjo tabelë vëmë re se mesatarja e të punësuarve me nivel arsimor të ulët, e marrë nga intervista është rreth 30% ndërsa të punësuarit me nivel arsimor të mesëm është më i lartë, rreth 40%. Duke u nisur nga të dhënat e INSTAT-it për nivelin e të punësuarve në sektorin shtetëror rezulton se,

Tabela 3. Punësimi në sektorin shtetëror

Niveli arsimor	Gjendja e vitit						
	Të punësuar me nivel arsimor:						
Punësimi në sektorin shtetëror	Gjithsej	Të ulët	%	Të mes	%	Të lartë	%
		19010	2661	14%	9505	50%	6843

Vëmë re nga të dhënat e mësipërme se në sektorin shtetëror, të punësuarit me nivel arsimor të ulët përbëjnë 14% të totalit. Kjo shifër është relativisht e kënaqshme. Por a është e njëjta situatë dhe në sektorin privat? Për sektorin privat nuk kemi të dhëna të tilla. Për këtë ngremë hipotezën **H₀: Të punësuarit me nivel të ulët arsimor në sektorin shtetëror janë në të njëjtat nivele me sektorin privat.**

Kemi arsye të mendojmë kështu sepse kërkesa për arsimin duhet të jetë më e lartë në sektorin privat duke ditur që rrogat janë relativisht më të larta. Por nga ana tjetër, ndërmarrjet në sektorin privat si p.sh., ato të industrisë përpunuese, punojnë duke shfrytëzuar krahun e lirë të punës në Shqipëri dhe proceset e punës nuk kanë nevojë për ndonjë nivel arsimor të madh.

Për këtë ngremë hipotezën alternative:

H₁: Numri i të punësuarve me arsim të ulët në privat është më i lartë se ai në shtet.

Pra, mendojmë se numri i të punësuarve me arsim të ulët, është më i lartë se ai shtetëror, pasi profesionet që nuk kërkojnë nivel arsimor janë të përhapura kryesisht në fushën e shërbimeve (punëtor, pastrues, roje etj.) dhe se kjo fushë në rajonin e Shkodrës është përfaqësuar nga një numër i konsiderueshëm subjektsh.

Duke kryer verifikimin e hipotezës, me $\alpha = 0.05$; ku niveli, të cilit do t'i referohet hipoteza do të jetë $p_0 = 0.14$, që është niveli i të punësuarve me arsim të ulët në sektorin shtetëror dhe duke konsideruar:

$$H_0: p = p_0$$

$$H_1: p > p_0$$

Meqenëse, vlera e vrojtuar e testit është $t = 5,443$ dhe është më e madhe se pika kritike 1.65, del se hipoteza H_0 nuk është e vërtetë gjë që tregon se të punësuarit me nivel të ulët arsimor në sektorin privat nuk janë

në të njëjtat nivele me sektorin shtetëror, përkundrazi, janë në nivel më të lartë.

Bilanci i punësimit gjatë një viti

Të dhënat e anketimit për periudhën një vjeçare në studim jepen në tabelën e mëposhtme:

Tab. 4 Bilanci një vjeçar i punësimit

Emertimi	Bilanci i punësimit					
	Viti 2009	hyrje	difinitiv	dalje	Zëvendësim	Viti 2010
Industria përpunuese	760	410	310	387	280	783
Energjia dhe gazi	5	2	2	0	0	7
Ndërtimi	220	105	85	93	83	232
Tregti	260	140	120	102	90	298
Hoteleri	130	70	60	45	30	155
Transporti	20	12	10	6	4	26
Shëndetësia	77	22	17	18	15	81
Arsimi	82	34	28	7	5	109
Aktivitete financiare	6	4	3	2	2	8
Shërbime	713	130	110	104	90	739
Administrim publik	4	3	2	1	1	6
Të tjera	12	5	3	9	6	8
Totali	2286	937	750	774	606	2452

Duke parë këtë tabelë përmblledhëse mund të themi se punësimi gjatë vitit 2010 është rritur, por shumë nga të anketuarit kanë përmendur se një problem shumë shqetësues ka qenë ndërprerja e prodhimit në pjesën më të madhe të ndërmarrjeve të sektorit të industrisë tekstile dhe veshje, ndërmarrjet Fason (mungesa e lëndës së parë, bllokimi i tregut të shitjeve), gjendje që aktualisht është stabilizuar dhe kështu pritet të vazhdojë deri në ndërrimin e sezonit të ardhshëm në këto sektorë. Në

lidhje me sektorët e tjerë të industrisë përpunuese mund të themi se për industrinë e përpunimit të drurit dhe për industrinë ushqimore do të ketë një gjendje stabile.

Për sektorin e ndërtimit mendohet se do të ketë shumë investime, gjë që do të ndikojë edhe në hapjen e vendeve të lira të punës.

Nga të dhënat e vjelura nga intervistat në ndërmarrje, vëmë re se punësimet definitive përbëjnë rreth 80% të numrit të përgjithshëm të punësimeve kurse ato sezonale 20% të tyre. Po të krahasojmë këto të fundit me shkurtimet e vendeve të punës ato qëndrojnë pothuajse në të njëjtat nivele. Në fushat e ndërtimit, tregtisë dhe hotelerisë, të cilat kanë specifike punësimet me periudha piku, vërejmë se punësimet sezonale dhe pastaj shkurtimet e vendeve të punës janë më të larta së në fushat e tjera të aktivitetit të ndërmarrjeve.

Gjithashtu vërejmë se, punësimet e kryera në ndërmarrjet e intervistuara qëndrojnë në raportin 1.2:1 krahasuar me largimet e të punësuarve në to, gjë që flet për paqëndrueshmëri relativisht të lartë të të punësuarve në këto ndërmarrje.

Përsa i përket fushave të aktivitetit, largimet nga punë për arsye zëvendësimi janë më të theksuara në fushën e industrive përpunuese. Këtu zëvendësimet janë në nivele të tilla që arrijnë mbi 90% të numrit të punësimeve definitive. Kjo shifër është shumë e lartë po të kemi parasysh se këto janë aktivitetet me numrin më të madh të punësimeve. Raporti i largimeve të fuqisë punëtore me punësimet e kryera për industrinë përpunuese është 1:1.1. Kjo paqëndrueshmëri në punësim vjen si rrjedhojë e rritjes së kërkesave për pagë më të lartë dhe kushte më të mira pune, e lëvizjeve nga një ndërmarrje në tjetrën brenda të njëjtës fushë aktiviteti, por edhe nga niveli i ulët i kualifikimit i të punësuarve që nuk i përshtaten kërkesave të prodhimit në to. Ky nivel, në një masë të caktuar, është pasojë e punësimit të fuqisë punëtore të pakualifikuar që sjellin lëvizjet demografike nga zonat rurale.

Nga intervistimet ka rezultuar se 78% e largimeve të të punësuarve nga ndërmarrjet janë zëvendësime dhe 15% e tyre ndodhin për efekt të shkurtimeve të vendeve të punës. Nëse shkurtimet ndodhin kryesisht për arsye të punësimeve sezonale apo ristrukturimit të ndërmarrjeve, zëvendësimet tregojnë për nivele të larta të paqëndrueshmërisë të të punësuarve.

Performanca e punësimit

Interes të veçantë në këtë studim është edhe mënyra e realizimit të punësimeve të kryera gjatë periudhës një vjeçare në studim.

Të dhënat për vendet e lira të punës dhe mënyrës së plotësimit të tyre pasqyrohen në këtë tabelë:

Tabela 5. Të dhënat për vendet e lira të punës dhe mënyrës së

Emërtimi	Të dhëna për vendet e lira të punës viti 2010							
	Vendet e lira të hapura			Vendet e lira të plotësuara				
	gjiths	Vend i ri pune	zëvendësim	gjiths	Mbi bazë njohjeje	Nëpërmjet njoftimeve në media	Nëpërmjet Z.P	Forma të tjera
Ind. përpu	430	140	290	410	230	13	130	37
Energazi	2	2	0	2	0	0	2	0
Ndërtimi	120	40	80	105	10	30	5	60
Tregti	150	50	100	140	20	40	70	10
Hoteleri	78	38	40	70	40	10	15	5
Transport	15	7	8	12	2	2	8	0
Shëndetesi	25	10	15	22	8	3	2	9
Arsim	37	32	5	34	4	1	3	26
Aktiv.fina	6	4	2	4	1	0	3	0
Shërbime	137	47	90	130	20	20	80	10
Adm publi	5	4	1	3	1	0	2	0
Të tjera	6	6	0	5	0	2	3	0
Totali	1011	380	631	937	336	121	323	157

plotësimit të tyre.

Vëmë re nga kjo tabelë përmbledhëse se haset më shumë mënyra e plotësimit të vendeve të lira të punës mbi bazë njohjeje.

Nga tabela mund të llogaritet se plotësimi i vendeve të lira arrin

93% të atyre të hapura. Edhe këtu vëmë re se disa sektorë të veçantë si industrinë përpunuese, të cilat mbajnë një peshë të konsiderueshme duke e krahasuar me numrin e përgjithshëm të të punësuarve, hasin vështirësinë më të madhe në plotësimin e vendeve të lira të punës. Numri i madh i tyre i hapur për shkak të zëvendësimeve, tregon edhe njëherë paqëndrueshmërinë e punësimeve në këta sektorë.

Po të shohim mënyrën e plotësimit të vendeve të punës sipas degëve të ekonomisë shohim se raportet ndryshojnë. Le të shohim nëse ka ndonjë lidhje midis këtyre.

Për këtë, për çdo vend të lirë të plotësuar vrojtojmë dy karaktere X dhe Y ku X i përket fushës së aktivitetit dhe Y mënyrë së plotësimit të këtij vendi të lirë.

Ndërtojmë tabelën e kontigjencës si më poshtë:

Tabela 6

A	Y1	Y2	Y3	Y4	Σ
X1	230	13	130	37	410
X2	0	0	2	0	2
X3	10	30	5	60	105
X4	20	40	70	10	140
X5	40	10	15	5	70
X6	2	2	8	0	12
X7	8	3	2	9	22
X8	4	1	3	26	34
X9	1	0	3	0	4
X10	20	20	80	10	130
X11	1	0	2	0	3
X12	0	2	3	0	5
Σ	336	121	323	157	937

Ku elementet e vektorëve X dhe Y përfaqësojnë:

X1 ---- industria përpunuese

Y1 ---- mbi bazë njohje

X2 ---- energji dhe gaz
X3 ---- ndërtim

X4 ---- tregti
X5 --- hoteleri
X6 ---- transport, telekomunikacion
X7 ---- shëndetësi
X8 ---- arsim
X9 --- aktivitet financiar
X10 --- shërbime
X11 --- administ.publik
X12 ---- të tjera

Y2 ---- nëpërmjet mediave
Y3 -- nëpërmjet zyrës së punës
Y4 ---- rrugë të tjera

Ndërtojmë hipotezën

H₀: Plotësimi i vendit të punës që përdor ndërmarrja, nuk varet nga aktiviteti ekonomik i saj.

Na rezulton se në fusha të ndryshme preferencat për rrugën më efikase të plotësimit të vendit të lirë të punës janë të ndryshme për aktivitete të ndryshme. Kjo na vë në dyshim për supozimin tonë. Kështu që nga kontrolli i kësaj hipoteze shohim nëse supozimi ynë është i drejtë apo ndodh ndryshe.

Për të vlerësuar nëse diferenca midis dendurisë teorike dhe asaj të vrojtuar është ose jo esenciale përdorim testin e Pirsonit, e kontrollojmë hipotezën tonë me një nivel rëndësie $\alpha = 0.05$

Duke zëvendësuar të dhënat, marrim $V^2=520.32$; ndërsa në tabelën e ligjit χ^2 gjejmë pikën kritike $\chi^2_{\alpha}(12-1)(4-1) = \chi^2_{0.05}(33) = 45,50095$

Meqenëse $V^2 > \chi^2_{0.05}(33)$ hipoteza H₀ hidhet poshtë, pra tiparet X dhe Y të zgjedhjes janë të varura d.m.th., me $\alpha = 0.05$, pranohet se mënyra e plotësimit të vendit të punës që përdor ndërmarrja, varet nga aktiviteti ekonomik i saj.

Vërejmë se punësimet me bazë njohje zënë numrin më të madh të plotësimit të vendeve të lira të punës së hapura për një vit kalendarik, por gati në të njëjtat nivele është edhe plotësimi i vendeve të lira me ndërmjetësimin e zyrës së punësimit. Industria përpunuese i përdor të gjitha mënyrat për arsye se në punësimet në aktivitete që përfshin kjo fushë, punësimet janë masive dhe plotësimi i tyre është pak i vështirë ndaj përdoren të gjitha burimet.

Punësimet nga njoftimet në media, të cilat shpesh kanë kosto më të lartë për ndërmarrjen dhe kërkojnë më shumë kohë e burime njerëzore për përzgjedhjen e kandidatëve, zënë dhe pjesën më të vogël të rekrutimeve. Në fushën e shërbimeve, si: bankat, arsimi e shëndetësia, rekrutimet nëpërmjet medias pothuajse nuk përdoren fare. Për plotësimin e vendeve të lira të punës në këto fusha përdoren kryesisht format e tjera të rekrutimit.

Ndërsa në fushën e energjisë e gazit dhe në përgjithësi në ndërmarrjet shtetërore, përdoren kritere të tjera për rekrutimin e stafit sipas procedurave të administratës publike.

Duke u nisur nga të dhënat e punësimit mund të themi se shihet një rritje e punësimit gjatë vitit 2010.

Faktorët që kanë ndikuar në nivelin e punësimit janë:

a) Zgjerim i aktiviteteve.

Këtu përfshihen kryesisht ndërmarrjet e industrisë përpunuese dhe të ndërtimit. Shumë prej bizneseve në Shkodrës shprehen për nisma të reja dhe kjo është e kuptueshme në një ekonomi që po shkon drejt rritjes dhe njerëzit shpresojnë për një zgjerim të mëtejshëm të aktiviteteve të tyre. Këtu përfshihen kryesisht ndërmarrjet e industrisë përpunuese dhe të ndërtimit. Fluksi i ndërtimeve, si në objekte edhe në rrugë vazhdon të jetë në rritje, edhe pse kjo rritje është në nivele më të ulëta nga ajo e parashikuar, për shkak të krizës, e cila ka dhënë ndikimin e vet.

b) Teknologji të reja. Në përgjithësi mund të themi se niveli i teknologjive është pak a shumë bashkëkohor, kjo vërtetohet edhe me faktin që produktet e prodhuara në përgjithësi, janë jo vetëm për tregun e brendshëm, por edhe për tregun e jashtëm. Vitet e fundit, përmirësimet në teknologji kanë sjellë rritjen e produktit me kosto më të ulët duke çuar kështu në rritje të të ardhurave dhe zgjerim të aktivitetit. Mund të theksojmë se vazhdon të jetë i rëndësishëm fakti se në sektorët e konfeksioneve dhe të këpucarisë janë punësuar shumë nga të ardhurit nga rrethinat.

c) Zhvillimi i turizmit. Zhvillimi i turizmit përbën një sektor që tërheq vëmendjen e disa aktorëve të fuqishëm dhe po zhvillohet shumë. Duke iu referuar pozicionit gjeografik dhe pasurive natyrore të rajonit, turizmi ka sjellë rritjen e numrit të hoteleve, restoranteve dhe të bizneseve.

d) Lëvizja demografike. Një interes për të punësuar punëtorë nga fshati paraqesin edhe punëdhënësit, të cilët punësojnë fuqi punëtore me banim në fshat përkundrejt një pagese më të ulët. Kohët e fundit janë hapur shumë ndërmarrje edhe në periferi të Shkodrës dhe një numër i madh personash janë punësuar aty. Shpërngulja masive e popullsisë fshatare drejt qytetit e rëndoi tregun e punës dhe i hapi rrugë zhvillimit të ekonomisë informale dhe aktiviteteve ekonomike të padeklaruar. Ky fenomen spikat më shumë në fushën e konfeksioneve dhe në ndërtim.


Parashikimi i punësimit

Për të bërë parashikimin e punësimit në rajonin e Shkodrës për vitin 2011 bëjmë përafrimin e të dhënave për punësimin në sektorin privat për 10 vitet e fundit 2001 – 2010.

Për të bërë këtë parashikim i referohemi sektorit privat, pasi sektori shtetëror është vazhdimisht në rënie.

Tabela 7. Punësimi në sektorin privat për 10 vitet e fundit.

VITI	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Punësimi	4126	4738	4800	4950	5090	5496	5611	6529	7102	9102



Burimi: Drejtoria rajonale e punësimit, Shkodër.

Për të bërë një parashikim të punësimit për 2011 përdorim modelin kuadratik të përafrimit të të dhënave, gjejmë polinomin me anë të kodit matlab dhe gjejmë se **për vitin 2011 marrim që punësimi në sektorin**

privat do të jetë në vlerën $y=11091$ (persona të punësuar).

LITERATURA:

1. “Tregues sipas qarqeve”, INSTAT, 2007-2008.
2. Sadije Bushati, “Matematika 2” (Teoria e probabiliteteve dhe statistikave matematike), SHBLU, 1997.
3. Lulëzim Hanelli, Flora Osmani, “ Analiza numerike me Matlab”.
4. “Ekonomia në rritje dhe me stabilitet monetar”, Ministër i Financave Ridvan Bode, 17.12.2009, Tiranë (internet). “Rritja ekonomike në Shqipëri më e larta në Evropë”, artikull internet.
5. Material nga bashkia e Shkodrës, Zyra e zhvillimit ekonomik Regjistri i biznesit i Zyrës rajonale të punësimit.

Turizmi si mundësi e vendit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

Elez Osmani, Fatos Ukaj

Qendra për Hulumtime Ekonomike, Ulqin, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit, Universiteti i Prishtinës, Pejë,

Tourism as an opportunity for the country's sustainable economic development

ABSTRACT

In daily discussions and on various government levels and civil societies is present the linking concept of economic development with development of various economic branches of a country. Although we see an increased attention devoted to development of tourism by individuals, government institutions and non-governmental organizations in these last two years, is observed and is identified non- success on building up a plan for the use of all potentials possibilities including here even the historical cultural heritage in Kosove. It can be noted and taken into account that there has not been sustainable development of tourism industry, and that there has not been the use of historical cultural heritage in function of tourism.

This paper examines some of the possibilities and ways to reach sustainable development of a branch of the tourism industry, and so it is important having a wider cooperation to achieve this goal.

Emphasizing the importance and the need for a coordinated approach to resource planning for tourism development, needs, respectively the interests of the population and institutions, which is more and more into focus and it, will bring to the partnership, in order to achieve the initial results in a sustainable economic development of the country.

Mutual influence that will have tourism and historical cultural heritage in Kosovo is taking in the focus of this paper, in order to identify, respectively to analyse, and in order to be given suggestions.

1. Hyrje

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i një vendi mund të arrihet vetëm me bashkëpunimin në nivel të institucioneve qeveritare dhe subjekteve ekonomike, duke koordinuar aktivitetet edhe me organizata joqeveritare. Një ndër çështjet themelore në të cilat do të bazohet zhvillimi i turizmit në Kosovë janë edhe se si do të funksionalizohen trashëgimia kulturo-historike, e cila me të vërtetë nuk i mungon, por nuk është e evluar sa duhet, sistemuar dhe prezantuar para publikut të gjerë. Kosova si term gjeografik dhe si rajon me ofertë turistike është e locuar në qendër të Ballkanit perëndimor, dhe ka trashëguar nga e kaluara përafërsisht të njëjtat vlera kulturo- historike si edhe shtetet fqinjë, me dallim se në një periudhe të gjatë kohore nuk ka mundur të kujdeset dhe ruajtur vlerat e tilla nga dëmtimet, ndikimet dhe keqpërdorimet. Pas vitit 1999 Kosova ka pasur një zhvillim të turizmit dhe rritje të ofertës turistike por kjo ndodh duke i falënderuar rrethanave dhe iniciativës së individëve dhe grupeve për aksione në afat të shkurtër, e jo nga koordinimi apo planifikimi i organizuar dhe në afat të gjatë. Turizmi në Kosovë është një degë e ekonomisë që ka një rritje në pjesëmarrjen e saj në aktivitetin ekonomik pas vitit 1999. Kjo vjen sepse në përgjithësi Kosova e ka trashëguar edhe një traditë turistike, e cila me vite ka qenë e paavancuar duke iu referuar situatës politike dhe të sigurisë jo të volitshme dhe jo stimuluese për zhvillimin e turizmit. Kosova është dhe duhet të jetë vend turistik në të ardhmen, kurse tani gjithsesi është vend i orientuar nga zhvillimi i turizmit. Një rritje e investimeve dhe qarkullimit turistik na bind se turizmi për vendin është dhe do të jetë një forcë shtytëse e zhvillimit të ekonomisë në përgjithësi. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i një vendi arrihet me bashkëpunimin në nivel të institucioneve shtetërore dhe subjekteve ekonomike, por në fakt ky bashkëpunim do të duhet të bazohet në tre përbërësit e vet, e ato janë: ekonomia, ekologjia dhe shoqëria e vendit. Këto tri dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm janë në ndërveprimin e vazhdueshëm të ndërsjellë duke e plotësuar njëra-

tjetrën. (Ebner,D. & Baumgartner,R.J 2006).




Figura.1. Ndërlidhja e tre përbërësve themelor të zhvillimit të qëndrueshëm të një vendi.

Gjithsesi duhet konstatuar se për të arritur një zhvillim dhe efekte pozitive ekonomike nga turizmi në Kosovë, është e domosdoshme që i gjithë ky zhvillim të vihet nën kontroll dhe të nxirret në nivel vendi strategjia e zhvillimit të turizmit, e cila do të mundësojë një ecje përpara me orientime në ato forma të turizmit, të cilat i përgjigjen me së shumti, ka bazë të mirë për rritje, të cilat do të sjellin përfitime për të gjithë pjesëmarrësit në “industrinë turistike” të Kosovës. Kjo duke pasur si njohuri dhe orientim se vendi përbëhet nga disa regjione specifike për turizëm të ndauardurt, i cili nëse arrihet që të ndërlidhet në një tersi, do të krijojë një ofertë turistike sa specifike në vete aq edhe komplementare me ofertat turistike të vendeve në regjion, e që duhet të jetë orientim afatgjatë i punonjësve turistik kosovar dhe atyre të regjionit. Bashkëpunimi regjional në nivel të vendeve të Ballkanit në lëmin e turizmit është i paragjykuar, plotëson ofertën turistike të njëri-tjetrit dhe mundëson një përjetim unik për turistët që gjatë një pushimi të shijojnë dhe të shfrytëzojnë lloj-llojshmërinë e pashoqe në një hapësirë të vogël gjeografike.

2. Valorizimi i resurseve të trashëgimisë kulturo-historike të rajoneve të ndryshme në Kosovë

Prurja e situatës kur mund të konkludohet se e kemi formësuar ofertën turistike kosovare, mund të ndodhë vetëm atëherë kur të jemi në gjendje që të bëjmë formësimin turistik të një hapësire p.sh. rajoni i Prizrenit, a i Pejës apo Dukagjinit etj. Kjo është një detyrë tejet komplekse dhe në vete duhet të përmbajë analiza gjithpërfshirëse kulturore, historike, etnike-demografike, dhe parashikimin e ruajtjes, kultivimit dhe zhvillimit në të ardhmen. Për këtë nevojitet kohë e ajo është gjithnjë e më e pakët nëse dëshirohet që të zihet hapi me procesin që vetëm se po ndodh në regjion dhe në vendet me të cilat Kosova kufizohet dhe korrespondon në lëmin e turizmit. Qëllimi i këtij punimi është që të sugjerohet bërja e projekteve me theks në ndikimin e zhvillimit të turizmit, në valorizimin e resurseve turistike, e në rend të parë atyre kulturore e historike me të cilat disponon çdo rajon i veçantë, por edhe Kosova si **tersi** me ofertën e vetë turistike. Duke shikuar rajonet e ndryshme gjeografike apo sub-regjionet nëpër Kosovë konkludojmë se ato kanë veçoritë e veta dhe nivel të ndryshëm të traditës dhe nivelit të qasjes ndaj organizimit të degës së turizmit. Por vërtetojmë se nga larmia e evidentuar e përparësive natyrore(flora dhe fauna), trashëgimisë kulturo-historike nëpër rajonet e veta, vendi mundet që në një fundament të fortë të ndërtojë përparësi dhe identitet të produktit turistik në forma dhe përmbajtje shumë kualitative, produkt i cili do të jetë konkurrent dhe komplementar me ofertën e vendeve të Ballkanit dhe në veçanti të jetë plotësuese e ofertës së Shqipërisë dhe Malit të Zi. Gjithsesi se Kosova i ka potencialet e veta të fshehta, të cilat me një zhvillim gradual dhe të rafinuar mund të qojnë në ndryshimin e rolit të turizmit në ekonominë e saj, por edhe në stabilizimin dhe ndërtimin e profilit turistik , që do të mundësojë rritjen e harxhimeve të vizitorëve nëpër rajone dhe do të ndikojë në mbështetjen e bizneseve lokale, dhe të gjithë atyre që ofrojnë shërbime turistike.

Tabela.1 *Krahasimi i vizitave dhe qëndrimit të turistëve në Hotele në Kosovë.*

Nr.	Periudha e vitit	Numri i vizitorëve	Net qëndrimi
-----	------------------	--------------------	--------------

		Të brendshëm	Të jashtëm	Të brendshëm	Të jashtëm
1	TM 4 2008	4,769	6,735	5,242	12,434
2	TM 4 2009	17,925	8,017	18,026	23,536
3	Total:	22,694	14,725	23,628	35,970

Burimi: ESK2009

Në mënyrë që të nxitet dhe të ndihmohet turizmi kosovar si cak, propozojmë si njëri nga masat e nevojshme futjen e konceptit të marketingut në veprimtarinë turistike, e cila do të shërbente si mjet për shpalosjen e potencialeve turistike të rajoneve kosovare, por edhe të ofertës turistike të Kosovës në përgjithësi. Rajonet gjeografike kosovare me lokalitetet e veta kulturore siç janë ai i Pejës me Qarshin e vjetër, 10 lokalitete arkeologjike që nga shekulli II p.e.s e deri në kohet e reja, kullat si ndërtesa karakteristike, xhamitë në qytet si dhe 23 objekte tjera fetare myslimane, Patrikana dhe 12 objekte fetare të krishtera duke përfshirë manastiret, etj. Në të njëjtin rajon mund të shijohet-vizitohet trashëgimia kulturore në muzeun etnografik të qytetit, ekspozitat nëpër kulla, në manifestimet e dramës, prozës dhe poemës, evinimentët e muzikës që zhvillohen gjithandej në periudha kohore dhe stinë të ndryshme. Rajoni i Bjeshkëve të Sharrit që ofrojnë mundësi të përjetimit të mënyrës tradicionale të jetës se popujve me gjuhe të ndryshme dhe të veshjeve, dasmave dhe aktiviteteve kulturore unike, kombinuar me turizmin malor gjatë pranverë-verës dhe atë dimëror gjatë dimrit të gjatë më se pesë muaj. Kosova pra ka çfarë të ofrojë dhe për çfarë të jetë në shënjestër të lajmeve përveç situatës dhe ngjarjeve politike, dhe atë për tema rreth historisë së begatshme (vend i luftërave dhe monumenteve historike), lokaliteteve arkeologjike të jashtëzakonshme (qyteti Ulpiana), lokaliteteve turistike (banjat shëruese, qendrat e skijimit, lumenjtë, liqet, fshatrat turistikë). E gjithë kjo është shenjë se e kemi momentin të cilin duhet shfrytëzuar menjëherë në rritjen e aktivitetit, në rritjen e gatishmërisë së kapaciteteve turistike për pritjen e një numri të madh të vizitorëve, e karshi kësaj që të bëhet një adaptim i planit (nëse ekziston) të institucioneve për zhvillimin e turizmit. E gjithë kjo, pra lidhja e këtyre atraksioneve dhe lokaliteteve turistike në një tërësi si oferta turistike e Kosovës nuk do të mund të bëhet

pa një infrastrukturë të komunikacionit që duhet përmirësuar dhe zgjeruar. Lidhjet e mira të komunikacionit në nivel të vendit, por edhe me vendet fqinjë, posaçërisht me Shqipërinë dhe Malin e Zi, mund ta vendosin Kosovën si cak turistik për një numër të madhe turistësh. Krijimi i mundësive për shfrytëzimin e aeroporteve (Prishtinë, Gjakovë, Kukës), për sjelljen e vizitorëve është një nevojë dhe rrugë, e cila do t'i ndihmojë zhvillimit të degës së turizmit në Kosovë. E gjithë kjo do të jetë jo komplete nëse nuk i kushtohet kujdes ruajtjes së baraspeshës ekologjike në rajonet ku kjo nuk është dëmtuar, hapave urgjent në **sanimin** e dëmeve të bëra ekosistemit, eliminimit të ndotjeve të ambientit në tërë vendin.

3. Hapat e mëtejshme në ndërtimin e konceptit të zhvillimit të turizmit në nivel vendi

Në baze të përvojave të deritanishme në turizëm dhe hotelieri, rajonet e Kosovës, por edhe në nivel vendi do të duhej të ndërtojnë konceptin e bazuar në ndërtimin e identitetit të "*Vendit turistik*", i cili do të bëhej sinonim për vizitorët - shfrytëzuesit e ofertës ekzistuese turistike dhe përparimin e përmbajtjeve të reja të bazuara në trashëgiminë kulturo-historike, me të cilën disponojnë rajonet dhe Kosova si destinacion turistik. Mund të konstatojmë se zhvillimi i turizmit në Kosovë në përgjithësi ka qenë jo i koncentruar, e kjo duke iu falënderuar faktit se edhe lokalitetet dhe destinacionet turistike janë të shpërndarë gjithandej, pra ka një disperzion në hapësirën e gjithë vendit, e që është shkaku i faktorëve shoqëroro-ekonomik të ndryshëm nëpër rajone. Se a është më mirë që zhvillimi i turizmit të jetë i koncentruar apo i shpërndarë në aspektin gjeografik, në nivelin e teorisë nuk mund të jepet një konstatim i prerë. Kjo sepse secila formë, edhe ajo kur zhvillimi i turizmit dhe hotelierisë bëhet më shumë dhe shpejt në disa rajone se në tjerat, por edhe kur zhvillimi i turizmit dhe hotelierisë është i koncentruar në të njëjtën kohë në tërë rajonet, apo në nivel vendi ka përparësitë krahasuese dhe mangësitë, kështu që e sugjerojmë që arsyetimin e zhvillimit të koncentruar apo të shpërndarë-disperziv të vërtetohet sipas rasteve konkrete duke u bazuar edhe në caqet shoqëroro-ekonomike, të cilat dëshirohet të arrihen me këtë zhvillim

-Ofertën turistike të Regjionit të Ballkanit Perëndimor

-Ofertën globale të tregut turistik.

Për të arritur këtë duhet së pari të përcaktohet vendi dhe roli i turizmit dhe hotelerisë, në Kosovë duhet që të përcaktohen kahet dhe caqet strategjike të turizmit dhe hotelerisë si degë ekonomike, duke bërë:

- Identifikimin dhe valorizimin e potencialeve turistike duke u bazuar në qasjen strategjike për udhëheqjen me turizmin
- Orientimin në krijimin e identitetit në tregun e turizmit global si “destinacion turistik”

Sigurisht është bërë mund dhe punë në identifikimin e potencialeve ekzistuese, por jemi të bindur se ka edhe shumë lokalitete turistike atraktive dhe segmente të destinacioneve turistike për vizitorët, për të cilat duhet hulumtuar, përgatitur, vënë në funksion dhe zhvilluar aktivitetet e marketingut për njoftimin e publikut me to. Marketingu i përdorur për destinacionet turistike duhet që të ndihmojë edhe në eliminimin e dëmeve të krijuara në imazhin jo të volitshëm të vendit nga koha e krizës politike, luftës dhe kohës së tranzicionit deri te pavarësia, tek vizitorët e huaj, por edhe ata vendas në disa raste. Nëse nuk punohet sistematikisht në krijimin e imazhit pozitiv të vendit atëherë edhe zhvillimi i turizmit mund të mos jetë ai që në presim, por ky imazh duhet ndërtuar edhe me mundin dhe investimet në ruajtjen e trashëgimisë kulturo-historike, ruajtjen e ambientit, ruajtjen e baraspeshës ekologjike të florës dhe faunës, ujit dhe ajrit, si mundësi për të avancuar ofertën turistike me markën “*ekologjike*”. Në caqet dhe masat strategjike të zhvillimit të ekonomisë në Kosovë, turizmi dhe hoteleria si degë dhe aktivitet ekonomik do të duhej të kenë shenjën e prioritetit, dhe me aktivizimin e KOTAS-it (Asociacioni kosovar i turizmit), si partner i qeverisë dhe institucioneve donuese të projekteve në turizëm (USAID,GTZ,etj), ka marrë hov promovimi i turizmit dhe hotelerisë si një ndër prioritetet në kuadër të zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik të Kosovës. Me këtë aktivitet të shtuar në lëmin e turizmit dhe hotelerisë do të duhej që të fokusohemi në nevojën e planifikimit dhe futjes së punës shkencore-hulumtuese në këtë degë ekonomike, si një prej nevojave që në mënyrë inter-disiplinore të shqyrtimit të ndikimit të faktorëve të ndryshëm që janë të pranishëm dhe kanë pjesëmarrje domethënëse në zhvillimin e turizmit në rajone të Kosovës, por edhe në nivel vendi.

4. Mënyrat e arritjes së realizimit të konceptit të zhvillimit të

turizmit dhe hotelerisë

4.1. Aktivitetet

Në funksion të zhvillimit me të shpejtë të ofertës turistike të rajoneve dhe të Kosovës si tërësi, planifikimin dhe zhvillimin e konceptit duhet shikuar në nivelin mikro dhe makro.

Në nivelin mikro duhet:

- që në mënyrë adekuate të evidentohet dhe planifikohet zhvillimi i mikrolokacioneve turistike nëpër rajone

Në nivelin makro duhet:

- të hartohet, evidentohet dhe planifikohet ndërlidhja e mikrolokacioneve turistike në destinacione turistike rajonale dhe në nivel vendi

- të identifikohen dhe planifikohen aktivitetet përcjellëse që janë në funksion të zhvillimit të turizmit (komunikacioni, pastërtia, legjislacioni etj.)

- të planifikohet dhe përkrahët zhvillimi i kapaciteteve turistike hoteliere dhe përmbajtjeve turistike plotësues (hotele, motele, pasione, kampingje, restorante, bife etj.), që do të ishte si parakusht i zhvillimit turistik.

Tabela 2. *Pasqyra e numrit të bizneseve të regjistruara në lëmin e turizmit dhe hotelerisë në Kosovë, krahasuar me numrin bizneseve të regjistruara në aktivitetet afariste të tjera.*

Viti	Gjithsej ndërmarrje të regjistruara gjatë vitit	Hotelet dhe restorantet	% e hoteleve dhe restoranteve në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara
2008	7,557	855	11.31%
2009	7,505	807	10.75%

Burimi: ESK 2009,

Aktivitetet të cilat do të duhej të ndërmarrin në nivel të rajonit turistik, por edhe në nivel vendi për rritjen dhe zhvillimin konstant të ofertës turistike do të ishin:

- formimi dhe zhvillimi i asociacioneve dhe shoqatave në nivel rajoni dhe

nivel vendi, që do të funksiononin si gjenerator i zhvillimit të turizmit si biznes fitimprurës.

- zhvillimi i ofertës turistike për tregun e vizitorëve një ditor
- zhvillimi i ofertës turistike për turizmin kongresial dhe format tjera
- përgatitja dhe zhvillimi i aktiviteteve marketingore domethënëse për regionet dhe në nivel vendi, që do të jenë të rëndësishme për profilimin e mëtejshëm të mikrolokacioneve dhe makrolokacioneve në kuadër të zhvillimit të industrisë së turizmit dhe biznesit në përgjithësi.

Kjo do të jetë e dobishme nga aspekti makro, ndërsa bashkëpunimi i mëtejshëm nga baza e piramidës do të sjellë koordinimin më të mirë të aktiviteteve individuale për përfitimin e përgjithshëm të bizneseve që marrin pjesë në industrinë turistike të Kosovës.

4.2 Kualiteti

Përsa përmendëm më lart, mund të themi se zhvillim të turizmit nuk mund të ketë pa zhvillimin e agjencioneve turistike, të cilat janë ndërmjetësues në qarkullimin turistik. Duhet vërejtur fakti se ato e kanë rolin e vet në formimin e produkteve turistike, e nxitin dhe e drejtojnë kërkesën turistike, e mbështesin marketingun e destinacioneve turistike dhe përmbajtjeve interesante për vizitorët. Të bazohesh në emocionet pozitive të harxhuesve-vizitorëve ndaj ofertës ekzistuese nuk do të preferohej, në aspektin se vjen deri tek ngopja me ofertën turistike, rrjedhimisht i duhet kushtuar rëndësi kualitetit të shërbimeve në afat të gjatë. Domosdoshmërisht kualiteti në turizëm duhet të jetë në fokus të vëmendjes së aktorve në turizmin e Kosovës, duke bërë përpjekje të vazhdueshme që të freskohen, apo ndërtohen gjithnjë mënyra të reja të ofrimit të shërbimeve në turizëm.

Nga kjo rrjedhe se

- Kualiteti do të duhej të jetë nisma-mbarimi i çdo veprimi-aktiviteti, të cilat ndërmerren dhe do të ndërmerreshin në të ardhmen
- do të duhej insistuar në kualitetin më të mirë të mundshëm të gjithë produkteve-shërbimeve, të cilat e përbëjnë ofertën turistike në tregun turistik-hotelier, i cili po bëhet gjithnjë e më përzgjedhës dhe i rafinuar
- do të duhej krijuar dhe vendosur në afarizëm një standard, i cili do të përmbliedhte “*kualitetin e vlerave regjionale*”, të bëhet standardizimi i kualitetit të produkteve-shërbimeve që do të ndihmojë në krijimin e

imazhit për ofertën turistike të Kosovës dhe çështjet tjera të lidhura me të Krijimi dhe futja në veprim e standardeve të kualitetit do të ishte detyrë urgjente, e për këtë të thirrur janë bizneset dhe institucionet.

4.3 Komunikimi

Zhvillimi i turizmit ka dhe jep efekte pozitive në punëzënieën e popullsisë lokale, në veprimtaritë e ndryshme që ofrojnë produkte-shërbime për turistët dhe turizmin. Ky zhvillim i turizmit nëse bëhet në bazë të konceptit të marketingut, do të duhej që të krijohet një sistem informative, i cili do të mundësonte përcjelljen e zhvillimeve në nivel rajonesh, nivel vendi dhe në nivelin e tregut global të turizmit.

Nevoja për të komunikuar e “*destinacionit turistik*” do të mbështetej në këto aspekte të komunikimit:

- Komunikimi intern (biznesi, komuniteti, vizitori-harxhuesi)
- Komunikimi me faktorët e jashtëm (mikrolokacionet, tregu në nivel vendi, tregu global)
- Komunikimi miks (komuniteti, destinacioni turistik, tregu i vendit, tregu global ndërkombëtar)

Destinacionet turistike dhe bizneset do të duhej të jenë të gatshëm dhe të kenë interes gjithnjë për zhvillimin e marrëdhënieve me mediat dhe publikun, në mënyrë të gjetjes se formave më të mira të marketingut-promovimit të turizmit kosovar.

Në varësi të asaj se si komunikohet në mes të bartësve të këmbimit në turizëm, dallojmë edhe mjetet e ndryshme të përdorura, të cilat mund të jenë a) mjetet konvencionale (TV, radio, shtypi, etj.) dhe b) mjetet e specializuara (interneti, evinimentet, etj.), duhet theksuar gjithsesi se komunikimi nuk mund të bëhet vetëm në nivel të aktiviteteve marketingore të destinacionëve turistike.

5. Përfundim

Padyshim se po vërtetohet se zhvillimi i turizmit në këto vitet e fundit, por edhe në të ardhmen mbështetet në kombinimin e llojeve të ndryshme të ofertave të produktit turistik, duke e përfshirë gjithnjë e më shumë trashëgiminë kulturo- historike, të cilën e disponojmë dhe atyre, të cilat janë në fazën e zbulimit dhe përgatitjes për vizitorë. Çdo lloj plani dhe

planifikimi për zhvillimin e turizmit në Kosovë, do të jetë vështirë të realizohet pa angazhimin dhe përfshirjen e të gjithë aktorve të tregut turistik kosovar dhe partnerëve të interesuar nga tregu global turistik. Oferta turistike e Kosovës është e larmishme dhe përparësi duhet vendos në zhvillimin e kushteve për turizmin transit, turizmit në natyrë, turizmit shëndetësor, turizmit dimëror, turizmit kulturor, turizmit aventuristik, për të cilat tipa të turizmit Kosova zotëron resurse dhe mundësi që në të ardhmen t'i valorizojë, dhe të bëjë turizmin në një nivel që të jetë shtylla e zhvillimit ekonomik. Punësimi i popullsisë është një nga faktorët, potencialet në të cilat duhet vlerësuar të arriturat e zhvillimit të turizmit në vend në të ardhmen e afërt. Tradita e turizmit në Kosovë është relativisht e mangët duke pasur parasysh historinë dhe situatën politike në të cilën ka kaluar Kosova, por kjo nuk do të duhej të paraqesë pengesë për angazhimin e ekspertëve ekzistues dhe atyre të edukuar rishtas në botën e jashtme për të krijuar një traditë autoktone, të bazuar në të arriturat e vendeve të zhvilluara turistike. Konfuzioni i deritanishëm lidhur me mospasjen e një *“masterplani për turizmin kosovar”* e kanë vështirësuar më shumë situatën, sepse nuk dihet se në çfarë drejtimi do të shkohet në zhvillimin e turizmit, kush do të përcaktoj këtë drejtim, por mungojnë edhe përgjigjet në pyetjet *Si, Kush dhe Kur* do të marrë leadershipin në zhvillimin e turizmit në vend. Komunikimi ndërmjet aktorve të ofertës turistike, por edhe me vetë turistët tregohet si domosdoshmëri dhe nevojë në mënyrë që t'u përgjigjemi pyetjeve të vazhdueshme të tij, se turisti nuk pyet më *“ku do të shkojë në pushime”* por e shtron pyetjen se *“çfarë do të bëjë atje ku do shkoje”*. Implementimi i një sistemi informativ mbi dhe për turizmin kosovar shihet si imperativ. Shkollimit të gjeneratave të reja të ekspertëve dhe punëtorëve për tregun turistik paraqitet si imperativ për të reaguar menjëherë e pa vonesë. Bartja e eksperiencës nga jashtë nëpërmes bashkëpunimit me vendet e regjionit dhe me gjerë duhet që të bëhet në mënyrë permanent, ashtu që të arrihet baraspeshimi i njohurive dhe dijes bile me vendet në regjion që kanë ofertë të përafërt turistike. Bazuar në këto konstatime del si e nevojshme që të bëhet hulumtim intensiv për risitë dhe ndodhitë në tregjet turistike. Kjo do të duhej të jetë një aktivitet i gjerë, dhe mirë i udhëhequr në formësimin, ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë historiko-kulturore, bazuar në informacionet e marra nga analizat interdisiplinare dhe bashkëpunimi ndersektorial. Një projekt i konceptuar mirë do të tregojë rrugën nga duhet të shkohet në

zhvillimin e turizmit në rajonet gjeografike dhe në nivel vendi në Kosovë. Si ndikim i këtij projekti do të mund të lindin projekte të tjera që do të jenë burim i aktiviteteve të tjera shoqërore dhe afaristë që kanë të bëjnë direkt apo indirekt me zhvillimin degës se turizmit, por edhe në përgjithësi të zhvillimit ekonomik e kulturor të rajoneve, por edhe të Kosovës. Në këtë punim kemi bërë përpjekje që të japim kontribut në analizën e realitetit ekonomik në Kosovë dhe ndikimi në zhvillimin e turizmit, si një ndër faktorët e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Literatura:

1. Ebner, D. & Baumgartner, R.J. (2006): The relationship between Sustainable Development and Corporate Social Responsibility. www.crrconference.org
2. Ukaj, F. (2010): Marketing Concept as a tool for Development of Tourism in Kosovo. Journal of Environmental Management and Tourism (JEMT), Volume 1 Issue 1, ASERS, 2010, 57-62.
3. Ukaj, F. (2006): “Promocioni dhe segmentet bashkëkohore promociionale në turizëm”, Pejë.
4. Ukaj, F. (2007): Konferenca “Perspektiva e turizmit fshatar në regionin e Rugovës”, f.1-4, Prill, 2007, Pejë.
5. Ukaj, F. (2008): Punimi i prezantuar në Simpoziumin Ndërkombëtar “Prirodno i Kulturnohistorijsko nasljedje i novi modeli upravljanja razvojem turizma”, Vlastic, 14-15, Mars, 2008, BiH, “Trashëgimia historike e Kosovës në dritën e trendëve të reja të zhvillimit të turizmit”

Ecuria e vlerës së pasurive të patundshme dhe normave të interesit në Shqipëri

Esmeralda Uruçi, Nevila Kiri

Universiteti Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit

ABSTRACT

Relationship between interest rate and the price of real estate.

The aim of this paper is to present the real relationship between interest rates and the prices of real estate in Albania. In this work, we identify and investigate the impact of different factors in real estate prices. This study aims at proofing in reality the existing macroeconomic theoretic model basing on a simple empirical model. We present if, in general terms, the interest rates effect in a negative way the real estate prices.

Historical evidences, provided from different statistical sources for Albania are used for statistical analysis. Simple statistical method like correlation coefficient and regression line are used in order to build a relationship between interest rates and real estate prices.

Research findings have shown that houses, industrial and trade buildings are effected negatively from interest rates.

1. Hyrje

Tregu i pasurive të patundshme në çdo vend të botës është një treg mjaft i rëndësishëm në ekonominë e një vendi.

Vitet e fundit në Shqipëri, por edhe në vende të tjera, çmimet e pasurive të patundshme kanë pësuar luhatje të shpeshta duke ngritur çështje serioze për diskutim. Studiuesit janë përqendruar në studimin e

racionalitetit të tregut të këtyre pasurive. Ato kanë analizuar normat e ndryshimit të vlerës së disa tipave të pasurive të patundshme në qytete të ndryshme. Nga përfundimet e këtyre analizave rezulton se në disa raste normat e ndryshimit të vlerës nuk shpjegohen nga teoritë themelore të ekonomisë (Green, 2002). Disa studiues kanë marrë në shqyrtim faktin nëse tregu i pasurive të patundshme është racional apo i parashikueshëm (Wheaton 1987, 1999 dhe Quigley, 1999). Rezultatet e studimeve të tyre nuk japin të njëjtat konkluzione. Ndërkohë, studiues të tjerë kanë analizuar faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në lëvizjet e çmimeve të pasurive të patundshme (Clapp dhe Giaccotto 1994, Mullbauer dhe Murphy 1995, Dolde dhe Tirtiroglu 2002, Jud dhe Winkler 2002, Miller dhe Peng 2003). Pjesa më e madhe e këtyre studimeve janë empirike.

Për shembull, në qoftëse një studim empirik gjen një lidhje midis të ardhurave dhe normave të vlerësimit të pasurive, nuk do të thotë domosdoshmërisht që madhësia e ndryshimit në çmim do të shpjegohet nga madhësia e ndryshimit në normen e të ardhurave. Në qoftëse norma e rritjes së të ardhurave është 50% nuk është e mundur që ndryshimi në çmim të jetë sërish 50% (Chan, Wang dhe Yang, 2002).

Vitet e fundit, në Shqipëri çmimet e banesave dhe të disa pasurive të tjera të patundshme, si ndërtesa industriale kanë ulur ritmin e rritjes (në terma të përgjithshëm) duke përjashtuar vitin 2009. Arsye kryesore të këtij fenomeni janë ulja e kredive hipotekore nga ana e bankave private në vend, stepja e individëve për të blerë pasuri të patundshme (duket se të gjithë po presin që çmimet të ulen, ndonëse kjo nuk mund të ndodhë për të gjitha zonat), rënia e dërgesave të emigrantëve etj.

2. Zhvillimet që nga viti '90

Mbas vitit 1991 në vendin tonë filluan reformat për privatizimin e ekonomisë. Ky proces nënkuptonte hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor, krijimin e institucioneve përgjegjëse dhe privatizimin e objekteve shtetërore. Kuadri ligjor i miratuar nga parlamenti nxiti zhvillimin e tregut të tokës. Ndërkohë që pas vitit 1992 u bënë ndryshime në sistemin bankar duke rritur nivelin e kreditimit dhe numrin e pronave që merren si kolateral. Në këtë mënyrë mund të themi se në vendin tonë ka filluar të funksionojë dhe të zhvillohet tregu i tokës dhe i pasurive të patundshme.

2.1. Konstatime mbi zhvillimin e tregut të pasurive të patundshme


në vendin tonë

Tabela 1. Çmimi mesatar i banesave në qytetet kryesore të Shqipërisë (Lek/m²)

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Çmimi i Banesave (Lek/m ²)	24,523	18,909	23,735	26,356	25,803	27,575	28,250	26,545	26,173	27,092	30,722

1. Burimi: INSTAT, Statistika në vite¹⁶

Grafiku 1. Ecuria e çmimive të banesave (Lek/m²)



Tregu i pasurive të patundshme është ndër aktivitetet me të fuqishme në vendet e zhvilluara, me influenca të ndjeshme në ekonomi. Madje ndikimi i tij ishte i ndjeshëm kur kriza e Real Estate në SHBA, solli rënien drastike të çmimeve të pasurisë së patundshme, duke i shkaktuar humbje prej miliarda dollarësh gjigandëve të ekonomisë botërore.

Kriza financiare filloi në vitet 2003 dhe 2004 kur banka e Rezervave Federale Amerikane aplikonte përqindje të interesit tejet të ulët 1%, për të stimuluar konsumin, për të nxitur familjet amerikane për të investuar në blerjen e shtëpive. Mjaftonte që të shprehje dëshirën e blerjes së shtëpisë edhe pa të ardhura mund të blije shtëpinë duke akorduar kredinë me 110% të vlerës reale të shtëpisë. Këto kushte sollën edhe

¹⁶Janë llogaritur si një mesatë e çmimeve të qyteteve kryesore të Shqipërisë.

rritjen e kërkesave nga familjet për këto kredi dhe blerjen e shtëpive çka rrjedhimisht shkaktoi edhe rritjen e çmimeve të tregut imobilier.

Ndërsa në vendin tonë deri në vitin 2005, përgjithësisht konstatohet një rritje e shpejtë e tregut dhe e vlerës së pasurive të patundshme.

Më i zhvilluar është tregu i banesave. Në terma të përgjithshëm (deri në vitin 2009), vihet re një rënie e ritmit të rritjes së vlerës së banesave. Gjatë viteve të fundit, tregu i banesave është karakterizuar nga frenimi i ritmit të rritjes së çmimeve dhe nga luhatje të çmimit të qirasë (BSH, 2008). Frenimi në normën e rritjes së çmimeve të banesave mund të jetë i lidhur si me zbutjen e kërkesës për banesa ashtu edhe me një ofertë relativisht në rritje. Bazuar në të dhënat zyrtare, numri i lejeve të ndërtimit, që shpesh përdoret si një tregues i zhvillimeve në sektorin e ndërtimit, është rritur, çka sugjeron se investimi në këtë sektor pritet të zgjerohet në muajt e ardhshëm. Nga ana tjetër, në vrojtimin e aktivitetit kreditues, bankat u shprehën për një forcim të standardeve të kredidhënies për këtë qëllim, kryesisht gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008. Ndërkohë, indeksi i kushtimit në ndërtim nuk paraqet zhvillime të qenësishme gjatë vitit 2008. Zhvillimet në këtë indeks, tregojnë që çmimet në tregun e banesave udhëhiqen kryesisht nga faktorë të tjerë, të ndryshëm nga kostot e ndërtimit.

Ritmi i rritjes së portofolit të kredisë për individët është reduktuar në 41 për qind nga 67.7 për qind që ishte në vitin 2007. Kjo ecuri, sipas Bankës së Shqipërisë, është ndikuar nga reduktimi i ndjeshëm i ritmeve të rritjes vjetore të kredisë konsumatore me rreth 29.3 për qind, si dhe nga reduktimi i normës së rritjes së kredisë për banesa (46.7 për qind).

Gjithsesi, gjatë gjithë vitit 2008, pjesa më e madhe e portofolit të individëve përbëhet nga kreditimi për blerje banesash. Siç mësohet, në muajin shtator, kredia për banesa përbënte rreth 66 për qind të këtij portofoli. (BSH, 2008)

Gjatë vitit 2009, tregu i pasurive të paluajtshme është karakterizuar nga rritja e çmimeve të shitjes së banesave dhe rënia e lehtë e çmimit të qirave. Gjithashtu, ka patur një rënie të kërkesës për banesa dhe një ofertë të qëndrueshme. Vlerësimi për kërkesën në rënie bazohet në të dhëna të tërthorta sasiore dhe cilësore nga vrojtimet. Kështu, bizneset e sektorit të ndërtimit kanë vlerësuar në rënie kërkesën e individëve për blerje banese gjatë këtij viti. Rënia e remitançave si dhe


ndjekja e një politike shtrënguese të bankave për akordimin e huave hipotekare për individët nuk kanë mbështetur kërkesën për blerje banese. Nga ana tjetër vlerësohet se oferta për banesa ka mbetur në nivele të qëndrueshme.

Tabela 2. Çmimi mesatar i hoteleve në qytetet kryesore të Shqipërisë (Lek/m²)

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Çmimi i Hoteleve (Lek/m ²)	26,917	32,027	33,038	19,474	24,825	25,214	28,286	27,667	23,417	30,000	34,020

Burimi: INSTAT, Statistika në vite

Grafiku 2. Ecuria e çmimeve të hoteleve (Lek/m²)



Duke iu referuar tabelës 2 mund të themi se vitet e fundit përveç periudhës 2006-2007 në zonat turistike konstatohet një rritje e vlerës së hoteleve. Kjo për arsye të kërkesës në rritje dhe kufizimit të sipërfaqes së trojeve.

Rritja e vlerës së tokës në të gjithë zonën turistike, pavarësisht nga statusi ligjor i saj ka ardhur edhe si rezultat i mungesës së studimeve urbanistike dhe indiferences ndaj ndërtimeve pa leje. Në këto zona vlerat e pasurive janë krahasuar me vlerat në zonat urbane më të afërta.

Me kryerjen dhe miratimin e studimeve parashikohet të ketë ndryshime në drejtim të vlerës së tokës brenda zonës turistike e për


rrjedhjojë do të ndryshojnë edhe çmimet e hoteleve.

Tabela 3. Çmimi mesatar i ndërtesave tregtare në qytetet kryesore në Shqipëri (Lek/m²)

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Çmimi i Ndertes. Treg. (Lek)	24,634	13,780	41,724	23,548	21,362	23,466	23,494	23,381	24,609	29,902	33,909

Burimi: INSTAT, Statistika në vite

Grafiku 3. Ecuria e çmimive të ndërtesave tregtare (Lek/m²)




Gjatë viteve të fundit ka patur një rritje të vlerës së ambienteve për aktivitete biznesi, dyqane, zyra, studio e aktivitete të tjera tregtare. Si arsye kryesore e kësaj rritje, përveç sa përshkruam më sipër është rritja e kërkesës në treg. Qytetet e mëdha kanë pësuar dhe vazhdojnë të pësojnë ndryshime demografike të theksuara. Kërkesat për punësim janë gjithnjë në rritje dhe nga alternativat më kryesore për punësim është aktiviteti privat.

Tabela 4. Çmimi mesatar i ndërtesave industriale në qytetet kryesore në Shqipëri (Lek/m²)

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Çmimi i Ndertes. Ind. (Lek)	2,474	12,113	19,308	17,867	16,586	23,833	31,241	22,513	15,608	27,207	30,853

Burimi: INSTAT, Statistika në vite

Grafiku 4. Ecuria e çmimeve të ndërtesave industriale (Lek/m²)



Siç shohim nga tabela 4, çmimet e ndërtesave industriale kanë pësuar luhatje të dukshme gjatë viteve. Megjithatë parashikohet të ketë rritje të vlerës si rezultat i rritjes së vlerës së truallit. Duhet të theksohet se rritja e vlerës së truallit deri tani ka qenë më e madhe se vlera e amortizimit të objekteve e makinerive.


Shumë biznese tashmë janë konsoliduar dhe kanë kaluar në aktivitete prodhimi. Për rrjedhojë do të vazhdojë të rritet vlera duke u vlerësuar si biznese dhe jo vetëm si asete.

Tabela 5. Norma mesatare e kredisë në Shqipëri(vjetore në përqindje)

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Norma e Intreresit (%)	25.8	24	11.9	16	10.5	13.7	12.2	11.2	13.6	12.82	13.59

Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku 5 Ecuria e normës së kredisë (vjetore në përqindje)



2.2. Faktorët ndikues në rritjen e vlerës së pasurive të patundshme gjatë viteve 2001-2004

Arsyet e rritjes së vlerës së pasurive të patundshme janë nga më të ndryshmet dhe në lidhje edhe me situatën social-ekonomike që po kalon vendi.

Nga një analizë e tregut ka rezultuar se rritja e vlerës së apartamenteve ka patur një ndikim zinxhir edhe në rritjen e vlerës së pasurive të tjera të patundshme. Kjo për arsye se vlera e apartamenteve ndikon direkt pothuajse në mënyrë propocionale në rritjen e vlerës së truallit.

2.2.1. Kërkesat për strehim. Në qytetet e mëdha, Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë etj., prurjet demografike akoma dhe sot janë të konsiderueshme, që do të thotë që ka kërkesa të mëdha për strehim. Duke krahasuar shifrat e vitit 1990 me ato të vitit 2005 konstatohet që në rastin e parë popullsia që jeton në fshat përbën 64% të popullsisë totale të vendit dhe në vitin 2005 ajo përbën 55% të saj. Mesatarisht në vit kanë migruar drejt zonave urbane 20300 persona. I njëjti konkluzion nxirret edhe nga analiza e shifrave të mëposhtme. Emigrantët gjithashtu kanë ndikuar ndjeshëm në tregun e banesave.

2.2.2. Ndërtimet në qendër të qyteteve.

Ndërtuesit preferojnë të ndërtojnë kryesisht në qendër të qyteteve, për shkak të infrastrukturës së gatshme dhe ekzistences së shërbimeve që përgjithësisht mungojnë në periferi. Duke marrë si shembull qytetin e Tiranës, konstatohet një larmi çmimesh në zona të ndryshme të qytetit.

2.2.3. Rritja e përqindjes së sipërfaqës së ndërtimit që marrin pronarët e truallit.

Në vendin tonë është zhvilluar një formë origjinale e tregut të trojeve për ndërtim. Si rezultat i mungesës së fuqisë paguese vlera e trojeve konvertohet në sipërfaqe ndërtimi. Në qendër të qyteteve sipërfaqet e trojeve janë më të kufizuara. Kjo ka bërë që të kemi rritje të përqindjes së sipërfaqes së ndërtimit që marrin pronarët e truallit dhe për pasojë rritje të kostos dhe vlerës së apartamenteve.

2.2.4. Destinacioni i ndërtesave. Gjatë këtyre viteve kemi një ndryshim të theksuar të destinacionit të pallateve për banim. Pallatet përveç sipërfaqes së banimit kanë mesatarisht dy kate parkim dhe 2-3 kate me destinacion për shërbime, si: dyqane, zyra, studio, etj., të cilat e rrisin shumë vlerën e investimit, gjë që reflektohet në çmimin e apartamenteve dhe të truallit.

2.2.5. Cilësia e materialeve të ndërtimit dhe e punimeve. Duhet të theksohet që cilësia e punimeve në përgjithësi ka qenë në rritje. Materialet e ndërtimit që përdoren janë më cilësore, më të shtrenjta dhe vlera e tyre reflektohet në koston e ndërtimit. Në përgjithësi është konstatuar një rritje e vlerës së materialeve që përdoren për ndërtim dhe e karburanteve.

2.2.6. Mungesa e lejeve të ndërtimit. Një arsye tjetër është mungesa e funksionimit të rregullt të institucioneve që miratojnë lejet e ndërtimit.

2.2.7. Përmirësimet e infrastrukturës. Rregullimet e infrastrukturës brenda qyteteve, kryesisht rrugore, kanë ndikuar në preferencat e qytetarëve për zona të caktuara banimi, për rrjedhojë në rritjen e kërkesës dhe të çmimit në këto zona.

2.2.8. Forcimi i sistemit fiskal dhe ulja e informalitetit në punësim.

Një arsye tjetër që ka ndikuar në rritjen e çmimeve është forcimi i sistemit fiskal dhe ulja e informalitetit në punësim. Udhëzimi i fundit i Ministrisë së Financave mbi llogaritjen e taksës së transferimit të pronësisë do të ketë ndikime direkte në rritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme. Ndërsa ulja e informalitetit në punë ka sjellur në përgjithësi rritjen e zërit “Shpenzime për paga”, i cili sipas INSTAT në vitin 2007 është rritur 67% në krahasim me vitin 1999.

2.2.9. Legalizimet dhe proceset e kthimit dhe të kompensimit të pronave.

Përveç arsyeve të renditura më lart, një ndikim në rritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme ka patur miratimi i ligjeve “Për pronat” dhe “Për

legalizimet”. Është e natyrshme që një pronë e pajisur me dokumente ligjore kushton më shtrenjtë se një pronë informale.

3. Gjendja aktuale e sektorit të ndërtimit dhe parashikimi për të ardhmen

Bizneset e ndërtimit do të investojnë dhe punojnë më shumë sepse nuk ka likuiditet dhe aktiviteti total përlllogaritet të ulët 60% të kapaciteteve. Dy arsye kryesore të tkurrjes së tregut janë (Revista *Monitor*, 25 Janar 2009):

- Nga individët e thjeshtë blerjet e pasurive të patundshme janë në ulje, sepse ka rënë numri i huave bankare. Ulja e kredidhënies është si rezultat edhe i një analize më të mirë kreditore nga ana e bankave e kapacitetit të pagesës së klientit dhe planit të investimit me qëllim rritjen e cilësisë. Kjo ka sjellë që të rritet numri i klientëve që nuk kreditohen nga bankat.
- Ngadalësimi i rritjes ekonomike apo dërgesave nga emigrantët.

Parashikimi për të ardhmen nuk është shumë optimist për tregun e banesave. Pritet që “stepja” e kreditimit nga ana e bankave të ndikojë në tkurrjen e kërkesës për blerje të pasurive të patundshme. Sipas të dhënave nga agjencitë vendase, thuhet se 80% e kërkesave për blerje shtëpie janë nëpërmjet kredive hipotekore dhe shumica e klientëve i drejtohen bankave që t’i ndihmojnë me hua. Konfirmimi vjen nga vetë bizneset e këtij sektori, të cilët parashikojnë një reduktim krahasuar me një vit më parë. Sektori përbën 13% të prodhimit të brendshëm bruto, duke zënë një peshe të konsiderueshme në ekonomi.

Sigurisht që ky sektor ka qenë më aktiv kur vjen fjala të kreditimi në vitet e fundit. Por ka ndodhur që ata faktorë të cilët e nxitën dikur këtë treg, të mos jenë aq aktivë sa atëherë. Qytetet kryesore të vendit ishin shumë atraktive për biznesin e ndërtimit, falë kërkesës që erdhi si rezultat i zhvendosjes drejt tyre të shumë banorëve. Nga ana tjetër tregu i banesave nisi të shihej edhe si formë investimi. Të dy këto elementë nuk janë më sot. Një pjesë e apartamenteve kanë mbetur pa u shitur, që do të thotë se normalisht duhet të kishim një rënie çmimi për të nxitur blerjen e tyre (Revista *Monitor*, 23 Gusht 2010).

Edhe në Shkodër tregu i pasurive të patundshme po shkon drejt

ngopjes. Bankat kanë vështirësuar kreditimin megjithatë kemi një rritje të çmimeve gjatë vitit 2009.

4. Analiza sasiore e lidhjes mes norms së interesit dhe çmimit të pasurive të patundshme

Më poshtë do të trajtojmë një analizë regresioni mes normave të interesit dhe çmimeve të disa tipave të pasurive të patundshme. Analiza e regresionit e realizuar në këtë studim ka si bazë dy komponentë të rëndësishëm:

1. Variabli i varur (vlera e pasurisë së patundshme). Vendoset në boshtin vertikal.
2. Variabli i pavarur (normat e interesit), është një variabël që ndikon në variablin e varur. Vendoset në boshtim horizontal.

4.1. Lidhja mes normës së interesit dhe çmimit të banesave


Meqë pasuritë e patundshme përfshijnë disa lloje kemi marrë në analizë çmimin e banesave, hoteleve, ndërtesat industriale dhe ato tregtare.

Tabela 5. Normat e interesit (vjetore në përqindje) dhe çmimi i banesave (Lek/m²)

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Norma e Interesit (%)	25.8	24	11.9	16	10.5	13.7	12.2	11.2	13.6	12.82	13.59
Çmimi i Banesave (Lek)	24,523	18,909	23,735	26,356	25,803	27,575	28,250	26,545	26,173	27,092	30,722

Koeficienti I Korrelacionit	-0.6
-----------------------------	------

Grafiku 5



Scatter diagrama tregon grafikisht që rritja e normave të interesit ka efekt negativ në çmimin e banesave. Pavarësisht se lidhja midis dy variablove është negative, pikat nuk bien në një vijë të drejtë. Për të matur fortësinë e lidhjes midis dy variablove ne gjejmë koeficientin e korrelacionit.

Siç shikohet nga grafiku 5 ekziston një lidhje inverse mes çmimit të banesave dhe normës së interesit. Konkretisht koeficienti -0.6 tregon një lidhje relativisht të fortë negative mes dy variablove, domethënë kur njëri rritet tjetri ulet, por jo me të njëjtën madhësi. Këto evidenca të mbledhura përgjatë viteve pothuajse konfirmojnë modelet teorike makroekonomike. Pra, çmimet e banesave janë të ndjeshme nga normat e interesit. Individët ulin kërkesën për banesa në qoftë se kostoja e huamarrjes rritet. Ekuacioni i regresionit përcakton lidhjen lineare midis dy variablove. Forma e përgjithshme e ekuacionit të regresionit linear është: $Y = a + bX$


4.2. Lidhja mes normës së interesit dhe çmimit të hoteleve

Tabela 6. Normat e interesit dhe çmimi i hoteleve

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Norma e Interesit (%)	25.8	24	11.9	16	10.5	13.7	12.2	11.2	13.6	12.82	13.59
Çmimi i Hoteleve (Lek)	26,917	32,027	33,038	19,474	24,825	25,214	28,286	27,667	23,417	30,000	34,020

Koeficienti i Korrelacionit	0.06
------------------------------------	------

Grafiku 6



Koeficienti i korrelacionit mes normave të interesit dhe çmimit të hoteleve është 0.06, që do të thotë se ekziston një lidhje pozitive e dobët. Ndryshe nga çmimi i banesave, në këtë rast modeli teorik nuk vërtetohet.

Kjo mund të jetë si rezultat i mosekzistencës së informacionit perfekt dhe gjithashtu i ndikimit të faktorëve të tjerë. Një ndër faktorët mund të jetë varësia e çmimit të hoteleve më të ardhurat nga emigracioni (remitancat). Ndryshe nga banesat një pjesë e madhe e hoteleve janë ndërtuar me të ardhurat që sjellin emigrantët.


4.3. Lidhja mes normës së interesit dhe çmimit të ndërtesave tregtare

Tabela 7. Normat e interesit dhe çmimi i ndërtesave tregtare

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Norma e Interesit (%)	25.8	24	11.9	16	10.5	13.7	12.2	11.2	13.6	12.82	13.59
Çmimi i Ndm. Treg. (Lek)	24,634	13,780	41,724	23,548	21,362	23,466	23,494	23,381	24,609	29,902	33,909

Koeficienti i Korrelacionit	-0.41
------------------------------------	--------------

Grafiku 7



Përsa i takon lidhjes normë –interesi - çmimi, i ndërmarrjeve tregtare ekziston një lidhje negative jo e fortë.


4.4 Lidhja mes normës së interesit dhe çmimit të ndërtesave industriale

Tabela 8. Normat e interesit dhe çmimi i ndërtesave industrial

Viti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Norma e Interesit (%)	25.8	24	11.9	16	10.5	13.7	12.2	11.2	13.6	12.82	13.59
Çmimi i Ndm. Ind. (Lek)	2,474	12,113	19,308	17,867	16,586	23,833	31,241	22,513	15,608	27,207	30,853

Koeficienti i Korrelacionit -0.73

Grafiku 8



Lidhja mes normave të interesit dhe çmimit të ndërtesave industriale është një lidhje e fortë negative që vërteton teorinë ekonomike.

Siç shikohet nga studimi i mësipërm duke qenë se korrelacionet janë negative të tre prej ndarjeve kryesore të pasurive të patundshme themi se përgjithësisht normat e interesit ndikojnë negativisht në çmimin e pasurive të patundshme në Shqipëri.

KONKLUZIONE

- Në Shqipëri ka një ngadalësim të ritmit të rritjes së çmimeve të pasurive të patundshme në përgjithësi.
- Vështirësimi i kredidhënies ka rezultuar në frenimin e blerjeve dhe në rënien e ritmit të rritjes së çmimeve të pasurive të patundshme.
- Normat e interesit kanë një ndikim negativ në çmimin e banesave. Siç rezultoi nga studimi, lidhja mes normave të interesit dhe çmimit të banesave rezultoi një lidhje e fortë negative.
- Lidhja mes normave të interesit dhe çmimit të hoteleve rezultoi një lidhje e dobët pozitive gjë që kundërshton teorinë ekonomike.
- Normat e interesit ndikojnë negativisht gjithashtu në çmimin e ndërtesave tregtare. Lidhja është mesatare.

- Çmimi i ndërtesave industriale preket ndjeshëm nga ndryshimi i normave të interesit. Lidhja rezultoi e fortë negative.

REKOMANDIME

- Investimi në pasuritë e patundshme duhet të shikohet gjithmonë si një alternative që siguron shumë avantazhe.
- Investitorët duhet të jenë të informuar rreth faktorëve që ndikojnë në çmimet e pasurive të patundshme dhe duhet të ndjekin në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet në tregun e pasurive të patundshme.
- Nëse normat e interesit të kredisë rriten individët duhet të shikojnë mundësinë që të përdorin kursimet e tyre për të investuar në pasuri të patundshme.

KUFIZIMET E STUDIMIT

- Metoda e regresionit linear që është përdorur nuk është më e mira e mundshme, sepse ka kufizimet e saj që lidhen me supozimet mbi të cilat ndërtohet.
- Përveç normës së interesit mund të jenë edhe faktorë të tjerë që shkaktojnë uljen e çmimit të pasurive të patundshme.
- Besueshmëria e të dhënave.

LITERATURA:

1. Basle, *The transmission of monetary policy in emerging market economies*, BIS Policy papers, Monetary and Economic Department Basle, Zvicër, 1998.
2. Brumbullulli Spiro, *Investimet*, Libri Universitar, 1998, f. 232-242
3. Bull Adrian, *The Economics of Travel and Tourisms*,(2) Logman Limited
4. Clapp, J. M. and C. Giaccotto (1994), The Influence of Economic Variables on Local House Price Dynamics, *Journal of Urban Economics*, 36(2), f. 161-183.

5. Dolde, W. and D. Tirtiroglue (2002), Housing Price Volatility Changes and Their Effects, *Real Estate Economics*, 30(1), f. 41-66.
 6. Eduart A. Moses & John M. Cheney *Investments: analysis, selection, & management*, 1989, f. 630.
 7. Green, R. (2002), Can We Explain the Santa Clara County Housing Market? *Housing Policy Debate*, 13(2), f. 351-368.
 8. Jud, D. and D. Winkler (2002), The Dynamics of Metropolitan Housing Prices. *Journal of Real Estate Research*, 23(1), f. 29-45.
 9. Quigley, J. (1999), Real Estate Price and Economic Cycles. *International Real Estate Review*, 2(1), f. 1-20.
 10. Floyd, 1990, *Real Estate Principles*.
 11. Miller, N. and L. Peng. (2003), *Exploring Metropolitan Housing Price Volatility*, Working Paper. University of Cincinnati.
 12. Muellbauer. J. and A. Murphy. (1995), Booms and Busts in the U.K. Housing Market. *The Economic Journal*, 107(445), f. 1701-1727.
 13. Uruçi Esmeralda, *Mikroekonomia*, Toena, Tiranë, 2003, f. 368-369.
 14. Wang, K., Y. Zhou, S. H. Chan, and K.W. Chau (2000), Over-Confidence and Cycles in Real Estate Markets: Cases in Hong Kong and Asia, *International Real Estate Review*, 3(1), f. 93-108.
 15. Wang, K. and Y. Zhou (2000), Overbuilding: A Game-theoretic Approach, *Real Estate Economics*, 28(3), f. 493-522.
 16. Wheaton, W. (1987), The Cyclical Behavior of the National Office Market. *American Real Estate and Urban Economics Association Journal*, 15(4), f. 181-199.
 17. Wheaton, W. (1999), Real Estate Cycles: Some Fundamentals. *Real Estate Economics*, 27(2), f. 209-230.
- [Në internet: www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org) ;
www.bankofalbania.org;
www.instat.gov.al

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010

Flukset e investimeve të huaja direkte në rajonin e Shkodrës

Blerta Dragusha, Zemaida Kastrati (Mozali)

Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi, Departamenti i Financë-Kontabilitetit

Flows of foreign direct investment in the region of Shkodra

ABSTRACT

The successful FDI performance of CEE countries during their preparation for the EU accession in the last years shows that FDI inflows can have a very positive impact on the economic development of a country.

During the last years, Albania has experienced a considerable increase in the level of foreign direct investments. This increased level of FDI has positively affected the Albanian economic growth even during the global financial crisis.

This paper analyses FDI inflows in the region of Shkodra focusing on the actual situation of FDI inflows and the opportunities that this region offers to attract new foreign investments as a way to increase employment, bring new technologies and effect the further economic development of this region.

Hyrje

Historikisht Shkodra ka qenë një ndër qytetet kryesore shqiptare. Zhvillimin më të madh e mori në shekullin XIX. Më 1870 ajo kishte rreth 50 000 banorë dhe u bë një e rëndësishme tregtare për gjithë Ballkanin, me 3500 dyqane, në zonën ku sot njihet si “*pazari i vjetër*”.

Ishte qyteti i fundit shqiptar që ra nën sundimin osman më 1479, dhe qyteti që kundërshtoi më së shumti ardhjen e komunizmit më 1944. Qytetarët shkodranë ishin të parët që rrënuan simbolet e diktaturës më 1989. Aty filloi edhe shkëndija e parë e protestave gjithëpopullore kundër komunizmit në fundin e vitit 1990.

1. Ecuria e zhvillimit ekonomik të rajonit të Shkodrës gjatë periudhës 1944-1990

Aktivitetet kryesore ekonomike që zhvilloheshin gjatë periudhës së ekonomisë të centralizuar (1944-1990) në Shkodër ishin industria e lehtë dhe ushqimore që merreshin me përpunimin e duhanit dhe prodhimin e cigareve, prodhimet ushqimore të konservuara, prodhimet e sheqerit, prodhimet e pijeve, qumështit, prodhimet e makaronave, bukës, orizit, vajit etj. Në industrinë tekstile kryesore ishin ndërmarrja e konfeksioneve dhe fabrika e mëndafshit kurse në industrinë e drurit kombinati i drurit dhe i letrës. Në industrinë mekanike gjatë kësaj periudhe disa nga ndërmarrjet më të rëndësishme ishin uzina e kablllove, uzina e teleferikëve, uzina e blojës, uzina “*Drini*”, ofiçina e automjeteve Shkodër, parku i autobuzave etj. Dy ndërmarrje të rëndësishme të punimeve artizanale ishin ndërmarrja artistike dhe ndërmarrja e punimeve zukth - kashtës. Gjatë kësaj periudhe Shkodra zinte vendin e pestë në ekonominë e Shqipërisë krahasuar me qytetet e tjera.

2. Ecuria e aktiviteteve ekonomike në rajonin e Shkodrës pas viteve ‘90


Pas viteve ‘90, si rezultat i ndërmarrjes së reformave ekonomike rrënjësore, ndodhën ndryshime të mëdha strukturore të ekonomisë së qytetit të Shkodrës. Në vitet 1994-1995 vihet re një rritje e numrit të

subjekteve ekonomike. Ky rezultat ishte rrjedhojë e reformave ekonomike të ndërmarra dhe platformës së privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore të klasifikuara biznese të vogla dhe të mesme.

Në periudhën 1997-1999 kemi një rënie drastike të numrit të tyre (786 subjekte më pak se vitet paraardhëse). Ulja e numrit të bizneseve aktive gjatë kësaj periudhe kohore ishte si rezultat i bllokimit të kufirit me ish-Jugosllavinë (Malin e Zi) duke ulur në mënyrë të ndjeshme aktivitetin tregtar ndërkufitar. Për shkak të krizës së vitit 1997, bizneset shkodrane u dëmtuan shumë dhe u detyruan të mbyllnin aktivitetet e tyre ose t'i reduktonin maksimalisht ato.

Sot në Shkodër janë regjistruar 653 subjekte biznesi të madh, nga ku biznese prodhuese janë 101, ndërtimi 113, tregti 339, transport 17, shërbime 69 dhe të tjera 14.¹⁷ Siç shihet dhe nga grafiku peshën më të madhe e zë tregtia me rreth 52%, e cila pasohet nga ndërtimi dhe industria përkatësisht me 17% dhe 16%. Një rritje të konsiderueshme vitet e fundit ka shënuar dhe sektori i shërbimeve me rreth 67 subjekte të mëdha, të cilat ushtrojnë aktivitete të tilla. Sektorët më pak të zhvilluar janë konkretisht transportet dhe një grup i vogël biznesesh ku kemi përfshirë televizionet, telefoninë rurale, blegtorinë etj.

Grafiku 1 Shpërndarja e bizneseve të mëdha gjatë vitit 2009



1 Të dhënat janë përpunuar nga autorja


Grafiku më poshtë bën një paraqitje të zhvillimit të bizneseve të mëdha sipas sektorëve të ekonomisë shkodrane. Siç shihet edhe nga grafiku, pjesën më të madhe të biznesit të madh e zë tregtia.

Grafiku .2 Shpërndarja e bizneseve të mëdha gjatë vitit 2009



Grafiku më poshtë paraqet shpërndarjen e subjekteve të biznesit të vogël sipas sektorëve të ekonomisë për vitin 2009 në Shkodër:

Grafiku 3. Shpërndarja e subjekteve të biznesit të vogël -2009



3. Analiza SWOT për Shkodrën

Më poshtë bëhet një paraqitje e analizës SWOT për rajonin e Shkodrës:

Pikat e forta:

- Pozita gjeografike
- Ekzistenca e burimeve natyrore.
- Ekzistenca e potencialeve turistike dhe tradita e mikpritjes.
- Burimet e favorshme për zhvillimin e agrobiznesit dhe agroturizmit.
- Tradita në artizanat dhe tregti.
- Burime njerëzore të kualifikuara dhe kosto e ulët e punës.
- Mosha mesatare e re (27 vjeç).
- Ekzistenca e Universitetit “Luigj Gurakuqi”.
- Ekzistenca e një tradite në fushën e arsimit, kulturës, sportit dhe trashëgimisë kulturore.
- Ekzistenca e qendrave të formimit profesional.
- Ekzistenca e një komuniteti dashamirës për ndryshime.

Pikat e dobëta:

- Mungesa e një klime favorizuese për biznesin.
- Mundësi e ulët e punësimit.
- Mospërputhja e kërkesës për formim dhe kualifikim profesional me ofertën trajnuese territoriale.
- Mungesa e zbatimit të legjislacionit të urbanistikës nga KKRT-ja dhe e akteve të tjera normative lokale.
- Keqadministrim i pronave publike dhe mungesa e regjistrimit të tyre.
- Amortizimi i rrjetit inxhinierik të qytetit.
- Niveli i ulët i zbatimit të projekteve dhe i kontrollit të tyre.
- Mungesa e kontrollit mbi territorin nga ana e administratës së Bashkisë.
- Ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Niveli i ulët i të ardhurave lokale.
- Mungesa e transparencës.
- Infrastrukturë e dobët e institucioneve të kulturës, arsimit, formimit profesional dhe sportit, si dhe mbështetja e dobët financiare.
- Mungesa e një strategjie për mbrojtjen e ambientit.

Mundësitë:

- Procesi i decentralizimit. Hartimi i strategjisë të zhvillimit ekonomik DELTA.

- Strategjitë kombëtare në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Liberalizimi i sistemit banker. (Hapja e filialeve të bankave).
- Fillimi i disa projekteve të organizatave dhe fondacioneve të huaja (BB, GTZ, SOROS, USAID, UNDP, REC, UNOPS, COOPERAZIONE ITALIANA, etj).
- Ekzistenca e projektit për ndërtimin e korridorit Veri-Jug (by-pass i qytetit të Shkodrës).
- Ekzistenca e disa financimeve të huaja në rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve dhe perspektiva e zgjerimit të tyre në të ardhmen.
- Projekti i Bankës së Investimeve Evropiane për shtrimin e linjave 20 Kv.
- Zbatimi i projektit të zgjerimit të rrjetit të telefonisë fikse për qytetin e Shkodrës.
- Aprovimi i legjislacionit të ri për shërbimet sociale.

Kërcënimet:

- Mungesa e investimeve kapitale nga pushteti qendror.
- Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme.
- Mungesa e sigurisë publike.
- Ekzistenca e tregut informal dhe evazionit fiskal.
- Mungesa e një politike mbrojtëse për tregun vendas.
- Niveli i ulët ekonomik i popullsisë.
- Korrupsioni i lartë.
- Migracioni nga zonat e thella rurale dhe emigracioni i detyruar i trurit.
- Ecja me ritme të ulëta e procesit të decentralizimit.
- Strategjia kombëtare jo e favorshme për strehimin.
- Ndryshimet e regjimit ujor të nyjës hidrike liqen, Bunë, Kir dhe Drin.
- Mosmbulimi me shërbime sociale i të gjitha grupeve në nevojë.

4. Situata e përgjithshme e IHD-ve në Shkodër

Zhvillimi ekonomik dhe investimet e huaja në Shkodër vazhdojnë të jenë në një nivel të ulët dhe kjo vjen kryesisht nga mangësitë e vazhdueshme të sistemit gjyqësor, doganave, taksave dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me korrupsionin, informalitetin e lartë, mungesën e infrastrukturës dhe problemet e pronësisë.


Firmat investuese të huaja në Shkodër trajtohen njëjloj sipas ligjit ashtu si dhe ato vendase dhe janë të garantuara ndaj shpronësimit dhe shtetëzimit. Të gjithë sektorët e ekonomisë në Shkodër janë të hapur ndaj investimeve të huaja direkte. Në Shkodër sipas informacioneve të marra nga bashkia Shkodër (Drejtoria e Zhvillimit të Marrëdhënieve me Jashtë) dhe zyra e Tatim-Taksave kemi këto të dhëna në lidhje me investimet e huaja për vitin 2009:

- Numri i firmave të huaja dhe të përbashkëta është 52. Nga të cilat 18 firma janë të huaja dhe 34 të përbashkëta.

Pjesën më të madhe të investimeve të huaja në Shkodër e zënë ato në sektorin e industrisë (55%). Investimet dominuese në këtë sektor i përkasin industrisë tekstile (38%).

Rreth 72% e investimeve të huaja në sektorin e industrisë janë ndërmarrje të përbashkëta ose të huaja që punojnë me material porositësi (subjekte fasoniste), ku rreth 80% e tyre i përkasin sektorit të veshjeve. Dominojnë ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta italiane, por ka edhe investime gjermane (ALB-Tiefbau), malazeze, bullgare (ALFA/SH) etj.

Grafiku 4



Vihet re një rritje pozitive e subjekteve të huaja dhe të përbashkëta që kanë shtrirë aktivitetin në Shkodër gjatë këtyre viteve të fundit. Kështu

nga viti 2004 kur numëroheshin vetëm 21 subjekte të tilla shohim një rritje me 150% të tyre. Pjesa më e madhe e subjekteve (65%) janë të përbashkëta.

Arsyet kryesore e të investuarit në Shkodër janë “*krahu i lirë i punës*” dhe pozicioni gjeografik. Këto firma të huaja kanë ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e papunësisë dhe në sjelljen e teknologjive të ndryshme në Shkodër, të cilat nga ana tjetër kanë ndihmuar edhe në krijimin e shumë bizneseve të reja vendase.

Shkodra në raport me numrin total të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta që zhvillojnë aktivitetin ekonomik në Shqipëri zë afërsisht 5% të totalit të investimeve të huaja. Niveli aktual i IHD-ve në Shkodër krahasuar me totalin është shumë i ulët duke patur parasysh potencialet e Shkodrës në drejtim të tërheqjes së investitorëve të huaj.

4.1 Mundësitë për investime në Shkodër

Mundësitë që Shkodrës t’i rikthehet emri i saj i dikurshëm nuk janë të pakta. Mundësitë ekzistojnë, gjithçka varet nga dëshira dhe strategjitë, por edhe sigurimi i fondeve për t’i shfrytëzuar ato. Potencialet natyrore, krahu i lirë i punës si dhe mundësitë që ofron ky rajon për t’u lidhur me vendet e tjera fqinjë, janë disa nga arsyet pse investitorët e huaj dhe ato vendas duhet të investojnë në Shkodër.

Pozicioni i favorshëm gjeografik është një përparësi për shkodranët, duke bërë që ky rajon të jetë një urë kalimi për bizneset vendase me ato të shteteve të afërta fqinjë, si: Mali i Zi, Kosova, Serbia, Maqedonia, Italia e deri te ato më të largëta.

Burimet natyrore janë një tjetër përparësi për këtë rajon. Në zonën e Shkodrës ka shumë burime minerale mjaft cilësore, të cilat janë plotësisht të pashfrytëzuara. Nga ana tjetër, një përparësi për investitorët është edhe kosto e ulët e krahut të punës, por edhe një forcë punë e specializuar.

Pavarësisht numrit të ulët të IHD-ve në Shkodër, ky rajon i Shqipërisë ka potenciale të mëdha ende të pashfrytëzuara nga investitorët e huaj. Ndër burimet kryesore përmendim burimet natyrore dhe njerëzore të Shkodrës.

- *Burimet natyrore*

Rrethi i Shkodrës kufizohet nga veriu me rrethin Malësi e Madhe, në perëndim me Republikën e Malit të Zi dhe detin Adriatik, nga jugu me rrethin e Lezhës dhe në lindje me rrethin e Pukës. Ka një sipërfaqe prej 2049 km² dhe një popullsi prej 243 mijë banorë. Në këtë territor ka tre liqene.

Vetëm 8 km larg qytetit, gjendet një zonë argjilore në të cilën vite më parë ekzistonte një kompleks prodhimi që më pas u braktis. Gjithashtu Shkodra ofron mundësi edhe për industrinë e ujit, falë burimeve të pasura ujore.

-*Burimet elektro-energjitike*

Shkodra është e pasur edhe me burime elektro-energjitike. Në malësitë e Shkodrës ekziston një pellg ujembledhës malor, me lartësi mesatare 800 m dhe me një rezervë energjie të shfrytëzueshme prej 400 MË/orë, e cila është e përshtatshme për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla.

Duke patur parasysh që ky sektor është kthyer tashmë në një nga më të rëndësishmit në sytë e investitorëve të huaj, mund të themi që edhe rajoni i Shkodrës që njihet si një ndër rajonet më të pasura hidrike të Shqipërisë ka mundësi për tërheqjen e këtyre investimeve.

- *Turizmi*

Turizmi në rajonin e Shkodrës ka patur traditë që në kohëra të hershme. Produktin turistik që ka ofruar ky rajon e ka konsumuar dhe pëlqyer shumë si turisti dhe vizitori i huaj ashtu edhe vendasit e sidomos shkodranët. Turizmi ka qenë i zhvilluar si në drejtim të ardhjes së turistëve të huaj ashtu edhe në konsumin në pjesën më të madhe të produktit turistik nga vendasit.

Rajoni i Shkodrës, duke e konceptuar jo të veçuar Shkodrën nga Malësia e Madhe, ka një pozitë gjeografike që favorizon më tepër nga çdo rajon tjetër në Shqipëri zhvillimin e disa llojeve kryesore të turizmit. Ato janë katër:

- Turizmi qytetar i përfaqësuar nga qyteti i Shkodrës me objektet e saj të kultit (me ekzistencën e tre besimeve fetare në qytet), monumentet e kulturës, kështjellën “Rozafa” dhe 40 shtëpitë karakteristike.

- Turizmi malor i përfaqësuar nga zona Razëm –Bogë – Theth vetëm 45km nga qyteti.
- Turizmi bregdetar i përfaqësuar nga Velipoja, vetëm 30 km nga qyteti. Ndërtimet pa leje kryesisht kanë krijuar një “lëmsh” të madh dhe të pazgjidhshëm në këtë zonë mjaft të bukur të bregdetit shqiptar. Kjo është një ndër arsytet e mungesës së investimeve të huaja në këtë zonë e cila duhet thënë se nga viti në vit po bëhet shumë tërheqëse për turistët vendas dhe të huaj (kryesisht kosovarë dhe turistë nga vendet e Lindjes). Një zonë tjetër shumë e bukur e bregdetit shqiptar është zona e Rrjollit, e cila për shkak të problemeve të pronësisë dhe mungesës së rrugës, nuk ka tërhequr akoma investime. Kjo zonë do të ishte shumë e përshtatshme për zhvillimin e fshatrave turistike.
- Turizmi liqenor i përfaqësuar nga zona e Shirokës dhe Zogaj.

- Bujqësia dhe agrobiznesi

Shkodra ka mundësi të mëdha për zhvillimin e bujqësisë në sajë të klimës së saj të favorshme, relievit kryesisht malor dhe kodrinor dhe krahut të lirë të punës në zonat rurale. Deri tani nuk ka patur investime të huaja në sektorin e bujqësisë në rajonin e Shkodrës. Bile ky ka qenë sektori më pak tërheqës për investitorët e huaj në rajonin e Shkodrës. Problemet e pronësisë së tokës, si dhe mungesa e krahut të punës në disa zona rurale të rrethit të Shkodrës (largimet masive të popullsisë së këtyre zonave drejt Italisë dhe Greqisë kryesisht, pas viteve '90), duket se i kanë mbajtur larg investitorët nga ky sektor mjaft interesant i ekonomisë shkodrane.

Gjithashtu një mundësi tjetër për investitorët e huaj është edhe sektori i agrobiznesit. Mundësitë për investime ekzistojnë në disa nënsektorë të kësaj industrie, por me interesant për rajonin e Shkodrës paraqiten ato segmente në të cilët ekziston eksporti siç janë bimët mjekësore, duhani, perimet e sezonit dhe jo të sezonit, produktet e konservuara, si: ullinjtë apo vaji i ullirit, peshku i freskët dhe ai i përpunuar etj. Premisat e Shkodrës në këtë aspekt janë të mëdha duke patur parasysh që në këtë rajon nuk mungon lënda e parë për zhvillimin e kësaj industrie (Shkodra është e pasur me bimë mjekësore, ullinj apo peshk i freskët), por as burimet njerëzore që kanë eksperiencë në këtë industri duke përmendur faktin që gjatë periudhës së para viteve '90 Shkodra ka patur disa fabrika që kanë operuar në këtë sektor të ekonomisë

(përpunimin e duhanit dhe prodhimin e cigareve, përpunimin e bimëve mjekësore, prodhimet ushqimore të konservuara, prodhimet e sheqerit, prodhimet e pijeve, qumështit, prodhimet e makaronave, bukës, orizit, vajit etj).

Pavarësisht premisave të këtij sektori, duhet pranuar që investimet e huaja në këtë sektor të ekonomisë janë minimale. Një nga arsyet e këtyre investimeve të huaja të munguara është edhe fakti se gjatë periudhës së tranzicionit, ndërmarrjet e sipërpërmendura e humbën destinacionin e tyre fillestar pasi u privatizuan. Procesi i ngadaltë i privatizimit që u aplikua gjatë viteve të para të tranzicionit edhe në rajonin e Shkodrës është një ndër arsyet e humbjes së destinacioneve të ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese dhe shpesh herë edhe e shkatërrimit masiv të tyre.

- Burimet njerëzore

Ndër burimet më tërheqëse të Shkodrës për investitorët e huaj janë padyshim burimet njerëzore. Më poshtë tregohen disa të dhëna demografike për Shkodrën:

Popullsia e rrethit të Shkodrës ka këto karakteristika:

Popullsia: rreth 230,000 (rreth 140000 banorë është popullsia e qytetit të Shkodrës).

Mosha mesatare e popullsisë së rrethit të Shkodrës është 27 vjeç.

Koeficienti i moshimit është 8%.

Tabela më poshtë bën një paraqitje të popullsisë të rrethit të Shkodrës sipas grupmoshave për vitin 2009, ku siç shihet përqindjen më të madhe e zë grup mosha 20-34 vjeç:

Tabela 1 . Popullsia e Shkodrës për vitin 2009 sipas grupmoshave

Grup moshat	0-1 vjeç	1-4 vjeç	5-9 vjeç	10-14 vjeç	15-19 vjeç	20-34 vjeç	35-54 vjeç	55-64 vjeç	Mbi 65 vjeç
Në %	1.36	7.87	8.31	8.57	8.51	26.04	22.96	7.28	9.10

Burimi: Bashkia Shkodër

- Arsimimi

Pas viteve '90 vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të personave me arsim të lartë dhe kjo pa dyshim i dedikohet Universitetit të Shkodrës, i cili nga viti në vit ka rritur numrin e degëve të tij e rrjedhimisht edhe

numrin e të diplomuarve. Duke qenë i vetmi universitet për zonën e Veriut të Shqipërisë ai është kthyer tashmë në një qendër të rëndësishme akademike dhe kërkimore që njihet dhe vlerësohet në Shqipëri dhe jashtë saj. Gjithashtu një burim i rëndësishëm i arsimimit dhe formimit profesional të Shkodrës janë edhe shkollat profesionale dhe qendrat e trajnimit profesional .

4. 2. Investimet e huaja të orientuara nga burimet njerëzore të Shkodrës

- Sektori i veshjeve dhe i lëkurë-këpucëve

Siç u theksua edhe më lart, pjesën më të madhe të investimeve të huaja në Shkodër e zënë ato në sektorin e industrisë (55%). Investimet dominuese në këtë sektor i përkasin industrisë tekstile dhe të lëkurë-këpucëve. Rreth 72% e investimeve të huaja në sektorin e industrisë punojnë me material porositësi (subjekte fasoniste), ku rreth 80% e tyre i përkasin sektorit të veshjeve. Rreth 68% e të punësuarve në ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta i përkasin industrisë tekstile dhe të lëkurë - këpucëve. Këto sektorë të industrisë kanë qenë një burim i madh punësimi për Shkodrën që para viteve '90.

Pavarësisht, rolit pozitiv në punësim të ndërmarrjeve të huaja në këta sektorë të ekonomisë shkodrane, duhet thënë se pjesa më e madhe e të punësuarve në këto sektorë janë me arsim 8-vjeçar dhe të mesëm, duke krijuar idenë se Shkodra ka potenciale njerëzore, të cilat mund të përdoren kryesisht në rrobaqepësi.

Ndërkohë që Shkodra ka potenciale njerëzore, të cilat mund të përdoren me shumë efektivitet edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë. Ajo që i mungon kësaj force të punës në Shkodër është mungesa e promovimit, kryesisht nga pushteti lokal dhe Universiteti i Shkodrës (si kryeqendra arsimore e Veriut të Shqipërisë).

- Shërbimet ndaj biznesit

Në këtë aspekt Shkodra si kryeqendra e Veriut të Shqipërisë paraqet mundësi të mëdha për të tërhequr investime të huaja. Kjo falë disa avantazheve konkurruese që ka rajoni Shkodrës, si: forcë punëtore e kualifikuar (Universiteti i Shkodrës, shkollat profesionale dhe qendrat e formimit profesional), me zotërim të gjuhëve të huaja (pjesa më e madhe

e të rinjve shkodranë flasin italisht dhe anglisht) dhe me kosto mesatare sa një e pesta e vendeve evropiane, por edhe më të ulët se rajone të tjera më të zhvilluara të Shqipërisë si Tirana apo Durrësi, mundësi për të siguruar ambiente dhe zyra të standardeve të larta falë bumit të ndërtimeve të reja në Shkodër gjatë kësaj periudhe, rrjet i telekomunikacionit në zhvillim etj.

- Sistemi Bankar në Shkodër

Banka e parë në Shqipëri e filloi jetën e saj pikërisht në Shkodër në vitin 1863 degë e Bankës Otomane si bankë emisioni e Perandorisë Turke¹⁸. Kjo bankë ishte nën kontrollin e kapitalit anglo-francez.

Në fillim të viteve '90 pas ndryshimeve rrënjësore që ndodhën, Banka e Kursimit krijoi degën e saj në dhjetor të 1992, ndërsa Banka Kombëtare hapi degën e saj në Shkodër në janar të vitit 1993.

Fillimi i viteve 2000 do të sjellë një rritje të ndjeshme të degëve të bankave në qytetin e Shkodrës. Kështu sot në qytetin e Shkodrës operojnë 13 banka të nivelit të dytë, të cilat kontribuojnë pozitivisht në punësimin dhe zhvillimin e qytetit. Tabela e mëposhtme pasqyron në mënyrë më të detajuar vitet e krijimit dhe emërtimet përkatëse të bankave. Zgjerimi i sektorit bankar në Shkodër gjatë viteve të fundit (përmes hapjes së filialeve të bankave), ka ndikuar pozitivisht si në kreditimin e ekonomisë vendase dhe në lehtësimin e kryerjes së shumë shërbimeve financiare për bizneset vendase dhe të huaja që operojnë aktualisht në Shkodër, ashtu edhe në zgjerimin e tregut të punës në këtë rajon.

Zhvillimi i tregut bankar në qytetin e Shkodrës u shoqërua me një rritje të të punësuarve pranë këtyre institucioneve financiare ku një numër i konsiderueshëm i tyre ishin të diplomuar nga Fakulteti Ekonomik i Shkodrës. Duhet theksuar se deri para tre-katër viteve ekzistonte tendenca e punësimit të pjesës më të madhe të të diplomuarve të Fakultetit Ekonomik jashtë qytetit të Shkodrës, sepse numri i bankave ishte i vogël dhe rrjedhimisht edhe kërkesa për punësim në banka ishte e ulët. Aktualisht në tregun bankar të Shkodrës mbi 60% e të punësuarve janë kuadro të diplomuar pranë Fakultetit Ekonomik të Shkodrës.

¹⁸ Agim Parruca, "Shkodra bastion e qyteterimit shqiptar", 2001.

4.3. Masat e marra për të tërhequr IHD – të në rajonin e Shkodrës

Megjithëse të ulëta krahasuar me totalin e Investimeve të Huaja në Shqipëri, IHD-të në Shkodër kanë pësuar një rritje të ndjeshme sidomos gjatë 4 viteve të fundit. Por cilat janë disa nga arsyet e kësaj rritjeje? Disa arsye janë kombëtare dhe disa të tjera janë tërësisht locale.

Ndër arsyet kombëtare pa dyshim si më të rëndësishmet mund të përmendim nënshkrimin e MSA-së, e cila i hapi rrugën Shqipërisë drejt integritit të plotë në BE, dhe siç u përmend në fillim të këtij punimi, të gjitha studimet në lidhje me integrimin në BE dhe rolin e tij në flukset e IHD-ve të vendeve të përfshira në këtë integrim, tregojnë një lidhje të fortë pozitive mes këtyre dy elementëve. Nga ana tjetër përfundimi i luftës në Kosovë dhe anëtarësimi në NATO kanë ndikuar ndjeshëm në uljen e riskut politik për Shqipërinë duke ndikuar kështu pozitivisht në tërheqjen e investitorëve të huaj që deri pak kohë më parë e konsideronin Shqipërinë një zonë të rrezikshme për investim. Gjithashtu qeveria ka ndërmarrë një sërë masash për rritjen e atraktivitetit të Shqipërisë në sytë e investitorëve të huaj dhe këtu do të përmendnim nismën “*Shqipëria 1 euro*”.

Por janë edhe disa faktorë lokalë të cilët kanë ndikuar pozitivisht në drejtim të IHD-ve. Kështu vlen të përmenden investimet e bëra nga Bashkia Shkodër në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës (furnizimi me drita dhe ujë, rikonstrukcioni i shumë rrugëve etj.), këto investime janë bërë në kuadër të zbatimit të strategjisë për zhvillimin e biznesit në Shkodër ku një sërë objektivash kanë të bëjnë pikërisht me tërheqjen e investitorëve të huaj. Vlen gjithashtu të përmendet edhe puna e disa OJF-ve si TEULEDA, të cilat kanë organizuar disa aktivitete jashtë Shqipërisë me konkretisht në disa rajone të Italisë me qëllim promovimin e Shkodrës dhe potencialeve të saj për investitorët e huaj.

Një vlerësim mjaft pozitiv për Shkodrën vjen nga një raport i fundit i Bankës Botërore, e cila në një studim të bërë në lidhje me lehtësitë e të bërit biznes në 7 ekonomitë e Evropës Juglindore e rendit atë (Shkodrën) në vendin e tretë në këtë rajon të Evropës përse i përket lehtësirave të të bërit biznes (parë në aspektin e fillimit të një biznesi). Faktorët të cilët kanë ndikuar në këtë vlerësim pozitiv janë se ditët e hapjes së një biznesi në Shkodër janë vetëm 7 ndërsa procedurat e

kërkuara për hapjen e tij janë vetëm 6 (Raporti i Bankës Botërore, 2008).

REKOMANDIME:

- Në Shqipëri, në përgjithësi dhe në Shkodër, në veçanti, nuk mungojnë burimet njerëzore. Shkodra ka një popullsi me moshë mesatare të re, të arsimuar dhe me dëshirë për të punuar, por përpjekjet e qeverisë dhe të pushtetit lokal duhet të përqendrohen në përdorimin dhe promovimin efiçent të këtyre burimeve. Zhvillimi i panairëve të tregut të punës nga pushteti lokal, në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës, për të bërë të njohur kapacitetet njerëzore të rajonit të Shkodrës, mendojmë se mund të jetë një mundësi e mirë promovimi e tyre.
- Edhe pse Shkodra ka një pozicion të favorshëm gjeografik, që favorizon zhvillimin e turizmit malor, detar dhe liqenor, IHD-të në këtë fushë nuk ekzistojnë. Për këtë arsye, rekomandojmë një promovim më të madh të këtij sektori jashtë vendit, përmes formave të ndryshme të marketingut. Pushteti lokal mund të caktojë një fond të veçantë për realizimin e këtij promovimi jashtë Shqipërisë.
- Mendojmë se pushteti lokal në Shkodër duhet të nxisë dhe të financojë nisma të tilla si ajo e OJF-së "TEULEDA", për promovimin e Shkodrës në rajone të ndryshme të Italisë.
- Duke patur parasysh nivelin e ulët të IHD-ve në rajonin e Shkodrës, rekomandojmë gjithashtu krijimin e një agjencie rajonale për IHD-të, e cila të japë informacione dhe rekomandime për investimet e huaja në sektorët prioritarë të ekonomisë së rajonit të Shkodrës. Gjithashtu, kjo agjenci mund të qëndrojë vazhdimisht në kontakt me investitorët e huaj që aktualisht operojnë në rajonin e Shkodrës, për të evidentuar problemet me të cilat ato hasen dhe për të mundësuar zgjidhjen e tyre.
- Mendojmë se pushteti lokal i Shkodrës duhet të forcojë lidhjet me emigrantët, kryesisht të rajonit të Shkodrës, që jetojnë e punojnë jashtë Shqipërisë, në mënyrë që ata të nxiten të vijnë e të investojnë në Shkodër.
- Ringjallja në Shkodër e disa aktiviteteve prodhuese të suksesshme deri para viteve '90, përmes investimeve të brendshme, mendojmë se mund të japin efekte mjaft pozitive në të ardhmen për tërheqjen e kapitalit të huaj.

- Sugjerojmë që pushteti lokal, në bashkëpunim edhe me komunitetin e biznesit vendas dhe të huaj si dhe me stafin akademik të Universitetit të Shkodrës, mund të hartojnë një strategji të plotë dhe specifike për nxitjen e investimeve të huaja, si një faktor i rëndësishëm në rritjen ekonomike të rajonit.
- Krijimi i një parku industrial, me infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme, mendojmë se do të ulte koston e investimit në mënyrë të ndjeshme në një rajon si Shkodra, duke kontribuar kështu në rritjen e flukseve të investimeve të huaja .

BIBLIOGRAFIA:

1. Bashkia Shkodër (2005):“ Strategjia e zhvillimit ekonomik 2005-2015”.
2. Faggio, G. (2001): “ Foreign Direct Investment and Wages in Central and Eastern Europe”. working paper.
3. Gerxhani, K. (1999) : “ Politico-economic Institutions and the informal Sector: A spontaneous Free Market in Albania”
4. Hunya G. (2000): “International Competitiveness Impacts of FDI on CEECs”, Research Reports,The Vienna Institute for Comparative Economic Studies, No. 268, Vienna.
5. Lati, L dhe Sollaku, S. (2002): “Ndikimi i strukturës së pronësisë mbi sjelljen e ndërmarrjes – rasti i ndërmarrjeve të privatizuara shqiptare“, working Paper, Universiteti i Tiranës.
6. Mancellari, A. (2004): “Internal Market and Trade Integration. The case of Albania” working Paper,University of Tirana.
7. Parruca, A. , (2001): “Shkodra bastion e qyteterimit shqiptar”.
8. Xhepa, S. and Agolli, M. (2004). Small and Medium-Sized Enterprises Development: Albania, Report. Institute for Contemporary Studies/Albanian Center for International Trade.

<http://www.albinvest.gov.al>

<http://www.acit.gov.al>

<http://www.instat.gov.al>

<http://www.bankwatch.org>.

<http://www.unctad.org>

<http://www.usaid.gov/our work>

<http://www.mete.gov.al>

**E drejta kontraktore si mundësi për zbatimin e
strategjive alternative të investimeve në ekonomitë e
vendeve të tranzicionit**

Armand Krasniqi, Skënder Kercuku

Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, Universiteti “Kristal”, Tiranë

The right contractor as an opportunity to implement alternative
investment strategies in economies transition countries

ABSTRACT

Every country that has passed or is in the process of transition and social transformation and economic - in normal circumstances is aware that creating conditions for active participation in the operations of the advanced beginner or are international business necessity. Of course, those depending on the stage of development they have in the international business environment, adopt and implement specific strategies. This despite the forms of operation in place or friend in the host country, speaks out the task of any government to assess the importance and cost of investment and only after that create legal opportunities for safe and secure environment. In the professional literature - scientific and practical life insight and operation of certain enterprises in terms of economy of scale for countries that have emerged from the late transition and those who will come, estimated to be difficult if not an impossible. In this situation, governments must seriously committed to align its legislation with internationally recognized standards through the application of international contractual principles. It is believed that, particularly in the development stage of initial operations, the country's economic progress can be easier, safer and economical low cost strategies based on the popular alternatives to entering through certain types of contracts internationally recognized. Alternative options market penetration which guarantees the right of each contracting country that may be in the form of licenses, franshizave, etc., must still assess and possibly apply to be part of the international business environment.

Key words: contract, contractual right, alternative investments, market economy, franshiza, license, business environment, etc..

Hyrje

Zhvillimi i intensiv i teknikës dhe i ekonomisë në mënyrë të detyrueshme është përcjellë dhe determinuar nga zhvillimi i instrumenteve dhe teknikave juridike, roli i të cilave është që të mundësojë realizimin e papengueshëm dhe të sigurt të aktiviteteve biznese. Pikërisht për shkak të zhvillimit të vullshëm dhe aktiviteteve të ndërlikuara ekonomike institutet e të drejtës klasike nuk iu përgjigjën marrëdhënieve të reja ekonomike. Para së gjithash, praktika biznese, në suaza të rendit ekzistues juridik, ka krijuar instrumente të reja juridike, të

cilat do t'i përgjigjen situatës të sapo krijuar në qarkullimin e vlerave. Së këndejmi ka ardhur deri të krijimi i një serie kontratash të reja, të cilat duke filluar nga disa parime të përgjithshme dhe premisave të së drejtës detyrimore, e duke e rregulluar situatën deri tani joekzistuese, por të krijuar faktikisht në jetën praktike, në masë të madhe fillojnë të dallohen nga të ashtuquajturat kontratat klasike të së drejtës civile. Këto kontrata, shpesh ngjasojnë me ato klasike, me përmbajtjen dhe qëllimin e tyre aq shumë diferencohen sa tani më nuk mund të flitet për përkatësinë e tyre njëra nga grupet ekzistuese të kontratave, por për kontrata të llojit të ri, të pavarur, sui – generis. Lumenjtë e jetës ekonomike në kuadër të të cilave ka ardhur deri të krijimi i llojit të ri të kontratave, madje edhe instituteve dhe degëve të reja juridike, para së gjithash janë: ndërtimtaria investive, financimet, kreditimet, operimet, investimet e përbashkëta (në vend dhe jashtë) transporti, sigurimet, turizmi, hulumtimet, etj.. Në këtë mënyrë janë krijuar dhe aplikohen kontratat mbi inxhinieringun, faktoringun, franshizingun, lizingun, etj.. Këto kontrata janë krijimet moderne juridike të praktikës biznese, e cila ka dalë nga nevoja që zhvillimi ekonomik të formësohet – përformohet juridikisht. Elementet “ekonomike” dhe “juridike” këtu ndërthurur thellësisht duke e përcaktuar esencën e secilës punë kontraktore. Pasi që në praktikë ekziston një numër i madh i punëve kontraktuale, analogjikisht ekziston mundësia që nëpërmjet tyre të krijohen strategji alternative të sigurimit të investimeve të huaja në të gjitha lumenjtë e jetës shoqërore – ekonomike.

Ecuria e procesit të investimeve në funksion të zhvillimit ekonomik në Evropën Qendrore dhe Lindore

Deri në vitet 80' të shekullit XX shumica e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore ishin të izoluar nga rrjedhat e kapitalit ndërkombëtar për shkak të natyrës dhe ekonomisë së planifikuar. Pas kësaj faze me fillimin e procesit të tranzicionit ato bëhen anëtarë të institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare për çfarë ndihma dhe mbështetja financiare e tyre bëhet njëri ndër burimet kryesore të financimit për këto ekonomi. Me përparimet e shënuara në proceset e reformës, rrjedhat financiare private çdo herë e më shumë bëhen pjesë e rëndësishme e të hyrave të kapitalit. Në kuadër të këtyre flukseve kapitali privat ka depërtuar nëpërmjet investimeve të huaja direkte dhe të

investimeve portofol. Qëllimi i çdo qeverie ishte që të sigurojë përfshirjen e partnerëve të huaj në lidhje me punësimin, investimet shtesë dhe më tej zhvillimin e kompanisë së shitur. Në këtë mënyrë, me përjashtim të çmimeve që sigurisht përbëjnë njërin ndër kriteret e rëndësishëm të vlerësimit të ofertave të investitorëve të huaj, zgjedhja e investitorëve pretendohej që të drejtohet në aspektin e angazhimit të vazhdueshëm si koncept shumë i rëndësishëm për interesat e ekonomisë kombëtare të vendit pritës. Detyra e përzgjedhjes së një partneri të huaj me reputacion është realizuar vetëm pas një analize të detajuar të planit të biznesit të propozuar. Është dëshmuar e rëndësishme dhe përgjegjësi e qeverisë që procesi sa i ndjeshëm aq edhe i ndërlikuar i përzgjedhjes të jetë varur jo vetëm nga suksesi ose modeli i procesit të privatizimit, por edhe nga një seri faktorësh të tjerë determinues politikë, ekonomikë e juridikë. Nisur nga eksperiencia e vendeve që kanë shënuar suksese në procesin e privatizimit të mbështetura në bazën e çmimit të shitjes, janë konsideruar indikatorë të saktë të synimeve të investitorëve të huaj. Motivi i të gjithë këtyre vendeve ka qenë aspirata që nëpërmjet këtyre investimeve të arrihen rezultate sa më të shpejta aq edhe efektive. Procesin e investimeve në shumicën e vendeve duhet shikuar edhe nga gatishmëria e investitorëve, të cilët kanë treguar vullnet që, pavarësisht nga shkalla e rrezikut të lartë dhe nga faktorët me ndikim të paparashikueshëm dhe të parashikueshëm, të operojnë suksesshëm dhe njëkohësisht të krijojnë fitime të mëdha. Në kuadër të këtij procesi në këto hapësira, së paku deri më tani, mund të konkludojmë se ekonomitë e tregut nuk mund të zhvillohen pa zbatimin e procesit të privatizimit në ekonomitë në tranzicion.

Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore pikërisht për shkak të efekteve negative që në raste të caktuara ka pasur procesi i investimeve të huaja direktet dhe portofolio janë bërë më të vetëdijshëm për përgjegjësitë e krijimit të një ambienti për investitorët e huaj specifikë e potencialë. Prandaj, sektorët jetikë, siç janë ato që konsiderohen të shëndetshëm dhe konkurrues në familje, kornizat ligjore dhe institucionale që të inkurajojë investimet, “*pa diskriminim*”, një sistem liberal të këmbimit valutor, tregun fleksibël të punës, rregullimin e avancuar të sektorit publik dhe sigurimi i infrastrukturës fizike dhe njerëzore, janë përcaktues në mënyrë që t’u krijohet një vend komod në kuadër të këtij mjedisi.

Megjithatë, ne jemi dëshmitarë të faktit se procesi i integritimit

ekonomik, i filluar që në fillimet e viteve 50' të shekullit XX, i ka dalluar një dinamikë pozitive zhvillimore, e cila nuk mbahet mend në historinë e njerëzimit. Vitet 80' të po këtij shekulli janë karakterizuar me rritje të konkurrencës dhe ekonomi të shkallës¹⁹, gjë që sipas mendimit tonë e ka ngushtuar dhe vështirësuar në masë të madhe interesimin e subjekteve të caktuara biznesore për investime direkte ose portofolio. Në disa nga vendet, siç mund të jetë rasti me Kosovën dhe me disa vende të tjera, procesi i tranzicionit është i stërzgatur dhe se konfigurimi i tregut rajonal nga investitorët e huaj është stabilizuar, konsiderojmë se strategjia e investimeve të huaja alternative nëpërmjet rregullimit të bazës së gjerë legjislative duke i dhënë vendin e duhur të drejtës kontraktore posaçërisht duke hartuar strategji alternative të investimeve nëpërmjet liçencave, franshizave dhe kontratave të tjera të njohura ndërkombëtare.²⁰

Veprimtaritë ekonomike- turistike me elementë ndërkombëtare

Kontrata që rregullojnë ofrimin e shërbimeve turistike, dhe kontratat e tjera të ngjashme, në pikëpamje ndërkombëtare janë kontrata nëpërmjet të cilave ofruesit e shërbimeve detyrohen, me kompensim, të ofrojnë shërbime të caktuara turistike (p.sh. vendosje, ushqime, organizimin e udhëtimit, etj.), për turistët e huaj ose për organizatat e huaja turistike.²¹ Veprimtaritë për ofrimin e shërbimeve turistike në sferën e qarkullimit ndërkombëtar realizohen nga ndërmarrjet turistike dhe hoteliere të vendit, si dhe nga organizatat ekonomike të regjistruara të organit kompetent për kryerjen e punëve të transportit ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve me botën e jashtme.²² Në aspektin ndërkombëtar veprimtaria e organizimit të turizmit rregullohet me lloje të caktuara të kontratave tip dhe kushteve të përgjithshme (si p.sh. Franshizingu, Rregullorja Ndërkombëtare për rendin shtëpiak, të cilën e ka nxjerrë Organizata Ndërkombëtare e Hoteleve dhe Ndërlidhja Ndërkombëtare e Agjencive të udhëtimit, etj.).²³ Këto uzansa në pikëpamje ndërkombëtare i definojnë të drejtat dhe detyrimet e agjencive dhe të hoteleve me rastin e pranimin të

¹⁹ Kristo I., Biznesi Ndërkombëtar, Botimi i dytë, Tiranë, 2004, f. 82.

²⁰ Po aty, f. 244.

²¹ Gorenac V & Šmid V: Poslovno Pravo u Turizam i Ugostiteljstvu., Školsaka Knjiga, Zagreb, 1999, f.11.

²² Po aty

²³ <http://www.wto.com>

mysafirëve dhe ofrimit të shërbimeve.

Praktika turistike ndërkombëtare ka krijuar një seri kontratash specifike, të cilat rregullojnë kryerjen e shërbimeve turistike në lëmin ndërkombëtar dhe njëkohësisht ndihmojnë që bashkëpunimi biznesor ndërkombëtar dhe depërtimi i investimeve të huaja të jetë i lehtë dhe i mundshëm. Kontratat e sipërpërmendura në ekonomi e në veçanti në planin turistik, në praktikë janë mjaft të ndërlikuara dhe përveç se rregullojnë marrëdhëniet në relacionin: shfrytëzues të shërbimeve turistike – agjencioni turistik; organizata turistike – hoteli dhe hoteli shfrytëzues i shërbimeve ato sigurojnë pjesëmarrjen e investitorëve të huaj që kanë reputacion dhe fuqi ekonomike. Në biznesin turistik më të rëndësishmet kur është fjala e rregullimit të marrëdhënieve me mes të palëve kontraktuese janë kontrata e franshizingut, lizingut Know How – it, etj.. Nëpërmjet rregullimit të këtyre marrëdhënieve, përveç sigurimit të investimeve, shfrytëzohen edhe teknika dhe praktika bashkëkohore që kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave mbi qiranë e objekteve hoteliere, kontratave në bazë të kërkimit dhe vërtetimit e rezervimit dhe kontratave mbi alotmanin.²⁴

Funksionimi i së drejtës kontraktore - kusht për strategjinë alternative të investimeve

Marrëdhëniet shoqërore – ekonomike specifike, të cilat kanë ndikuar në krijimin dhe kodifikimin e së drejtës biznesore ndërkombëtare, kanë kaluar nëpër një rrugë të gjatë. Në këtë pikëpamje procedurat konkrete për zyrtarizimin e kodifikimit dhe unifikimit kanë qenë mjaft të koklavitura e të ngadalshme sa që proceset ekonomike nuk kanë mundur të presin. Spontanisht, nëpërmjet praktikës në sferën e biznesit ndërkombëtar, dokeve, rregullave të përgjithshme të afarizmit, kontratave tip dhe formular, gradualisht është krijuar një e drejtë profesionale të cilën nuk e ka krijuar shteti, por organizatat e ndryshme biznesore. Nga praktikat biznesore ndërkombëtare në teorinë e të drejtës është emërtuar si e drejtë biznesore autonome ndërkombëtare. Unifikimi përmes kontratave ndërkombëtare, kronologjikisht ka ndikuar në procesin e unifikimit spontan. Mund të konstatohet se kodifikimi i të drejtës dhe rregullave

²⁴ Gorenac V & Šmid V: Poslovno Pravo u Turizam i Ugostiteljstvu., Školsaka Knjiga, Zagreb, 1999, f. 139.

materiale në lëmin e të drejtës kontraktore ndërkombëtare përveç qëllimeve kryesore të rregullimit të raporteve specifike në këtë lëmë kanë krijuar edhe mundësinë që vende të tranzicionit të shfrytëzojnë kontratat për të përmirësuar zhvillimin e vet ekonomik pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të shtetit.²⁵

Funksionimi në bazë të praktikës biznesore ndërkombëtare

Parimi i autonomisë së shprehjes së vullnetit të palëve është afirmuar në të gjitha sistemet juridike në lëmin e marrëdhënieve detyrimore. Pra, të gjithë ligjdhënësit nisen nga supozimi se vetë palët në mënyrën më të mirë dhe të përshtatshme do të rregullojnë marrëdhëniet e tyre, të bazuar në interesin e përbashkët dhe rrethanat konkrete për secilën punë juridike. Parimi i vullnetit të palëve ka luajtur rolin kryesor në formimin e rregullave uniforme juridike të biznesit ndërkombëtar. Duke i shfrytëzuar këto mundësi, afaristët ndërkombëtarë kanë thelluar pozitivisht marrëdhëniet e tyre pothuajse deri në fund dhe plotësisht duke i rregulluar ato me kontratë. Këto marrëdhënie janë sforcuar më tutje duke i paraparë dhe inkuadruar të gjitha elementet, në mënyrë detale, në kontratë me të cilën i rregullojnë çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë edhe me kontestet eventuale, ligjin e aplikueshëm nacional etj. Përsëritja e vazhdueshme e klauzolave me përmbajtje të njëjtë në këto kontrata arrin që të shndërrohen në rregulla doksore të biznesit ndërkombëtar, të cilat në praktikë e dërgojnë sistemin e vjetëruar juridik nacional dhe relativizmin e ndikimit të shtetit në marrëdhëniet ekonomike. Në procesin e unifikimit të të drejtës ndërkombëtare tregtare përmes praktikës që sot krijon mundësi të mëdha zhvillimi dhe investimi, rol të rëndësishëm kanë luajtur organizatat e mëdha dhe të fuqishme profesionale dhe shoqata, të cilat kanë qenë në pozitë të influencojnë tipizimin e rregullave në një lëm të caktuar të të drejtës ndërkombëtare biznesore. Me kontratat e tyre tip dhe formular paraprakisht kanë qenë të rregulluara edhe elementet më të imta, konfrom klauzolës për *“kryerjen e veprimtarive më lehtësi dhe më siguri”*. Palët të cilat dëshirojnë që të lidhin kontratë me pjesëtarët e këtyre organizatave, nuk kanë mundësi të tjera vetëm që t’i pranojnë në tërësi ose të refuzojnë në tërësi kushtet e kontratës, dhe se pikërisht nga kjo emërtohen kontrata sipas aderimit (pranimit) apo kontratë athezione. Si

²⁵ V. Šmid: Putnička agencija i njeni ugovori s putnicima i davaocima Usluga., Monografij, Savremena Administracija Beograd, 1977, f. 48.

formë e unifikuar e tipizimit të kontratave janë edhe kushtet e përgjithshme ose kushtet e biznesit, të cilat i sjellin organizatat profesionale të sipërpërmendura në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve kontraktore në një lëmë shkencore të caktuar.

Me kushtet e përgjithshme dhe kontratat formulare janë krijuar parimet ndërkombëtare biznesore, të cilat përjashtojnë zbatimin e të drejtave nacionale dhe sjellin në praktikë teknika të reja për lidhjen e kontratave. Në këtë funksion procesi dhe procedurat e strategjive alternative të investimeve bëhen të lehta dhe me kosto jashtëzakonisht të ulët. Ato themelohen në atë mënyrë që palët pa shumë mund dhe me pak kohë të shpenzuar të lidhin kontrata me të cilat i rregullojnë në detale marrëdhëniet e tyre. E drejta e cila është krijuar si produkt i këtyre marrëdhënieve, në teorinë juridike, quhet e *drejta formulare*.²⁶ Duke iu falënderuar këtyre kontratave, në lëme të ndryshme shkencore të biznesit ndërkombëtar është krijuar një rregullim i ri juridik, i cili përjashton përdorimin e sistemit juridik nacional. Në këtë mënyrë arrihet që plotësisht të përjashtohet mundësia e ndërhyrjes të gjykatave në raste të caktuara kontestuese. Subjektet biznesore ndërkombëtare parapakisht parashohin kompetencën e mekanizmave të veçantë respektivisht arbitrazhave ose gjykatave të zgjedhura, gjë që rrjedhimisht e rrisin në masë të madhe sigurinë e investimeve. Shikuar në aspektin e përgjithshëm, subjektet biznesore ndërkombëtare në kontratat e tyre me lehtësi arrijnë që t'u mënjanojnë aplikimit të të drejtës nacionale dhe gjykatave, duke arritur kështu që të krijojnë një sistem të veçantë të sanksioneve që do të shqiptoheshin kundër atyre palëve të cilat refuzojnë që të zbatojnë vendimet e arbitrazhit. Pavarësisht nga elementet pozitive dhe negative që ka e drejta formular në praktikë, ajo është duke u zhvilluar, edhe pse ndoshta në mënyrë anarkike, duke i rregulluar në detaje çështjet, në bazë të klauzolave dhe autonomisë së vullnetit të palëve, të cilat lidhin kontrata dhe njëkohësisht është një formë – alternativë e tërheqjes së investimeve të huaja për vendin.

Përafrimi i legjislacionit me konventat ndërkombëtare

Aktet e unifikuara më përpara karakterizohen me zbatimin e tyre vullnetar. Kjo nënkupton se ato janë zbatuar vetëm te kontratat në të cilat palët janë thirrur në to ose ato nuk janë përjashtuar. Detyrueshmërinë e

²⁶ Krasniqi, A: E drejta në Turizëm dhe Hotelieri, Shkolla e biznesit, Pejë, 2004 f. 32.

zbatimit të rregullave të unifikuara mund të sigurojnë vetëm aktet të cilat i kanë miratuar organet kompetente shtetërore përmes konventave ndërkombëtare. Koncepti për unifikimin zyrtar fillon nga ligji, jurispodenca e doktrinë shkencore dhe rezultatet e para janë arritur në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Të arriturat më të rëndësishme në këtë lëmë janë shënuar lidhur me pasurinë industriale, komunikacion, të drejtës kambialore dhe çekore. Tendencave për të qëndruar dhe vazhduar më tutje në këtë drejtim i kanë kontribuar edhe organizatat (shtetërore) ndërkombëtare.²⁷

Organizata e Kombeve të Bashkuara duke e studiuar dhe njohur mirë efektin e shumëfishtë pozitiv që unifikimi i të drejtës biznesore në planin regjion dhe në atë global ka potencuar rëndësinë e kësaj detyre. Në kuadër të kësaj më rëndësi të veçantë potencohet veprimtaria e OKB – së, lidhur me unifikimin e së drejtës. Hap të rëndësishëm ka paraqitur themelimi i komisionit të veçantë pranë kësaj organizate për të drejtën biznesore ndërkombëtare (UNCITRAL) në vitin 1966. Përafërsisht për tri dekada puna e UNCITRAL ka dhënë rezultate të rëndësishme, duke sjellë këto Konventa dhe rregullore:

- Konventa e OKB mbi paparashikueshmërinë para shitjes ndërkombëtare
- Konventa e OKB mbi kontratat për shtijen ndërkombëtare
- Konventa e OKB mbi trasimin kambialit personal ndërkombëtar
- Konventa për çequet ndërkombëtare
- Rregullorja për arbitrazhin UNCITRAL
- Konventa për transportin e mallrave
- Rregullat uniforme mbi klauzolat për shumën e kontraktuar për shkak të mospërmbushjes.²⁸

Metoda dytë, për natyrën uniforme të të drejtës kontraktore, karakterizohet me efekte të rregullimit të marrëdhënieve të caktuara. Me miratimin e ligjeve të ngjashme rregullohen marrëdhëniet e caktuara nëse ato e kanë karakterin ndërkombëtar, ndërsa ligji nacional, nëse edhe më tutje qëndron në fuqi, rregullon vetëm marrëdhëniet e karakterit të

²⁷ VukovićB & Ksenija K: Turizam i Razvoj – Pjam, načela, postupci., Manualia Universitatis Studiorum Zagrabiebis, Zagreb, 2001, f. 257.

²⁸ Po aty.

brendshëm. Kjo nënkupton se me miratimin e konventës në praktikë ekzistojnë dy lloje dispozitash:

- Rregullat e ngjashme ligjore të miratuara në konventë, e cila zbatohet në marrëdhënie kontraktore me palët të cilët njëra i përket shtetit të huaj me të cilin është nënshkruar konventa
- Rregullat ligjore nacionale të cilat edhe më tutje zbatohen në marrëdhënie kontraktore të cilat kanë elementë të huaj.

Ligjet uniforme si burime të së drejtës edhe pse të rralla, janë rezultat i një pune të gjatë, të vështirë dhe të koklavitur, por që sot prodhojnë efekte pozitive për zhvillimin e ekonomisë dhe të formave dhe strategjive alternative për tërheqjen e investimeve të huaja. Dokumentet ndërkombëtare të cilave duhet t'u përshtatet legjislacioni i turizmit dhe hotelerisë për strategji alternative dhe efektive për investime të huaja.

Nëse e komentojmë literaturën ekzistuese dhe burimet që na ofron praktika biznesore ndërkombëtare do të bindemi se vendet e Evropës të cilat e kanë turizmin të zhvilluar janë në proces të vazhdueshëm që të kenë një strategji unike, fleksibile dhe të qëndrueshme për të garantuar zhvillim të lartë të turizmit elitare. Nisur nga kjo që në fillim të shekullit XXI këto vende kanë vërtetuar nevojat për strategjitë e qëndrueshme të zhvillimit të turizmit. Konferenca e komisionit për turizëm të qëndrueshëm (CSD), e ka cilësuar turizmin si njërin ndër forcat më të madha me fuqi lëvizëse në proceset e stabilitetit dhe të qëndrueshmërisë. Në këtë konferencë është konstatuar se Evropa është njëra ndër burimet më kryesore të turizmit, e cila sot përfshin rreth 60% të tregut në raport me ardhjet ndërkombëtare (sipas statistikave të WOT të vitit 1999). Është karakteristike se në Evropë realizohen 50% të udhëtimeve intelektuale në raport me tërë botën.²⁹ Nga kjo konferencë ka afirmuar rolin specifik të turizmit dhe iu është bërë thirrje të gjitha vendeve të BE-së dhe vendeve të cilat pretendojnë të integrohen në BE, që urgjentisht të marrin masa për nxjerrjen dhe implementimin e politikave për turizëm të qëndrueshëm në mënyrë që me mekanizëm të fuqishëm legjislativ të garantojnë këtë objektiv.

Nga kjo kanë dalë disa parime të cilat duhet të jenë të detyrueshme për të gjitha vendet të lidhura me çështjet se

- Turizmi është industri e rëndësishme e ekonomive vendore

²⁹ Center for responsible and sustainable tourism development, 29.01.2004, f. 1.

- Ndikon pozitivisht në cilësinë e jetesës dhe mjedisit
- Nevojën e investimeve të vazhdueshme për ekonomi cilësore turistike
- Nevojën e politikave evropiane për kufizimin e efekteve supraregjonale
 - Çështjeve kryesore për politikën e turizmit të qëndrueshëm
 - Programi akcional për turizëm të qëndrueshëm në Evropë
 - Turizmi dhe komunikacioni.

Të gjitha këto më qëllim të ndërmarrjeve të aksioneve konkrete në këtë lëmë aktiviteteve në planin nacional dhe atë lokal, zhvillimin regjional dhe planifikimin hapësinor, sigurimin dhe ruajtjen e hapësirave mjedisore, zhvillimin e formave të ndryshme të bazuar në ekoturizmin, etj..

Vendet pjesëmarrëse në këtë konferencë kanë hartuar një kërkesë të veçantë të cilën ia kanë adresuar BE –së, respektivisht Komisionit Evropian dhe institucioneve kompetente të vendeve anëtare që të zbatojnë politika koherente dhe efikase për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe posaçërisht i lusin vendet që i kushtojnë kujdes mjedisit jetësor dhe politikave mjedisore.³⁰ Njëkohësisht këto politika, vizione, qëllime dhe strategji duhet të shfrytëzohen në formën e kooperimit kontraktual duke siguruar njëkohësisht një mundësi alternative investive për subjektin biznesor të interesuar dhe për vetë vendin në përgjithësi.

Përfundim:

Procesi i tranzicionit për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore është përcjellë me zhvillime interesante dhe rolin dominant të shtetit për mëkëmbje dhe transformim ekonomik nëpërmjet krijimit të kushteve për investime të huaja direkt dhe portofol. Meqë koha, fazat dhe tërësia e procesit të transformimit në këto vende nuk ka qenë e njëjtë, për shkak të ndikimit të efekteve të caktuara politike, funksionit të shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, suksesi i tyre natyrisht që nuk ka konstatuar që të jetë i ngjashëm. Vendet e Ballkanit për shkak të mbizotërimit të situatave të komplikuar politike me vështirësi po arrijnë të transformojnë sistemin ekonomik dhe të rrisin aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve nacionale. Në kuadër të rikofigurimit të tregut në këto hapësira kanë përfituar vendet

³⁰ Center for responsible and sustainable tourism development, po aty.

me ekonomi të qëndrueshme duke diktuar kushtet në bazë të parimit të ekonomisë së shkallës. Pa dyshim turizmi si veprimtari ekonomike dhe biznesit turistik ndërkombëtar në sferën e qarkullimit të njerëzve, kapitalit, mallrave dhe shërbimeve është bërë proces dinamik dhe dominant në marrëdhëniet e reja shoqërore. Mirëpo, është interesante se zhvillimi i turizmit në përmbajtje është pothuajse jokompatibil me zhvillimet të cilat kanë ndodhur në aspektin formal – të rregullativës juridike nacionale. Fakti se turizmi është më shumë veprimtari e karakterit ndërkombëtar dhe si e këtillë kërkon legjislacion cilësor e të unifikuar, shtet që zbaton ligjin dhe parime të avancuara juridike ndërkombëtare. Andaj këto komponente garantojnë përparime ekonomike vetëm nëpërmjet bashkëpunimit në pikëpamje regjionale dhe globale. Shumica e vendeve turizmin e rregullojnë më norma juridike nacionale, të cilat jo rrallë behën pengesë për zhvillimin e kësaj lëmë. Duke u nisur nga kjo situatë organizata e ndryshme turistike, kompanitë, touroperatorët etj., zhvillimin e turizmit, në pikëpamje juridike, e kanë mbështetur në shfrytëzimin e parimeve dhe zakoneve biznesore duke i fisnikëruar këto marrëdhënie edhe me parimet dhe kushtet e të drejtës kontraktore. Sifidimi i legjislacionit nacional dhe zvogëlimi i ndikimit të shtetit në rregullimin e veprimtarisë turistike në masë të madhe i ka kontribuar zhvillimi i përgjithshëm i marrëdhënieve kontraktore ndërkombëtare sipas parimeve të së cilës ofrohen metoda për tejkalimin e vështirësive që shfaqen në mes të sistemeve juridike nacionale duke dhënë edhe rekomandime që këto raporte të rregullohen sipas parimeve të të drejtës biznesore. Rolin dominant për rregullimin e këtyre marrëdhënieve po e luan parimi i “*autonomis së vullneit*” në marrëdhënie kontraktore. Në përgjithësi, konform proceseve ndërkombëtare për globalizimin dhe integrimin e vendeve në bazë të unifikimit të sistemit juridik, turizmi dhe e drejta e turizmit ndërkombëtar seriozisht janë duke tentuar që nëpërmjet instrumenteve juridikë të unifikojnë bazën legale dhe atë nëpërmjet forumeve ndërkombëtare, normalizimit të praktikës biznesore ekzistuese dhe unifikimit nëpërmjet konventave ndërkombëtare. E gjithë kjo veprimtari do të jetë garanci e zhvillimit të mëtejshëm të turizmit dhe të rregullimit juridik cilësor në pikëpamje ndërkombëtare. Mbi të gjitha avancimi i këtyre marrëdhënieve ndërkombëtare ka ndikuar në lindjen e një seri kontratave të reja, të cilat jo vetëm që palëve kontraktuese u garantojnë siguri të lartë juridike, por njëkohësisht u mundësojnë edhe

shteteve që rishikojnë mundësitë për hartimin dhe zbatimin e strategjive alternative për tërheqjen e investimeve të huaja në vend. Këto kontrata tani më kanë faktuar se e drejta kontraktore autonome e palëve arrin që të kufizojë rolin e shtetit, të rrisë sigurinë juridike biznesore, tërheqjen e investimeve të huaja me një kosto të ulët ekonomike, sigurim të profit dhe nëpërmjet bashkëpunimit biznesor të rrisë imazhin dhe forcën konkurruese të ndërmarrjeve vendore në tregun ndërkombëtar.

Literatura:

1. Andersen, A., Regionalism and the World Trading System, WTO, 1995
2. Gorenac V & Šmid V., Poslovno pravo u turizam i ugostiteljstvu, Zagreb 1999
3. Hetemi M., E drejta me njohutitë themelore të së drejtës afariste, Prishtinë, 1996
4. Kristo I., Biznesi Ndërkombëtar, Tiranë, 2004.
5. Krasniqi A., E drejta në turizëm dhe hotelieri, Pejë, 2005.
6. Šmid Dr. V., Putnička: Agencija i njeni ugovori s putnicima i davaocima usluga. Savremena Administracija, Beograd 1977
7. Šmid Dr. V., Putnička: Agencija i njeni ugovori s putnicima i davaocima usluga. Savremena Administracija, Beograd 1977
8. Gorenac V & Šmid V., Poslovno Pravo u Turizmu i Ugostiteljstvu, Zagreb, 1999
9. Godštajn A: Privredno ugovorno pravo., Informator br.1, Zagreb 1980.
10. M Skakun., Poslovno Pravo, Beograd 2000
11. UNCTD (1999) World Investment Report (WIR) 1999, New York;
12. UNCTD (2000) World Investment Report (WIR) 2000, New York;
13. OECD (1992) Foreign Direct Investment in Central and Eastern Europe: Policies and Trends in Fourteen Economies in Transition, Paris;

14. Global forum for *tourism* policy issues and a practical source of *tourism* know-how.
www.unwto.org/
15. ECE (1999) Economic Survey of Europe in 1999, Third part, NY and Geneva
16. <http://www.wto.org/>
17. <http://www.unwto.org/>

Sfidat e ekonomisë shqiptare

Ylvije Kraja (Boriçi), Emira Spahaj

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti i Administrim-Biznesit,
Universiteti “Kristal”, Tiranë*

Challenges of albanian economy

ABSTRACT

This paper is going to present the challenges of Albanian economy. The aim of this article is to evaluate the impact of the world crises in the Albanian economy. The Albanian economy has passed through a long period of transition. There are 20 years now that the Albanian economy is moving ahead and is having sustainable growth. All economic factors and the businesses in the Albania should be part of the economic development strategy for the future and also in this process should be involved even local and central government in the sustainable economic growth, since economic problems are complex and interrelated. This paper in the end provides some conclusions and some recommendations on how to improve and to have sustainable growth in our economy.

Key words: *challenges, economic growth, sustainable growth.*

Hyrje

Ekonomia shqiptare është një ekonomi që kaloi nga një periudhë tranzicioni drejt një bote me një pasiguri shumë të madhe dhe pavarësisht ritmeve të rritjes ekonomike të vendit për shkak të krizës financiare globale, ekonomia shqiptare nuk shkoi në recension, ashtu siç ndodhi me

shumë ekonomi të tjera në botë.

Si³¹ rezultat i procesit të globalizimit, zhvillimi i ekonomisë botërore po përjeton ndryshime të shpejta, transformime jo vetëm të natyrës sasiore, por mbi të gjitha, ajo po evidenton shndërrime të shpejta cilësore dhe shumë dimensionale, të cilat e kanë bazën e tyre në zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të informacionit.

Ekonomia shqiptare ka pësuar ndryshime rrënjësore si në drejtim të bazës së funksionimit të saj, ashtu edhe në drejtim të strukturës së përbërjes dhe zhvillimit të saj.

Zhvillime të ekonomisë shqiptare

Rritja ekonomike është rritja e prodhimit, kapaciteteve prodhuese dhe e të gjithë përbërësve të tjerë të një ekonomie. Rritja ekonomike vjen si pasojë e rritjes së fuqisë punëtore, të kapitalit, teknologjisë apo rentabilitetit të punëtorëve.

Rritja ekonomike ndodh kur njerëzit i marrin burimet dhe i riarrenxhojnë në mënyrë që të jenë më të vlefshme. (Economic Growth, Paul M Romer, 2007)

Rritja ekonomike matet me shkallën e rritjes, e cila shprehet si prodhimi i brendshëm bruto ndarë nga numri i banorëve, GDP për frymë. (Macroeconomics, Paul Krugman & Robin Wells, Second Edition).

Shqipëria ka bërë përparime në drejtim të zhvillimit. Inflacioni është vënë përgjithësisht nën kontroll dhe sektori bankar është vërtet duke u zhvilluar.

Infrastruktura e tregjeve financiare të fuqishme, e përbërë prej infrastrukturës fizike, sistemeve dhe proceseve, rregullit të ligjit, një kulture banking, mund të ndihmojë në nxitjen e investimeve të brendshme dhe të huaja, në promovimin e rritjes ekonomike.

Britanikët shpikën patentat dhe të drejtën e autorit në shekullin e

³¹ Ekonomia dhe tranzicioni (reviste ekonomike QSHKE). Shpejtësia e kësaj lëvizje ka si moto të vetën, rritjen e fluksit të shkëmbimeve tregtare, uljen e kostove të transaksioneve si dhe reduktimin e barrierave administrative.

17- të, amerikanët veriorë shpikën universitetet moderne, sfidat me të cilën përballen vendet e industrializuara është që të shpikin institucione të reja që inkurajojnë një kërkim dhe zhvillim më të lartë në sektorin privat.

Shqipëria ka qenë mjaft e sukseshme në përballimin e efekteve të krizës ekonomike dhe kjo falë politikave të duhura që janë ndjekur .

Të gjitha këto kanë bërë që të rritet kredibiliteti i mjedisit ekonomik shqiptar si një mjedis i aftë për t'u integruar jo vetëm në tregjet e vogla rajonale, por edhe në strukturat konkurruese evropiane.

Mekanizmi i tregut ndonëse jo i përsosur, ka vërtetuar me kalimin e kohës të jetë shpërndarësi më eficient dhe më i besueshëm i burimeve ekonomike.

Vendet e orientuara nga tregu kanë shansin të përfitojnë nga përparimet në teknologji, nga shpejtësia e qarkullimit dhe e përpunimit të informacionit.

Shqipëria ka qenë një ndër të paktat vende që i ka rezistuar krizës ekonomike ndërkombëtare dhe e pati më të lehtë të kalojë sfidat, me të cilat u përballën vendet e tjera gjatë krizës. Ekonomia shqiptare përformoi pozitivisht.

Përdorimi i instrumenteve ekonomikë, si ato fiskalë dhe monetare çojnë në rritje ekonomike dhe ulje të punësimit, (f. 377, Economies in transition, sesioni 3-4).

Vendet e tjera të rajonit

Situata në rajon dhe në botë, nuk është se paraqitet në formën e saj më të shkëlqyer. Por vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet e larta në sistemin financiar, e kjo në aspektin e sistemit global. Viti 2010 mund të cilësohet si një vit pozitiv për ekonominë shqiptare, po ta krahasojmë me situatën ekonomike të vendeve të rajonit. Për Bosnjën, Malin e Zi dhe Kroacinë parashikohet që rritja ekonomike në 2010-n të jetë negative në shifrën -1 %. Maqedonia pritet që këtë vit të jetë në një gjendje stanjacioni, një situatë me rritje ekonomike zero. Përveç Shqipërisë, rritje ekonomike me rreth 1 % pritet të kenë edhe Republika e Çekisë, Sllovakia dhe Sllovenia, ndërsa Hungaria, Rumania, Serbia dhe Bullgaria pritet që të mos shënojnë rritje.

Norma e rritjes ndryshon vazhdimisht nga njëri vend në tjetrin. Vendet e Azisë Lindore, si: Singapori, Korea e Jugut dhe Taivani kanë

pasur një rritje ekonomike me 7 % në vit. Si rezultat i kësaj norme e ardhura mesatare është dubluar në 10 vite. Në të kundërtën disa vende të Afrikës kanë të ardhura mesatare të ulëta. (Macroeconomics, Gregory Mankew).

Sistemi bankar

Shqipëria ka modernizuar sistemin financiar dhe rrjeti bankar e lehtësoi ndjeshëm goditjet që ekonomia mori nga kriza ekonomike botërore.

Përfitimet nga një sistem tregu janë edhe në sektorin financiar. Në sferën bankare, mekanizmi i tregut vepron në shpërndarjen e burimeve financiare. Një sistem bankar i orientuar nga tregu mund të shërbejë fuqishëm në rritjen ekonomike.

Sektori bankar është relativisht i shëndoshë, bankat kanë kapital të konsiderueshëm. Ketë verë kemi pasur forcimin e monedhës, kundrejt valutave euro/dollarë.

- Të gjitha këto kanë bërë që të rritet kredibiliteti i mjedisit ekonomik shqiptar si një mjedis i aftë për t'u integruar jo vetëm në tregjet e vogla rajonale, por edhe në strukturat konkurruese evropiane.
- Zhvillimi dhe modernizimi i sektorit financiar, ndërmjetësit financiarë, kredia dhe kostoja e saj, tregu i kapitaleve dhe funksionimi i tij, do të jenë faktorë që do të mbështesin modernizimin e ekonomisë shqiptare dhe modelin e ri.
- Në bankat tregtare që veprojnë në Shqipëri është evidentuar një rritje e ndjeshme e depozitave të popullatës dhe të bizneseve private.
- Kjo do të thotë se sektori bankar operoi me masa të forta në sistemin e kredidhënies ndaj biznesit.
- Papunësia e emigrantëve shqiptarë në këto shtete bënë, që ata të sjellin më pak kursime në Shqipëri.

Modeli i ri duhet bazuar në kapitalet njerëzore të mirëkualifikuara, në teknologjitë dhe infrastrukturën moderne, në një ambient biznesi sa më mbështetës dhe nxitës, në ente rregullatore dhe mbikëqyrëse sa më efektive. Këto reforma pa kosto buxhetore mund ta rrisin produktivitetin e ekonomisë sonë, mund të rrisin tregjet dhe mund të mbështesin më mirë ritmet e larta dhe të qëndrueshme të saj.

EKSPORTET

Ecuria e ekonomisë në këto vite është karakterizuar nga luhajtje mjaft të mëdha në drejtim të stabilitetit, ristrukturimit, ritmeve të rritjes etj, duke pësuar shumë transformime. Kjo ecuri ka shoqëruar edhe atë pjesë të ekonomisë së orientuar drejt eksportit duke e kthyer ekonominë dhe tregun e brendshëm në një ekonomi dhe treg të mbështetur kryesisht tek importi.

Megjithëse eksportet shqiptare kanë njohur një rritje të shpejtë, kërkesa totale në ekonomi ka qenë e pamjaftueshme për të shfrytëzuar plotësisht kapacitetet prodhuese të vendit.

Lufta e tregjeve është mjaft e vështirë dhe veçanarisht për produktet tona të eksportit.

Shqipëria ka qenë mjaft e suksesshme në orientimin e eksporteve shqiptare për të shkuar drejt specializimit të produktit dhe të shërbimit. Promovimi i markës shqiptare të produkteve “Made in Albania” është objektivi strategjik i nxitjes së eksporteve.

- Mallrat shqiptare po prezantohen në cilësi dhe shifra shumë të kënaqshme në tregjet evropiane.
- Në krahasim me një vit më parë, ka një rritje prej 77.7 % të “eksportit të parë”, ose mallrave me origjinë 100% shqiptare dhe një rritje me 122.1% të rieksperteve, që i përkasin përpunimit aktiv, këtu bëhet fjalë për përpunimin e lëndës së parë industriale që importohet nga jashtë dhe eksportohet përsëri në vendet e Bashkimit Evropian.
- Riekspertet nga përpunimi aktiv gjatë 6 muajve të këtij viti shënuan gjithashtu rritje në sasi e vlerë krahasuar me 6 mujorin e parë të vitit të kaluar.
- Pasuritë tona natyrore duhet të përfshihen në një cikël më të plotë nxjerrje-përpunimi dhe eksportimi, duke rritur vlerën e shtuar në ekonomi dhe duke rritur të ardhurat nga eksporti
- Rritja e produktivitetit të kompanive shqiptare duke shfrytëzuar avantazhet konkurruese të saj dhe bërjen e ekonomisë shqiptare kompetitive.
- Eksportet shqiptare gjatë muajit qershor, 2010 shënuan gjithashtu rritje në sasi e vlerë, krahasuar me muajin qershor, 2009.
- Rritja e treguesve të eksportit të mallrave, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të prodhimit të sektorëve aktualë që punojnë për eksport,

si dhe shtimi i gamës së sektorëve dhe artikujve të rinj për të dalë në eksport.

Lufta e tregjeve është mjaft e vështirë dhe veçanërisht për produktet tona të eksportit. Në këtë kontekst, orientimi i eksportuesve shqiptarë për të shkuar drejt specializimit, të produktit dhe shërbimit merr një rëndësi primare. Promovimi i markës shqiptare të produkteve “Made in Albania” është objektivi strategjik i nxitjes së eksporteve.

Rritja ekonomike aktuale përballë asaj potenciale

Nga Adam Smith e këtij, dimë se zhvillimi është shtyrë, është nxitur nga kërkimi i fitimit.

Rritja e aktivitetit ekonomik është mbështetur së fundi nga gjallërimi i sektorit privat. Sektori publik, ndonëse vijon të japë një ndikim pozitiv të saj të stimullit fiskal, ka ulur kontributin e tij në aktivitetin ekonomik. Rritja e shpejtë e eksporteve dhe tendenca pozitive e investimeve private kanë dhënë ndikim më të madh në rritjen ekonomike. Ekonomia shqiptare vazhdon të karakterizohet nga përmirësimi gradual i aktivitetit, por ajo mbetet gjithsesi poshtë ritmeve potenciale të zhillimit të saj. Problemi kryesor me të cilën po përballet dhe do të vijojë të përballet ekonomia jonë është niveli i ulët i kërkesës së brendshme. Megjithëse eksportet shqiptare kanë njohur një rritje të shpejtë, kërkesa totale në ekonomi ka qenë e pamjaftueshme për të shfrytëzuar plotësisht kapacitetet prodhuese të vendit. Kjo situatë është reflektuar ndër të tjera në: presione të ulëta inflacioniste të gjeneruara nga ekonomia e brendshme, në një ecuri më të zbehte të tregut të punës dhe të treguesve të punësimit, si dhe në një kërkesë të moderuar të ekonomisë për kredi bankare.

Një rritje e qëndrueshme imponon përmirësimin cilësor të ambientit të biznesit, duke rritur hapjen ekonomike të vendit, duke reduktuar barrierat administrative, duke dhënë incentive për sektorët e ekonomisë që rrisin aftësinë konkurruese, që rrisin tregjet potenciale, që ulin kostot dhe çmimet për mallrat dhe shërbimet në tregun e brendshëm dhe global.

Në terma vjetore, të ardhurat buxhetore janë rritur me 5.7 %, ndërsa shpenzimet janë tkurrur me 5.5 % gjatë tetë muajve të parë të vitit (A. Fullani, Governor i Bankës Qendrore.)

Faktorët e rritjes aktuale

- Stabiliteti makroekonomik-inkurajon mjedis ekonomik të favorshëm, çmime relativisht të qëndrueshme, dhe nivel të kënaqshëm besimi ndaj monedhës.
- Faktorët e produktivitetit – rialokimi i burimeve nga sektorët me produktivitet të ulët drejt atyre me produktivitet të lartë.
- Zgjerimi i konsumit – ka dy elementë që e nxisin këtë
 - Rritja e kreditimit
 - Remitancat e emigrantëve – këto janë një burim i prurjeve valutore në vend. Rënia e dërgesave nga emigrantët duhet të kompensohet duke mbështetur eksportet.
- Kemi rritje ekonomike falë sistemit të shëndoshë bankar.
- Ekspozimit të kufizuar të ekonomisë shqiptare ndaj tregjeve ndërkombëtare.
- Mbledhja e të ardhurave në tatime dhe në dogana ka bërë që ekonomia shqiptare të njohë rritje gjatë këtij viti.
- Faktorët që e pengojnë rritjen ekonomike janë sidomos:
 - Mungesa e pronësisë
 - Niveli i lartë i informalitetit
 - Korrupsioni, etj..

Duhet siguruar funksionimi sa më eficient i konkurrencës së lirë, duke lejuar që të aktivizohen mekanizmat e stabilizimit të tregjeve.

Sfida e ekonomisë shqiptare

Rritja ekonomike e qëndrueshme dhe zhvillimet e gjithanshme sociale dhe politike mbetën sfidat e Shqipërisë në kushtet e paskrizës financiare ndërkombëtare.

Sfida e Shqipërisë për arritjet e mëtejshme konsiston në aftësinë e ekonomisë së vendit për të mbajtur në një nivel të qëndrueshëm investimet dhe zhvillimin social. Pasiguria ekonomike në mjediset globale ekonomike dhe rajonale pritet të vazhdojnë për disa kohë duke e kthyer si sfidë për ekonominë e vendit menaxhimin e zhvillimit ekonomik.

- Sfida e re lidhet me promovimin e investimeve dhe novacionit në të gjithë ekonominë shqiptare.
- Sfida të reja dhe më komplekse vijnë si rezultat i rritjes së nivelit të të ardhurave, sofistikimit të mallrave dhe të shërbimeve të prodhuara dhe rritjes së kërkesës për to.
- Sfida për një model të ri ekonomik është serioziteti shkencor dhe kredibiliteti i hartimit dhe implementimit të një strategjie kombëtare afatgjatë.

Sfida për një model të ri ekonomik është serioziteti shkencor dhe kredibiliteti profesional i hartimit dhe implementimit të një strategjie kombëtare afatgjatë. Sot modelet e reja ekonomike vlerësojnë si parakusht impaktin që ka mirëqeverisja e vendit.

E ardhmja do të sigurojë shumë sfida por edhe mundësi, ne të gjithë duhet të mësojmë për t'u përshtatur dhe të veprojmë për t'u përgjigjur në mënyrë të tillë që të sigurojmë rritjen e aftësisë konkurruese dhe qëndrueshmërinë ekonomike në vend dhe në Evropë.

Objektivi për një rritje gjithëpërfshirëse, për rritje ekonomike që i rrisin mundësitë për sa më shumë shqiptarë, për rritje që reduktojnë dhe eliminojnë varfërinë, për një rritje ekonomike që rrit kohëzisionin social, kërkon një harmonizim më të mirë të politikave monetare me ato fiskale.

Rritja ekonomike e Shqipërisë është paralajmëruar edhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, si BERZH, FMN apo edhe Banka Botërore.

“Shqipëria përmendet si një nga përformueset më të mira ekonomike të rajonit të Evropës Juglindore dhe një nga vendet me një sistem të shëndoshë bankar” - thotë restigjiozja “Wall Street Journal”.

Rritja e të ardhurave kërkon një ekonomi që bazohet jo te vlera e ulët e krahut të punës, por te produktiviteti në rritje i ekonomisë sonë. Arritja e këtij objektivi kërkon një ndryshim cilësor në faktorët e rritjes sonë ekonomike, të cilat arrihen në bazë të një strategjie të qartë kombëtare, e cila vendos në qendër të saj mirarsimimin, trajnimin dhe ritrajnimin e çdo shqiptari. Kjo do të rrisë produktivitetin dhe fleksibilitetin e tyre, duke synuar rritjen e të ardhurave.

KONKLUZIONE

- Shqipëria është një ndër vendet që nuk është prekur shumë nga kriza botërore. Sistemi bankar përbën një faktor të rëndësishëm mbështetës.
- Hartimi i një pakete ekonomike financiare do të ndihmojë kompanitë më të goditura dhe më të rrezikuara, të cilat kane aktivitetin e tyre në sektorët më të prekur nga ethet e krizës.
- Shqipëria duhet të vazhdojë me reformat sektoriale. Eliminimi i praktikave të padrejta dhe minimizimi i korrupsionit do të ketë shumë ndikim në rritjen ekonomike.
- Nxitja e çdo iniciative të zhvillimit industrial në funksion të zhvillimeve ekonomike.
- Sfida është që dhe politikbërësit të mbështesin bizneset duke shfrytëzuar mundësitë e reja ekonomike, pasi krizat mund të shihen si mundësi dhe për të implementuar mekanizma të rinj që ndihmojnë në ecjen dhe rritjen ekonomike të vendit.
- Ndërtimi i shërbimit të inovacionit dhe transferimit teknologjik për të bërë të mundur modernizimin e bazës prodhuese për eksport.
- Modeli i ri ekonomik duhet të shërbejë për shpejtimin e ritmeve të transformimeve ekonomike, shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë, për mobilizimin e burimeve ekzistuese, zbulimin e burimeve të reja dhe vendosjen e tyre në funksion të prioriteteve të reja të zhvillimit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë.

REKOMANDIME

- Të shqyrtohet mundësia e fillimit të një politike të re, kreditimi me perqindje të ulëta, por edhe kreditimi i disa sektorëve që kanë perspektivë zhvillimi. Në këto rrethana të duhet të mbështetet më shumë nxitja e sektorit privat të ekonomisë nëpërmjet kredisë bankare.
- Dhënia e kredive duhet të jepet mbi bazën e planeve të bizneseve të studiuara, të vlefshme për financim, të cilat do të ulin rrezikun, si

- dhe do të reduktonin kostot. Në këtë kontekst bankat të jenë të kujdesshme me politikat e tyre të zhvillimit dhe politikat kredituese.
- Zhvillimin dhe garantimin e një shërbimi cilësor të konsulencës dhe trainimeve për rritjen e kapaciteteve menaxheriale dhe teknike të kompanive në rritje dhe në internacionalizim.
 - Ambienti global po shtron sfida të reja, në këtë kuadër nevojitet që të studiohen dhe të vendosen modele të reja ekonomike.
 - Pasuritë tona natyrore duhet të përfshihen në një cikël më të plotë nxjerrje – përpunimi dhe eksportimi, duke rritur vlerën e shtuar në ekonomi dhe duke rritur të ardhurat nga eksporti.
 - Shqipëria duhet të vazhdojë me reformat sektoriale.
 - Kujdes duhet treguar dhe për deficitin publik, në këtë kuadër duhet të mbahet parasysh që jo vetëm të punohet për të mos krijuar borxh të ri, por edhe për të shlyer borxhin e vjetër me efikasitet maksimale. Këtu mund të ndiqet edhe strategjia e daljes nga borxhi që mund të jetë zëvendësimi i borxhit të vjetër të shtrenjtë me një borxh të ri më të lirë.
 - Që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm të vendit është mirë të mbështetemi në strategji afatgjata, ku objektivat kryesore duhet të jenë rritja e produktivitetit dhe aftësia konkurruese e saj.
 - Rritja e aftësisë konkurruese dhe menaxhuese, si dhe sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të kompanive eksportuese në rrjetin e tregut ndërkombëtar.

LITERATURA:

1. Ekonomia dhe tranzicioni, Reviste ekonomike tremujore (QSHKE), Prill – Qershor, 2010.
2. Ardian Fullani Guvernatori i Bankës së Shqipërisë e mërkurë, 08 tetor 2008 Tiranaobserver.
3. Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, publikime.
4. Political business cycle and imports of “electorate sensitive” goods. “Economies in Transition” Holger Kachelein.
5. Macroeconomics “G.Mankiew”
6. Banka Qendrore, Raporti vjetor.
7. Economies in Transition, 2009.

Roli i tregtisë se jashtme në zhvillimin ekonomik të Kosovës

Veli Lecaj, Olda Cico

Kolegji Universitar "Gjilani,,Gjilan, Universiteti "Kristal,, Tiranë

ABSTRACT

The role of foreign trade in economic development of Kosovo.

Kosovo looked at the historical aspect, was the most undeveloped part of the former Yugoslavia, compared with other former federal parts and in Balkan and European relations.

Economic base of Kosovo inherited in former Yugoslavia, was as an influential factor for economic development in last years, although that in the former Yugoslav development policy, the equitable policy of economic development seems a important targets.

Today, Kosovo has a liberal trade regime, which is characterized by simplicity and neutrality, as the main features that are considered to be important for stimulating to growth private sector and creating better conditions for export.

However, since trade liberalization was not accompanied by improved competitiveness of local manufacturing sector that were newly created, now Kosovo is faced with high trade deficit.

Continuation of this trend would hinder stability and macroeconomic growth of Kosovo. In addition, Kosovo as a new state, that the political status has yet solved, still has problems and obstacles to investment from being equal partners in regional initiatives (for e.g. Stabilization and Association Process and the Stability Pact), but there is a light for Kosovo, since Kosovo is a membership of the IMF and World Bank.

Kosovo's foreign trade has large discrepancy between the export and

import, to have an important role in its economic development (because about 7% is average coverage of imports by exports in the referred period).

In export of Kosovo dominate mainly raw materials. So, in the postwar period (January 2001 - April 2010) Kosovo's export was € 904.3 million compared with the import value of € 12,044.2 million. As a result, Kosovo has a very high trade deficit, which reaches a value of € 11,139.9 million.

The cause of such situation are the weaknesses of the newly sectors created products

and services, unsuccessful of the foregoing export sectors based on centralized planning, delay of the start to the Kosovo privatization process after the war etc.

Upon entry into force of the European Commission Regulation no. 2007/2000 (18 September 2000), the EU has formally recognized Kosovo as an independent customs area by eliminating the maximum tariff for industrial products and improve market access for agricultural products (European Commission, 2000), that 95 percent of Kosovar's origin products imported duty-free by the EU.

Therefore, standardization and technology required in the EU markets remain a challenge for Kosovo, which requires institutional capacity building for standardization and certification of Kosovo's products.

Kosova vështruar nga aspekti historik ishte pjesa më e pazhvilluar e ish- Jugosllavisë, krahasuar me ish pjesët tjera federale dhe në relacionet ballkanike e evropiane.

Baza ekonomike që trashëgoi Kosova në ish-Jugosllavi, është faktor me ndikim të madh për zhvillimin ekonomik gjatë periudhës së mëvonshme, edhe pse në politikën zhvillimore ish-jugosllave, politika e zhvillimit të barabartë ekonomik parashtrohej si qëllim i rëndësishëm.

Në teorinë e zhvillimit ekonomik është konstatuar dhe vërtetuar përmes analizave empirike, se ekziston lidhshmëria e ngushtë dhe reciproke mes sistemit ekonomik dhe zhvillimit ekonomik shikuar nga aspekti sektorial dhe territorial.

Sistemi ekonomik përkufizon rregullatorin kryesor në procesin e prodhimit, i cili përmes nënsistemeve dhe mekanizmave të tij si sistem i

financimit të riprodhimit të zgjeruar, sistemi i planifikimit, sistemi i çmimeve, sistemi i marketingut, sistemit devizor, sistemit monetar kreditor, sistemit politikës së jashtme, sistemi i tregtisë së jashtme etj., mundëson realizimin e qëllimeve të projektuara në kuadër të ekonomisë kombëtare në tërësi.

Ndërsa politika e zhvillimit ekonomik formulon objektivat dhe masat për sendërtimin e tyre në rrafshin sektorial, shtetëror, rajonale e më gjerë.

Zhvillimi bashkëkohor i ekonomisë botërore dëshmon për thellimin e ndërvarësisë ekonomike, financiare e informative midis vendeve.

Por edhe zhvillimi ndërkombëtar tekniko-teknologjik dhe migrimi i fuqisë punëtore, janë po ashtu faktorë të tjerë mjaft të rëndësishëm që karakterizojnë karakterin dhe ndërvarësinë reciproke ndërkombëtare të ekonomisë. Rëndësi të madhe në strukturën e sistemit ekonomik të çdo vendi ka edhe tregtia e jashtme si pjesë përbërëse e tij.

Tregtia e jashtme në Kosovë para vitit 1999

Sistemi ekonomik jugosllav njihej si sistem në mes të dy sistemeve botërore, nga njëra anë, i bazuar në tregun e lirë dhe në anën tjetër në sistemin ekonomik të llojit sovjetik.

Prandaj sfera e prodhimit dhe e këmbimit brenda dhe jashtë Jugosllavisë janë bazuar në mekanizmat e tregut, ndërsa elementi socialist-vetëqeverisës në lidhje me pronën mbi mjetet e prodhimit dhe qeverisjen, kishte pronësi shoqërore që nënkuptonte së punëtorët ishin pronarë të këtyre mjeteve të punës, për dallim nga shumë shtete të tjera socialiste lindore që pronësia mbi mjetet e punës ishte e karakterit shtetëror.

Mjetet nëpër Organizata të Punës së Bashkuar (OPB) i qeverisnin me nikoqirllëk punëtorët të cilët kishin rolin kryesor në strukturat vendimmarrëse të OPB-ës, përmes këshillit të punëtorëve si organ i tyre, edhe pse asetet (mjetet e ndërmarrjes së sotme) e tyre i takonin shoqërisë.

Qasja e tillë liberale në ekonominë jugosllave nuk zgjati shumë kohë, sepse diku pas viteve të shtatëdhjeta filloi të rritet me të madhe roli i shtetit në ekonomi ndërsa aktiviteti i pavarur i ndërmarrjeve u kufizua në masë të konsiderueshme.

Rritja e rolit të shtetit në ekonomi arsyetohet me atë se mekanizmat e tregut në ekonomi ndikuan që të paraqiten cikle të shpeshta ekonomike në ekonominë jugosllave, të rritet niveli i papunësisë, erdhi deri te rritja e disparitetit të jashtëm dhe të brendshëm, rritja e vazhdueshme e borxheve të jashtme dhe deficitit tregtar, përkundër që zhvillimi ekonomik jugosllav, u fokusua në zhvillimin rapid industrial me norma të larta të investimeve në industrinë prodhuese.

Mirëpo, sidomos gjatë kësaj periudhe deficitit tregtar rritej në mënyrë drastike, sa që borxhi i jashtëm arrin shifrën prej disa miliarda dollarë, me këtë rast u kufizua edhe aktiviteti i bizneseve të asaj kohe që shoqërohej me pengimin e themelimit të ndërmarrjeve të reja në tregun jugosllav, normalisht përfshirë edhe Kosovën si pjesë të saj.³²

Kështu që gjatë kësaj periudhe vërehej një rritje e eksportit prej 15.40% në nivel vjetor, por importi në këtë kohë shënoi një rritje me të madhe diku rreth 20.40%, si rezultat i këtij ndryshimi të vazhdueshëm gjatë disa viteve paraqitet deficitit tregtar.

Gjatë periudhës kohore të viteve 1970/1-deri afërsisht në vitin 1988, kontributin si eksportuesin kryesor më të madh në paraqitjen e rritjes së eksportit në Jugosllavi e kishin dhënë republikat e zhvilluara, si Sllovenia, Kroacia, dhe Serbia (së bashku me Vojvodinën por pa Kosovën), që kanë gjeneruar së bashku rreth 80.00% të eksportit të përgjithshëm jugosllav.³³

Ndërsa nga regjionet më pak të zhvilluara, kontributi i Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë, ishte shumë i vogël krahasuar me republikat e cekura më lart, saqë Maqedonia me 5.10%, Kosova me 2.00 % dhe Mali i Zi me 1.80% mesatarisht për periudhën e njëjtë kohore.

Bilanci tregtar i Kosovës me botën, gjatë kësaj periudhe kishte tendenca të ndryshme të mbulimit të importit me eksport, që ishte përafërsisht i njëjtë me atë të Jugosllavisë, saqë nëse analizojmë dallimet i shohim se p.sh. në vitin 1979 mbulimi ishte 43 % për Kosovën ndërsa për Jugosllavinë ishte 48%, ndërsa në vitin 1987 indeksi i mbulimit ishte 98% për Kosovën, me 90% për Jugosllavinë, në veçanti duhet të shihen të dhënat e vitit 1988 kur indeksi i mbulimit ishte 123% për Kosovën, me 89% për Jugosllavinë, kjo ishte një tregues që Kosova konform fuqisë

³² Dr.Skender Berisha "Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare"Universiteti i Prishtinës,1998, f.231

³³ Savezni zavod za statistiku,br.2, Beograd,1988, str.201.

ekonomike dhe financiare kishte mundësi të mira për mbulim importi me eksport në krahasim me Jugosllavinë Socialiste të asaj kohe si tërësi.

në miliona dinarë

Vitet	Eksporti	Importi	Saldoja	Mbulimi i importit me eksport	Mbulimi i importit me eksport
				Kosova	Jugosllavia
1971	23,565	s'ka te dhëna	s'ka te dhëna	s'ka te dhëna	s'ka te dhëna
1972	43,560	35,158	8,402	124	69
1973	56,378	65,657	(9,279)	86	63
1974	120,689	105,796	14,893	114	51
1975	146,807	155,182	(8,375)	95	53
1976	149,156	132,278	16,878	113	66
1977	155,079	146,283	8,796	106	54
1978	155,796	236,173	(80,377)	66	57
1979	193,061	446,033	(252,972)	43	48
1980	259,502	476,187	(216,685)	54	60
1981	252,510	476,120	(223,610)	53	69
1982	241,114	288,567	(47,453)	84	77
1983	233,531	287,607	(54,076)	81	82
1984	252,088	257,556	(5,468)	98	85

1985	264,274	253,567	10,707	104	87
1986	220,996	256,837	(35,841)	86	85
1987	219,700	225,122	(5,422)	98	90
1988	279,885	226,877	53,008	123	89

Vlerat janë të shprehura sipas paritetit 1\$=1262.00 din.


Burimi: Vjetari statistikor i Kosovës, 1989, f.195

Meqë në raport me bilancin e tregtisë së jashtme të Jugosllavisë, Kosova nuk pati aq deficit të madh, madje gjatë periudhës së shqyrtuar 6 vjet pati suficit në bilancin tregtar, Jugosllavia asnjë vit nuk pati suficit tregtar, por edhe mbulueshmërinë e importit me eksport, Kosova e kishte diku rreth 90% , ndërsa Jugosllavia diku 70%.³⁴

Duke analizuar strukturën e eksportit kosovar sipas industrive vërejmë së dominues në eksportin e Kosovës ishin kategoria e mjeteve dhe pajisjeve; prej 10 % sa merrnin pjesë në totalin e eksportit në vitin 1978, ndërsa në vitin 1986 kjo kategori mbulonte rreth 40 % të totalit të eksportit, me përfshirje më të madhe të kategorisë së produktit si bateritë për automjete dhe pjesët rezervë të tyre.

Nga statistikat e raportuara lidhur me partnerët tregtarë kryesorë të Kosovës nga viti 1972 deri në vitin 1986 ishin vendet socialiste, të cilat absorbuan në mënyrë konstante rreth 58 % të eksportit të Kosovës, e sidomos periudha kohore 1981-1983 ishte diku rreth 70 % të eksportit të Kosovës. Është interesante dhe indikative të përmendet se përderisa eksportet e Jugosllavisë në këtë periudhë shkonin në drejtim të vendeve të zhvilluara të Perëndimit, eksportet e Kosovës drejt vendeve socialiste ndërsa në drejtim të OECD-së, apo të Perëndimit pësonin zvogëlim.

³⁴ Dr. Skender Berisha “Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare”, Universiteti i Prishtinës, 1998, f. 332.



Një komponent tjetër i rëndësishëm në totalin e eksportit të Kosovës, ishte produkti i tekstilit dhe veshmbathjeve, edhe pse me një trend rënës, por sidomos këtu duhet thënë, se kishin rënie të theksuar metalet ndërsa eksporti i energjisë kishte shënuar një rritje krejt nga fundi i viteve të tetëdhjeta, megjithatë përkundër rritjes nuk ishte komponent i rëndësishëm i eksportit të Kosovës.

Struktura e eksportit Kosovar sipas industrive, 1976
– 86, në %³⁵

Periudha kohore	1976-78	1979-81	1982-84	1985-86
Prodhimet ushqimore, pijet, dhe duhani	5.09	5.88	3.38	1.25
Produktet e tekstilit	25.46	21.07	15.52	12.18
Prodhimi i energjisë	0.00	0.32	2.11	6.81

³⁵ Vjetari statistikor i Kosovës, Prishtinë, 1988, f.169.

Metalet	45.78	30.34	23.62	23.85
Prodhimi i makinerisë dhe i pajisjeve	9.92	14.52	33.36	36.82
Të tjera	13.75	27.87	22.01	19.09
TOTALI	100.00	100.00	100.00	100.00

Partnerët kryesor tregtar të Kosovës, 1972 – 1986, në % ³⁶					
Vendet e OECD-së/Periudha kohore	1972-74	1975- 77	1978- 80	1981- 83	1984- 86
<i>Gjermania</i> ³⁷	16.6	8.21	11.12	8.51	9.67
<i>Italia</i>	4.03	5.19	6.23	4.39	4.07
<i>SHBA-të</i>	10.01	14.15	10.48	4.07	1.55
<i>Totali</i>	30.64	27.55	27.83	16.97	15.29
Vendet socialiste					
<i>BRSS</i>	24.57	43.57	36.94	47.24	39.59
<i>Çekosllovakia</i>	18.4	8.35	7.49	17.17	13.21
<i>Shqipëria</i>	0.8	0.55	2.15	1.68	0.9
<i>Bullgaria</i>	4.71	0.58	1.7	1.35	0.49
<i>Rumania</i>	4.41	4.11	2.52	2.32	5.38
<i>Totali</i>	52.89	57.16	50.8	69.76	59.57
Vendet tjera	16.47	15.29	21.37	13.27	25.14
TOTALI	100.00	100.0 0	100.0 0	100.0 0	100.0 0

Siç është e ditur botërisht në Jugosllavinë Socialiste filluan ndryshime të mëdha politike në vitin 1989, saqë Kosova humbi pozitën e saj kushtetuese brenda Jugosllavisë Socialiste. Në Kosovë pati ndikime substanciale nga aspekti ekonomik dhe politik, duke suprimuar autonominë e KSAK si qehej në atë kohë Kosova dhe duke iu marrë të gjitha ingerencat në duart e Beogradit.

Në Kosovë menjëherë filluan të bien në mënyrë drastike aktivitetet ekonomike, nuk kishte rrjedhë normale të informatave për situatën

³⁶ Vjetari statistikor i Kosovës, Prishtinë, 1987, f.190.

³⁷ Shënim: Të dhënat për shtetin Gjerman janë të përmblëdhura për të dy ish-Gjermanitë.

ekonomike, edhe ato që ishin, rezultinin shumë të pakta dhe jo **përmbajtjesore.**

Këto ndryshime politike në Jugosllavinë Socialiste të asaj kohe patën ndikime të mëdha në Kosovë me karakter shumë dimensional, si: rënien drastike të produktit shoqëror, largimin e pjesës dërmuese të punësuarve, shpejt filluan bashkimin e ndërmarrjeve kosovare me ato të Serbisë, zëvendësimin e udhëheqjes së ndërmarrjeve me organe të dhunshme, instalimin e menaxhmentit të ri në ndërmarrje, vërehet rënie drastike e nivelit të investimeve dhe së fundi humbjen pothuajse të tërësishme të tregjeve të eksportit të Kosovës.³⁸

Prandaj nga ky vit e tutje për Kosovën, pjesa më e madhe e treguesve ekonomik prezantoheshin së bashku me treguesit ekonomik serb, që sipas treguesve statistikor të Serbisë, vetëm brenda tri viteve 1990 – 1992, eksportet nga Kosova shënuan rënie për 81.00%, duke mbetur kështu në të njëjtin nivel për shumë vite në vijim, ndërsa importet rriteshin me një përqindje të madhe, saqë në mbarim të vitit 1997 deficitit tregtar ishte enorm.

3. Kosova, tranzicioni dhe aktivitetet eksportuese pas vitit 1999

Ndërtimi i sistemit të ekonomisë së hapur është domosdoshmëri e kohës, sepse si vend i vogël dhe ekonomikisht i pazhvilluar, Kosova është e detyruar të orientohet në ekonominë e hapur drejt tregut të jashtëm. Vetë liberalizimi i tregtisë në Kosovë orienton vemendjen në tri drejtime: racionalizimi dhe zëvendësimi i importit, lehtësimet në tregti dhe promovimi i eksportit.³⁹

Në praktikën e zhvillimit ekonomik ndeshemi me modele alternative të ekonomisë së hapur ndaj tregut, modele këto që kërkojnë përshtatje konform përvojave ndërkombëtare të vendeve në zhvillim e sidomos të vendeve të rikrijuara siç janë Kroacia, Sllovenia, Estonia etj. Ndërtimi i ekonomisë së hapur ndaj tregut të jashtëm në Kosovë, ballafaqohet me probleme të trashëguara zhvillimore, gjatë krijimit të

³⁸ Instituti për hulumtime zhvillimore RIINVEST: “*Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës*”, 1997/98, f. 18-21.

³⁹ Strategjia e integruar e eksportit e UNCTAD-it (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Tregti), 2009, f. 28.

strukturave të menaxhmentit të ri, aktivizimin e kapitalit privat në ndërtimin e institucioneve të ekonomisë së tregut etj.

Pra, problemet kryesore në këtë rast janë: problemi me pronësinë e patransformuar, shkalla e ulët e zhvillimit dhe papunësia e madhe, pamundësia e plotë e vetëfinancimit, trendi i gjatë kohor i recesionit, vëllimi dhe shkalla e dobët e cilësisë së prodhimit, shkalla dhe struktura e pavolitshme e eksportit, bilanci tregtar dhe i pagesave i pavolitshëm, ballafaqimi sfidues me korrupsionin dhe kontrabandën etj.

Kështu që biznesi kosovar edhe sot e kësaj dite përballet me probleme të brendshme të natyrës financiare - mungesa e kapitalit, pastaj mungesa e theksuar e shërbimeve të marketingut dhe aktiviteteve të tjera promovuese, duke u mbështetur ekskluzivisht në shitjen personale, pasojë e së cilës është mospasja e shërbimit të marketingut në strukturën e tyre organizative.⁴⁰

Përvoja dhe teoria botërore nuk njeh ndonjë vend të mbyllur dhe të zhvilluar njëkohësisht.

Kështu Kosova përmes hapjes ndaj tregut të jashtëm, përmes politikave që mbështesin fushat që tërheqin investimet e jashtme dhe atyre sektorëve që prodhimet e tyre i kanë të orientuara për eksport, ka **shans** që të nisët drejt rrugës zhvillimore ekonomike të ndjekur nga “Tigrat e vegjël aziatik”(Singapori, Koreja Jugore, Hong Kongu, Tajvani etj.),⁴¹ por me orientim të veçantë drejt konsolidimit të ekonomisë eksportuese kosovare.

Hapja ndaj ndikimeve tekniko-teknologjike dhe shkencore, Kosovës i mundëson që t’i identifikojë, analizojë, shfryëzojë potencialet dhe prioritetet e veta komparative si mundësi të mirë për inkuadrim në proceset e integritimeve rajonale dhe evropiane, të cilat janë bërë sot realitet i zhvillimeve botërore, problem kyq dhe synim afatgjatë i rendit të ri botëror. Për Kosovën do të ishte me interes të bëhet pjesë e të gjitha integritimeve rajonale ekonomike përveç CEFTA-as, edhe e UE, EFTA, APEC etj., por jo vetëm formalisht.

Prandaj, vlen të përmendet p.sh. marrëveshja e CEFTA-s, që vazhdon të mos implementohet në tërësi, pasi që eksportet e prodhuesve të Kosovës vazhdojnë të bllokohen nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina,

⁴⁰ Veli Lecaj, “Roli i promocionit në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës”, Punimi i magistraturës, Prishtinë, shtator, 2008, f. 98.

⁴¹ http://www.osce.org/publications/eea/2006/07/19786_640_sq.pdf

ndërkohë që ekspertët bëjnë thirrje që të fillojë dialogu me Brukselin për zgjidhjen e kësaj çështje, ose të merren masat e reciprocitetit.⁴²

Objekt i vështrimit tonë janë vetëm format e integrimve rajonale ekonomike, të cilat varësisht nga shkalla dinamike integruese, shkojnë nga niveli preferencial për tregti të lirë, union doganor, union ekonomik dhe unionin monetar.⁴³ Me 18 shtator 2000, Komisioni Evropian nxori rregulloren Nr. 2007/2000, me të cilën BE-ja formalisht e ka pranuar Kosovën si zonë doganore të pavarur dhe i ka dhënë preferenca tregtare duke eliminuar kufijtë maksimalë tarifor për produkte industriale dhe duke përmirësuar kushtet për qasje në treg për produktet bujqësore.

Por që nga viti 2009 Banka Botërore dhe FMN, kur e pranuan Kosovën si një anëtare të tyre ishte një hap i rëndësishëm në sigurimin e ndihmës aq të nevojshme ndërkombëtare dhe konfirmimin e statusit të pavarur të Kosovës. Pas anëtarësimit në Bankën Botërore, Kosova do të jetë në gjendje të tërheqë investitorë të mëdhenj, si dhe do të jetë pjesë e integruar e tregut global.⁴⁴

Kështu, Kosova nga aspekti demografik, aspekti i moshës (me një popullatë relativisht të mirë dhe të re) mbi mesataren evropiane, të edukuar dhe profesionalisht të ngritur ka hapësirë potenciale për tregti të lirë në EJT dhe inkuadrimi i saj në integrimet ekonomike rajonale dhe botërore, posaçërisht në UE, si një integrim i suksesshëm dhe i qëndrueshëm duhet të jetë prioritet mbi prioritetet e Kosovës në të ardhmen sa më të afërt.

Prandaj të inkuadruarit në integrimet ekonomike rajonale mund të bëhet duke i pranuar rregullat e lojës demokratike perëndimore në rrafshin e sigurisë, stabilitetit rajonal, atij evropian dhe në rrafshin civilizues euro perëndimor.

Në ekonominë kosovare paraqitet liberalizimi tregtar i Kosovës si çështje esenciale për ndërtimin e një ekonomie të hapur dhe për forcimin e konkurrencës së ekonomisë vendore për t'u ballafaquar me importin në Kosovë dhe për të ngritur **paraqitjen** e eksportit.

Në Kosovë, liberalizimi tregtar është realizuar në rrethana tejet specifike dhe dallon nga përvoja e vendeve të tjera të tranzicionit:

⁴² www.Kosovapress.com, Prishtinë, 3 gusht 2010, Koha 10:57.

⁴³ Blerim Reka "E drejta e unionit evropian, Instituti kosovar për integrimet euroatlantike, 2000, Prishtinë, f.187-189.

⁴⁴ Klan Kosova me datën 05qershor 2009.16;50.

⁴⁵ pasojat e luftës, vonesa 10 vjeçare në tranzicion, mungesa e një qëndrueshmërie ekonomike dhe sociale, niveli i ulët i bizneseve prodhuese, veprimi i instrumenteve asimetrike tregtare, mungesa e politikave për mbrojtjen e prodhuesve në fazën fillestare të liberalizimit tregtar.

Prandaj liberalizimi i shpejtë tregtar edhe në disa vende të tranzicionit nuk është shoqëruar me përkrahje të duhur institucionale, duke dhënë të kuptohet se krijimi i institucioneve mbështetëse nuk është krijuar dhe nuk mund të krijohet brenda natës.

Liberalizimi i tregtisë nuk ka qenë i shoqëruar me përmirësimin e aftësisë konkurruese të sektorëve prodhues vendorë të sapokrijuar, Kosova po ballafaqohet me deficit të lartë tregtar.

Krijimi i kapaciteteve administrative dhe institucionale konsiderohet si element kyç për suksesin e reformës së politikave tregtare.⁴⁶

Kosova si shtet i ri, me status sapo të zgjidhur politik dhe i pranuar ndërkombëtarisht, si kusht themelor për antarësim në bankën botërore dhe fondin monetar ndërkombëtar, ka mundësi të mira të ecjes drejt stabilitetit ekonomik, drejt reformave dhe zhvillimit në nivel rajonal. Për t'u arritur këto synime në Kosovë për promovimin dhe realizimin e investimeve, tregtisë dhe të eksportit, janë të involvuara këto institucione dhe këta akterë:

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)⁴⁷
2. Ministria e Punëve të Jashtme
3. Ministria për Integritet Evropian
4. Oda Ekonomike e Kosovës/Euro Info Qendra,
5. USAID - KBS
6. Shoqata e Eksportuesve të Kosovës (SHEK)
7. Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB)

Sipas shumë indikatorëve makroekonomik, ekonomia kosovare pas stagnimit shumëvjeçar ka shpërpjesëtime në tregtinë e jashtme, shpërpjesëtime këto që kanë implikime afatgjata makroekonomike nga

⁴⁵ Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest"Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë, 2004, f.18

⁴⁶ Trade Policy during the Transition, Lessons from the 1990s, CERT.

⁴⁷ Duhet të bëhet e qartë se rolin kryesor në procesin e bërjes së politikave tregtare e ka MTI, megjithëse ekziston një numër aktorësh të tjerë qeveritar dhe të tjerë relevant të përfshirë në këtë proces për shkak të ndërvarshmërisë së madhe të politikës tregtare me funksionet e ndryshme ekonomike

aspekti i qëndrueshmërisë konkurrueshmërisë, stabilitetit dhe të rritjes ekonomike.

Pra ekonomia e Kosovës, përkundër masave të ndërmarra në konsolidimin e saj, ajo ka shënuar rritje relativisht të ulët, por jo edhe të favorshme në periudhën e pasluftës.

Së këndejmi, reduktimi i këtyre shpërpjesëtimeve duhet të jetë një prioritet afatgjatë i Kosovës.

Nëse nisemi nga analiza e bilancit tregtar të Kosovës, si faktor mjaft relevant, vërejmë se gjatë kësaj periudhe kohore 2001- prill 2010, ekziston një diferencë e lartë negative e bilancit tregtar si pasqyrë e nivelit të ulët konkurrues të produkteve kosovare në tregun e jashtëm, si pasqyrë e promovimit të pamjaftueshëm të eksportit, si tregues përmes së cilëve mund të vërehet varësia e ekonomisë kosovare nga importi etj.

vlera në1000 €⁴⁸

Periudha	Eksporti	Importi	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
2001	10,559	684,500	-673,941	1.5
2002	27,599	854,758	-827,159	3.2
2003	35,621	973,265	-937,644	3.7
		1,063,34	1,006,78	
2004	56,567	7	0	5.3
		1,157,49	1,101,20	
2005	56,283	2	9	4.9
		1,305,87	1,195,10	
2006	110,774	9	5	8.5
		1,576,18	1,411,07	
2007	165,112	6	4	10.5
2008	198,463	1,928,23	-	10.3

⁴⁸ Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme, Prishtinë, 2010, f. 20.

		6	1,729,773	
			-	
2009	165,328	1,935,541	1,770,213	8.5
Janar-Prill 2010	78,003	564,956	-486,953	13.8

Duke analizuar të dhënat gjatë periudhës 2001-2009 vërehet se në vazhdimësi kemi një rritje të eksportit dhe të importit.

Eksportet në periudhën e pasluftës kanë shënuar rritje të vazhdueshme mirëpo nga një nivel shumë i ulët fillestar. Nëse krahasohet eksporti i vitit 2002 me vitin 2001, kemi një rritje prej 161 %, e në anën tjetër kemi një rritje të importit për 25% , për të njëjtën periudhë. Vlera e ulët fillestare e eksporteve përkundër rritjes se vazhdueshme prapë se prapë nuk ka pasur mundësi mbulimi të importit, sepse mbulimi i importit me eksport në vitin 2001 ishte 1.5% ndërsa në vitin 2002 ishte vetëm 3.2%, përkundër rritjes se theksuar më lart të eksportit prej 161 %, në vitin 2006 mbulimi i importit me eksport ishte vetëm 8.5%, në vitin 2007 ishte 10.5%, në vitin 2008 ishte 10,3% si më specifik është viti 2008, sepse eksporti është rritur në krahasim me vitin paraprak për 20% ndërsa importi është rritur 22% në të njëjtën periudhë, në vitin 2009 kemi rënie të përqindjes së mbulimit në 8.5% krahasuar me vitin e mëparshëm, si dhe në kuartalin e parë të vitit 2010 kemi përqindjen e mbulimit me një rritje të theksuar prej 13,8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009 ku mbulimi ishte vetëm 6.8%. *Megjithatë pavarësisht nga përmirësimet jo të vogla të eksportit kosovar, i cili që nga viti 2001-2009 më së shumti ishte 10.5% të vlerës së importit d.m.th. se është jashtëzkonisht i ulët. Evoluimi pozitiv i importeve, shikuar nga aspekti i shkëmbimeve tregtare shpreh një faktor jo të favorshëm për Kosovën, duke e bërë ekonominë kosovare gjithnjë e më të varur nga importet.*

Kjo rritje e madhe e importeve ka bërë të pamundur mbulimin edhe simbolik të importeve nga eksportet, saqë nga viti 2004, kur importi ishte në vlerë prej 1,063,347,000 euro u dyfishua përafërsisht saqë në vitin 2009 arriti vlerën prej 1,935,541,000 euro, ndërsa eksporti mezi u rrit nga vlera 56,567,000euro në vitin 2001 në vlerën 165,328,000 euro në vitin 2009, apo 12 herë ishte importi më i lartë se eksporti në kuptimin e

vlerës monetare, apo shprehur edhe në përqindje eksporti është rritur diku rreth 200%, ndërsa importi diku afër 100 %, por pa ndonjë efekt të madh.

Një pasqyrë më premtuese do të shfaqej po që se merret në konsideratë edhe i ashtuquajtur i eksport virtual që përfshin konsumin e ndërkombëtarëve në Kosovë, sipas të cilit eksporti mbulon 20 % të importit (në llogaritë kombëtare kjo pjesë e eksportit konsiderohet si ‘eksport në shërbime’).

(Vlera në 000 €)


Partnerët kryesorë të Kosovës në vitin 2009 për tregtinë e jashtme					
Vendet	Eksporti	%	Importi	%	Bilanci tregtar
Italia	46,218	28.00	87,646	4.50	-41428
Shqipëria	26,182	15.80	58,385	3.00	-32203
Maqedonia	17,355	10.50	291,837	15.10	-274482
Gjermania	7,563	4.60	246,120	12.70	-238557
Turqia	6,512	3.90	141,545	7.30	-135033
Serbia	3,504	2.10	210,901	10.90	-207397
Sllovenia	2,882	1.70	66,249	3.40	-63367
Kina	1,596	1.00	128,318	6.60	-126722
Totali	111,812	68	1,231,001	64	-1119189
Vendet tjera	53,516	32	704,540	37	-651024
Totali	165,328	100.00	1,935,541	100.00	-1770213

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme, Prishtinë, 2009

Lidhur me eksportin dhe importin e Kosovës, partnerë kryesor tregtarë

janë vendet ballkanike, të cilat marrin pjesë me 36.3% për eksport dhe 43.1% për import, ndërsa BE merë pjesë me 43.1% për eksport dhe 39.0% për import, në raport me totalin e vitit 2009 (vendet me pjesëmarrje më të lartë nga BE janë Italia me 28% eksport dhe 4.5% import, Gjermania me 4.6% eksport dhe me 12.7% import.). Përsa i përket eksporteve të Kosovës me vendet ballkanike, Shqipëria merr pjesë me 15.8%, Maqedonia me 10,5%, Turqia me 3.9% në raport me totalin e vitit 2009, ndërsa pjesëmarrjen më të madhe të importeve në Kosovë nga vendet ballkanike e kanë Maqedonia me 15.1%, Serbia me 10.9% dhe Turqia me 7.3% .⁴⁹

Duke krahasuar të dhënat e periudhës 2005-2009 për disa grupmallrash vërejmë se mesatarisht përbërësit kryesorë të eksportit janë: mallra të përpunuara me 40%, materiale të papërpunuara 30%, lëndë djegëse 6%, yndyrat bimore dhe shtazore kanë vlerë simbolike të eksportit, produktet kimike 1%, makineritë dhe pajisjet e transportit 8%, pijet dhe duhani 3%, mallrat të tjera të përpunuara 4% dhe ushqimi dhe kafshët e gjalla 8%.




Sa i përket importeve kishte rritje vjetore mesatare me pak se dhjetë %

⁴⁹ Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme, Prishtinë, 2009, f. 25-27.

ndërsa rritja e importit në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, kishte një rritje simbolike prej 0.38%. Duke parë strukturën e përbërësve kryesorë të importeve (makineritë dhe pajisjet e transportit me 21%, materiale të papërpunuara me 2%, produktet kimike 10%, mallrat të tjera të përpunuara 9%, mallra të përpunuara me 19%, mallra të paklasifikuara diku tjetër kanë rënie dhe vlerë simbolike importi, pijet dhe duhani me 5%, yndyrat bimore dhe shtazore me 1%, lëndët djegëse 16% dhe ushqimi dhe kafshët e gjalla me 17%), vijmë të konkluzioni se ekonomia kosovare gjendet në gjendje të shumë të rëndë, meqë nevojat themelore për ushqim është e detyruar t'i mbulojë përmes importit, por importohen po ashtu një sasi e konsiderueshme e mallrave tjera të përpunuara dhe atyre kimike, sigurisht për shkak të mungesës së potencialit tekniko-teknologjik për përpunimin e tyre. Logjikisht në vazhdimësi është duke u rritur importi i të mirave kapitale (makineritë dhe pajisjet e transportit me 21%), i cili është i domosdoshëm për prodhimtarinë vendore dhe paraqitet si imperativ e kohës, pasi që momentalisht është jo në nivel të kënaqshëm. Andaj është brengosës fakti së shumë produkte nga importi janë të prodhuara në vendet fqinje, e disa prej tyre edhe në ato rajonale, tek të cilat niveli i *zhvillimit ekonomik dhe tekniko-teknologjik nuk është shumë më i avancuar se i Kosovës.*

Prandaj, këto të dhëna për tregtinë e jashtme të Kosovës, pasqyrojnë nivelin e ulët të zhvillimit të forcave prodhuese dhe njëherit janë dëshmi e ngecjes së ekonomisë kosovare.

Shumica e prodhuesve vendorë plasmanin e produkteve të veta e bëjnë në tregun e Kosovës. Në bazë të analizës së çmimeve të produkteve vendore, të bëra nga MIT rreth 80 % e produkteve kosovare kanë çmim më të lartë se ato të importuara. Kjo ndodh pikërisht për shkak të kostos së lartë të prodhimeve vendore që rrjedh si pasojë: e aplikimit të normave të larta doganore në importimin e lëndës së parë, repromaterialeve dhe mjeteve të punës, mungesa e energjisë elektrike, mungesa e lëndës së parë dhe teknologjia e vjetër.



Një sërë problemesh ndikojnë në aktivitetet eksportuese në Kosovë; këto probleme janë të natyrës ekonomike, historike dhe politike, janë probleme të brendshme dhe të jashtme, kurse disa prej tyre janë të trashëguara e disa janë të lidhura me tranzicionin dhe me funksionimin e shtetit të ri të Kosovës.

Përveç kësaj, rrjedhja e eksportit të Kosovës është penguar nga masat dhe instrumentet e aplikuara në politikat tregtare të vendeve të tjera; eksportuesit kosovarë ishin detyruar të ndeshen me ngarkesa tarifore (për shembull, taksat transit), si dhe me ngarkesat jotarifore (të tilla si subvencionet). Veçanërisht këto të dytë kanë qenë revalente, dhe kanë marrë forma nga më të ndryshmet.⁵⁰

Ndër arsyet kryesore të efikasitetit të dobët tregtar janë:

⁵⁰ MTI, Politika Tregtare e Kosovës, 2009, f.14.

- statusi i sapozgjedhur politik i Kosovës
- ekonomi e trashëguar me kompani dhe industri pothuajse në kolaps pas shkatërrimeve dhe vjedhjeve
- komplikimet dhe vonesat e shumta gjatë procesit të privatizimit të kompanive shoqërore,
- të qenurit e Kosovës shumë kohë jashtë iniciativave regjionale ekonomike
- prezenca në masë të madhe e ekonomisë joformale
- orientimi i ndërmarrjeve të sapoformuara private pas luftës kryesisht në tregti
- ambienti jo i sigurt për investime
- kufizimet kreditore dhe normat e larta të kamatës
- mungesën e informatave
- përkrahjen e dobët institucionale
- prezenca e dukurive negative në ekonomi si krimi i organizuar dhe korrupsioni
- politika tatimore jofavorizuese për prodhimin vendor dhe norma uniforme e doganave dekurajuese për zhvillimin e bizneseve prodhuese në Kosovë
- institucionet jofunksionale për sigurimin e cilësisë dhe ekspertizave
- problemet e brendshme të firmave në Kosovë (mungesa e kapitalit, mungesa e përvojës për bërje biznesi në tregjet e ndërkombëtare)
- marketingu dhe aktivitetet promovuese të dobëta
- problemi i qarkullimit të lirë të personave.
- ekonomia jo ⁵¹formale
- masat dhe instrumentet e aplikuara në politikat tregtare të vendeve tjera etj⁵².

Këto probleme, të cilat që nga fillimi kanë qenë të lidhura me realitetin e ri kosovar në korrelacion me politikat jointegrale ekonomike dhe institucionet joefikase kanë ndikuar në zhvillimin joefikas të sektorit

⁵¹ Në bazë të EC (2008) ekonomia joformale në Kosovë llogaritet sipas disa vlerësimeve 30% të BPV-së në Kosovë, apo 700 milion € në vit (The European Commission Liaison Office to Kosovo press release of 27 August 2008)

⁵² Pasi që Kosova nuk i kontrollon të gjitha pikat doganore të saj, meqë një pjesë e kufirit të Kosovës në veri sot e kësaj dite mbetet jashtë kontrollit doganor dhe tatimor kosovar në masë të madhe. Kjo krijon mundësinë që përmes kësaj pike kufitare të pambikëqyrur nga organet kosovare të realizohet evazioni fiskal.

privat të ndërmarrjeve, sektor ky i cili do të duhej të mbarte barrën kryesore të eksportit.

Por ekonomia e Kosovës me faktorët e vetë të prodhimit, burimet natyrore jo të pakta, burimet njerëzore ndër me të rejat në rajon e më gjerë dhe me potencialin e vet prodhues, ka një mundësi reale për mbështetje të zhvillimit ekonomik, njëherit shfrytëzimi racional dhe efikas i këtyre faktorëve kërkohet që ekonomia kosovare sa më shpejt të inkuadrohet në rrjedhat bashkëkohore ekonomike dhe në proceset integruese me vendet e Ballkanit, Evropës dhe më gjerë.

Orientimi i zhvillimit ekonomik në Kosovë në ditët e sotme, përkundër privatizimit të bërë nuk është duke dhënë sinjale të mira për mirësimin për ndonjë ndryshim të theksuar pozitiv brenda një afati të shkurtër kohor, bile as për avancimin e tregtisë së jashtme.

Prandaj si prioritet afatgjatë, i Kosovës përveç zvogëlimit të shpërpjesëtimeve në tregtinë e jashtme, politika kosovare për tregti të jashtme duhet të fokusohet në:

- përmirësimin e organizimit institucional dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet akterëve kryesorë përmes krijimit të njësisë koordinuese në kryeministri
- rritjen e aftësisë konkurruese përmes përmirësimit të cilësisë së produkteve
- zvogëlimin e mundshëm të shpenzimeve të panevojshme në procesin prodhues
- rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese
- promovimin e eksportit
- krijimin e ambientit të sigurt për investime
- politikave kreditore favorizuese për eksport (ulja e kufizimeve kreditore dhe normave të larta të kamatës),
- ndërtimin e sistemit informativ
- përkrahjen e fortë institucionale për bizneset eksportuese
- luftimin e prezencës së dukurive negative në ekonomi, si krimi organizuar dhe korrupsioni
- politika tatimore favorizuese për prodhimin vendor dhe norma jo uniforme e doganave si inkurajuese për zhvillimin e bizneseve prodhuese në Kosovë

- krijimin e institucioneve funksionale për sigurimin e cilësisë dhe ekspertizave
- rritjen e rolit të marketingut dhe aktiviteteve të tjera promovuese
- lehtësimin e qarkullimit të lirë të personave
- ekonomia joformale (zvogëlimi i saj në minimum)
- Lidhja e sa më shumë marrëveshjeve tregtare me vendet e tjera etj.

Nga e tërë kjo që u tha më lart, me plot të drejtë mund të themi se nuk ka ndonjë formulë specifike për sukses, por duhet të punohet në vazhdimësi në zhvillimin e politikave promovuese të tregtisë së jashtme, sidomos të eksportit si determinuese për shtim eksporti dhe zhvillim ekonomik.

4. KONKLuzionet:

- a) Problemi kryesor me të cilin ballafaqohet ekonomia kosovare është importimi i pjesës dërmuese të mallrave. Prandaj përkrahja e bizneseve vendore sidomos atyre të vogla dhe të mesme, për ndërtimin e kapaciteteve konkurruese në tregun e brendshëm me synim të ballafaqimit me konkurrencën e jashtme, përmes rritjes së aftësisë konkurruese, përmes përmirësimit të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara për treg, përmes zvogëlimit të mundshëm të shpenzimeve të panevojshme në procesin prodhues etj., do të ishte politika më e mirë zhvillimit.
- b) Meqë sektori privat në Kosovë është relativisht i ri, ska mundësi financimi personal në teknikë dhe teknologji të re, remitencat nga diaspora janë në zvogëlim e sipër, investimet e përbashkëta të pamundshme, depërtimi në tregje të jashtme i paarrtshëm, rezulton se aftësia konkurruese kosovare edhe për një periudhë jo të shkurtër kohore do të jetë mjaft e dobët.
- c) Sektori shtetëror është jofunksional, ska tregje, si pjesë e ekonomisë së trashëguar me kompani dhe industri pothuajse në kolaps pas shkatërrimeve dhe vjedhjeve para dhe gjatë luftës, ndërsa ai privat jo i konsoliduar dhe mjaft i brishtë, i cili funksionon në një ekonomi, e cila s'ka mundësi akumulimi financiar të madh që t'iu mundësojë pjesëmarrje bizneseve kosovare në tregun e jashtëm.
- d) Mungesa e strategjisë dhe politikave të mirëfillta zhvillimore paraqet pengesë për tërheqjen e investimeve të jashtme, mungesa e

informacioneve, mungesa e luftimit të prezencës së ekonomisë joformale (zvogëlimi i saj në minimum), mungesa e krijimit të ambientit të sigurt për investime, mosafrimi i projekteve adekuate dhe alternativave zhvillimore nga faktori vendor, ndikon në humbjen e besimit të investitorëve të jashtëm në aftësitë dhe gatishmërinë e kreatorëve kosovarë të politikave ekonomike dhe zhvillimore.

- e) Ndërmarrja e nismave rreth hartimit dhe zbatimit të politikave si dhe shkathtësive zhvillimore fiskale për stimulimin e eksportit duke u bazuar në rekomandimet e ekspertëve kosovarë dhe ndërkombëtarë, që mund të bëhet përmes këtyre instrumenteve.
- Politika tatimore favorizuese për prodhimin vendor dhe norma jo uniforme e doganave si inkurajuese për zhvillimin e bizneseve prodhuese në Kosovë.
 - Implementimi i sistemit dy tarifor me 0% në mallrat kapitale të importuara si dhe për pjesën dërmuese të llojeve të lëndës parë.
 - Shqyrtimi i shtyerjes së afatit të pagesës për TVSH për bizneset fillestare, si dhe përcjellja e rezultateve të kësaj mase.
- f) Moskrijmi i lehtësirave dhe finacimeve të NVM, pa përkrahjen e fortë institucionale për bizneset eksportuese, moslehtësimit i qarkullimit të lirë të mallrave dhe personave, që natyrisht do të thotë moszhvillim, mosdepërtim në tregje qoftë vendore apo ndërkombëtare, rritje të papunësisë, varfërim të popullsisë, humbje besimi në institucionet kosovare, paraqitje tensionesh sociale etj., janë sfida jo lehtë të tejkalueshme dhe të zgjidhshme për institucionet e Kosovës. Prandaj në kuadër të një ekonomie të tillë, konkurrenca e së cilës është shumë e pavolitshme, që domethënë se përmes eksportit depërtimi në tregjet e jashtme është i pamundur.
- g) Përmes zhvillimit të kuadrit ligjor dhe atij institucional, Insatitucionet e Kosovës duhet të thellojnë angazhimet e tyre për mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat, si i vetmi sektor me perspektivë në drejtim të forcimit të kapaciteteve të biznesit prodhues, sidomos atij me orientim nga eksporti, me qëllim që këto biznese të jenë të suksesshme në tregjet jashtme.
- h) Biznesi kosovar duhet të intensifikojë dhe dinamizojë përpjekjet, veçanërisht në drejtim të zhvillimit të produktit dhe ofrimit të shërbimeve, menaxhimit dhe shërbimit të marketingut konform standardeve rajonale dhe më gjerë.

- i) Intensifikimi i punës në drejtim të krijimit të institucioneve funksionale për sigurimin e cilësisë dhe ekspertizave, si kusht themelor për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve “ Made in Kosova”.

LITERATURA:

1. Dr. Skender Berisha “Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare”, Prishtinë,1998.
2. Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme, Prishtinë, 2010.
3. MTI, Politika tregtare e Kosovës, 2009,
4. The European Commission Liaison Office to Kosovo press release of 27 August 2008
5. Enti Statistikor i Kosovës /Tregtia e jashtme, Prishtinë, 2009.
6. Strategjia e integruar e eksportit e UNCTAD-it (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Tregti), 2009.
7. Veli Lecaj, ”Roli i promovimit në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës”, Punimi i magistraturës, Prishtinë, 2008.
8. Vjetari statistikor i Kosovës, Prishtinë,1988.
9. Vjetari statistikor i Kosovës,Prishtinë,1987.
10. Instituti për hulumtime zhvillimore RIINVEST: “Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës”, 1997/98.
11. http://www.osce.org/publications/eea/2006/07/19786_640_sq.pdf¹
12. Blerim Reka, ”E drejta e unionit evropian, Instituti kosovar për integritet euro atlantike”, 2000, Prishtinë.
13. Klan Kosova me datën 05 Qershor 2009,16;50.
14. Instituti për Hulumtime Zhvillimore “RIINVEST”, Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë,2004,
Trade Policy during the Transition, Lessons from the 1990s, CERT

Përgjegjësia sociale, një kërkesë e kohës

Brikenë Dionizi

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Departamenti i administrim-biznesit

Social responsibility, a requirement in today environment

ABSTRACT

Profit maximization is the main objective of every business. In order to stay in the market and have a competitive advantage the companies have to satisfy their customers.

Nowadays corporate responsibility is becoming more and more important. Corporate Social Responsibility includes such elements as environmental protection, social equity and economic growth. It has a strong affinity with the founding principles of quality management. As by the Advisory Group on CRS at the International Organization for Standardization, Corporate Social Responsibility is "a balanced approach for organization to address economic, social and environmental issues in a way that aims to benefit people, communities and society"⁵³.

CSR includes considerations of such issues as:

- Human rights,
- Workplace and employees issues,
- Unfair business practices,
- Organizational governance,
- Environmental aspects.

⁵³ International Organization for Standardization strategic advisory group on CRS, preliminary working definition of organizational social responsibility, ISO/TMB AGCSR, N.4, 2002

Corporate Social Responsibility can be advanced more rapidly if it is incorporated into established quality management models and methodologies.

Maksimizimi i fitimit është sigurisht objektivi kryesor për çdo organizatë biznesi. Por, organizatat e kuptojnë, që në mënyrë që të mbijetojnë në këtë treg shumë konkurrues në ditët e sotme, duhet që të kenë konsumatorë të kënaqur.

Dhe, në ditët e sotme bëhet një kërkesë përherë dhe më e rëndësishme, përgjegjësia sociale e biznesit. Përgjegjësia sociale e biznesit përfshin elemente të tilla, si: mbrojtja mjedisore, barazia sociale dhe rritja ekonomike, dhe ajo ka një lidhje të fortë me parimet bazë të menaxhimit të cilësisë. Sipas grupit strategjik të këshillimit mbi përgjegjësitë sociale, pranë Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), Përgjegjësitë sociale të kompanisë (PSK) përshkruhen si *“një praktikë për organizatat, e cila adreson çështje ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në një mënyrë që i siguron përfitim njerëzve, komunitetit dhe shoqërisë⁵⁴”*.

PSK përfshin çështje që lidhen me:

- Të drejtat e njeriut
- Vendin e punës dhe punonjësit, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë
- Praktikën jo të drejtë të biznesit
- Udhëheqjen organizative
- Aspektet mjedisore
- Tregun dhe konsumatorët
- Përfshirjen e komunitetit
- Zhvillimet sociale

Etika dhe vlerat janë thelbi mbi të cilin është formuar biznesi, dhe nëpërmjet të cilave mund të arrihet suksesi e të zhvillohet komuniteti.


Ka shumë arsye pse një kompani duhet të ketë parasysh përgjegjësitë sociale, disa prej të cilave po i rreshtoj më poshtë:

- Përmirësohet morali i punonjësve

⁵⁴ ISO, grupi i këshillimit, puna paraprake mbi përgjegjësitë sociale organizative, ISO/TMB AGCSR N.4, 2002

- Rritet besnikëria e konsumatorit, si dhe aftësia për të tërhequr konsumatorë të rinj
- Përmirësimin e pasqyrimin financiar
- Eleminimin e pasqyrimin negativ që do të rezultonte nga veprime joetike
- Rritet aftësia për të tërhequr stakeholders të tjerë
- Bën botën një vend më të mirë

Figura 1 tregon efektet e ndërlidhura të një klime etike në biznes.



Burimi: O.C. Ferrell, John Fraedrich dhe Linda Ferrell, Business Ethics: Ethical Decision Making and Cases, 2000

Duke kontribuar në pjesën e brendshme të organizatës dhe në angazhimet e saj, klima etike ndikon së fundmi në nivelet e përfitimeve.

PSK ndikon një gamë të gjerë të aktiviteteve organizative, duke përfshirë:

- Prodhimin dhe integritetin e produktit
- Etiketimin dhe paketimin
- Marketimin dhe reklamimin
- Praktikat e shitjes
- Vendosjen e çmimit

- Shpërndarjen⁵⁵

PSK siguron një sërë përparësish për biznesin, duke përfshirë:

- Përmirësimin e kënaqësisë së konsumatorit
- Mbrojtjen e imazhit të kompanisë
- Uljen e mungesave dhe largimeve të punonjësve, duke rritur gjithashtu aftësinë për të mbajtur punonjësit e talentuar
- Ulja dhe kufizimi i çështjeve të diskutueshme që mund të përfundojnë dhe në gjyq

Filozofët mbi përgjegjësitë sociale

PSK dhe cilësia janë të lidhura fort nëpërmjet parimeve të tilla si etika dhe respekti për njerëzit. Këto parime janë të përfshira në filozofitë e Philip Crosby, W. Edwards Deming, Joseph Juran dhe Kaoru Ishikawa⁵⁶.

Crosby ka folur për integritetin kur ka thënë *“Drejtuesi duhet të përpiqet t’i japë konsumatorit, atë që i ka premtuar, duhet të besojë që kompania do të lulëzojë vetëm nëse të gjithë punonjësit ndjehen mirë, dhe duhet të jetë i bindur që as punonjësit, as konsumatorët nuk dëmtohen”*.

Deming thekson tek 14 pikat e tij *“eliminimin e frikës”*, krijimin e mundësisë për të bërë pyetje e për të shprehur ide, për të thyer barrierat ndërmjet punonjësve, për të inkurajuar krenarinë në punë dhe për të vendosur vetëpërmirësim për secilin. Deming, mbështeste një klimë organizative ku marrëveshjet ndërmjet menaxherëve, punonjësve dhe konsumatorëve vendosen mbi baza etike.

Duke u bazuar në mësimet e Deming, struktura si dhe shumë i rëndësishëm, sistemi i vlerësimit dhe shpërblimit, duhet të promovojnë vlera organizative dhe jo të krijojnë kontradikta. Kjo rezulton në një kulturë sinqeriteti dhe besimi, si jashtë ashtu dhe brenda organizatës, duke përmirësuar kështu edhe reputacionin e kompanisë.

Juran ka folur për një sistem vlerash, besimesh dhe sjelljesh që janë të nevojshme për suksesin organizativ. Ai ka hedhur idenë që cilësia njihet për fokusin te njerëzit nëpërmjet kohës së punës dhe kënaqësisë së punonjësve.

⁵⁵ Biznesi për përgjegjësi sociale, www.bsr.org

⁵⁶ Corporate Social Responsibility, Denis Leonard&Rodney McAdam, QP, Tetor, 2008, f. 27-31.


Ishikawa ka bërë një pohim me të vërtetë të fortë në lidhje me PSK kur ka thënë: “ *Shqetësimi i parë i një kompanie është lumturia e njerëzve që kanë të bëjnë me të. Nëse njerëzit nuk ndjehen të lumtur, ajo kompani nuk e meriton të ekzistojë*”⁵⁷.

Cilësia është një element shumë i rëndësishëm në mënyrë që kompania të jetë e suksesshme në zbatimin e PSK dhe janë pikërisht katër elemente kyçe që formojnë mjedisin e përshtatshëm të menaxhimit të cilësisë:

- **Mjetet dhe teknikat**, që përfshijnë mjete dhe sisteme menaxhimi për zgjidhjen e problemeve, të tilla si ISO 9000, ISO 14000 dhe së shpejti ISO 26000
- **Modele të cilësisë**, që përfshijnë modele që serviren nga filozofët e cilësisë
- **Strategjia e kompanisë**, e cila përcakton drejtimin e rrugën, nëpërmjet së cilës organizata do të arrijë objektivat e veta dhe që është në të njëjtën linjë me mjetet dhe modelet e cilësisë
- **Filozofitë** që janë elementi më i rëndësishëm dhe janë thelbi i menaxhimit të cilësisë. Të ndërtuara mbi mësimet e Deming, Juran dhe të tjerëve, këto filozofi e bëjnë unik menaxhimin e cilësisë, krahasuar me teoritë dhe praktikën e biznesit. Ato influencojnë dhe udhëheqin formimin e vlerave organizative, duke ndikuar përfundimisht në vizionin dhe misionin e kompanisë.

Sa thamë më sipër mund të paraqitet skematikisht si më poshtë vijon (fig.2), ku në qendër janë filozofitë, vlerat dhe kultura. Të gjitha këto nuk mund të mendohen pa praninë e tre elementëve të tjerë (mjete dhe teknika, modele të cilësisë, strategjia e kompanisë), në mënyrë që të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për menaxhimin e cilësisë.

⁵⁷ Kaoru Ishikawa, What is Total Quality Control? The Japanese Way, Quality Progress, Shtator, 2003, f.48-54.



Pergjegjesia sociale e kompanise eshte ne qender

ISO 26000

Standardet ISO kontribojnë në zhvillimin, prodhimin e furnizimin e produkteve e shërbimeve në mënyrë më efçente e të sigurt. Ata e bëjnë më të lehtë e më të sigurt tregtinë mes vendeve. Ata ndihmojnë në transferimin e teknologjisë në vendet në zhvillim. Gjithashtu standardet ISO mbrojnë konsumatorët e produkteve apo shërbimeve dhe bëjnë jetën e tyre më të thjeshtë⁵⁸.

Në lidhje me përgjegjësitë sociale një praktikë e strukturuar e PSK-së, në fakt, ka ekzistuar prej kohësh në formën e ISO 14000⁵⁹ (standardi menaxherial mjedisor), i cili i kombinuar me standardet e familjes ISO 9000 (grup standardet e menaxhimit të cilësisë), ka funksionuar deri diku në këtë drejtim. Me zhvillimet e sotme, me ndërgjegjësimin gjithnjë e më tepër të publikut për rëndësinë e

⁵⁸ 10 Elementët bazë të cilësisë, B. Dionizi, Buletini Uni. Shkodër, 2009.

⁵⁹ Drejtimi i cilësisë dhe standardet mjedisore, Konf. Shkencore Ulqin, Prill, 2010.

përgjegjësi sociale, del e domosdoshme prania e një standardi specifik për përgjegjësi sociale dhe aktualisht Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO) po punon për formulimin e një standardi të ri që ka si objekt pikërisht përgjegjësi sociale, ISO 26000 “*Udhëzim mbi Përgjegjësi Sociale*”, i cili aktualisht është botuar si draft-standard ndërkombëtar. Sipas propozimit të Bordit menaxherial teknik në ISO, standardi i ri ka për qëllim⁶⁰:

- Të ndihmojë organizatat në adresimin e përgjegjësi sociale, duke respektuar edhe ndryshimet kulturore, shoqërore, mjedisore dhe ligjore, si dhe kushtet e zhvillimit ekonomik
- Të sigurojë udhëzim praktik për të aplikuar përgjegjësi sociale, për të identifikuar dhe për t’u angazhuar me stakeholders, për të rritur besueshmërinë e raporteve rreth përgjegjësi sociale
- Të theksojë rezultatet e performancës dhe përmirësimet
- Të rrisë besimin dhe kënaqësinë në organizatë të konsumatorët dhe stakeholders të tjerë
- Të sigurojë vazhdueshmëri dhe jo të jetë në kundërshtim me dokumentet ekzistuese dhe standardet ekzistuese të ISO
- Të promovojë një terminologji unike në fushën përgjegjësi sociale
- Të zgjerojë ndërgjegjësimin për përgjegjësi sociale
- Të mos ulë autoritetin e qeverisë për t’iu adresuar përgjegjësi sociale të organizatave

ISO 26000 “*Udhëzimi mbi përgjegjësi sociale*”, mbulon kryesisht çështje ekonomike, të shëndetit dhe sigurisë, të zinxhirit të vlerave dhe këndvështrimet e ndryshme të njerëzve të ndryshëm. Kjo mund të përdoret nga organizata për të filluar përpjekjet për përgjegjësi sociale dhe përmban⁶¹:

- **Qeverisjen organizative:** sistemi nëpërmjet të cilit merren vendime dhe zbatohen këto në përputhje me objektivat e organizatës.
- **Të drejtat e njeriut:** bazuar në të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe idenë që të drejtat e njeriut kapërcejnë ligje dhe tradita kulturore.

⁶⁰ Strong Foundation, Solid Future, Denis Leonard, Quality Progress, Mars, 2008, f. 30-35

⁶¹ Taking Responsibility, Stanford Liebesman, Quality Progress, Maj, 2010, f.60-62

- **Praktikat e punës:** përfshin rekrutimin dhe promovimin e punonjësve, procedurat disiplinore dhe të ankimeve, transferimin e punonjësve, mbarimin e kontratës së punësimit, shëndetin e sigurinë, dhe çdo politikë apo praktikë që ndikon kushtet e punës.
- **Mjedisin:** pohon që një organizatë ka nevojë të marrë në konsideratë ndikimin ekonomik, social dhe mjedisor në vendimet dhe aktivitetet e saj. Shqetësime kyçe këtu janë parandalimi i ndotjes, përdorim i qëndrueshëm i burimeve, lehtësimin e ndryshimit klimatik, si dhe mbrojtjen dhe rregullimin e mjedisit natyror.
- **Praktikat operuese të drejta:** lidhet me sjelljen etike në marrëdhënien me organizata dhe individë. Përfshin antikorrupsionin, përfshirjen politike të përgjegjshme, konkurrencën e drejtë dhe respektimin e të drejtës së pasurisë.
- **Çështjet e konsumatorit:** ka të bëjë me praktikat operuese të drejta dhe përfshin praktika të drejta për marketingun, dhënien e informacionit dhe bërjen e kontratave; mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve, mbrojtjen e të dhënave të konsumatorëve, edukim dhe ndërgjegjësim etj.
- **Përfshirjen e komunitetit:** kontributet (individualisht ose nëpërmjet shoqatave) për të ndihmuar në forcimin e shoqërisë civile dhe të institucioneve të saj dhe për të fuqizuar vlerat demokratike dhe qytetare.

Situata në vend

Ç'mund të themi për kompanitë në vend? A ndërmarrin ato përgjegjësi sociale? Si e planifikojnë angazhimin e tyre për përgjegjësi sociale, në planet e tyre afatgjata?

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për vitin 2009, rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

- 109, 267 ndërmarrje rezultojnë aktive në fund të vitit 2009
- Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar dominojnë në numër, 92 përqind
- 734 ndërmarrje janë klasifikuar si VIP, 0.7 përqind⁶²

⁶² www.instat.gov.al

Duke patur parasysh që marrja e standardeve kërkon investime të konsiderueshme, biznesi i vogël, që zë dhe vendin më të madh në vend, e ka më të vështirë të planifikojë dhe të ndërmarrë rrugën e marrjes së standardeve. Sipas informacioneve të marra pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, standardet më të kërkuara janë standardet e sistemeve të menaxhimit të cilësisë (standardi ISO 9001) dhe standardet e ndërtimit. Megjithatë kjo nuk do të thotë që kompanitë shqiptare nuk ndërmarrin përgjegjësi sociale. Ka kompani që ndërmarrin PSK në mënyrë jo të rregullt, por ka dhe kompani që PSK i ndërmarrin në mënyrë të vazhdueshme.

Për sigurimin e të dhënave në lidhje me angazhimin në përgjegjësi sociale u bënë intervista në 20 kompani në vend. Për marrjen e intervistave u selektuan ato kompani që kanë të shprehur angazhimin në përgjegjësi sociale (PSK) në strategjinë e tyre. U intervistuan drejtuesit në katër degë bankash në Shkodër (me seli qendrore në Tiranë) dhe pjesa tjetër e intervistave u realizua në kompani me vendndodhje në Tiranë. Intervista u realizua me drejtuesin e kompanisë ose një person tjetër në pozicion menaxherial. Në këto intervista u bënë pyetjet e mëposhtme:

1. Angazhimin në PSK e konsideroni një aktivitet të përvitshëm?
2. Në çfarë fushash e konsideroni të rëndësishëm PSK?
3. Sa merrni parasysh PSK në planet tuaja afatgjata?
4. A planifikoni të merrni standardin ISO 26000?

Në përgjigjet që u morën, 13 kompani (65 përqind) investonin çdo vit në PSK, ndërkohë që 7 (35 përqind) prej tyre investonin në mënyrë rastësore.

Përsa i përket pyetjes së dytë të gjithë investonin në bamirësi, në shtresat në nevojë, por vetëm 12 (60 përqind) prej tyre investonin dhe në përmirësimin e kushteve të punonjësve dhe në ruajtjen e mjedisit.

Pyetjes së tretë 11 (55 përqind) iu përgjigjën pozitivisht se i merrnin parasysh PSK në planet e tyre afatgjata, por vetëm 5 (25 përqind) prej tyre pohojnë që janë të gatshëm të marrin standardin 26000.

A përfaqësojnë 20 kompani biznesin shqiptar? Në fakt është një shifër shumë e vogël krahasuar me numrin total të bizneseve që veprojnë në territorin shqiptar. Por duhet të kemi parasysh që edhe pse jemi një vend i vogël, që vazhdojmë të eksperimentojnë në fushën e biznesit, edhe pse biznesi përgjithësisht është biznes i vogël, përgjegjësi sociale ndërmerren nga kompani të ndryshme që veprojnë në Shqipëri dhe shifrat

tregojnë që kompanitë jo vetëm reagojnë nga ana sociale, por gjithashtu edhe përfshihen. Kjo do të thotë që ato vetë janë personalisht të pranishme në shoqërinë përreth me iniciativa sociale. Megjithatë duhet pranuar që në këtë drejtim duhet të bëhet shumë.

Konkluzione:

- Përgjegjësitë sociale janë një element shumë i rëndësishëm në shoqërinë e sotme, ku secili duhet të sillet si një qytetar i mirë, dhe kjo përfshin edhe përfshirjen në përgjegjësi sociale. Konsumatori i sotëm këkon një standard jetese më të mirë, ai është më tepër kërkues për produktet e shërbimet që konsumon dhe për mjedisin që e rrethon. Kjo detyron edhe kompanitë që të reagojnë e të përfshihen edhe ato vetë në shoqëri.
- Prandaj dhe ISO 26000 do jetë një udhëzues shumë i mirë për bizneset që kërkojnë të angazhohen në PSK. Një standard gjithnjë të orienton për një praktikë të mirë pune dhe standardi ISO26000 i shërben biznesit për të matur e kontrolluar angazhimin në PSK. Për më tepër ky është një standard ndërkombëtar që do të thotë është dhe një certifikatë për bizneset që kërkojnë të dalin në tregun ndërkombëtar (duke pasur parasysh këtu dhe ndryshimet që po ndodhin më Shqipërinë në marrëdhënie me Komunitetin Evropian)
- Por duhet të pranojmë që biznesi në Shqipëri vazhdon të mbetet kryesisht një biznes i vogël, që në mënyrë të vazhdueshme synon mbijetesën prandaj dhe në më të shumtën nuk i ka kapacitetet për të ndërmarrë iniciativa sociale.
- Strukturat përkatëse duhet të bëjnë më tepër në rritjen e ndërgjegjësimit të biznesit për PSK dhe në asistimin e biznesit për marrjen e standardeve. Këtu duhet të përmend vetë shtetin, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, e cila ka për detyrë jo vetëm të adoptojë standardet evropiane dhe ndërkombëtare, por të punojë edhe në drejtim të promovimit dhe të ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e standardeve në jetën e secilit. Por, ky mund të jetë edhe një objekt interesant për OJF-të e ndryshme që veprojnë në komunitet dhe kanë karakter social.

RREFERENCA:

1. Kaoru Ishikawa, What is Total Quality Control? The Japanese Way, Quality Progress, Shtator, 2003.
 2. Corporate Social Responsibility, Denis Leonard&Rodney McAdam, QP Tetor, 2008.
 3. 10 Elementët Bazë të Cilësisë, B. Dionizi, Buletini Uni. Shkodër, 2009.
 4. Drejtimi i Cilësisë dhe Standardet mjedisore, Konf. Shkencore Ulqin, Prill, 2010.
 5. Strong Foundation, Solid Future, Denis Leonard, Quality Progress, Mars, 2008.
 6. Taking Responsibility, Stanford Liebesman, Quality Progress, Maj, 2010.
 7. O.C. Ferrell, John Fraedrich dhe Linda Ferrell, Business Ethics: Ethical Decision Making and Cases, South Western, 2000.
- www.instat.gov.al
 - www.dps.gov.al
 - www.iso.org
 - www.bsr.org

Ndikimi i krizës globale mbi sektorin financiar shqiptar dhe cilësia e informacionit në financimin e biznesit

Fatbardha Molla, Blerta Dragusha

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Departamenti i Financë-Kontabilitetit

ABSTRACT

**Impact of global crisis on the Albanian financial sector and the
quality of information on business financing**

At a global level, the crisis of the last period was a result of the wrong stimulations that supported the misbalanced development of the financial activity, and the wrong perception of evaluation, quotation and risk administration. The supervising institutions, sometimes trapped in complicated structure situations, with insufficient sources and impossibility to follow and understand financial innovators of the market and the position of the risk, were not able to adjust the situation at the proper time. The need to return and maintain the financial stability during this un-preceded crisis requires extraordinary measurements by the public authorities, coordinated and immediate, in the monetary and fiscal field. The central banks have removed every limit and have taken unconventional measures to equip the international markets with liquids. The governments have shown a great engagement to diminish the systemic risk, defending thus the important financial institutions, by guaranteeing the inter-banking loaning, by raising the level of public plan deposits etc.

The crisis is giving to the public authorities and markets of international markets, the best opportunity to identify the gaps and correct them, by avoiding such a crisis in the future. This requires powerful measures and visionary ones, which in a middle term period, will make possible the strengthening of the supervising architecture on different levels, but they will also create the fiscal and financial conditions to avoid the disorders in the financial activity, not only in the financial industry but in the balance of individuals or businesses as well. These measures will require a coordination and high level of responsibility of the public authorities on a national level, as well as the engagement to undertake necessary steps for the reforming and improvement of the supervising superstructure on a regional, European and global level.

Hyrje

Në nivel global, kriza e kohëve të fundit ishte pasojë e stimujve të gabuar që mbështetën zhvillimin e çekuilibruar të aktivitetit financiar dhe perceptimin e gabuar të vlerësimit, kuotimit dhe administrimit të rrezikut. Institucionet mbikëqyrëse, ndonjëherë të zëna në grackë në situata strukturash të ndërlikuara, në pamjaftueshmëri burimesh e pamundësi për të ndjekur dhe kuptuar novatorët financiarë të tregut dhe vendndodhjen e rrezikut, nuk ishin në gjendje ta rregullonin situatën në kohën e duhur. Nevoja për të rikthyer dhe ruajtur stabilitetin financiar gjatë kësaj krize të paprecedentë, kërkon marrjen e masave të jashtëzakonshme, të koordinuara dhe të menjëhershme nga autoritetet publike, në fushën monetare dhe atë fiskale. Bankat qendrore kanë hequr çdo kufizim dhe kanë ndërmarrë masa jokonvencionale për të pajisur tregjet financiare me likuiditet. Qeveritë kanë treguar një angazhim shumë të madh për të ulur rrezikun sistematik, duke mbrojtur institucionet e rëndësishme financiare, duke dhënë garanci për kredidhënien ndërbankare dhe duke rritur nivelin e garancive të depozitave për publikun etj...

Kriza po iu jep autoriteteve publike dhe tregjeve kudo në botë mundësinë më të mirë për të identifikuar mangësitë dhe për t'i korrigjuar ato, me qëllim shmangien e një krize të tillë në të ardhmen. Kjo detyrë kërkon masa të fuqishme dhe vizionare, të cilat në periudhë afatmesme do të mundësojnë forcimin e arkitekturës mbikëqyrëse në nivele të ndryshme, por do të krijojnë gjithashtu kushtet fiskale dhe financiare për të shmangur

çrregullimet në aktivitetin financiar, jo vetëm në industrinë financiare por edhe në bilancin e individëve dhe të bizneseve. Këto masa do të kërkojnë një bashkërendim dhe përgjegjësi të lartë të autoriteteve publike në nivel kombëtar, si dhe angazhimin për të ndërmarrë hapa të nevojshëm, për reformimin dhe përmirësimin e supërstrukturës mbikqyrëse në nivel rajonal, evropian dhe global.

Në këtë kuadër në punim do të trajtohen me kujdes roli i raportimit financiar cilësor dhe i besueshëm dhe ndikimi i tij në zhvillimin e sistemit financiar, hyrjen në tregjet e kapitalit, rolin e tij në parandalimin e krizave.

Dhe së dyti pasojat e krizës financiare në zhvillimin e vendeve tona.

Cilësia e informacionit në financimin e biznesit

Cilësia⁶³ e lartë e raportimit financiar është një faktor kyç për besueshmërinë e informacionit financiar, për zhvillimin ekonomik e financiar të një vendi si dhe për hyrjen e investimeve të huaja. Në një vend ku informacioni i PF nuk është i besueshëm dhe i sigurtë nuk ka zhvillim të tregjeve të kapitalit, investitorët e huaj nuk kanë sigurinë e duhur për të marrë vendime të drejta mbi bazën e informacionit financiar që sigurohet nga kontabiliteti.

Ka mjaft raste në botë, sidomos në dy dekadat e fundit që demonstrojnë rolin e madh që ka informacioni i raportimit financiar me cilësi të lartë. Një kontabilitet i cili nuk siguron një informacion cilësor e të besueshëm mund të bejë që përdoruesit e tij të marrin vendime të gabuara me pasoja katastrofike për ta, për ekonominë e vendit, por edhe me gjerë. Kështu rastet e skandaleve të ENRON, Parmalat, Worldcom, etj., janë shembuj evident të rolit dhe pasojave negative që mund të ketë informacioni kontabël jocilësor dhe jo i besueshëm. Si pasojë e informacionit të gabuar dhe shtrembëruar të siguruar nga pasqyrat financiare të përgatitura nga kontabiliteti i këtyre kompanive, mijëra aksionerë humbën kapitalet e tyre, mijëra punonjës humbën vendet e punës, një sërë kompanish të lidhura me to falimentuan duke sjellë dëme të mëdha edhe për ekonominë e vendit, shumë banka pësuan humbje të mëdha.

⁶³ Prof.dr SOTIRAQ DHAMO , Kontabiliteti i Avancuar, 2009, f. 69.

Kontabiliteti i organizuar mirë dhe raportimi financiar cilësor dhe i besueshëm janë një faktor që ndikojnë në zhvillimin e sektorit financiar dhe të tij ekonomik.

Ndikimi i RF me cilësi të lartë në zhvillimin e sektorit financiar dhe privat shprehet në disa drejtime.

RF cilësor dhe i besueshëm:

- siguron forcimin e akitekturës financiare vendase dhe reduktimin e rrezikut të krizave të tregjeve financiare dhe ndikimeve negative ekonomike që shoqërojnë ato.
- Lehtëson procesin e huamarrjes të shoqërive të vogla prej sektorit financiar formal duke ulur kështu koston e informacionit dhe të huamarrjes.
- Ndikon në futjen e investimeve të huaja direkte si dhe mobilizojnë kursimet vendase.
- Lejon investitorët të vlerësojnë perspektivat e shoqërive dhe marrjen e vendimeve të investimeve të mirinformuara, të cilat çojnë në uljen e koston të kapitalit dhe shpërndarjen me të mirë të burimeve.
- Siguron informacionin i cili lejon që akionerët dhe publiku të ketë një mundësi marrje të informacionit për të vlerësuar ecurinë e drejtimit dhe duke mundësuar kështu një rol të tyre aktiv në tregjet e kapitalit.
- Mbështet integrimin ekonomik rajonal dhe global.

Për nivelin e raportimit financiar me cilësi të lartë, një faktor i rëndësishëm është edhe ekzistenca e tregjeve financiare të zhvilluara. Por po ashtu edhe raportimi financiar është një faktor kyç për zhvillimin e shëndoshë të ekonomisë së tregut dhe të tregjeve financiare. Pra ka një ndërvarësi midis cilësisë dhe besueshmërisë së RF dhe zhvillimit të tregjeve financiare. Mungesa e tregjeve financiare në Shqipëri ndikon dhe në nivelin e raportimit financiar dhe anasjelltas.

Realizimi i një raportimi financiar të besueshëm varet nga një serë faktorësh:

a - Nga ambienti ekonomik

Sigurimi i një raportimi financiar me cilësi të lartë është i pandarë nga ndikimi i ambientit ekonomik ku operojnë njësitë ekonomike raportuese. Këtu do të rendisim faktorë të tillë si ekonomia informale, ritmet e shpejta të zhvillimit ekonomik dhe pasurimit të shtresave të vaçantë atë popullsisë, niveli i korrupsionit dhe evazionit, niveli i konkurrencës në treg dhe konkurrenca e pandershme, prirja për pasurim të

shpejtë, kultura e ulët e ekonomisë së tregut, vendosja e hartuesve të PF përballë presioneve të dyfishta: të organeve tatimore shtetërore dhe të pronarëve/drejtuesve të shoqërisë.

b - Kudri rregullator kombëtar dhe me gjerë është një faktor që ndikon në cilësinë dhe besueshmërinë e RF.

- *Rregullimi fiskal* është një faktor që ndikon në tërësinë e kërkesave për informacion të një prej përdoruesve kryesorë të RF. Hartimi i rregullave të sakta, të qartë dhe neutralë në lidhje me vendosjen e tatimeve dhe taksave janë një parakusht dhe për besueshmërinë e RF sidomos për vende si Shqipëria.

- *Vendosja e rregullave kontabël* të qarta e të kuptueshme në nivel kombëtar është bazë për një raportim financiar të besueshëm. Harmonizimi dhe koherenca e rregullimit kontabël kombëtar me rregullimin ndërkombëtar ndikon në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e tregjeve financiare dhe të kapitalit dhe në integrimin e vendit në rajon dhe me gjerë.

a- Struktura ekonomike dhe e biznesit ndikojnë dhe në nivelin e RF.

Shqipëria është një vend me drejtim zhvillimi ekonomik bujqësinë dhe importin. Mungojnë tregjet e kapitalit dhe ato financiare. Nëse shikohet struktura e biznesit në vendin tonë rezulton që mbizotëron mikrobiznesi dhe biznesi i vogël. Kjo bën që dhe kosto / përfitimi i informacionit të jetë një faktor mjaft i ndjeshëm në drejtim të raportimit financiar të këtyre njësive.

Bizneset e mesme dhe të mëdha janë në numër të vogël. Ato përbëhen kryesisht nga ish-ndërmarrjet publike, si dhe disa biznese të mëdha që shpesh janë monopole. Kjo strukturë ndikon dhe në cilësinë e informacionit të RF (a) BV dhe të mesme më pak të kujdesshme (b) BM me shumë interes për RF.

b- Niveli i përgatitjes profesionale dhe i organizimit profesional ndikon në cilësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar.

Sigurimi i programeve në nivelin e studimit universitar në përputhje me zhvillimet aktuale të kontabilitetit dhe të ndërkombëtarizimit të tij, zhvillimi i edukimit kontabël jo vetëm për kontabilistë, por edhe për drejtuesit dhe përdoruesit e niveleve të ndryshme, është një faktor që siguron një ambient për raportim financiar cilësor e të besueshëm. Po kështu dhe cilësia e edukimit kontabël të profesionistëve të kontabilitetit është një faktor jo pak i rëndësishëm në

drejtim të sigurimit të cilësisë dhe besueshmërisë të raportimit financiar.

Në rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë të raportimit financiar ka ndikuar edhe standardizimi ndërkombëtar i kontabilitetit. Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar synojnë në sigurimin e pasqyrave financiare që japin informacion të besueshëm dhe cilësor të vlefshëm në marrjen e vendimeve nga përdoruesit e tyre.

1. Përdoruesit e pasqyrave financiare të publikueshme e nevoja e tyre për informacion

Përdoruesit e pasqyrave financiare përfshijnë investitorët aktualë dhe potencialë, të punësuarit, borxhdhënësit, furnitorët dhe kreditorët e tjerë të tregut, klientët, qeverinë dhe agjencitë e saj dhe publiku. Ato përdorin pasqyrat financiare për të plotësuar disa nga nevojat e tyre për informacion.

Këto nevoja përfshijnë:

a- Investitorët : Përfituesit e riskut të kapitalit dhe konsulentëve të tyre janë të shqetësuar lidhur me riskun e natyrshëm dhe kthimin e përfitur nga investimet e tyre. Ato kanë nevojë për informacion për t'i ndihmuar ata që të vendosin se kur duhet të blejnë, të shesin apo të mbajnë aksionet që ata zotërojnë. Aksionarët janë gjithashtu të interesuar për informacionin, i cili bën të mundur që shoqëria të vlerësojë aftësinë për të paguar dividendet.

b- Të punësuarit : Këta si dhe grupet e tyre përfaqësuese janë interesuar për informacionin mbi stabilitetin dhe përfitueshmërinë e punëtorëve të tyre. Ato interesohen gjithashtu për informacionin, i cili u bën të mundur atyre që të vlerësojnë aftësinë e shoqërisë për të përmirësuar kushtet e punës, për të dhënë shpërblime, rritjet e pagës, përfitimet e daljes në pension dhe mundësitë e punësimit.

c- Kredithënësit: Këta janë të interesuar për informacione që bëjnë të mundur që ata të vendosin nëse borxhi i dhënë dhe interesat e lidhura me to të paguhen kur i vjen koha.

d- Furnitorët dhe kreditorët e tjerë tregtarë: Këta janë të interesuar për informacione që u bën të mundur atyre të vendosin nëse shuma që shoqëria i detyrohet atyre do të paguhet apo jo në kohë. Kreditorët e

tregut mund të jenë të interesuar për shoqërinë për një periudhë me të shkurtër sesa borxhdhënësit.

e- Klientet: Kanë interes për informacionin mbi vazhdimësinë e shoqërisë, sidomos kur ata kanë një përfshirje afatgjatë me to, ose janë të varur nga ajo.

f- Qeveria dhe agjencia e saj: Ato janë të interesuara për shpërndarjen e burimeve dhe aktivitetin e ndërmarrjes. Ato kërkojnë gjithashtu informacion në mënyrë që të rregullojnë aktivitetet e shoqërisë, të vendosin politikat e taksave dhe tatimeve dhe informacionin që shërben si një bazë për të ardhurat kombëtare dhe situata të ngjashme.

g- Publiku: Shoqëritë ndikojnë publikun në mënyra të ndryshme. Për shembull shoqëria mund të ketë një kontribut thelbësor në ekonominë lokale. Pasqyrat financiare mund të ndihmojnë publikun në përfitimin e informacionit mbi tendencën dhe zhvillimet aktuale në prosperitetin e njësisë ekonomike dhe të një mase të aktiviteteve.

2. Efektet shkatërruese të krizës në sistemin financiar dhe në ekonomi

Kriza⁶⁴ aktuale ka përfshirë botën e me theks të veçantë, vendet më të zhvilluara, të atyre shteteve që kanë shumicën e brutoproduktit botëror dhe që kanë nivelin e lartë të jetesës.

Efektet shkatërruese të kësaj krize do të jenë më të rënda se asnjë herë më parë dhe nuk mund të parashikohen.

Kohë të gjatë, në teorinë ekonomike botërore pati sunduar teoria e ligjeve të tregut të lirë. Me bindjen se tregu është rregullatori i të gjitha problemeve ekonomike. Tregu, si uji i lumit do e gjejë rrjedhën më të mirë dhe do të gjejë zgjidhjen e nevojshme më të mirën. Prandaj sa më pak barriera shtetërore tregut, sa më pak ndërhyrje shtetërore dhe vetë tregu është një autorregullator ekonomik. Ekonomia e tregut të lirë u bë model i zhvillimit dhe progresit ekonomik botëror, ajo kaloi barrierat kombëtare dhe u bë ligji i zhvillimit të mbarë ekonomisë botërore. Globalizmi dhe tregu i lirë botëror u bënë parimet e zhvillimit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar. Të gjithë organizmat ndërkombëtarë, si:

⁶⁴ Mr. Beqir Beqa, I diplomuar në shkencat ekonomike në Lozanë/Zvicër
Magjistër i ekonomisë 07 shkurt, 2009

Banka Botërore, shtetet e fuqishme ekonomike, parime të zhvillimit dhe bashkëpunimit, vunë ekonominë e tregut të lirë dhe eliminimin e ndërhyrjeve shtetërore. Sa më pak intervenim të shtetit sa më tepër liri veprimit të tregut, ky ishte parimi kryesor ndërkombëtar.

Ekonomia botërore shënon një hov të madh zhvillimi, dhe ligji i cikleve të zhvillimit të ekonomisë u minimizua, krizat kaloheshin më lehtë dhe ekonomitë vazhdonin me ritme të zhvillimit pozitiv ose në fazat më të këqija niveli i zhvillimit zero. Duke pasur tregu si parimin kryesor të saj fitimin, u realizua një zhvillim i hovshëm dhe fitime të papara më parë. Kapitali financiar krijoi produkte të reja dhe i freskoi ato të vjetrat, si aksionet, obligacionet dhe letrat tjera me vlerë për të realizuar rentabilitet sa më të madh.

Fillimet e krizës financiare

Gjatë vitit 2003 dhe 2004, Banka e Rezerveve Federale Amerikane « *Federal Reserve Bank* », aplikonte përqindje të interesit tejet të ulët, për të stimuluar konsumin, për të nxitur familjet amerikane për të investuar në blerjen e shtëpive. Mjaftonte që të shprehesh dëshirën e blerjes së shtëpisë edhe pa të adhura mund të bleje shtëpinë duke të akorduar kredinë edhe me 110% të vlerës reale të shtëpisë. Këto kushte sollën edhe rritjen e kërkesave nga familjet për këto kredi dhe blerjen e shtëpive çka rrjedhimisht shkaktoi edhe rritjen e çmimeve të tregut imobilier (objekteve). Zakonisht vitet e para (1,3 apo 5 vite) ishin të mbuluara me përqindje të interesit fiks të promovimit që pastaj kalohej në përqindje të interesit variabile. Kjo formë e tregut, financimit « subprime » u zgjerua jo vetëm mbi sektorin imobilier-hipotekë, por edhe tek kartat e kreditit, veturave me qira dhe sektorë të tjerë duke iu akorduar kredi edhe një klienti jo solvable.

Ky lloj tregu shënoi hove sidomos gjatë viteve 2002-2006, ku bie fjala huat hipotekare prej 200 miliard USD në vitin 2002 u rritën në 640 miliard USD në vitin 2006. Logjika ishte shumë e thjeshtë : derisa sektori imobilier rritet, shtëpitë e hipotekuara sigurojnë se përfundimi do të jetë i mirë, pasi që në rast rriziku banka mund t'i marrë paratë e veta duke shitur shtëpinë. Kjo mbulohej edhe më mirë nga rritja e përhershme e çmimit të tregut të shtëpive dhe sektorit imobilier.

Ndyshimi i situatës

Banka e Rezervave Federale Amerikane (Fed) në mënyrë progresive bëri rritjen e përqindjes së interesit nga 1% në 5.25 % (2004

dhe 2006).

Si rezultat i zvogëlimit të kërkesës, çmimi i shtëpive dhe sektorit imobilier shënoi zbritje duke filluar nga viti 2006. Ky ndryshim llogaritet në disa regjione deri në 20 % në 18 muajt e fundit.

Si rrjedhim huamarrësit u gjendën para rritjes së shpejtë të shumës së kthimit të borxhit mujor dhe ata me të ardhura më të ulëta u gjendën të pafuqishëm për kthimin e tyre. Njëkohësisht tregu i shtëpive dhe i imobiliereve në përgjithësi shënoi rënie. Bankat u gjendën para problemit të tërheqjes së kredisë, sidomos në rastin kur paaftësia e kthimit të borxhit nga huamarrësit u bë masovik. Në vitin 2007 përqindja e paaftësisë së kthimit të borxheve nga huamarrësit arriti në 15%.

Josolvabiliteti (pafuqia e kthimit të borxheve), i huamarrësve dhe rënia e çmimeve të sektorit imobilier shkaktuan falimentimin e disa bankave të specializuara për huatë hipotekare me rreziqe.

Problemi i kredive hipotekare nuk ndalet vetëm me kaq. Huatë e dhëna për hipoteka zakonisht për të transferuar rrezikun shndërrohen në letra me vlerë, të cilat të konsideruara si të sigurta shiten tek bankat dhe fondacionet financiare.

Këto hipoteka të shndërruara në letra me vlerë zakonisht janë ndarë në pjesë shumë më të vogla të saj duke u bashkuar me pjesë të tjera të letrave me vlerë siç janë aksionet, obligacionet, duke krijuar produkte të reja financiare që shiteshin si të tilla jo vetëm tek bankat amerikane, por në gjithë sistemin financiar botëror. Bankat shitnin produktet e kombinuara për të bartur dhe minimizuar rrezikun në tregun financiar, pa ditur blerësi rrezikun real që paraqesin ato letra me vlerë. Këto produkte financiare të titrizuara zakonisht i blenin investitorët e ndryshëm, fondet investuese klasike, fondet spekulative etj.

Në këtë mënyrë investime të rrezikuara nuk mbeten vetëm investimet në hipoteka, por edhe produktet e tjera financiare, pa pasur mundësi të krijohet një ndarje mes atyre me rrezik dhe atyre të sigurta.

Investitorët e ndryshëm duke u mbështetur në rendimentin e lartë të kredive subprime të titëruara, me kërksat e tyre të vazhdueshme, kanë ushtruar një presion të madh mbi zgjerimin e madh të këtyre produkteve me qëllim rritjen e performancës së fondeve të veta. Ata i kërkonin këto produkte financiare, sepse siguronin rendiment të lartë të emituara nga bankat më prestigjioze amerikane që ofronin siguri.

Dhe së treti edhe vetë bankat janë të financuara nga huatë

afatëgjata të ashtuquajtura dinamike që premtojnë një fitim të lartë, fitim ky i cili tani me krizën e paraqitur doli se është vetëm virtuel dhe jo real dhe se bankat bartin jo vetëm rrezikun e kredive të akorduara, por edhe të kredive të marrura nga vetë banka. Tani në kohën e krizave edhe vetë bankat u gjendën josolvabile, në pamundësinë e kthimit të kamatave të larta të premtura dhe garantuara për borxhet e marrura.

Shpërthimi dhe thellësia e krizës

Kriza financiare e thelluar në shtator të vitit 2008, ku shumë institucione financiare amerikane u gjendën në situatë të falimentimit ose u shpëtuan nga reagimi i Fed (kompania e sigurimeve AIG, Fannie Mae dhe Freddie Mac), u blenë më një çmim simbolik Bear Stearns nga JPMorgan ose falimentuan (Lehman Brothers). Këto ngjarje shkakatuan kaos jashtë SHBA-së e veçanërisht në Evropë, ku shumë institucione financiare u gjendën para falimentimit. I gjithë sistemi bankar ndërkombëtar ishte i ndërlidhur, në veçanti me strumbullarin e vet, qendrat bankare amerikane.

Nga kjo situatë me shpejtësi ndryshoi dhe vazhdon të ndryshojë struktura bankare, ndërsa bursa pësoi rënien më të thellë në historinë e saj, vetëm nga janari deri me 24.10.2008 pësoi një rënie e paparë. : Dow Jones (SHBA) zbriti për 36.83%, Nikkei (Japonia) për 50.03%, FTSE 100 (Britani) për 39.86%, DAX (Gjermani) për 46.75%, CAC 40 (Francë) pësoi rënie prej 43.11%, Bursa e Moskës u mbyll për javë të tëra nga frika e efekteve bursiere.

Planet e shpëtimit të sektorit bankar të rrezikuar fillimisht u pasuan në SHBA dhe Evropë dhe në të shpeshtën e rasteve ka dy aktorë të mëdhenj :

- Qeveritë dhe bankat qendrore.

Bankat qendrore po reagojnë në zbritjen e përqindjes së interesit të tyre si dhe në marrjen si garant të aktiviteteve të infektuara të bankave në vështirësi. Psh., në tetor të vitit 2008, Fed dyfishoi nivelin e likuiditetit të vënë në dispozicion të bankave duke arritur shumë në 9000 miliard dollarë.

Qeveria Amerikane aplikoi Planin Paulson, i cili parashikon blerjen e aktiviteteve të infektuara nga bankat e ndryshme në shumë prej

700 miliard dollarë.

Përkundër këtyre masave të papara për të stabilizuar sektorin bankar dhe për të minimizuar efektet e krizës, kriza vazhdon rrugën e thellimit të saj.

Sistemi bankar u bë i dyshimtë dhe i rrezikshëm, frikë nga ai. U zbulua edhe skandali i financierit Bernard Madoff, që bankat dhe investitorët humbën mbi 50 miliard dollarë. Një sistem investues privat i ndërtuar në sistemin e piramidave klasike të ngjajshme me ato që kemi parë më parë në ekonominë e Shqipërisë. Më e keqja është se fundi i këtyre keqmenaxhimeve dhe të papërgjegjësive nuk shihet askund dhe çdo ditë qëndrohet nën ethet e njërit nga shumë skandalet e pazbuluara bankare!!! Sipas disa analistëve humbjet vetëm të ekonomisë amerikane do të sillen në 3600 miliard dollarë.

Shumë analistë mbështesin idenë se kriza e kredive imobilier « subprime » është vetëm shkëndija e shkaqeve më të thella të kësaj krize. Kriza dalngadal po bartet edhe në ekonominë reale. Kriza bankare po ndryshon formën e saj dhe po paraqitet si krizë e mbiprodhimit. Sektori i industrisë automobilistike është ai i radhës për të përfshirë me shpejtësi të gjithë sektorët e tjerë. Të gjitha parashikimet tani janë duke paraparë një rënie të brutoproductit shoqëror në të gjitha ekonomitë e shteteve të fuqishme dhe të tërë globit. Ato sillen nga parashikimet për vitet 2009 e 2010 në -3 e deri në -10 % të BPSH.

Shumë shtete janë duke krijuar plane gjiganteske të investimeve duke rritur defiçitin buxhetor për të stimuluar ekonominë dhe zvogëluar efektet negative të krizës.

Si është e mundur ky kataklizëm financiar dhe ekonomik i kapitalizmit modern kur të gjithë menduam se kapitalizimi dhe forma e tij moderne neoliberalizimi ishin rregullatorët e mrekullueshëm të tregut dhe shoqërisë? Si është mundur që sistemet demokratike model të krijojnë hapësirë për parregullsi të tilla financiare? Edhe mbrojtësit më të mëdhenj të tregut të lirë si rregullatori i vetëm, janë tërhequr dhe po kërkojnë një kontroll dhe rregullator shumë më të fuqishëm për të evituar përsëritjen e krizave të ngjashme.

E majta e njohur si e majta tradicionale në Evropë ka kohë që mbronte parimin e liberalizimit të plotë të tregut. Edhe ata sikurse edhe e djathta mbronin lirinë e plotë të veprimit të ligjeve të tregut si autorregullator të tregut. Tani si e majta edhe e djathta në Evropë po

kritikojnë këtë filozofi si të rrezikshme për shoqërinë, por që të gjithë nuk dijnë si do të zhvillohet sistemi bankar dhe çfarë rregullash do të vendosen. Të gjithë janë të një mendje se sistemi aktual i vendosur mbi bazat e Breten–Wudit dhe të dollarit si divizë reference, është i pasuksesshëm dhe duhet ndryshuar. Gjithë e keqja erdhi nga Amerika, ku kishte primatin e një tregu „*strehë*“ për të tjerët u bë vend i derdhjes së parasë pa kthim.

Në takimin e G20, i cili u mbajt rreth muajit prill në Londër, u theksua :

- përmirësimin e transparencës së bankave në nivelin e tyre të kontabilitetit
- përforcimin e kontrollit mbi bankat përmes një revizionimi më të mirë
- përmirësimin e menaxhimit të rrezikut duke vendosur modele të reja dhe në kontrollin e pagesës së traderëve-menaxherëve
- përmirësimin e supervizionit të tregut duke rritur kooperimin ndërmjet shteteve dhe përforcimin e kontrollit të bankave të mëdha ndërkombëtare
- përmirësimin e rregullave, duke kërkuar nga FMN dhe të Forumit të stabilitetit financiar për të formuluar rekomandimet për limitimin e efekteve ciklike financiare
- përforcimin e kapaciteteve të institucioneve financiare ndërkombëtare për të ndihmuar ekonominë në vështirësi.

3. Ndikimi i krizës globale financiare në Shqipëri. Konkluzione

Ekonomia botërore dhe veçanërisht sistemi financiar pësuan tronditje të mëdha gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2008. Kriza, e cila goditi sistemin financiar botëror, u transmetua në mënyrë progresive e të pandalshme në aktivitetin ekonomik të vendeve të zhvilluara, duke i çuar ekonominë e disa prej tyre në recesion.

Përballë ⁶⁵kësaj vale goditëse, ekonomia shqiptare ka shfaqur rezistencë gjatë periudhës në fjalë. Sipas të dhënave zyrtare të disponueshme, Banka e Shqipërisë konstaton se aktiviteti ekonomik i vitit 2008 është zhvilluar përgjithësisht në linjë me parashikimet e fillimvitit, si për sa i përket rritjes ekonomike ashtu edhe në drejtim të ruajtjes së balancave makro-ekonomike. Në veçanti, Banka e Shqipërisë e ka

⁶⁵ Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani.

përmbushur mandatin e saj parësor, duke kontribuar në qëndrueshmërinë e stabilitetit të çmimeve.

Natyrisht që një recesion ekonomik i gjatë dhe i thellë në Eurozonë, partnerin tonë më të madh tregtar, do të kishte implikime negative për disa zëra të bilancit të pagesave, si: remitancat, importet, eksportet dhe investimet e huaja direkte. Gjithashtu, shtrëngimi i kushteve financiare botërore mund të ndikojë kushtet financiare në vend, duke u përkthyer në reduktimin e ritmeve të zgjerimit të ndërmjetësimit financiar në vend dhe në kushte më të vështira financimi për huamarrjen e huaj.

Megjithatë, ka disa faktorë që na bëjnë optimistë në lidhje me qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në vend. Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë mbështetet në faktorë të brendshëm ekonomikë dhe financohet nga burime të brendshme. Stabiliteti makroekonomik dhe kreditimi i sektorit privat kanë nxitur rritjen e konsumit dhe të investimeve në vend. Për këtë arsye, ndikimi i krizës ekonomike botërore do të ishte i reduktuar.

Kërkesa e brendshme dhe reformat strukturore të ekonomisë përbëjnë premisa të forta për garantimin e rritjes ekonomike në horizontin afatmesëm. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë dhe aktorët e tjerë që merren me politikat ekonomike, mbeten të angazhuar të ruajnë balancat makroekonomike në vend, duke mos lejuar që elementet e rrezikut të përmendura më sipër, të shkaktojnë deformime ekonomike dhe të çenojnë potencialin e zhvillimit ekonomik në periudhën afatgjatë.

Banka e Shqipërisë, thekson se ndikimi i krizës botërore në ekonominë shqiptare do të varet si nga intensiteti, ashtu edhe nga kohëzgjatja e saj.

Kanalet, të cilat ekspozojnë më shumë ekonominë shqiptare ndaj goditjeve të ambientit ekonomik botëror, janë rënia e prurjeve valutore, si të natyrës korente ashtu dhe kapitale, dhe shtrëngimi i kushteve të financimit në përgjithësi.

BIBLIOGRAFIA :

8. Allott, A. (2000), Management Accounting Change, Management Accounting, UK.
9. Ferrara, W. (1995), Cost/Management accounting: The 21st Century Paradigm.
10. Management Accounting, USA, Dhjetor, f. 30, 36.
11. Banka e Shqipërisë, Buletini Ekonomik, Vëll. 8, nr. 4, dhjetor, 2005.
12. Halit Xhafa, Beshir Ciceri, Drejtimi financiar.
13. Vjollca Karapici, Analiza financiare.
14. Magdalena Bregasi, Politika financiare e ndërmarrjes.
15. Ardian Fullani, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë , 08 tetor 2008, Tiranaobserver.

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010

Financat personale, jo luks, tashmë një domosdoshmëri për mirëqenien financiare të individit

Belinda Meshini, Hidajet Shehu, Ilirjana Zyberi

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, UBT, Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër

ABSTRACT

Personal finances, not a luxury, now a necessity for the welfare individual financial

Is disturbing that consumers do not have knowledge of financial concepts and do not have enough tools that they need to take the best decisions about their economic welfare. Customer's financial decision-making affecting the current financial wellbeing of an individual or a family and the ability to save to meet short and long term financial goals. Many economic problems of recent world have led to increased attention to the study of personal finance making the knowledge on this field already be a necessity for the individual and his family. For this reason this study addressed briefly the history of personal finance, the current state of this discipline, level of education in this discipline and influential factors in making this knowledge.

In the past we developed a study by means of a questionnaire concerning the degree of knowledge of personal finance in the region of Gjirokastra.

Hyrje

Vitet e fundit, nevoja për edukim financiar ka fituar vëmendjen e një game të gjerë subjektësh përfshirë këtu kompanitë bankare, agjencitë qeveritare, konsumatorët, universitetet, shkollat dhe organizata të tjera.

Faktorë të shumtë kanë çuar në një kompleks të shërbimeve financiare të specializuara që i detyron konsumatorët që të angazhohen në mënyrë të tillë që të menaxhojnë financat e tyre në mënyrë sa më efektive. Forca e teknologjisë dhe të rinovimit të tregut, të nxitura nga një rritje e konkurrencës, kanë çuar në një industri të sofistikuar, në të cilën konsumatorëve u ofrohet një spektër i larmishëm shërbimesh nga një gamë e gjerë furnitorësh. Tendenca të tjera të rëndësishme demografike ashtu si dhe tregu, kontribuojnë në çështjet që përfshijnë diversitetin e rritjes së popullsisë.

Shqetësim mbizotërues është që konsumatorët nuk kanë njohuri mbi konceptet financiare dhe nuk kanë mjetet e mjaftueshme që u nevojiten për të marrë vendimet më të mira në lidhje me mirëqenien e tyre ekonomike. Vendimmarrjet financiare të konsumatorëve ndikojnë në mirëqenien aktuale financiare të një individi ose të një familje dhe në aftësinë për të kursyer për përmbushjen e qëllimeve afatgjata siç mund të jenë blerja e një shtëpie, ndjekja e një kualifikimi ose krijimi i një fondi privat pensioni. Përveç kësaj, vendimet e konsumatorit luajnë një rol të rëndësishëm në gjendjen ekonomiko-financiare të një vendi, siç u përjetua edhe nga kriza e fundit ekonomike.

Shumë probleme ekonomike botërore të kohëve të fundit si borxhi i kartave të kreditit, heqja e hipotekës së shtëpisë (për mosshlyerjen e huasë), pakësimi i kursimeve, ulja e vlerës së investimeve, kolapsi i kreditimit dhe numri në rritje i falimentimeve personale⁶⁶, kanë bërë që të ketë një rritje të vëmendjes në studimin e shkencave financiare.

Avancimet e teknologjisë kanë transformuar thuajse çdo aspekt të marketingut, shpërndarjes, shërbimeve dhe produkteve financiare. Forca e teknologjisë dhe e rinovimit të tregut, të nxitura nga një rritje e

⁶⁶ Falimentimi personal është një procedurë, e cila në disa juridiksione, lejon një individ të shpallë falimentimin. Në juridiksione të tjera, falimentimet janë të rezervuara vetëm për korporatat. Në SHBA, më shumë se 1.6 milionë njerëz në 2004, u regjistruan për falimentim personal.

konkurrencës, kanë çuar në një industri të sofistikuar ku një numër i madh prodhuesish u ofron konsumatorëve një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare. Këto zhvillime u kanë dhënë konsumatorëve më shumë mundësi dhe fleksibilitet më të madh për krijimin e marrëveshjeve financiare që u përshtaten më mirë nevojave të tyre.

Megjithatë, shërbimet financiare të specializuara dhe komplekse të tregut kërkojnë që konsumatori të jetë i informuar dhe i angazhuar në mënyrë aktive për të menaxhuar financat e veta në mënyrë sa më efektive.

Edhe pse ka shumë shkaqe që kanë çuar në përballjen e një seri problemesh ekonomike, është i pamohueshëm fakti se një nga faktorët kontribues është dhe mungesa e edukimit financiar. Shumë amerikanë u bënë pjesë e marrëveshjeve të huave të shtëpive, pasi nuk i kuptuan mirë, si pasojë shumica e tyre nuk i përballuan dot. Më gjerësisht, mungesa e njohurive themelore si, për shembull, krijimi dhe mirëmbajtja e një buxheti, kuptimi i kreditit ose kursimi për të ardhmen pengojnë miliona e miliona individë të përfitojnë nga avantazhet që ofron sistemi ynë ekonomik. Edukimi financiar nuk është problem vetëm për një popull, ai ndikon tek cilido, burrë apo grua, i ri apo i vjetër, i çfarëdo lloj feje dhe klase shoqërore qoftë (Shtetet e Bashkuara, Departamenti i Thesarit, Zyra e Edukimit Financiar, 2008).

Në këto rrethana i kushtohet një vëmendje më e gjerë edukimit me financat personale. Kjo çështje aktualisht po fiton vëmendje nga qarqe të ndryshme të shoqërisë të tilla si universitetet, qeveria, korporatat dhe organizatat jofitimprurëse etj. Vihet re një rritje e njohjes së rëndësishme së këtij sektori në qarqe të ndryshme akademike, siç është ekonomia dhe financa, që tradicionalisht nuk janë përfshirë në këtë çështje. Një prej sfidave, me një rritje interesi nga programe të ndryshme, është fokusimi në familje dhe më shumë se sa një përqendrim mbi vendimet individuale. Të menaxhosh një familje është më e vështirë se sa të menaxhosh një ndërmarrje, sepse vlera e një familjeje asnjëherë nuk mund të krahasohet me vlerën e saj neto.

Historiku i financave personale

Financat personale i kanë rrënjët në ekonomi, financa, menaxhim, në parimet e përgjithshme të vendimmarrjes të ndërmarrjes dhe menaxhimit të burimeve financiare të individit dhe familjes.

Kjo përfshin zbatimin e parimeve nga një shumëllojshmëri disiplinash të tilla, si: ekonomia, sociologjia, psikologjia, të mësuarit për të rriturit dhe këshillim për studimin e mënyrave se si individët dhe familjet sigurojnë, shtojnë dhe shpërndajnë burimet monetare për të përmbushur nevojat e tyre financiare aktuale dhe të ardhshme. Në sistemin dinamik të financave personale, vendimmarrësit janë kryesorët. Ata influencojnë dhe influencohen nga faktorë të ndryshëm si të ambientit të jashtëm dhe atij të brendshëm. Këtu përfshihen tregjet dhe institucionet financiare, agjencitë qeveritare, ekonomia, demografia, prirjet sociale dhe faktorët personalë dhe familjarë.

Financat personale përfshijnë mjete të tilla si pasqyrat financiare personale, llogaritë rrjedhëse dhe të kursimit, instrumentet e borxhit, huatë dhe investimet e ndryshme. Gjithashtu ato përfshijnë teknika në lidhje me menaxhimin e parasë, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, planifikimin e tatimeve, pensionet dhe pasurinë individuale. (Schuchardt et al. 2007). Për më shumë se 100 vjet këto koncepte janë mësuar në shkollat ekonomike (koha e shkuar). Kërkimet në lidhje me financat personale e kanë nisur në fillim të viteve 1920 me iniciatore Hazel Kyrk. Në veçanti disertacioni i saj në *ekonomiks* në universitetin e Çikagos, e përfunduar në 1920 vendosi themelin për zhvillimin e fushës së konsumit *ekonomiks*. Puna e saj e mëvonshme u përqendrua në themelin e fushës së *ekonomiks* familjar. Kjo studiuese më vonë u bë një mbrojtëse e fushës së ekonomisë familjare (TK Hira, 2009).

Një ekonomiste tjetër nga Çikago e quajtur Margaret Reid në 1934 njihet gjithashtu si një nga pionieret e studimeve të shumë sjelljeve konsumatore dhe financiare personale (Beller and Kiss, 1999).

Financat personale janë hasur gjatë kohës me emra të ndryshëm, si: ekonomia familjare, ekonomia e konsumit, ekonomia financiare dhe burimet e menaxhimit, financat shtëpiake etj. Megjithatë, financat personale nuk është vetëm një koncept themelor që lidhet me matematikën, financën, *ekonomiksin*, edukimin, apo teknologjinë e informacionit. Edukimi financiar personal shkon tej njohjes së këtyre faktorëve dhe pranon se operacionet financiare mund të jenë mjaft komplekse (Ginsburg, Manly, dhe Schmitt, 2006).

Supozimi themelor në ekonomi është se njerëzit janë racionalë. Megjithatë, disa njerëz nuk marrin vendime racionale dhe optimale dhe objektivat financiare nuk janë tërësisht objektiva në natyrë. Ariely (2009)

sugjeron se kriza globale ekonomike ka thyer dy marrëveshjet më të besueshme në teorinë standarde ekonomike: 1) Qeniet njerëzore zakonisht marrin vendime racionale dhe 2) Dora e padukshme e tregut shërben si një korigjues i besueshëm ekuilibri.

Që në fillim të 1947, fituesi i çmimit Nobel, Herbert Simon sugjeroi që vendimmarrësi që posedon informacion të kufizuar nuk kërkon gjithmonë zgjidhjen më të mirë të mundshme për shkak të burimeve të kufizuara dhe prirjeve personale.

Edukimi financiar krijon individë me njohuri, zotësi dhe aftësi bazë të nevojshme për të pyetur dhe informuar konsumatorët rreth shërbimeve financiare dhe për të menaxhuar me efektivitet financat e tyre (Mason dhe Wilson, 2000, f. 5).

Të kesh dije për financat do të thotë të kesh njohuri të mjaftueshme në lidhje me: a) paranë, kredinë, investimet, bankat, sigurimet, dhe taksat, b) konceptet themelore të menaxhimit financiar (për shembull, risku, humbja, fitimi), c) dhe të jesh në gjendje t'i përdorsh këto njohuri për të planifikuar dhe për të marrë vendimet e duhura financiare (Hogarth, 2002). Misioni i profesionit të financave personale është i ndryshëm nga studimi i financave apo ekonomiksit. Në fokus të financave personale nuk është më konsumatori ose konsumi, por familja/individit dhe mirëqenia e përgjithshme e tyre financiare.

Qëllimi kryesor i edukimit të financave personale është të pajisë individët dhe familjet me njohuri dhe aftësi për të bërë një zgjedhje financiare të informuar dhe produktive në të gjitha fazat e ndryshme të ciklit të jetës, zgjidhje këto që shtrihen përtej rolit të tyre si konsumatorë. Qëllimi i këtij edukimi ka të bëjë me të kuptuarit e marrëdhënieve midis vlerave, besimeve, qëndrimeve, emocioneve, vetëbesimit dhe shpenzimeve, huamarrjes, kursimit, investimit (Schuchardt, 2007).

Para 1990, shumica e studiuesve të interesuar për fushën e financave personale e konsideronin veten e tyre si ekonomistë të familjes, ekonomistë të konsumatorit, ekonomistë të konsumit, specialistë të menaxhimit të burimeve familjare apo edukatorë të konsumit. Jo çdo universitet ka programe akademike të dedikuara vetëm studimit të konsumatorit dhe çështjeve të financave personale.

Fakultetet e ekonomisë dhe biznesit i kushtojnë pak vëmendje financave personale, ato përqendrohen në çështje më të gjera të tilla si lëvizja në tregjet e parave dhe zhvillimin e parimeve financiare të

korporatave

Shumë institucione kanë qenë të angazhuara plotësisht në zhvillimin dhe ofrimin e programeve të financave personale në dekadat e fundit, puna e kryer nga këto institucione është publikuar gjerësisht në konferenca kombëtare, ndërkombëtare dhe revista të njohura⁶⁷. Disa revista si: *The Journal of Financial Counseling and Planning*, *The Financial Services Review*, *Journal of Financial Planning dhe Journal of Personal Finance*, janë të përkushtuara vetëm për tema në Financat Personale. Kërkimet në fushën e financave personale kanë qenë të bazuara në teoritë e disa disiplinave duke përfshirë studime të familjes, ekonomisë, psikologjisë, sociologjisë, ekonomisë familjare dhe menaxhimit të burimeve.

Modele konceptuale janë përdorur nga studiues duke marrë parasysh një spektër të gjerë të faktorëve të tillë si mjedisi i jashtëm dhe i brendshëm, karakteristikat socio-ekonomike, karakteristikat personale (vlerat, emocionet, besimet), dhe dinamika familjare (kultura, komunikimi). Disa shembuj të këtyre modeleve cituara nga (TK Hira, 2009) janë: teoria sociale e këmbimit (Homans, 1958), teoria e të mësuarit për të rritur (Mezirow, 1981), modeli ekologjik human (Bronfenbrenner, 1979), sistemet e menaxhimit të familjes (Deacon dhe Firebaugh, 1988), hipoteza e kursimeve të ciklit të jetës (Ando dhe Modigliani, 1963), hipoteza e sjelljes së ciklit të jetesës, teoria e veprimit të arsyeshëm, teoria e planifikimit të sjelljes (Thaler dhe Shefrin, 1981), dhe modeli shumë teorik i ndryshimit (Prochaska, 1979). Nickols (2008) raportoi se teoritë e tjera në ekonominë familjare dhe kërkimin e menaxhimit përfshijnë inxhinierinë industriale, organizimin, teorinë e burimeve njerëzore dhe teorinë e ekosistemeve

Shoqëritë profesionale⁶⁸ kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe forcimin e kësaj fushe.

⁶⁷ Revista që përfshijnë herë pas herë artikuj që kanë të bëjnë me financat personale janë: *Family and Consumer Sciences Research Journal*, *International Journal of Family and Consumer Sciences*, *Journal of Consumer Affairs*, and *Journal of Family and Economic Issues* etj

⁶⁸ Mund të përmendim këtu: *American Association of Family and Consumer Sciences*, *Western and South Eastern Family Economics and Resource Management Associations* etj.

Edukimi dhe financat personale

Aktualisht një vëmendje e madhe po i kushtohet edukimit financiar personal nga subjekte publike dhe private, me apo pa qëllim fitimi. Me qenë se shqetësimet rreth aftësisë financiare të konsumatorëve janë rritur, vihet re dhe një rritje e shumëllojshmërisë së programeve të edukimit financiar dhe ofruesve të programit.

Megjithatë, disa programe ofrojnë informacion të plotë mbi tema të ndryshme për një audiencë të gjerë, duke përfshirë kursimet, kreditë, menaxhimin e riskut, investimet, planifikimin e pensionit dhe tema të ngjashme. Të tjerë përqendrohen në një temë të vetme si, për shembull, menaxhimi i kredisë, planifikimi i daljes në pension, investimet dhe ata i përshtaten një grupi të veçantë, të tilla si të rinjtë apo gratë (Braunstein dhe Welch, 2002).

Megjithatë, emra të shumtë janë duke u përdorur për të identifikuar mësimdhënien dhe punën kërkimore që është bërë në fushën e financave personale. Disa nga emrat që janë përdorur për një kohë të gjatë janë: Ekonomia e konsumatorit, Familja dhe shkencat konsumatore, Ekonomia familjare, Ekonomia e familjes dhe menaxhimi i burimeve personale, Financat familjare, Menaxhimi financiar familjar, Ekonomia shtëpiake dhe Financat personale. Ndër emrat e përdorur së fundi përmendim: **Financat shtëpiake, Sjellja e financave shtëpiake dhe A,b,c-ja e edukimit financiar** (financial literacy⁶⁹). Që nga 1990, përdorimi i këtij termi ka qenë gjithnjë në rritje, por popullarizimi i tij ka krijuar konfuzion.

Shumë disiplina si, për shembull, Matematika, Ekonomiksi, Historia, Sociologjia dhe Psikologjia zakonisht identifikohen me një emër të vetëm. Për këto disiplina ka specialitete të ndryshme, por vetëm një emër. Për të pakësuar konfuzionin duhet të përdoret vetëm një emër për edukimin financiar personal, dhe më e rëndësishme është se duhet të ketë një kuptim të përbashkët të asaj që mund të përkufizohet nga një emër i tillë.

Trazirat e tregut dhe kriza e kredisë të vitit 2008 evidentojnë

⁶⁹ Disiplina që synon të edukojë individin financiarisht, në mënyrë që të jetë në gjendje të lexojë “dorëshkrimin vetjak financiar” dhe të arrijë të marrë vendimet e duhura financiare për të ardhmen e tij dhe të familjes së tij.

nevojën kritike për të përmirësuar edukimin financiar personal (Departamenti amerikan i thesarit, Zyra e edukimit financiar, 2008).

Qëllimi i përgjithshëm i edukimit financiar është të sigurojë që të gjithë të pajisen me informacionin e përshtatshëm, njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendime të mira financiare. Sfida për specialistët është të përcaktojnë se për çfarë aftësie specifike kanë nevojë njerëzit në mënyrë që të kuptojnë kostot afatgjata dhe përfitimet e vendimeve të tyre financiare (Hira, 1995). Konsumatorët që janë edukuar mirë në aspektin e financave personale janë një linjë mbrojtjeje e rëndësishme në mirëfunksionimin e tregjeve.

Një shkallë e mirë njohjeje e financave personale do të thotë që individit të ketë njohuri të mjaftueshme në lidhje me sistemin financiar dhe gjithë përbërësit e tij; përpilimin dhe mbajtjen e një gjendjeje pozitive të fluksit të parasë; përpilimin e një plani të shpenzimeve që të jetë në përputhje me burimet dhe prioritetet e tij; arsyet përse duhet të kemi një fond emergjence dhe si ta krijojmë këtë fond; procesin e vendimmarrjes në lidhje me marrjen me qira apo blerjen e një shtëpie; bazat e dhënies së një kredie, duke përfshirë vlerësimin, zgjedhjen dhe menaxhimin e kredisë, si dhe si të realizojmë një vlerësim të mirë të kredisë; procesin e identifikimit të rreziqeve të ndryshme financiare, duke përfshirë zhvillimin e një strategjie të menaxhimit të rrezikut për të vendosur se cilat rreziqe duhet të merren përsipër dhe cilat duhet të transferohen drejt kompanive të sigurimit; identifikimin dhe mbrojtjen nga vjedhjet e identitetit dhe mashtrimet e ndryshme financiare dhe çfarë duhet të dish dhe të bësh nëse mendon se ke qenë i viktimizuar; investimet bazë, marrëdhënien midis riskut dhe kthimit dhe kur, ku dhe pse duhet të zgjidhet një investim; vlerësimin e komponentëve të ndryshëm të planifikimit të daljes në pension, si dhe zhvillimin e një plani të përshtatshëm për një pension të sigurt; kalimin e saktë të pasurive të trashëgimtarët e duhur.

Në të njëjtën kohë është e rëndësishme të dimë se edukimi financiar nuk është zgjidhja, lind nevoja për rregullim efektiv që është nën përgjegjshmërinë e evoluimit të tregut që t'u sigurojë konsumatorëve se janë të mbrojtur nga praktikat abuzive dhe mashtruese të lojtarëve të paskrupullt.

A funksionon edukimi financiar?

Bell, Gorin dhe Hogarth në një studim të kohëve të fundit (2009), raportuan se edukimi financiar duhet të ndikojë në sjelljet specifike të menaxhimit financiar. Personat që kishin njohuri mbi financat personale përgjithësisht kishin një llogari kursimi për përmbushjen e qëllimeve të tyre afatshkurtra dhe kursenin rregullisht, gjithashtu këta persona kursenin më shumë për sa i takon pagesës së interesave të *overdraft*-it, kishin më shumë gjasa që të kishin një fond emergjence dhe që të informoheshin më shumë në lidhje me menaxhimin e parasë dhe, ajo çka është më e rëndësishme, kishin më pak gjasa për të lënë pa paguar kartën e tyre të kreditit.

Danes, Huddleston - Casas dhe Boyce (1999), kryen një studim për të vlerësuar ndikimin që kanë financat personale në qoftë se mësohet që në shkollat e mesme. Ata raportuan statistikisht se ndryshime të rëndësishme dhe vetë-efikasit janë gjetur në mënyrat e sjelljes të personat që kanë njohuri financiare, të ndodhura këto menjëherë pas kompletimit të kursit. Rreth gjysma e adoleshentëve demonstuan rritje të njohurive, një e treta demonstroi përmirësim të sjelljes dhe 40% rritje të besimit në menaxhimin e parave të tyre. Xiao, Newman, Prochaska, Leon, Bassett dhe Johnson (2004) argumentojnë se edhe pse edukimi financiar mund të jetë i dobishëm dhe mund të ketë një ndikim pozitiv në jetën e konsumatorëve, natyra e ndikimit dhe niveli i efektivitetit shpesh është e vështirë të matet. Për më tepër, ndikimet nuk mund të jenë të menjëhershme, por edukimi mund të jetë i dobishëm për të filluar procesin e ndryshimit të sjelljes ose duke lëvizur njerëzit nga një fazë e sjelljes në një tjetër.

Nga ana tjetër, Willis (2008) argumenton se edukimi me financat personale është paraqitur në premtimin e sovranitetit të konsumatorit, që ata mund të mësohen për të bërë zgjedhje të mirëqenies, në përmirësimin e sigurimit, të kreditit si dhe tregun e investimeve, të trajnuar për të lexuar udhëzuesin drejt udhëtimit për ëndrrën amerikane. Përmirësimi i sjelljes financiare jo domosdoshmërisht ndiqet nga rritja e informacionit financiar.

Në të kaluarën, profesionistët në fushën e ekonomisë familjare dhe menaxhimin e financave personale praktikuan përqasje shumëdisiplinore për të studiuar sjelljen financiare. Sot, profesionistë nga këto disiplina

(ekonomiks, sociologji, psikologji dhe shumë të tjera), janë duke studiuar sjelljen financiare, duke zgjeruar mundësitë dhe potencialin për një disiplinë më të fortë dhe të pasur. Disiplina duhet të përmbushë sfidat e krijimit të një mjedisi ku profesionistë nga disiplina të ndryshme të krijojnë lidhje të forta, të bashkëpunojnë dhe të gjenerojnë studime të vërteta

Faktorët që ndikojnë në shkallën e njohurive financiare

Informacioni financiar është i lidhur ngushtë me financat personale.

Me gjithë rëndësinë që kanë financat personale, njohja e tyre është shumë e pamjaftueshme në shumë vende të botës. Çfarë ndikon në marrjen e njohurive financiare në përgjithësi dhe të financës personale në veçanti?

Ndër faktorët kryesorë përmendim: pasurinë e individit, të ardhurat, marrja e informacionit, të dhënat demografike (gjinia, arsimimi, puna), karakteristikat personale (vlerat, emocionet, besimet, karakteri), dinamika familjare (kultura, komunikimi), toleranca e riskut, karakteri etj. Më poshtë po japim një panoramë se si studiues të ndryshëm janë shprehur rreth ndikimit të këtyre faktorëve në nivelin e njohjes së financave personale (C. Monticone 2009).

Literatura teorike evidenton rolin e pasurisë në këtë aspekt, duke theksuar se ai person që ka pasuri më shumë mund të inkurajojë marrjen e, të paktën, disa njohurive themelore për ta menaxhuar më mirë atë. Natyrisht, financat personale ndikojnë në shtimin e pasurisë. Ky fakt është theksuar nga shumë studiues. Një nga motivet për përfitimin e njohurive bazë financiare është roli i stimulimeve ekonomike. Ideja se burimet kanë rëndësi sugjerohet edhe nga Donkers dhe Van Soest (1999), që tregojnë, në lidhje me Hollandën, se individët me të ardhura më të larta janë më të interesuar në lidhje me çështjet financiare. Delavande et al. (2008) dhe Peress (2004) propozuan një kornizë teorike për të motivuar shkallën e njohurive financiare. Të dy cilësimet janë mjaft të ndryshme, por ndajnë një tipar të përbashkët: atë që madhësia e pasurisë ndikon në shkallën e njohurive financiare. Gjithashtu Delevande (2008) theksoi se përfitimi nga njohuritë financiare varet nga shuma e aktiviteteve të investuara për arsye se sa më e madhe të jetë kjo shumë aq më i madh do të jetë kthimi. Investitorët e marrin informacion rreth aktiviteteve me anë të gazetave,

seminareve, këshilluesve financiarë etj. Edhe pse të dy studimet fokusohen në financat personale dhe në informacionin financiar respektivisht kur flasin për "investim në dije", ata u referohen aktiviteteve shumë të ngjashme, si: marrja e informacionit nëpërmjet leximit të gazetave dhe librave, dëgjimi i radios dhe emisioneve televizive, ndjekja e seminareve apo kurseve të ndryshme ose këshillimi me një konsulent financiar. Bernheim (1998) konstaton se individët që gëzojnë karakteristikat e mëposhtme, pra ishin meshkuj, të bardhë, me një nivel të lartë arsimimi dhe me një punë me të ardhura të larta u përgjigjeshin më mirë pyetjeve në lidhje me financën dhe makroekonominë.

Në mënyrë interesante njohuritë mbi financat rriteshin me rritjen e nivelit të të ardhurave, ndërsa ajo makro-ekonomike jo. Sipas autorit, shkak për këtë është se individët me më shumë burime kanë më shumë stimuj për të marrë informacion në lidhje me çështjet financiare, por jo domosdoshmërisht në lidhje me ato makro-ekonomike.

Delavande et al. (2008) me anë të një ekuacioni konkludoi se njohuritë financiare varen nga aftësia njohëse, karakteri, probleme të ndryshme financiare, vështirësia e pyetjeve, mosha, gjinia dhe niveli i arsimimit. Gjithashtu ai konkludoi se përpjekja, aftësia dhe vetëvlerësimi i njohurive rrit saktësinë e përgjigjeve të testeve financiare.

Përveç se treguan se individët me karakter të fortë kanë më shumë mundësi për të përvetësuar më shpejt njohuritë financiare, Meier dhe Sprenger (2008), gjetën se preferencat kohore gjithashtu ndikonin në përfitimin e njohurive financiare. Autorët tregojnë se njohuritë kryesore në lidhje me financat personale janë të lidhura pozitivisht me karakterin, arsimimin dhe nivelin e të ardhurave.

Guiso dhe Jappelli (2006) shfrytëzuan kuadrin teorik të Peress (2004) për të hetuar marrjen e informacionit financiar në Itali. Duke përdorur një sondazh të klientëve kryesorë të një banke tregtare italiane, ata gjetën se pasuria financiare, toleranca e riskut dhe arsimimi kanë një efekt pozitiv në kohën e shpenzuar çdo javë për të marrë informacionin në lidhje me mënyrën e investimit të kursimeve të tyre.

Guiso dhe Jappelli (2008) vlerësuan njohuritë në lidhje me financat personale duke u nisur nga po i njëjti sondazh dhe konstatuan se të qenët më i arsimuar, mashkull, disponimi i të ardhurave dhe i pasurive financiare të larta shoqërohen me një nivel të admirueshëm dijesh mbi financat personale.

Si një alternativë për të mësuar në lidhje me menaxhimin e pasurisë dhe parave të tyre familjet mund të mbështeten në këshillat e ekspertëve përkatës. Vetëm një pakicë e familjeve në Holandë dhe në SHBA konsultohen me ekspertë financiarë (Lusardi dhe Mitchell, 2006). Në të kundërtën, sondazhi italian tregoi se më shumë se 50% e familjarëve të pyetur tregojnë bankën e tyre si burimin kryesor të informatave për menaxhimin e kursimeve të tyre, e ndjekur nga familja dhe miqtë me 11% (Beltratti (2007)⁷⁰

Financat personale në Shqipëri

Për sa i takon edukimit të financave personale në vendin tonë një punë të mirë ka bërë dhe Banka e Shqipërisë. Duke vënë në qendër të vëmendjes së saj ndërtimin e urave të komunikimit me të gjitha grupet e interesit, Banka e Shqipërisë synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm, që t'i shërbejë institucionit për rritjen e efektivitetit të transmetimit në ekonomi të vendimeve të politikës monetare. Nisur nga e kaluara e vendit tonë, por edhe nga ritmet e vullshme me të cilat zhvillohen ekonomia dhe financat botërore, Banka e Shqipërisë e ka parë të arsyeshme të ndërmarrë disa nisma konkrete në fushën e edukimit ekonomiko-financiar për krijimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare. Meqenëse rruga drejt një shoqërie të edukuar mbi ekonominë e financat fillon nga shkolla, aty ku formohet brezi i ri. me datë 13 dhjetor 2007, në ambientet e shkollës së mesme të përgjithshme "Qemal Stafa" të Tiranës, u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në fushën e edukimit të publikut mbi çështje të ekonomisë në përgjithësi dhe të Bankës Qendrore, në veçanti. Aktivitetet edukuese të Bankës së Shqipërisë aktualisht u drejtohen mësuesve dhe nxënësve të shkollave të mesme e nëntëvjeçare, studentëve e pedagogëve të fakulteteve brenda dhe jashtë vendit, gazetarëve të medias së shkruar dhe elektronike, punonjësve socialë, si dhe të gjithë atyre që me punën e tyre transmetojnë njohuri dhe përmirësojnë jetën e të tjerëve. Banka e Shqipërisë ka zhvilluar një sërë seminaresh trajnimi me mësuesit e lëndës së ekonomisë së zbatuar. Ka organizuar me nxënësit e

⁷⁰ Këto rezultate janë nxjerrë nga një studim i realizuar në 2007 për 1.002 persona. Për hollësi të mëtejshme shiko Beltratti (2007).

disa shkollave të mesme konkursin “Vlera e vërtetë e parasë” me anë të cilit Banka e Shqipërisë synon që nëpërmjet argëtimit të tërheqë vëmendjen e të rinjve drejt çështjeve financiare pak të trajtuara në tekstet e tyre mësimore.

Gjithashtu, po në lidhje me edukimin e financave personale, Banka e Shqipërisë ka publikuar një seri broshurash edukative si: Guida e studentit, Ndërtoni të ardhmen - Planifikoni të ardhurat tuaja, Përse duhet të keni një buxhet personal?, Guidë rreth llogarisë tuaj të parë etj.

Për të plotësuar të dhënat e pakta që mund të mblidhnim në shkallë institucionale mbi shkallën e njohjes të financave personale si dhe për të analizuar konkretisht zhvillimin e financave personale, zhvilluam një anketim bazuar në 174 pyetësorë në rrethin e Gjirokastrës, me anë të të cilit kërkoni opinionë për të kuptuar shkallën e njohjes së financave personale në përgjithësi dhe ndikimin që do të kishte rritja e nivelit të informacionit në lidhje me këtë disiplinë. Kuptohet që me anën e këtij pyetësori ne nuk mund të pretendojmë se kemi anketuar individët në çdo aspekt të financave personale, megjithatë kemi menduar të ndalemi në pjesë të rëndësishme të saj me qëllim që të arrijmë të kuptojmë nivelin e njohjes së kësaj disipline nga individët.

Mënyrat e zhvillimit të pyetësorëve ishte e drejtpërdrejtë ose nëpërmjet telefonit. Duhet marrë parasysh faktin se meqenëse një pjesë e mirë e të anketuarve janë përgjigjur nga telefoni, në disa përgjigje mund të ketë dhe mungesë sinqeriteti nga ana e tyre.

Kriteri i vetëm kufizues që vendosëm për plotësimin e pyetësorit ishte mosha mbi 22 vjeç. Nuk pati ndarje të mjedisit në bazë gjinie, profesioni, karakteri, dinamike familjare, pasurie, niveli arsimor etj.

Disa prej përfundimeve më interesante të pyetësorit po i paraqesim më poshtë.

Nga pyetësori rezulton se 26% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë njohuri fare mbi Financën Personale, siç tregohet dhe në tabelën e mëposhtme.

Pyetje:

Sipas mendimit tuaj në ç’ nivel i njihni Financat Personale?

Përgjigje:

- Mirë, 27%

- Jo dhe aq mirë, 47%

- Nuk është njoh fare, 26%

Pyetjes se nëse mbani buxhet për menaxhimin e financave vetjake, 65% e personave të anketuar u përgjigjën se nuk mbanin fare buxhet për menaxhimin e financave të tyre vetjake.

Pyetjes se si i menaxhoni paratë tuaja, morëm këto përgjigje:

- nuk bëj buxhet, 65% e të anketuarve,
- bëj një buxhet të shkruar dhe e ndjek hap pas hapi, 13% e të anketuarve,
- bëj një buxhet të shkruar dhe nuk e ndjek hap pas hapi, 22% e të anketuarve.

Pyetjes “A e keni të qartë ndikimin e inflacionit në të ardhurat që ju do të përfitoni në të ardhmen” 66% e të anketuarve i janë përgjigjur negativisht. Kurse pyetjes “A mendoni se njihni një pjesë të mirë të alternativave të investimit të parasë” vetëm 23% e të anketuarve kanë pohuar se njihnin disa prej tyre, më hollësisht për këto dy pyetje japim të dhënat e mëposhtme.

Pyetje:

A e keni të qartë ndikimin e inflacionit në të ardhurat që ju do të përfitoni në të ardhmen?

Përgjigje:

- Po, 16%
- Pak, 18%
- Nuk e kam të qartë, 66%.

Pyetje:

A mendoni se njihni një pjesë të mirë të alternativave të investimit të parasë tuaj?

Përgjigje:

- Njoh disa, 23%
- Nuk njoh asnjë, 51%
- Njoh pak, 28%.

Përgjigjet e pyetjes “A po kurseni për kohën e pleqërisë?” dhe “A është i rëndësishëm për ju sigurimi i pasurisë?”, janë si më poshtë:

Përgjigje:

- Për momentin jo, 27%
- Po kursej pranë një fondi privat pensioni 8%

- Vetëm pjesën që më mbahet e detyruar nga paga 65%.

Përgjigjet e pyetjes “A është i rëndësishëm për ju sigurimi i pasurisë?”, janë si më poshtë:

Përgjigje:

- Po, siguroj çdo element të pasurisë sime, 26%

- Po, por niveli i të ardhurave që unë disponoj nuk më lejon të siguroj gjithçka, 26%

- Po, por nuk i kushtoj rëndësinë e duhur, 49%

Përfundime:

Për të pakësuar konfuzionin e krijuar vitet e fundit nga përdorimi i shumë emërtimeve, duhet të përdoret vetëm një emër për edukimin financiar personal dhe më e rëndësishme është se duhet të ketë një kuptim të përbashkët të asaj që mund të përkufizohet nga një emër i tillë.

Nga pyetësori rezultoi se një pjesë e mirë e të anketuarve (47%) nuk e kishin shumë të qartë se çfarë ishin Financat personale, kurse 26% e të pyeturve nuk e njihnin fare, e si rrjedhojë e kishin të vështirë të merrnin vendime financiare në lidhje me të ardhmen e tyre, ose vendimet që ata merrnin nuk ishin të bazuara në njohuri financiare, por thjesht ishin të rastësishme. Fakti që 65% e të pyeturve nuk mbanin një buxhet të shkruar për të patur të qartë rrjedhën e flukseve të parasë së tyre (të ardhurave apo shpenzimeve personale), tregon që këta individë nuk janë të ndërgjegjshëm në lidhje me rëndësinë që ka mbajtja e një buxheti personal.

51% e të investuarve nuk njihnin asnjë alternativë të investimit të parasë dhe 66% nuk e kishin të qartë ndikimin e inflacionit në të ardhurat e tyre, fakt ky që flet për një nivel të ulët të edukimit financiar personal. Për sa i përket sigurimit të një pensioni për të ardhmen dhe sigurimit të pasurisë shumica e të anketuarve ishin shumë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e tyre edhe pse faktorë, si: niveli i të ardhurave, neglizhenca etj., i pengonin për t’i kushtuar rëndësinë e duhur.

Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në fitimin e njohurive financiare në përgjithësi dhe të financave personale në veçanti përmendim: pasuria e individit, të ardhurat, marrja e informacionit, të dhënat demografike (gjinia, ngjyra, arsimimi, puna), karakteristikat personale (vlerat, emocionet, besimet, karakteri), dinamika familjare

(kultura, komunikimi), toleranca e riskut, karakteri, etj.

Me qenë se financa personale është një disiplinë që ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e parasë dhe pasurisë së familjes, në mënyrë që të arrijë të marrë vendime financiare sa më efektive për të tashmen dhe të ardhmen e saj, sipas mendimit tonë duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi nga studiuesit, qeveria, institucionet, organizatat dhe mediat, ashtu dhe nga ana e vetë individit.

LITERATURA:

1. Ariely, D. (2009), "The End of Rational Economics."
2. Bell, C., Gorin, D. and Hogarth, J. M. (2009). "Does Financial Education Affect Soldiers"
3. Beller, A. H. and Kiss, D.E. (1999). "On the Contribution of Hazel Kyrk to Family Economics"
4. Braunstein S., and Welch, C. (2002). "Financial Literacy: An Overview of Practice, Research and Policy." Federal Reserve Board, Division of Consumer and Community Affairs.
5. <http://www.federalreserve.gov/pubs/bulletin/2002/1102lead.pdf>
6. Chiara Monticone (2009) "How much does wealth matter for financial literacy acquisition?"
7. Danes, S. M., Huddleston-Casas, C., and Boyce, L. (1999). "Financial Planning Curriculum For Teens: Impact Evaluation"
8. George Callaghan, Ian Fribbance, Martin Higginson (2006) "Personal finance"
9. Ginsburg, Manly, and Schmitt, (2006), "The Components of Numeracy"
10. Hira, T. K. (1995). "Family Resource Management Approach to Moderating the Effect of Toxic Environment on Children."
11. Hogarth, J.M. (2002), "Financial Literacy, and Family and Consumer Sciences"
12. Homans, G.C. (1958), "Social Behavior as Exchange."
13. Jeff Madura, "Personal finance" (third edition)
14. M. Yadollahi, L. Hj Paim, M. Othman, T. Suandi, (2009) "Factors Affecting Family Economic Status"

15. Mason and Wilson, (2000), "Conceptualizing Financial Literacy"
16. Schuchnardt, J., Bagwell, D. C., Bailey, W. C., DeVaney
17. Schuchnardt, J., Bagwell, D. C., Bailey, W. C., DeVaney, S. A., Grable, J. E., Leech, R. E., LowJ. M., and Xiao J. J. (2007). "Personal Finance: An Interdisciplinary Profession." *Journal of Finanning Counseling and Planning*
18. Tahira K. Hira (2009) "Personal Finance: Past, Present and Future"
19. Willis, L.E. (2008). "Against Financial-Literacy Education."
20. www.bankofalbania.org/
21. www.wikipedia.org/
22. Xiao, J. J., Newman, B. M., Prochaska, J. Leon, B.; Bassett, R. L.; & Johnson, J. L. (2004). "Applying the Transtheoretical Model of Change to Consumer Debt Behavior."

Financimi i aktiviteteve në biznes

Shefket Jakupi, Skender Kercuku

Fakulteti "PEP" Beograd, Universiteti, "Kristal", Tiranë

ABSTRACT

Financing of activities in business

Firms prefer to use retained earnings as sources of financing investment projects because they emerged as cheaper sources, but the amount of retained earnings is limited. For this reason, many business firms in certain periods of time should consider external sources of funding when the need for raising funds to finance various projects, or when planning expansion of operational activities of the firm.

Although large corporations from time to time provide capital by issuing debt in capital markets, however the most important way of securing capital from sources outside the firm but less frequently used, is issuing shares.

The total amount of funds for investment in the U.S. economy, which generate business firms within the firm, largely retained earnings and depreciation, the rate is generally 50 to 80%. Thus, for most firms in the business, internal cash flows are insufficient to meet the total needs for capital.

Sources of financing of business activity can be divided into two main groups:

- Internet resources, and
- external sources of funding.

Key words: profits generated, the savings generated through more

efficient management of working capital, depreciation funds of fixed assets and equipment of the firm, public markets,


1. Burimet interne

Firmat në biznes sigurojnë kapitalin financiar nga brenda firmës duke mbajtur fitimet e gjeneruara, figura 2.3. Këto fonde përfaqësojnë ndryshimin pozitiv ndërmjet shpenzimeve që krijon shoqëria: kostot e veprimit, pagesa e interesave, pagesa e tatimeve, pagesa e dividendëve, ose përtëritja e fondeve fikse të aseteve, si dhe të ardhurave që krijon ajo.

Një burim tjetër i brendshëm i financimit që shpesh nuk vihet re, janë kursimet e gjeneruara përmes menaxhimit më eficient të kapitalit punues. Ky kapital është i shkruar në asetet dhe detyrimet afatshkurtëra. Menaxhimi më eficient i kërkesave nga blerësit, detyrimeve ndaj furnitorëve, stoqeve të mallrave dhe rezervave monetare, mund të zvogëlojnë mbitërheqjet nga llogaria bankare dhe ngarkesat me interesa, dhe gjithashtu të rrisë rezervat monetare.

Burimi tjetër i financimit të brendshëm me rëndësi të madhe gjithsesi janë fondet e amortizimit të aseteve fikse dhe pajisjeve të firmës.


Figura 2.3.
Burimet e financimit të aktivitetit



2. Burimet eksterne

Ekzistojnë një mori e burimeve eksterne të financimit, të cilat mund të ndahen në dy lloje kryesore: burime financimi përmes borxhit dhe burime financimi përmes kapitalit aksioner, figura 2.4. Financimi ekstern mund të klasifikohet edhe nga aspekti i afatit të fondeve (financimi afatshkurtër, dhe financimi afatgjatë), si dhe nga aspekti institucional (sigurimi i fondeve financiare përmes tregut financiar, apo përmes ndërmjetësve financiarë).

Figura 2.4
Burimet eksterne të kapitalit



3. Përpjesëtimi relativ ndërmjet financimit intern dhe financimit ekstern

Fitimet e mbajtura dhe burimet tjera interne të financimit përbëjnë pjesën më të madhe të fondeve financiare për financimin e aktivitetit të firmave në biznes. Në pesë vitet e fundit përpjesëtimi i fondeve financiare me prejardhje nga burime interne të firmës zakonisht ishte ndërmjet 50 dhe 70%, me një mesatare për periudhën rreth 60%. Edhe pse në periudha të caktuara kohore, huazimet nga burimet e jashtme shënojnë rritje **sinjifikante**, megjithatë ato mbeten me rëndësi më të vogël në krahasim me burimet interne të fondeve financiare. Një përpjesëtim i tillë relativ ndërmjet burimeve interne dhe burimeve ekstere të financimit ishte karakteristikë për një periudhë të gjatë kohe, që nga vitet 1970.

4. Përpjesëtimi relativ ndërmjet financimit me borxh dhe financimit me aksione

Që nga vitet 1970 përpjesëtimi relativ ndërmjet financimit me borxh dhe financimit me aksione nuk ka ndërruar në mënyrë dramatike. Kështu, që atëherë, firmat në biznes kanë siguruar financimet e tyre me rreth 60% përmes emetimit të aksioneve, dhe me rreth 40% përmes emetimit të instrumenteve të borxhit. Përqindja e financimit përmes emetimit të aksioneve fillon të rritet dukshëm diku në vitet 1990.

Në vitet 1980, shuma totale e financimit me borxh në raport relativ me financimin përmes emetimit të aksioneve, sipas vlerës kontabël të borxhit dhe kapitalit aksioner, kishte shënuar rritje substanciale. Edhe pse kjo ishte interpretuar në vitet 1980, si zëvendësim i financimit me aksione me financimin përmes borxhit, ky interpretim ishte pak sa i gabuar dhe mashtrues. Firmat kishin riblerë aksionet e tyre nga mbajtësit e tyre, apo kishin blerë aksionet e firmës tjetër përmes shkrireve dhe bashkimeve.

Kështu, numër më i madh i aksioneve, ishin tërhequr nga qarkullimi se sa ishin emetuar në qarkullim. Megjithatë, kompensimi i atyre riblerjeve të aksioneve ishte një gjallërim i jashtëzakonshëm në tregun e bursave, që në mënyrë substanciale kishte rritur vlerën e tregut të aksioneve ekzistuese. Si rezultat, firmat ishin në situatë të tërheqin aksionet dhe të emetojnë instrumente borxhi pa e rritur fare me atë rast

përpjesëtimin borxhi/aksionet, të shprehur në vlerë të tregut, mbi shkallën e para viteve '80.

Duke përdor vlerat e tregut, del se proporcioni borxhi/kapitali aksioner kryesisht ka mbetur i pandryshuar në vitet 1980.

5. Faktorët që influencojnë përpjesëtimin relativ ndërmjet burimeve të financimit

Vendimi se cili do të jetë përpjesëtimi relativ ndërmjet burimeve interne dhe burimeve eksterne për financimin e projekteve investuese, apo zgjerimit të aktivitetit operacional të firmës, varet nga një numër faktorësh si vijon:

- Lartësia e fondeve të nevojshme
- Shkalla e fitimit e operacioneve ekzistuese
- Kosto oportune e fitimeve të mbajtura
- Kostot që shoqërojnë burimet eksterne të financimit
- Disponueshmëria e burimeve eksterne për firmën
- Politika e dividendit e firmës

6. Burimet publike dhe private për kapital

Firmat e biznesit sigurojnë fonde financiare nga burime publike dhe burime private. Fondet financiare të siguruar nga burime publike duhet të jenë në formë të letrave me vlerë të regjistruara në institucionin që rregullon dhe monitoron aktivitetin e tregjeve zyrtare të kapitalit – bursat. Në SHBA, letrat me vlerë të cilat shiten në bursat e letrave me vlerë, janë instrumente financiare të regjistruara në Komisionin për bursa dhe letra me vlerë (Securities and Exchange Comision – SEC), një agjencion qeveritar i themeluar në vitin 1934, që rregullon tregjet e letrave me vlerë.

Letrat me vlerë të burimeve publike, të regjistruara pranë institucionit qeveritar mbi bursat dhe letrat me vlerë, dallojnë nga instrumentet financiare të burimeve private, sepse ato mund të tregtohen në tregjet sekondare publike siç janë Bursa e Nju Jorkut dhe në Bursën Amerikane (The New York Stock Exchange–NYSE, and The American Stock Exchange–AMEX), të cilat janë dy institucione që lehtësojnë

tregtimin e letrave me vlerë publikisht të regjistruara. Shembujt e letrave me vlerë të tregtuara publikisht përfshijnë aksione të zakonshme, aksione të preferuara, dhe obligacione të korporatave.

Kapitali privat vije ose në formë të huave bankare ose në formë të vendosjeve private (private placements), që janë pretendime financiare të liruara nga detyrimi për regjistrim pranë komisionit për bursa dhe letra me vlerë. Për t'u kualifikuar për këtë vendosje private të liruara nga detyrimi për regjistrim, emetimi duhet të kufizohet në grupin e sofistikuar të investitorëve që numëron jo më shumë se 35 anëtarë, me kërkesa mbi minimumin e të hyrave dhe pasurisë. Zakonisht investitorët e tillë të sofistikuar përfshijnë shoqëritë e sigurimeve dhe fondet pensionale, si dhe individët e pasur. Ata gjithashtu përfshijnë edhe shoqëritë e posaçme për financimin e bizneseve të reja me risk dhe ripërtëritjeve (venture kapital).

Instrumentet financiare të vendosura në mënyrë private nuk mund të tregtohen në tregjet publike derisa nuk regjistrohen në Komisionin për bursa dhe letra me vlerë, me ç'rast ato shndërrohen në letra me vlerë publike. Megjithatë rregullorja 144A, e adoptuar në vitin 1990, lejon institucionet që zotërojnë asete në vlerë mbi \$100 milion, që të tregtojnë mes vete me instrumentet financiare të vendosura në mënyrë private, pa detyrim që ato të regjistrohen pranë komisionit për bursa dhe letra me vlerë.

Tregjet publike – bursat, janë anonime, çka do të thotë, se blerësit dhe shitësit mund të plotësojnë transaksionet e tyre, pa njohur fare identitetin e njëri-tjetrit. Për shkak të natyrës anonime të tregtimeve në këtë treg, investitorët e painformuar bartin riskun nga tregtimi me investitorët e tjerë, të cilët janë më shumë të informuar nga se disponojnë me informacion 'nga brenda' në lidhje me shoqërinë aksionere të caktuar dhe mbi këtë bazë mund të përfitojnë, duke krijuar fitime. Por, tregtimi i 'brendshëm' është ilegal dhe investitorët jo të informuar së pakut bile janë të mbrojtur me ligj që parandalojnë investitorët nga blerjet dhe shitjet e letrave me vlerë me karakter publik në bazë të informacionit të brendshëm, që në fakt janë informacion i brendshëm i shoqërisë aksionere, i cili nuk është bërë publik që më parë.

Në anën tjetër, investitorët e vendosjeve private të borxhit dhe kapitalit aksioner lejohen të mbështesin vendimet e tyre në informacionin, i cili nuk është bërë publik që më parë. Meqenëse tregtarët në tregje private supozohet të jenë investitorë të sofistikuar, të cilët janë informuar

mbi identitetin e njëri-tjetrit, informacioni i brendshëm mbi vendosjet private të letrave me vlerë, nuk përbën ndonjë problem të veçantë. Për shembull, në qoftë se blerësi i instrumentit të borxhit ka arsye të besojë se shitësi disponon me informacion që ai nuk e ka njohur ende, blerësi mund të mos e blejë fare instrumentin financiar. Në qoftë se shitësi e prezanton në mënyrë jo korrekte informacionin në lidhje me instrumentin financiar, për këtë blerësi mund ta padisë në gjyq më vonë. Meqenëse tregjet private nuk janë anonime, ata në përgjithësi janë më pak likuid, kostot e transaksioneve në lidhje me blerjen dhe shitjen e borxhit privat dhe kapitalit aksioner privat janë më të larta se sa kostot e blerjes dhe shitjes së letrave me vlerë në tregjet publike.

Sipas gjendjes aktuale në tregjet financiare, rreth 70% e borxhit të ofruar janë instrumente financiare të tregjeve publike, dhe 30% janë instrumente të tregjeve private – vendosje private. Por, ka edhe vite kur borxhi i ofruar privat arrin edhe në 40% të tregut të përgjithshëm. Mirëpo, vendosjet private të kapitalit aksioner mesatarisht kanë arritur vlerën e rreth 20% të kapitalit të siguruar rishtazi në tregun e aksioneve.

Shoqëritë mund të marrin fonde direkt nga bankat, shoqëritë e sigurimit, si dhe nga burime të tjera private pa kërkuar fare ndërmjetësimin e bankave të investimit. Mirëpo, në përgjithësi, shoqëritë kanë nevojë për shërbimet e bankave të investimit me rastin e emetimit të letrave me vlerë në tregjet publike.

PËRFUNDIME:

Menaxhimi më eficient i kërkesave nga blerësit, detyrimeve ndaj furnitorëve, stoqeve të mallrave, dhe rezervave monetare, mund të zvogëlojnë mbitërheqjet nga llogaria bankare dhe ngarkesat me interesa dhe të rrisë rezervat monetare.

Fitimet e mbajtura dhe burimet tjera interne të financimit përbëjnë pjesën më të madhe të fondeve financiare për financimin e aktivitetit të firmave në biznes

Financimi ekstern mund të klasifikohet edhe nga aspekti i afatit të fondeve (financimi afatshkurtër, dhe financimi afatgjatë), si dhe nga aspekti institucional (sigurimi i fondeve financiare përmes tregut financiar, apo përmes ndërmjetësve financiarë).

Firmat e biznesit sigurojnë fonde financiare nga burime publike dhe burime private. Fondet financiare të siguruara nga burime publike duhet të jenë në formë të letrave me vlerë të regjistruara në institucionin që rregullon dhe monitoron aktivitetin e tregjeve zyrtare të kapitalit – bursat.

Në anën tjetër, investitorët e vendosjeve private të borxhit dhe kapitalit aksioner lejohen të mbështesin vendimet e tyre në informacionin, i cili nuk është bërë publik që më parë. Meqenëse tregtarët në tregje private supozohet të jenë investitorë të sofistikuar, të cilët janë informuar mbi identitetin e njëri-tjetrit, informacioni i brendshëm mbi vendosjet private të letrave me vlerë, nuk përbën ndonjë problem të veçantë.

Sipas gjendjes aktuale në tregjet financiare, rreth 70% e borxhit të ofruar janë instrumente financiare të tregjeve publike, dhe 30% janë instrumente të tregjeve private – vendosje private.

Letrat me vlerë të burimeve publike, të regjistruara pranë institucionit qeveritar mbi bursat dhe letrat me vlerë, dallojnë nga instrumentet financiare të burimeve private, sepse ato mund të tregtohen në tregjet sekondare publike siç janë Bursa e Nju Jorkut dhe në Bursën Amerikane (The New York Stock Exchange–NYSE, and The American Stock Exchange–AMEX), të cilat janë dy institucione që lehtësojnë tregtimin e letrave me vlerë publikisht të regjistruara.

Kapitali privat vije ose në formë të huave bankare ose në formë të vendosjeve private (private placements), që janë pretendime financiare të liruara nga detyrimi për regjistrim pranë komisionit për bursa dhe letra me vlerë.

Tregjet publike – bursat, janë anonime; çka do të thotë, se blerësit dhe shitësit zakonisht investitorët e tillë të sofistikuar përfshijnë shoqëritë e sigurimeve dhe fondet pensionale, si dhe individët e pasur. Ata gjithashtu përfshijnë edhe shoqëritë e posaçme për financimin e bizneseve të reja me risk dhe ripërtëritjeve (venture kapital). Shoqëritë mund të marrin fonde direkt nga bankat, shoqëritë e sigurimit, dhe nga burime të tjera private pa kërkuar fare ndërmjetësimin e bankave të investimit. Mirëpo, në përgjithësi, shoqëritë kanë nevojë për shërbimet e bankave të investimit me rastin e emetimit të letrave me vlerë në tregjet publike.

LITERATURA:

1. Prof. dr. Zoran Jeremić: Tregjet financiare, Universiteti SINGIDUNUM, Beograd, shtator , 2009.
2. Prof.dr .Zoran Jeremić: Tregjet e aksioneve në Serbi: analiza e sektorit dhe 100 kompanive nga Bursa e Beogradit (biblioteka).
3. Prof.dr. BrankoVasiljević: Burimet e tregjeve financiare, Beograd, 2009.
4. www.telegrafi.com

Humbja e të drejtës së zgjedhjes

Ilir Berhani, Ermal Beqiri

Universiteti i Shkodrës "L.Gurakuqi", Fakulteti i Drejtësisë
Universiteti "Kristal", Tiranë

ABSTRACT

Loss of the right of choice

The article undertakes to handle a very important problem of the election. In this paper originally defined the right of election as a fundamental political right of citizens to direct derived from the constitution. In the first set positive and negative qualities that should have nationals legal capacity who own election. In the second part of the paper defines the conditions to be satisfied that the citizens can practice this very important political right of the individual. These conditions are: administrative registration of voters lists, which allows voters to exercise their electoral right, the opportunity to exercise the electoral right won a court decision. In the third paper dealt possibility of privation of electoral right posed by violations of the law and constitution bodies and administration of elections. In this section takes place the protection of citizens from arbitrary actions of official and civil servants who administrates the elections. Are handled major criminal crimes sanctions determined for them as well as administrative sanctions for violations administrative in the administration of elections.

Para shqyrtimit të kësaj çështjeje është e nevojshme që të bëhet një trajtim për përmbajtjen e kësaj të drejte, e cila përfaqëson legjitimitetin e pjesëmarrjes aktive të shtetasit, individit në qeverisjen apo në drejtimin e shtetit. Kjo do të thotë se duhet nënvizuar rëndësia e kësaj të drejte për

vetë individin dhe për shtetin. E drejta e zgjedhjes i krijon individit, shtetasit të një shteti, mundësinë e ushtrimit të sovranitetit. Me anë të ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes individi ka mundësinë të influencojë në zgjedhjen e qeveritarëve e të qeverisë së shtetit. Në këtë sens duhet të kuptohet se e drejta e zgjedhjes që zotëron individi apo shtetasi përfshin dy elemente përbërëse: a. aftësinë zgjedhore të zgjedhësit, b. mundësinë që ka zgjedhësi të ushtrojë konkretisht të drejtën e zgjedhjes.

I. Aftësia zgjedhore

Zgjedhës, shtetas ose individ që gëzon zotësinë juridike elektorale, sipas përcaktimit që bën neni 45/1 i kushtetutës sonë, është “çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve...”⁷¹ Në këtë kuptim që të jetë zgjedhës shtetasi, individi duhet të ketë zotësinë elektorale dhe të mos e ketë humbur atë. Aftësia për të qenë zgjedhës kërkon që zgjedhësi veç të tjerave të posedojë cilësi pozitive: pra të ketë shtetësinë dhe moshën e kërkuar nga ligji. Por aftësia për të qenë zgjedhës kërkon njëkohësisht që zgjedhësi të mos jetë në asnjë nga rastet penguese të parashikuara nga pika 2 dhe pika 3 e këtij neni, pra të mos jetë në kushtet e posedimit të të ashtuquajturave cilësi negative që i heqin atij këtë të drejtë.⁷²

a- Cilësitë pozitive për të qenë zgjedhës.

Që të jetë zgjedhës individi duhet të ketë zotësi juridike zgjedhore. Individit, sipas kushtetutës dhe kodit zgjedhor, për të qenë zgjedhës, titullar, bartës i të drejtës së zgjedhjes, duhet të plotësojë dy kushte. Kushti i parë për të qenë zgjedhës, sipas kodit zgjedhor, është të jesh shtetas shqiptar.⁷³ Megjithëse kushtetuta e ka lënë të papërcaktuar shtetësinë e shtetasit që ka të drejtën e zgjedhjes, ligji zgjedhor e përcakton qartë shtetësinë shqiptare për individët që zotërojnë të drejtën e zgjedhjes në Shqipëri. Është fjala në këtë rast dhe për të drejtën aktive dhe

⁷¹ Kushtetuta e RSH neni 45/1

Kodi zgjedhor 2008 neni 3/3. Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet.

⁷² Kushtetuta e RSH neni 45/2/3 Përfshihen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht. Të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur.

⁷³ Kodi zgjedhor 2008 nen3/3.

të drejtën pasive të zgjedhjes. Bazuar në sa parashikohet në kushtetutën tonë dhe kodin zgjedhor vetëm shtetasit shqiptarë kanë të drejtën të jenë zgjedhës, domethënë kanë të drejtën të zgjedhin (të votojnë) dhe të drejtën të zgjidhen (të votohen) në organet e zgjedhshme të shtetit. Kushti i dytë për të qenë zgjedhës është që shtetasi apo individ i të jenë në moshën e përcaktuar nga ligji. Kushtetuta e kodi zgjedhor kanë përcaktuar moshën tetëmbëdhjetë vjeç për shtetasit që të fitojnë zotësinë juridike të ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes.⁷⁴ “*Madje Kushtetuta e ka zgjidhur me hollësi dhe nuk lë vend për diskutim, kur thekson se zotësia për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes fillon nga dita kur shtetasi ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç*”⁷⁵

b - Cilësitë negative që pengojnë gëzimin e të drejtës së zgjedhjes.

Për të qenë zgjedhës dhe për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes kërkohet që shtetasit të mos jenë në asnjë nga rastet e pengimit dhe humbjes së plotë të së drejtës së zgjedhjes dhe të ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes, të cilat janë parashikuar në kushtetutë dhe në ligjin e zgjedhjeve. “*Në kushtetutë kjo është e lidhur me paaftësinë elektorale për shkak të paaftësisë mendore, gjë që mund të vendoset vetëm nga gjykata me vendim të formës së prerë. Edhe kodi zgjedhor ruan këtë përcaktim të vendosur nga kushtetuta. Duke interpretuar pikën 2 të nenit 45 të kushtetutës sonë në lidhje me kodin civil shqiptar, do të thoshim se nuk kanë zotësi për të qenë zgjedhës, si shtetasit që janë deklaruar me vendim gjyqësor të paaftë mendërisht, ashtu edhe ata që janë deklaruar me zotësi të kufizuar për të vepruar, përderisa kushtetuta nuk lë vend për diskutim.*”⁷⁶

Por kushtetuta ka parashikuar dhe një lloj zotësie të kufizuar të së drejtës së zgjedhjes ose siç mund të përcaktohet ndryshe një paaftësi e pjesshme elektorale. Paaftësi e pjesshme elektorale, ose e drejtë e pjesshme elektorale kemi në rastin e personave që janë duke vuajtur dënimin penal me heqje të lirisë. Kushtetuta u njeh këtyre shtetasve, individëve vetëm aftësi të pjesshme zgjedhore, pasi atyre “...u njihet

⁷⁴ Kushtetuta e RSH neni 45/1 dhe Kodi zgjedhor neni 44/1. Kushtet për të qenë zgjedhës 1. Çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 18 vjeç në datën e zgjedhjeve dhe që plotëson kushtet e parashikuara në këtë Kod, ka të drejtë të votojë për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e qeverisjes vendore.

⁷⁵ A. Anastasi Revista “Studime juridike”, nr 2, 2004, f.23.

⁷⁶ A. Anastasi, po aty, f. 23-24.

vetëm juss suffragii (e drejta për të votuar) dhe përjashtohen nga juss honorum, e drejta për t'u zgjedhur.”⁷⁷

Nga sa u nënvizua më sipër mund të arrijmë në përfundimin se zgjedhësi të drejtën e zgjedhjes e humbet në dy mënyra: *a- në mënyrë formale juridike*: në rastin kur kushtetuta dhe kodi zgjedhor përcaktojnë se kur shtetasi e humbet të drejtën e zgjedhjes apo përjashtohet nga kjo e drejtë.⁷⁸; *b- nga veprimet e paligjshme*: kur kjo e drejtë shkelet ose i mohohet nga veprime të paligjshme të kryera nga organe shtetërore apo individë në shkelje të ligjit zgjedhor dhe të kushtetutës.

II. Kushtet e ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes

1. Regjistrimi në listat e zgjedhësve. Megjithëse shtetasit e zotërojnë të drejtën e zgjedhjes, për ushtrimin e kësaj të drejte është i nevojshëm dhe i domosdoshëm regjistrimi i zgjedhësve në listat e zgjedhësve. Qenia zgjedhës nuk është e mjaftueshme për ushtrimin e kësaj të drejte, domethënë për realizimin e të drejtës së zgjedhjes. Për ta ushtruar këtë të drejtë krahas zotërimit të zotësisë juridike zgjedhore është e nevojshme që shtetasi, individi të jetë i regjistruar në listat e zgjedhësve (në rastin e të drejtës aktive zgjedhore), apo në listat e kandidatëve për t'u zgjedhur (në rastin e të drejtës pasive zgjedhore). Regjistrimi i zgjedhësit në listat elektorale është përcaktuar si një kusht dhe njëkohësisht dhe si një mundësi që shtetasi të mund ta ushtrojë këtë të drejtë të zgjedhjes, që shtetasi të mund ta realizojë këtë të drejtë. Pra, ushtrimi i kësaj të drejte është i varur nga një ngjarje juridike e natyrës burokratike dhe dokumentare. Mjafton që shtetasi apo individi që e zotëron të drejtën e zgjedhjes të mos regjistrohet në listat e zgjedhësve që ai të mos e ushtrojë dot këtë të drejtë, pra realisht ta humbasë atë. *“Nuk mund të mënjanojmë rëndësinë e një kushti faktik, i cili nuk buron drejtpërdrejt nga kushtetuta, por është po aq i rëndësishëm. Ky është regjistrimi në listat e zgjedhësve, pa të cilin nuk mund të ushtrohet e drejta e zgjedhjeve.”*⁷⁹

Dy parime të rëndësishme janë baza e regjistrimit të zgjedhësve në listat e zgjedhësve, së pari: përfshirja në listat e zgjedhësve e të gjithë

⁷⁷ A. Anastasi, po aty, f. 24.

⁷⁸ Kodi zgjedhor 2008 neni 44/2, Përjashtohen nga e drejta për të zgjedhur shtetasit e shpallur, me vendim gjyqësor të formës së prerë, si të pazotë për të vepruar.

⁷⁹ A. Anastasi, po aty, f.28.

zgjedhësve që gëzojnë zotësinë juridike zgjedhore, së dyti: ndalimi ose pengimi i përjashtimit nga listat e zgjedhjeve të shtetasve që gëzojnë zotësinë juridike zgjedhore.

Në këtë sens është evidente që humbja ose përjashtimi nga e drejta e zgjedhjes mund të ketë dhe një shkak ekstrakushtetues apo ekstraligjor që është mosregjistrimi i shtetasve në listat e zgjedhësve, i cili është thjesht një veprim i natyrës burokratike, administrative dhe dokumentare. Meqenëse ky veprim juridik i dokumentimit të zgjedhësve në listat zgjedhore kushtëzon ushtrimin e kësaj të drejte në Kodin zgjedhor është parashikur se regjistrimi i shtetasit në listat e zgjedhësve bëhet nga organe që e kanë në kompetencë një gjë të tillë. Sipas këtij kodi “Listat e zgjedhësve nxirren nga baza e të dhënave elektronike të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, nga zyra e gjendjes civile të njësisë së qeverisjes vendore, pas urdhërit të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse. Lista që shpallet duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe nëpunësi përgjegjës i gjendjes civile.”⁸⁰

Duket krejt qartë se detyrimi ligjor për regjistrimin e zgjedhësve në listat zgjedhore u përket organeve të qeverisjes vendore të vendit ku ka vendbanimin zgjedhësi. Shqyrtimi i kësaj çështje synon të zbulojë mundësinë që kanë këto organe të përjashtojnë zgjedhësin nga e drejta e zgjedhjes apo që t’i heqin zgjedhësit mundësinë e ushtrimit të së drejtës së zgjedhjes edhe në rastin kur ai e gëzon këtë të drejtë. Bazuar në kodin zgjedhor shtetasit nuk kanë detyrimin ligjor për regjistrimin në listat e zgjedhësve, madje shtetasit nuk kanë as detyrimin ligjor që të ushtrojnë këtë të drejtë, por janë të lirë në të drejtën për ta ushtruar të drejtën e zgjedhjes. Duke qenë se regjistrimi ose jo i zgjedhësit në listat e zgjedhësve ka si pasojë humbjen e të drejtës së zgjedhjes kodi zgjedhor parashikon një procedurë ligjore të detajuar për regjistrimin apo jo të zgjedhësit në listat e zgjedhësve, duke përcaktuar këtë në kompetencë të organeve shtetërore. Regjistrimi i zgjedhësve në listat e zgjedhësve është një kusht faktik, që nuk buron nga kushtetuta, por nga ligji i zgjedhjeve, pa të cilin nuk mund të ushtrohet e drejta e zgjedhjeve. Regjistrimi i shtetasve në listat e zgjedhësve kryhet nga organe të përcaktuara, të cilat kanë kompetencën, por dhe detyrimin ligjor të regjistrimit. Madje në kod përcaktohen në mënyrë mjaft të detajuar rregullime juridike – ligjore me

⁸⁰ Kodi zgjedhor, 2008, neni 48/1.

anë të cilave rregullohet regjistrimi i zgjedhësve. Për zgjedhësit ligji nuk ka përcaktuar detyrime juridike që rregullojnë regjistrimin **entire** në këto lista të zgjedhjeve dhe as detyrimin për të ushtruar këtë të drejtë.

Analiza që parashtrohet në këtë punim ka të bëjë pikërisht me mundësinë që ekziston për heqjen ose humbjen e kësaj të drejte së zgjedhjes për shkak të veprimeve të paligjshme që mund të kryejnë organet kompetente për të regjistruar zgjedhësit në listat elektorale.

Duhet të nënvizohet fakti se organi kompetent vendor që ka në kompetencë të regjistrojë shtetasin në listat e zgjedhjes nuk zotëron asnjë lloj pushteti diskrecional. Organet vendore në të kundërt kanë jo vetëm në kompetencën e tyre regjistrimin e zgjedhësve në listat e zgjedhësve, seleksionimin e individëve që përfshihen në këto lista, por këto organe kanë dhe detyrimin ligjor të regjistrojnë zgjedhësit në këto lista. Këto organe urdhërohen drejtpërdrejt nga ligji të kryejnë këtë regjistrim. Kjo do të thotë se organet vendore që kanë këtë detyrim mbajnë përgjegjësi ligjore në rat se ato nuk e ushtrojnë këtë kompetencë dhe në rast se padrejtësisht nuk regjistrojnë zgjedhësin në listat e zgjedhjeve. Organet mbajnë përgjegjësi ligjore për interpretimin korrekt të dokumentacionit që kanë në dispozicion për regjistrimin e shtetasit në listat zgjedhore.

2. *Garantimi gjyqësor i të drejtës së zgjedhjes.* Në doktrinën e së drejtës ka pikëpamje të cilat përcaktojnë që shkrimi në listat e zgjedhësve ka natyrën e një akti themelor të së drejtës, në të kundërt atëherë shkrimi në këto lista duhet t'i atribuohet një karakter deklarativ dhe jo themelues i së drejtës. Sot në doktrinën e së drejtës prezantohet si dominuese pikëpamja apo hipoteza se e drejta e zgjedhjeve lind nga cilësitë dhe kushtet e përcaktuara drejtpërdrejt nga kushtetuta dhe ligji zgjedhor dhe se zotërimi i kësaj të drejte nuk lidhet aspak me përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhjeve.

Zotëruesi i të drejtës së zgjedhjeve e garanton këtë të drejtë edhe pa qenë i shkruar në listat e zgjedhësve me një vendim deklarativ të dhënë nga gjykata për këtë të drejtë. Shkrimi në listat elektorale përfaqëson kushtin e nevojshëm e të mjaftueshëm për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes, përjashtohen ratet e veçanta të zgjedhësve të veçantë që e ushtrojnë këtë të drejtë edhe pa qenë të regjistruar në këto lista. Kjo i referohet të ushtuarit të së drejtës së zgjedhjes nga persona të cilët akoma nuk e kanë plotësuar moshën e përcaktuar nga ligji për të ushtruar këtë të drejtë. Është rasti i personave që fitojnë zotësinë juridike të veprimit para

moshës së përcaktuar me ligj. (Femrat e martuara). Ose është rasti i personave që lejohen të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes nga një vendim gjyqësor apo nga një vendim i organit vendor.

3. *Humbja ligjore e së drejtës së zgjedhjes.* Humbja e të drejtës së zgjedhjes dhe mosregjistrimi i zgjedhësit në listat e zgjedhësve nga organet vendore, mund të rrjedhë së pari drejtpërdrejt nga ligji.⁸¹ Në këtë rast verifikohet mungesa e një prej elementeve të përcaktuara në ligj. Në këtë rast organeve që hartojnë listat e zgjedhësve u mbetet vetëm të zbatojnë atë që është parashikuar në ligj. Organet e zgjedhjeve, për rrjedhim, veçse zbatojnë drejtpërdrejt atë çfarë përcaktohet nga ligji. Kjo për faktin se në këtë rast humbja e kësaj të drejte rrjedh drejtpërdrejt nga norma juridike. Pra zyra e regjistrimit të zgjedhësve në këtë rast bën vetëm ekzekutimin e një situate të verifikuar dhe veprimi administrativ në këtë rast veçse bën eficient atë çka verifikohet në lidhje me këtë të drejtë. Në këtë rast nëpunësi që administron listat e zgjedhësve nuk e regjistron zgjedhësin në këto lista ose e heq zgjedhësin nga listat.

III. Humbja e së drejtës së zgjedhjes nga shkeljet e ligjit

1. *Humbja e të drejtës së zgjedhjes nga veprimet e paligjshme.* Humbja e të drejtës elektorale mund të shkaktohet dhe nga veprimet administrative jo të ligjshme të zyrtarëve të administratës shtetërore dhe administratorëve të zgjedhjeve. Veprimet që mund të kryhen në këtë rast dhe të privojnë zgjedhësin nga e drejta e zgjedhjeve janë: mosregjistrimi i zgjedhësit në listat e zgjedhësve, në rastin kur zgjedhësi e zotëron këtë të drejtë; heqja e zgjedhësit nga lista e zgjedhësve kur zgjedhësi duhet të ishte në këto lista. Në të dy rastet kemi të bëjmë me veprime arbitrare që nuk janë të bazuara në ligj dhe në të kundërt me veprime në shkelje të ligjit. Ky është thjesht një veprim administrativ i zyrtarëve të administratës apo i nëpunësve të zgjedhjeve, por që paraqet vështirësi të shumta dhe është mjaft i komplikuar për t'u vërtetuar, për t'u shpjeguar dhe interpretuar. Ky është një veprim administrativ që sjell një pasojë shumë të rëndë juridike, i heq zgjedhësit të drejtën e zgjedhjes, të cilën zgjedhësi e fiton drejtpërdrejt nga kushtetuta dhe nga ligji zgjedhor.

Për të marrë këtë vendim nëpunësi i administratës dhe nëpunësi i

⁸¹ Kushtetuta e RSH neni 45/2 dhe kodi zgjedhor neni 44/2.

ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve nuk zotëron asnjë lloj pushteti diskrecionar. Kjo do të thotë se rastet e mosregjistrimit të zgjedhësve në listat e zgjedhjeve dhe heqja e zgjedhësit nga listat e zgjedhjeve janë të përcaktuara nga ligji dhe nuk janë në të drejtën e nëpunësve që administrojnë listat e zgjedhësve. Në çdo rast zyrtari elektoral apo nëpunësi që administron këtë funksion nuk vepron në mënyra diskrecionare, por gjithnjë ai për marrjen e vendimit bazohet në përcaktimet e bëra në ligj dhe në dokumente që vijnë nga subjekte të tjera me të cilat ai procedon për të vërtetuar humbjen e të drejtës së zgjedhjes ose mosregjistrimin në këto lista. Në vendimin e zyrës zgjedhore për humbjen e të drejtës zgjedhore përfshihet: mosregjistrimi ose fshirja e emrit të zgjedhësit nga listat e zgjedhësve dhe tregohet afati në të cilin shtetasi mbetet i privuar nga e drejta e zgjedhjes. Në këtë rast zyra zgjedhore nuk hyn në brendësi apo nuk analizon dokumentet që shqyrton në lidhje me regjistrimin ose jo dhe fshirjen nga listat e zgjedhësve të zgjedhësit. Një ndër rastet e heqjes së zgjedhësit nga listat e zgjedhësve është kur zgjedhësi ka humbur shtetësinë. Në rastin kur zyra elektorale shqyrton dokumentet që provojnë humbjen e shtetësisë së zgjedhësit, zyra elektorale vepron duke fshirë individin nga listat zgjedhore edhe pse ai ishte më parë i përfshirë në këto lista. Po kështu kur zyra elektorale merr në shqyrtim dokumente që provojnë mosekzistencën e shtetasit në regjistrin e gjendjes civile të shtetasve rezidentë atëherë kjo zyrë nuk e regjistron emrin e shtetasit në listat e zgjedhësve që janë rezidentë në atë qark elektoral. Kjo për faktin se ligji zgjedhor ka parashikuar se zgjedhësit regjistrohen vetëm në listat zgjedhore të vendbanimit, ose të vendit ku ata janë rezidentë të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile. Në të dy rastet e shqyrtuara më lart presumohet që dokumentacioni i zyrave të tjera të paraqitura është korrekt dhe i vërtetë.

2. Mbrojtja ligjore nga përjashtimi administrativ.

Kushtetuta në nenin 45/1 ka përcaktuar të drejtën e zgjedhjes si një të drejtë politike themelore të individit. Shteti, organet shtetërore duhet ta respektojnë këtë të drejtë, duke nxjerrë akte dhe duke vepruar që të sigurojnë për shtetasit ushtrimin e së drejtës së zgjedhjeve. Shteti ka detyrimin juridik pozitiv në respektimin e kësaj të drejte të shtetasve. E drejta e zgjedhjes është një e drejtë ...“*të cilën organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet ta respektojnë... si dhe të*

kontribuojnë në realizimin e saj".⁸² Ky detyrim pozitiv i shtetit për të garantuar këtë të drejtë dhe për të siguruar ushtrimin e kësaj të drejte përcaktohet krejt qartë në neni 3 të protokollit 1. Sipas konventës e drejta e zgjedhjes nuk është një e drejtë absolute dhe e pakufizueshme. Shteti ka hapësirë të vendosë kushte për ushtrimin e kësaj të drejte themelore politike të shtetasve. Në lidhje me këtë çështje Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar se shteteve palë u është dhënë hapësirë e gjerë vlerësimi në këtë fushë. Në vijim të kësaj të drejte që kanë shtetet për të caktuar kushte për ushtrimin e të drejtës së zgjedhjeve Kodi Zgjedhor përcakton se "Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç në datën e zgjedhjeve dhe që plotëson kushtet e parshikuara në këtë kod ka të drejtë të votojë për zgjedhjet për kuvendin dhe për organet e qeverisjes vendore".⁸³ Sidoqoftë gjykata nuk ka adaptuar një listë të mbyllur për të kufizuar ose deroguar nga kjo e drejtë subjektive.⁸⁴ Kushtetuta jonë duket se përcakton disa kushte për të zotëruar këtë të drejtë. Shprehimisht në paragrafin 1 (kufiri i moshës), paragrafi 2 (paaftësia mendore e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë) dhe paragrafi 3 (personat të cilëve u është hequr liria në të drejtën e tyre për t'u zgjedhur).⁸⁵

Megjithatë shtrohet gjithnjë pyetja sa është garantuar e drejta e zgjedhjes. Kjo për faktin se ushtrimi i të drejtës së zgjedhjeve është cënuar vijimisht nga veprimtaria e administratës së zgjedhjeve. Krahas humbjes dhe cënimit nga ligji të së drejtës së zgjedhjes vijimisht në zgjedhjet janë vërejtur cënime dhe humbje të kësaj të drejte nga veprimet e organeve që kanë drejtuar dhe administruar gjithë procesin e realizimit dhe ushtrimit të zgjedhjeve. Pra mund të nënvizohet dukshëm fakti që ushtrimi i të drejtës së zgjedhjes ka hasur në mjaft kufizime dhe devijime. Nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston një garanci absolute e plotë për të ushtruar këtë të drejtë. Kjo do të thotë se ekziston garancia konstitucionale dhe ligjore. Por ka mjaft raste dhe mundësi që shtetasve u

⁸² Raport mbi studimin e përjasjes së legjislacionit shqiptar me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut", Tiranë, 2003, f. 56.

⁸³ Kodi Zgjedhor 2008 neni 3.1.

⁸⁴ Raport mbi studimin e përjasjes së legjislacionit shqiptar me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut", Tiranë, 2003, f.56.

⁸⁵ Raport mbi studimin e përjasjes së legjislacionit shqiptar me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut", Tiranë, 2003, f.57.

cënohet kjo e drejtë dhe nuk aplikohen ligjet që e mbrojnë dhe garantojnë atë. Në zgjedhjet e zhvilluara në Shqipëri janë vërejtur devijime të dukshme në veprimtarinë e drejtimit dhe administrimit të zgjedhjeve, të cilat kanë çënuar ushtrimin e të drejtës së zgjedhjeve. Në qoftë se analizojmë në mënyrë sipërfaqësore procesin e zgjedhjeve të zhvilluara në vendin tonë në vitin 2009, për zgjedhjen e deputetëve do të vëmë re se kjo e drejtë u çënuar. Së pari, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2009 e drejta e zgjedhjeve u çënuar nga mospajisja e shtetasve me dokumente identifikimi. Një përqindje e konsiderueshme e shtetasve nuk e ushtruan të drejtën e tyre të votimit, sepse nuk zotëronin një pasaportë apo një kartë identiteti. Së dyti, kjo e drejtë u çënuar nga mosregjistrimi i një numri të konsiderueshëm të shtetasve në listat e zgjedhësve. Së treti, në zgjedhjet e vitit 2009 pati mjaft raste të votimit familjar që çënuan karakterin vetiak të votës. Së katërti, në zgjedhjet e vitit 2009 e drejta e zgjedhjes u çënuar dhe u shkel rëndë në procesin e numërimit dhe në procesin e nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve. Deformimi i rezultatit të zgjedhjeve nga numërimi i keq i votave përbën çënim të drejtpërdrejtë të së drejtës së votës, shkelje të saj dhe është rast flagrant i shkeljes së kushtetutës dhe i shkeljes së ligjit.

Nisur nga mundësia reale e çënimit të së drejtës së zgjedhjeve dhe e ushtrimit të kësaj të drejte në procesin zgjedhor legjislatori ka parashikuar dhe mbrojtjen ligjore të kësaj të drejte, duke parashikuar disa vepra të dënueshme për personat që pengojnë ushtrimin dhe çënojnë ushtrimin e kësaj të drejte. E drejta e zgjedhjes është një e drejtë e përcaktuar dhe e mbrojtur nga kushtetuta e shtetit. Ajo bën pjesë në të drejtat themelore të individit që shpallen dhe garantohen me kushtetutë. Pra është një e drejtë kushtetuese dhe për rrjedhim garantohet nga kushtetuta. Por kjo e drejtë gjen mbrojtjen e vet dhe në ligjin zgjedhor (kodi zgjedhor), si dhe në kodin penal. Në kodin penal kreu dhjetë përfshin veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.⁸⁶ Veprat penale që mbrojnë ushtrimin e kësaj të drejte janë: pengimi i subjekteve për zgjedhjet në organet përfaqësuese, falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve, shkelja e fshehtësisë së votimit, dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve, kanosja e zgjedhësit dhe

⁸⁶ Kodi penal i RSH, kreu X, f.142.

e kandidatëve, shkelja e të drejtës së zgjedhjes.⁸⁷ Edhe kodi zgjedhor ka parashikuar vepra të dënueshme, të cilat mund të kryhen nga organet shtetërore që drejtojnë e administrojnë zgjedhjet, nga administrata e zgjedhjeve dhe nga individët, duke parashikuar dhe sanksionet përkatëse. Në kod është një kapitull që përcakton përgjegjësitë dhe sanksionet e personave të ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve.⁸⁸ Vepra të tilla janë: braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve.⁸⁹ Në kod janë parashikuar dhe sanksione administrative për veprimet që nuk përbëjnë vepra penale apo shpërdorim të detyrës sipas nenit 248 të kodit penal.⁹⁰ Sanksionet e parashikuara në kod për shkelje të parimeve të kodit, të cilat janë përcaktuar si kundravajtje administrative në rastet kur nuk ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve dhe janë konsideruar kundravajtje penale kur këto veprime ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve. Në këtë rast parashikohet dënim me burgim nga 6 muaj deri në dy vjet.⁹¹ Problem i diskutueshëm për ushtrimin e të drejtës së zgjedhjes, është rasti i dënimit të individëve me ndalim të së drejtës së ushtrimit të detyrave si nëpunës shtetëror ose në shërbim publik⁹² dhe i heqjes të së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie.⁹³

Duket qartë se heqja e të drejtës së ushtrimit të një veprimtarie apo mjeshtërie në sensin e nenit 30 pika 5, duhet të diferencohet nga ndalimi që përbën pengesë për funksionet publike siç përcakton neni 30 pika 1 e kodit penal. Dënimi i dytë ndalimi i mundësisë për të ushtruar funksione të caktuara publike mund dhe të sillte si pasojë heqjen e të drejtës së elektorale aktive. Në këtë rast ligji mund të parashikonte pengimin e shtetasit të kandidojë për t'u zgjedhur dhe për të ushtruar funksionin e ligjvënësit apo funksione të tjera publike që fitohen përmes zgjedhjeve. Megjithatë në ligjin tonë zgjedhor nuk është përcaktuar asnjë lloj ndalimi

⁸⁷ Kodi penal i RSH, neni 331.

⁸⁸ Kodi zgjedhor neni 168 “Anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe nëpunësit e administratës publike në shërbim të këtyre komisioneve mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit në fuqi për shkeljen e dispozitave të këtij kodi”.

⁸⁹ Kodi zgjedhor neni 170 “...kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë/heqje lirie 6 muaj deri në 2 vjet”.

⁹⁰ Kodi zgjedhor neni 171.

⁹¹ Kodi zgjedhor neni 172.

⁹² Kodi penal i RSH, neni 30, pika 1.

⁹³ Kodi penal i RSH, neni 30, pika 1.

për shtetasit që krahas dënimit kryesor kanë si dënim plotësues ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike. Por është kushtetuta që u kufizon të drejtën aktive të zgjedhjes shtetasve të dënuar me burgim me vendim të formës së prerë që janë duke vuajtur dënimin. Kjo nënkupton që zbatimi i dënimit kryesor e pengon drejtpërdrejt zgjedhjen e shtetasit në organet përfaqësuese. Për këtë shkak nuk është parë e arsyeshme që ky pengim të parashikohet drejtpërdrejt në kodin zgjedhor. Në këtë rast, me dërgimin e vendimit nga gjykata, administrata e zgjedhjeve nuk pranon regjistrimin e shtetasit në listat e kandidatëve. Ka shtete ku shtetasit humbasin të drejtën e zgjedhjes për shkak edhe të padenjësive morale të përcaktuara nga ligji. Në këtë rast ato përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes.⁹⁴

BIBLIOGRAFIA:

1. Luan Omari, "Shteti i së drejtës", Tiranë, 2002.
2. Kurtesh Saliu, "E drejta kushtetuese", Prishtinë, 2001.
3. Aurela Anastasi, "E drejta kushtetuese", Tiranë, 2001.
4. Aurela Anastasi, "E drejta kushtetuese e krahasuar", Tiranë, 2009.
5. Xhezair Zaganjori, "Demokracia dhe shteti i së drejtës", Tiranë, 2002.
6. Ilir Berhani, "Bazat e të drejtës së zgjedhjeve", Tiranë, 2009.
7. Kushtetuta e RSH 1998.
8. Kodi zgjedhor, Tiranë, 2008.
9. Kodi penal i RSH.
10. Studime Juridike, nr. 2, Tiranë, 2004.
11. Revista "Jeta juridike", nr.1, Tiranë, 2002.
12. Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore. Strasburg. Tetor, 2002.
13. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
14. Protokolli 1 shtesë i KEDNJ.
15. Raport mbi studimin e përjasjes së legjislacionit shqiptar me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut", Tiranë, 2003.
16. Kushtetuta e republikës Italiane.

⁹⁴ Kushtetuta e Republikës Italiane neni 48, "E drejta e votës nuk mund të kufizohet veçse për pazotësi civile ose si pasojë e një vendimi penal të formës së prerë dhe në rastet e padenjësive morale të përcaktuara me ligj".

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010*

Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri parë në këndvështrimin e Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Florian Bjanku, Anila Kaçupi

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë
Universiteti “Illyria”, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë*

The process of restitution and compensation of Former property Owners in Albania from the point of view of the jurisprudence of the European Court of Human Rights.

ABSTRACT

In 1989 all land in Albania was owned by the state. The principle of exclusive state ownership was in the 1976 Constitution, which had been the final legal action abolishing all other forms of collective and personal property rights in land.

In 1991, the Government of Albania initiated reform of land and immovable property relations. Private ownership and subordinate rights of use and lease were to be created in the first stage of transformation by reviving principles of civil law and authorizing market transactions. Many persons interpreted these reforms to mean that full restitution or full compensation had to be given for all property owned prior to 1945. Other persons did not read this guarantee as broadly. On this question, reference was made to the European Convention on Human Rights, which had been ratified by the Republic of Albania, and to the case law of the European Court on Human Rights (ECHR).

This court had ruled that there is no absolute right to restitution and that each State has a wide margin of discretion in addressing the appropriate level of compensation and the manner of assessing the value of property. From the European perspective, therefore, there did need to be a guarantee of full compensation in all circumstances, because legitimate objectives of the public interest could call for an amount, which is less than full market value.

In order to determine the scale of compensation, reference also was made to cases of the European Court, in which property value has been calculated to compensate the interference with property rights. The court's approach in these cases had been based on the 'market value,' which could have been negotiated in a sale as of the date of the wrong. In applying this valuation method, the court required two conditions. First, it ruled that, in determining the compatibility of a certain act by a State with regard to land and property issues, any interference in the exercise of these rights must strike a fair balance between the aim sought to be achieved and the nature of the act. The key question was whether the interference would achieve a fair proportional balance between the rights of the victim and the general interest. Second, each claimant to restitution or compensation must have the right to an independent and impartial tribunal that would determine its claims in a speedy and effective way. This guidance from the European Court was influential in the constitutional debate.

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Konventen Evropiane për të Drejtat e Njeriut me 13 korrik 1996. Me ratifikimin që i ka bërë kësaj konvente me anë të ligjit nr. 8317 të 31 korrikut 1996 dhe me depozitimin e instrumenteve të ratifikimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës me 2 tetor 1996, Shqipëria ka përfunduar të gjitha procedurat e pranimit të Konventës dhe është anëtare e Këshillit të Evropës.

Duke qenë se Konventa Evropiane në vetvete bën pjesë në kategorinë e traktateve ndërkombëtare, në bazë të Kushtetutës ajo është pjesë e sistemit të brendshëm juridik⁹⁵, për rrjedhojë është e detyrueshme

⁹⁵ Shih neni 122 parag 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.

dhe direkt e zbatueshme për Republikën e Shqipërisë.⁹⁶ Një aspekt tjetër që garantohet në Kushtetutë është se kufizimet në të drejtat e njeriut kushtetuese (edhe ato në raste te veçanta), nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut.⁹⁷

Nga sa u tha më lart shihet qartë se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut duhet të jetë për autoritetet shqiptare një referencë bazë normative dhe statndardizuese në zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe natyrisht edhe sa i takon një prej të drejtave më themelore, siç është ajo e pronës.

Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave të shpronësuarve nga regjimi monist, ka qenë një nga çështjet më të diskutueshme në raport me të drejtën e pronës që garanton Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Debati mbi të drejtat e të shpronësuarve nuk u zgjidh as në periudhën kur u përgatit kushtetuta e Shqipërisë. Kushtetuta e re e aprovuar me referendum në 22 Nëntor 1998, përmban klauzola të forta që garantojnë të drejtën e pronës private. Gjithashtu, neni 181 garantonte se *“Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.”*

Shumë persona i interpretuan këto klauzola se nënkuptonin kthim dhe kompensim të plotë për të gjithë pronarët para vitit 1945. Të tjerë nuk e panë këtë si garanci kaq të gjerë. Kjo çështje i referohej Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, si dhe rastit ligjor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR).⁹⁸ Sipas kësaj gjykate nuk ka të drejtë absolute të kthimit dhe secili shtet ka një mundësi të gjerë të trajtimit të nivelit të duhur të kompensimit dhe mënyrës së vlerësimit të pronës.⁹⁹ Nga pikëpamja evropiane, kishte nevojë që të garantohej një kompensim i fortë në çdo rrethanë, sepse objektet legjitime të **internisti** publik mund të përbënin një shumë, e cila ishte më e vogël sesa vlera e plotë e

⁹⁶ Shih neni 5 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, 1998.

⁹⁷ Shih neni 17, pika 2 e Kushtetutës së RSH, 1998.

⁹⁸ Referencat nga rasti ligjor i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë marrë nga Qendra e të Drejtave dhe Dëbimeve Shtëpiake (COHRE) (2002) Albania: Resolving the Question of Land and Property Restitution and Compensation, raport i përgatitur për Bankën Botërore dhe OSBE.

⁹⁹ Jonas v. Czech Republic App 23063/93, E ComHR; Nohejl v. Czech Republic, App No. 23889, EurComHR).

tregut.¹⁰⁰

Për të përcaktuar shkallën e kompensimit iu referua rasteve të Gjykatës Evropiane, në të cilën vlera e pronës është llogaritur që të kompensojë ndërhyrjen në të drejtat e pronës. Në këto raste qasja e gjykatës bazohej 'në vlerën e tregut', e cila mund të negociohej në shitje si një datë e gabuar.¹⁰¹ Për të aplikuar këtë metodë vlerësimi gjykata kërkon dy kushte. Së pari, të tregojë se në përcaktimin e përshtatshmërisë së një akti të caktuar nga një shtet që kishte të bënte me çështje të tokës dhe pronës, çdo ndërhyrje në ushtrimin e këtyre të drejtave duhet të ngrejë një balancë të drejtë midis qëllimit që duhet arritur dhe natyrës së aktit. Pyetja kyç ishte nëse ndërhyrja do të merrte një balancë të drejtë, proporcionale midis të drejtave të viktimës dhe interesit të përgjithshëm.¹⁰² Së dyti, çdo pretendues për rikthim apo kompensim duhet të ketë të drejtën e një gjyqi të pavarur dhe të paanshëm që do të përcaktojë ankesat e tij në mënyrë të shpejtë dhe efektive. Ky udhëzim i Gjykatës Evropiane ndikoi në debatin kushtetues.

Gjykata Evropiane e Strasburgut ka trajtuar disa çështje mbi të drejtën e pronës që pretendohej se është cënuar në procesin e kthimit dhe kompensimit të subjekteve të shpronësuar gjatë regjimit monist në Shqipëri. Pretendimet e tyre kerkuesit i kanë mbështetur kryesisht në cënimin e nenit 1 të protokollit 1 të konventës.

Në fakt precedenti që ka ndjekur gjykata ka parashtruar në këtë aspekt, se konventa nuk mund të interpretohet si vendosje e detyrimit të përgjithshëm mbi shtetet kontraktuese, për të kthyer pronën e transferuar në favorin e tyre, para ratifikimit të konventës.¹⁰³ Nuk ekziston ndonjë detyrim i përgjithshëm, sipas konventës për krijimin e procedurave nëpërmjet të cilave mund të kërkohet kthimi i pronave. Megjithatë, kur një shtet kontraktues vendos të krijojë procedura ligjore të këtij lloji, ai nuk mund të përjashtohet nga detyrimi për të respektuar të gjitha garancitë përkatëse të parashikuara nga konventa, veçanërisht në nenin 6 § 1. Gjykata vëren se, legjislacioni shqiptar i kohës në fjalë, la në diskrecionin

¹⁰⁰ Papachelas v. Greece (1990) 30 EHRR 923, EctHR.

¹⁰¹ Shih Dinah Shelton (2000) Remedies in International Human Rights Law, Oxford Press, f. 24.

¹⁰² Centre on Housing Rights and Evictions -- COHRE (2002), Albania: Resolving the Question of Land and Property Restitution and Compensation, raport i përgatitur për Banka Botërore dhe OSBE, f. 13.

¹⁰³ Shih: Kopecky v. Slovakia [GC], No 44912/98, § 35 dhe von Maltzan and Others v. Germany (dec.) [GC], No 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74, ECHR 2005-V

e autoriteteve administrative përcaktimin e formës së përshtatshme të kompensimit, për ato raste, kur kthimi në natyrë i pronës ishte i pamundur.¹⁰⁴

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 sipas gjykatës nuk mund të interpretohet sikur vendos ndonjë detyrim të përgjithshëm mbi shtetet kontraktuese për të kthyer pasuritë e transferuara në favor të tyre, para se të ratifikonin konventën. Neni 1 i protokollit 1 nuk vendos kufizime as mbi lirinë e shteteve kontraktuese për të përcaktuar objektin e kthimit të pronës dhe për të përzgjedhur, se në çfarë kushtesh bien dakord t'u kthejnë të drejtat e pronës ish pronarëve.¹⁰⁵

Në veçanti, shtetet kontraktuese gëzojnë një shkallë të gjerë vlerësimi sa i takon përjashtimit të kategorive të caktuara të ish pronarëve nga kjo e drejtë. Kur kategoritë e pronarëve përjashtohen në këtë mënyrë, pretendimet e tyre për kthim nuk mund të shërbejnë si bazë për “*pritshmëri të ligjshme*”, që kërkon mbrojtjen e nenit 1 të protokollit Nr. 1.¹⁰⁶

Nga ana tjetër, kur një shtet kontraktues, që ka ratifikuar konventën, përfshi protokollin e parë shtesë, dekreton legjislacionin, që rregullon kthimin e plotë, ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar në regjimin e mëparshëm, ky legjislacion mund të konsiderohet si gjenerues i një të drejte të re pronësie, të mbrojtur nga neni 1 i protokollit 1 për personat që i plotësojnë kushtet për të fituar një të drejtë të tillë. E njëjta gjë mund të aplikohet në lidhje me rregullimet ligjore për kthimin ose kompensimin të parashikuara para ratifikimit, nëse ky legjislacion mbetet në fuqi, pas ratifikimit nga Shteti Kontraktues i Protokollit të Parë Shtesë.¹⁰⁷

Megjithëse gjykata ka interpretuar se sipas konventës nuk ekziston vendosje e detyrimit të përgjithshëm mbi shtetet kontraktuese, për të kthyer pronën e transferuar në favorin e tyre, para ratifikimit të konventës si dhe shkallën e gjerë të vlerësimit sa i takon përcaktimit të vlerës së kompensimit (për shtetet që e përcaktojnë më ligje të veçanta pas ratifikimit të konventës), autoritetet shqiptare në zbatimin e kushtetutës

¹⁰⁴ Vendimi “Beshiri etj kunder Shqiperise”, i datës 22-08-2006.

¹⁰⁵ Shih Jantner v. Slovakia, No 39050/97, § 34, 4 mars 2003.

¹⁰⁶ Shih, midis autoriteteve të tjera, Gratzinger and Gratzingerova

¹⁰⁷ Vendimi “Beshiri etj., kundër Shqipërisë”, i datës 22-08-2006 (tjetër shih Broniowski v. Poland [GC], 31443/96, §125, ECHR 2004-V)

(neni 41 dhe 181), si dhe ligjeve të dala dhe të ndryshuara në mënyrë të herpashershme për kthimin dhe kompensimin e pronës, kanë pasur mjaft difekte dhe shpesh herë nuk kanë siguruar mjete juridike të përshtatshme që të shpronësuarit të realizonin të drejtën e tyre kushtetuese, duke cënuar kështu edhe principet e Konventës:

Në çështjen “*Beshiri etj., Kundër Shqipërisë*”, sipas nenit 6 § 1 dhe 13 të konventës, ankuesit u ankuan edhe rreth neglizhencës së autoriteteve për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në vendimin e gjykatës së apelit, Tiranë të datës 11 prill 2001, në lidhje me çështjen e kompensimit. Ankuesit kundërshtuan efektivitetin e mjeteve juridike të referuara nga pala shqiptare. Ata argumentuan, se akti i ri i pronësisë nuk siguronte mjete juridike në kuptimin e konventës. Ata vërejtën më tej, se të drejtat e tyre të pronësisë ishin përcaktuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe, se një organ administrativ nuk mund të rishqyronte të njëjtën çështje. Së fundi, ata pohuan, se nëse gjykatat vendase do kishin urdhëruar kompensim në një nga format e parashikuara nga ligji, përmbuesit nuk do të kishin qenë në gjendje ta ekzekutonin atë vendim. Varet nga autoritetet shtetërore implementimi i masave efektive, qoftë nëpërmjet klasifikimit të pronave shtetërore, që do të përdoren për kompensim në natyrë, qoftë duke siguruar fonde të mjaftueshme buxhetore për kompensim financiar, me qëllim që kjo mënyrë ndreqeje të realizohet. Në përfundim, ankuesit i qëndruan mendimit, se pala shtetërore deri tani kishte neglizhuar marrjen e hapave efektive për të gjetur zgjidhje në lidhje me çështjen e kompensimit.

Gjykata në lidhje me pretendimet e ankuesve theksoi, se rregulli i shterimit të mjeteve juridike të brendshme, referuar Nenit 35 § 1 të konventës, detyron ankuesit të shterojnë mjetet juridike, që në sistemin ligjor vendas janë normalisht në dispozicion dhe të mjaftueshme për t'i mundësuar ata të sigurojnë rivendosjen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Mjetet juridike duhet të jenë mjaftueshmërisht të besueshme, si në praktikë dhe në teori. Pa këtë garanci, të cilën është përgjegjësi e shtetit ta sigurojë, këto mjete nuk do të mund të shterohen sipas nevojave dhe do të mbeten jo efektive.¹⁰⁸ Gjykata vlerësoi, se mjetet juridike të referuara nga pala shqiptare, ishin të pamjaftueshme për vënien

¹⁰⁸ (Shih Vernillo v. Francë, vendim i datës 20 shkurt 1991, Seria A, Nr. 198, f. 11-12, § 27; Aksoy v. Turqi, Nr. 21987/93, §§ 51-52, Reports 1996-VI; dhe Akdivar and Others v. Turqi, No 21893/93, §§ 65-67, Reports 1996-IV).

në vend të shkeljes së pretenduar. Në veçanti, për sa i përket argumentit të autoriteteve shtetërore në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të filluar procedimet e ekzekutimit, gjykata rithekson, se një personi, i cili pajiset me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund t'i kërkohej t'u drejtohet organeve përmbarimore për të ekzekutuar vendimin¹⁰⁹.

Për më tej gjykata u shpreh, se për sa i përket kundërshtimit në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të përdorur mjetet juridike të parashikuara në aktin e ri të pronësisë, gjykata vëren, se pala shqiptare nuk kishte paraqitur ndonjë fakt për të provuar efektivitetin e këtyre mjeteve. Autoritetet shqiptare nuk provuan, se Akti i ri mund të kishte ofruar në të vërtetë ndreqje për ankuesit dhe, se shteti mund të kishte plotësuar efektivisht detyrimin e tij për të paguar kompensim për pronën fillestare, konform vendimit të formës së prerë në favor të ankuesve.¹¹⁰

Precedentët me çështjet e tjera kundra Shqipërisë në lidhje me të drejtën e pronës para Gjykatës Evropiane:

Çështja “Qufaj Co”

Përveç sa përmendëm më sipër sa i takon çështjes “Beshiri etj., kundër Shqipërisë”, në Gjykatën Evropiane ka edhe precedentë të tjerë sa i takon dënimit që ka dhënë për Shqipërinë për çështje që kanë lidhje me të drejtën e pronës.

Rasti i parë, ku shteti shqiptar humb në gjykatën e Strasburgut, është ai i çështjes së njohur “*Qufaj Co*”. Me datë 9 qershor të vitit 1992, Bashkia e Tiranës i shiti shoqërisë “*Qufaj Co*” 788 metra katrorë tokë në një zonë banimi në Tiranë, ku firma mori lejen urbanistike për ndërtimin e 500 apartamenteve të banimit. Por më pas, bashkia nuk i dha lejen e ndërtimit. Kjo e detyroi firmën t'u drejtohet gjykatave duke kërkuar dëmshpërblimin dhe fitimin e munguar prej 60 milionë lekësh të rinj. Firma iu drejtua Gjykatës së Strasburgut, e cila pas shqyrtimit të çështjes më 30 mars të vitit 2005 vendosi që shteti shqiptar t'i paguajë firmës

¹⁰⁹ (shih *Cocchiarella v. Italy* {GC}, Nr. 64886/01, § 89, ECHR 2006; *Metaxas v. Greece*, Nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004; *Koltsov v. Russia*, No 41304/02, § 16, 24 shkurt 2005; dhe *Petrushko v. Russia*, No 36494/02, § 18, 24 shkurt 2005).

¹¹⁰ Vendimi “Beshiri etj., kundër Shqipërisë”, i datës 22-08-2006.

“Qufaj Co” dëmshpërblimin prej 60 milionë lekësh, 70 mijë euro dëm financiar dhe jo financiar dhe 2 mijë euro shpenzimet e gjykatës.

Çështja “Gjonboçari” kundër Shqipërisë

Gjykata evropiane ka dhënë 49 mijë euro dëmshpërblim moral për familjen Gjonboçari një familje, e cila ka pronat e saj në Vlorë dhe në Tiranë, ka fituar gjyqin me shtetin shqiptar për njohjen e pronësisë së tokës. Ankuesit janë shtatë vëllezër dhe motra të familjes Gjonboçari. Ata janë: Agron Gjonboçari, Midat Gjonboçari, Agim Gjonboçari, Gjon Gjonboçari, Hava Veizaj, Arben Gjonboçari dhe Gëzim Gjonboçari. Kanë lindur respektivisht në vitet 1939, 1927, 1934, 1931, 1924, 1949 dhe 1949. Janë shtetas shqiptarë dhe banojnë aktualisht në Tiranë dhe në Vlorë.

Çështja ka të bëjë me tri procedura, me anë të së cilave ankuesit kanë kërkuar kthimin e një toke që u përket prindërve të tyre dhe që është konfiskuar pa kompensim nga autoritetet nën regjimin komunist. Më 6 mars të vitit 2003, Gjykata e Lartë urdhëroi Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të shqyrtojë kërkesat për kthim dhe kompensim, që të marrë një vendim për pretendimet e ankuesve. Ky vendim i komisionit të kthimit të pronave nuk është marrë ende dhe sot e kësaj dite.

Mbi bazën e nenit 6, paragrafi 1 (e drejta për një proces të rregullt në një afat të arsyeshëm) dhe nenit 13 (e drejta për një apel të zbatueshëm) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pronarët janë ankuar në Gjykatën e Strasburgut për mosëkzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të 6 marsit 2003 dhe për kohëzgjatjen e tepruar të procedurës. Ata kanë evokuar gjithashtu nenin 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të marrë veç dhe të kombinuar me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të konventës dhe kanë fituar.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, seksioni i katërt i saj, i kryesuar nga gjyqtari Nicolas Bratza, i përbërë nga 7 gjyqtarë, përfshirë këtu dhe gjyqtarin shqiptar Kristaq Traja, i kanë dhënë të drejtë Gjonboçarit dhe të tjerëve dhe në mënyrë unanime kanë dënuar Shqipërinë për dhunim të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në kombinim për dhunim të nenit 13. Gjykata e Strasburgut, bazuar në nenin 44, paragrafi 2, u ka akorduar të shtatë

ankuesve nga 7000 euro secilit si dëmshpërblim moral (familja kishte kërkuar si dëmshpërblim moral shumë 2742774 euro). Me të njëjtin vendim, Gjykata e Strasburgut urdhëron Shqipërinë të zbatojë sa më parë vendimin e Gjykatës së Lartë të 6 marsit 2003, pra urdhëron shtetin shqiptar të marrë sa më parë një vendim për rastin Gjonboçari. Në të kundërt, Shqipëria do të penalizohet rëndë nga Komiteti i Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës.

Çështja "Driza"

Ankuesi R.Driza ka trashëguar nga babai i tij një truall prej 6000 metrash katrorë në qytetin e Tiranës, pronë e cila është sekuestruar nga shteti në vitin 1960. Me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në vitin 1996, ankuesit i është njohur e drejta e pronësisë për këtë pronë dhe kompensimi në një nga format e parashikuara nga ligji. Me vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë të vitit 1996, ankuesi është kompensuar në natyrë me dy sipërfaqe toke, respektivisht 1650m² dhe 3350 m², pronë të cilën ankuesi e ka regjistruar në favor të tij. Meqenëse toka e dhënë si kompensim ndodhej në zonën e ish ndërmarrjes bujqësore dhe si e tillë, një pjesë e saj ishte ndarë në favor të punonjësve ka filluar një proces gjyqësor, i cili është pasuar edhe nga një i dytë dhe pas disa vjet procesesh gjyqësore, në vitin 2002 ankuesit i është anuluar vendimi i komisionit, që i jepte atij kompensim në natyrë, duke vendosur që kompensimi të bëhej në forma të tjera. Driza është drejtuar në Gjykatën e Strasburgut duke pretenduar se i janë shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta e ankimit dhe e drejta e pronës. Në përfundim të shqyrtimit, dhoma prej 7 gjyqtarësh, në përbërje të Seksionit të Katërt të Gjykatës Evropiane ka pranuar pretendimet e ankuesit. *“Shteti shqiptar duhet t'i kthejë ankuesit një truall prej 1650 m² si dhe t'i paguajë një dëmshpërblim prej 50 000 euro. Në rast të pamundësisë për t'i kthyer truallin në natyrë, brenda gjashtë muajve nga data kur vendimi merr formë të prerë, shteti duhet t'i paguajë ankuesit një shumë prej 280 000 euro. Kurse për pjesën tjetër të truallit prej 3350 m² shteti duhet t'i paguajë ankuesit një shumë prej 500 000 eurosh brenda tre muajve nga data kur vendimi merr formë të prerë”*, ka vendosur Gjykata e Strasburgut.

Çështja Ramadhi

Nje proces tjetër është ai me ankues familjarët Ramadhi nga Kavaja. Ata janë pronarë të një toke, e cila pas shtetëzimit të saj nga regjimi komunist ishte përfshirë në ndërmarrjen bujqësore të Kavajës si dhe pronarë të dy dyqaneve, po në qytetin e Kavajës, të cilat edhe këto ishin shtetëzuar. Me vendim të Komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave, në vitin 1995 atyre iu njihet pronësia mbi dy dyqanet, por meqenëse ato ishin prishur dhe në vend të tyre ishin ndërtuar pallate, komisioni vendosi kompensimin e tyre për sipërfaqen e truallit të dyqaneve. Në vitin 1996, komisioni i bashkisë iu njeh ankuesve pronësinë për një pjesë të tokës prej 15.500 m² që përfshihej brenda qytetit, nga e cila u kthehet në natyrë 10 000 m², kurse për diferencën do të kompensoheshin. Kurse komisioni i ndarjes së tokës bujqësore, në vitin 1998 iu kthen ankuesve një pjesë të tokës nga 30 500 m² që pretendoheshin prej tyre. Sipas legjislacionit të kohës, toka e kthyer në natyrë u përkiste vetëm tre prej ankuesve që jetonin në të njëjtin vend ku ndodhej prona, duke përjashtuar tre ankuesit e tjerë që nuk jetonin aty. Disa muaj më vonë, komisioni ka anuluar vendimin që kishte dhënë më parë në favor të ankuesve, të cilët e kundërshtuan këtë vendim në gjykatë. Me vendim të formës së prerë në vitin 2000 është vendosur që ankuesve t’iu jepeshin përsëri aktet e marrjes së tokës në pronësi të anuluar më parë. Pas disa zvarritjeve, ky vendim gjyqësor është ekzekutuar në vitin 2003, por ankuesit kanë vazhduar të pretendojnë se ishin pronarë të më shumë se 30 000 m² tokë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Evropiane ka pranuar pretendimet e ankuesve. Sipas vendimit, shteti shqiptar duhet t’u kthejë ankuesve 30500 m² tokë bujqësore dhe t’u paguajë 25 000 euro dëmshpërblim. Në rast të pamundësisë së kthimit në natyrë të tokës brenda gjashtë muajve, t’u paguajë atyre 120 000 euro. Kurse për truallin e pakompensuar në qytet prej 5500 m², shteti duhet t’u paguajë ankuesve shumën prej 64 000 eurosh. Veç kësaj shteti duhet t’u paguajë ankuesve edhe 1676 euro për shpenzimet gjyqësore të bëra prej tyre.

Standardet e Konventes si kusht për procesin e integritimit evropian

Vargu i detyrimeve të Shqipërisë në procesin e integritimit,

parashikon më shumë sesa formulimet demagogjike dhe nganjëherë edhe shprehjet e njëanëshme të vullnetit për t'u përfshirë në strukturat Euroatlantike, kërkon reforma të thella, në të gjitha fushat. Një nga fushat më me rëndësi është edhe reforma në fushën e pronësisë mbi tokën, si krijimi i një tregu të qëndrueshëm të saj, respektimi i pronësisë së tokës, zgjidhja e çështjeve të pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist në dobi të pronarëve, etj. Në ceremoninë ku përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe të Shqipërisë firmosën Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, (hapi i parë i rëndësishëm drejt anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian,) Komisioneri për zgjerimin i BE-së, Olli Rehn, u shpreh: *“Këtëj e tutje, Shqipëria duhet të japë prova konkrete të zbatimit të Marrëveshjes, para se të merret në konsideratë çdo lloj hapi që do të bëhej në procesin e anëtarësimit”*. MSA-ja krijon kushtet për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore nga autoritetet shqiptare. Koncepti shqiptar i këtyre lirive dhe të drejtave, duhet të jetë i njëjtë me atë evropian¹¹¹.

Qeveria shqiptare në lidhje me kërkesat që vendos MSA dhe procesi i asociimit ka ndërmarrë disa iniciativa duke ndërtuar disa strategji dhe plane veprimi për të mundur zbatimin e këtyre kushteve që kërkon BE. Në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.634, datë 30.8.2004 *“Për miratimin e planit të veprimit në zbatim të përparësive të partneritetit evropian”*; VKM nr.317, datë 13.5.2005 *“Për miratimin e planit kombëtar të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimit të angazhimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit”*, VKM nr. 463 dt. 05-07-2006 *“Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”* qeveria, ndër të tjera, angazhohet për kryerjen e reformave në tregun e pasurive të paluajtshme, dhe përkatësisht 1. Reforma të tokës bujqësore, të tregut, mbrojtjes dhe administrimit të qëndrueshëm të saj. 2. Përshtetimi në ritmet e procesit të regjistrimit fillestar të pasurisë së paluajtshme, në zonat rurale dhe urbane, në një kohë sa më të shpejtë. 3. Një nga objektivat kryesore të qeverisë vlerësohet edhe përshtetimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës. 4. Si një prioritet më rëndësi vendoset edhe zbatimi i politikave shtetërore, për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.

¹¹¹ "Pasaporta e Stabilizim-Asociimit", botim i Qendrës Evropiane.

Në lidhje me pikën e parë, bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian, qeveria vendos si prioritete legislative afatshkurtëra dhe afatmesme si: ndryshimin e Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "*Për tokën*", i cili synon përfundimin e ndarjes së tokës (reformën) në gjysmën e parë të vitit 2008; ndryshime në Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 "*Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore*", që synojnë të konsolidojnë titujt e pronësisë në disa zona të veçanta të vendit; ndryshime në Ligjin Nr. 8312, datë 26.03.1998 "*Për tokat bujqësore të pandara*"; Miratimi i Udhëzimit të Ministrit "*Për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore dhe burimeve*"; Ndryshim në Ligjin nr. 8752, datë. 26.03.2001 "*Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit të tokës*". Gjithashtu, parashikohet edhe ngritja e disa organeve dhe agjencive të specializuara shtetërore që do të ndjekin këto reforma.

Në lidhje me pikën e dytë, prioritetet e qeverisë afatshkurtëra dhe afatmesme janë: Ndryshimi i ligjit Nr. 7843, datë 13.07.1994 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*"; përmirësimi i kapaciteteve administrative për regjistrimin fillestar nëpërmjet trajnimeve; zbatimi i strategjisë së IT nëpërmjet dixhitalizimit të hartave treguese të regjistrimit si dhe krijimi i standardeve; përfundimi i regjistrimit fillestar në 80 zona kadastrale me fondet e Bankës Botërore; si dhe disa ndryshime të tjera ligjore dhe ngritjeje të kapaciteteve institucionale.

Në lidhje me pikën e tretë, prioritetet e qeverisë janë shpallur: Përfundimi i hartës së vlerës së tokës; vazhdimi i procesit të kompensimit të pronave në zonat rurale dhe urbane; forcimi i mirëfunksionimit të komisioneve lokale të kthimit/kompensimit të pronave të ngritura tashmë nëpër rrethe.

Për pikën e katërt si prioritet vlerësohen nxjerrja e akteve nënligjorë për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që nevojitet për realizimin e legalizimeve, përcaktimi i koficientëve të shfrytëzimit të banesave, si dhe disa aspekte të karakterit institucional.

Respektimi i të drejtës së pronës dhe kryerja e reformave që do çojnë në një treg të qëndrueshëm të tokës përbëjnë kusht përcaktues për zbatimin e kushteve që vendos MSA dhe vetë procesi i integritetit evropian në përgjithësi për vazhdimin e marrëdhënies së asociimit.

Reforma e tokës dhe pronës nuk ka qenë subjekt i një dokumenti të veçantë gjithpërfshirës. Gjithsesi, elementët kryesorë të reformës së

tokës përfundimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, kalimi te ligji civil dhe marrëdhëniet e tregut, menaxhimi i tokave dhe pronave shtetërore, përdorimi në favor të ambientit i resurseve të tokës gjenden në pjesë të ndryshme të dokumentacionit të çështjeve të lidhura me njëra-tjetrën.

BIBLIOGRAFI:

1. “Për një rend të ri evropian”, *vendime të zgjedhura nga të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut*, botim i Këshillit të Evropës dhe QSHDNJ-së, Tiranë, 2001.
2. Marek Antoni Nowicki, “Rreth Konventës Evropiane, Komentar”, 2003
3. Dr. Avni Shehu, “Pronësia”, Tiranë, 2000.
4. Prof.dr. Paskal Haxhi, “Regjimi juridik i tokës në Shqipëri”, Tiranë, 1998
5. Monica Carss-Firsk, “E drejta e pronës - udhëzues”.
6. “Kthimi dhe kompensimi i pronave, subjekteve të shpronësuara në praktikën e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare”, botim i USAID dhe OSBE në Shqipëri, Tiranë, 2006.
7. “Shqipëria heqja e pengesave administrative për investimet, pjesë e pandashme e strategjisë së zhvillimit”, botim: Shërbimi Këshillimor i Investimeve të Huaja, Mars, 2003.
8. “Statusi i Reformës së Tokës dhe i Tregut të Pronave të Paluajtshme në Shqipëri”, botim: Zyra e Bankës Botërore në Shqipëri, Tiranë, 2006.
9. Centre on Housing Rights and Evictions - COHRE (2002), Albania: Resolving the Question of Land and Property Restitution and Compensation, raport i përgatitur për Bankën Botërore dhe OSBE.
10. "Pasaporta e Stabilizim-Asociimit", botim i Qendrës Evropiane, Tiranë, 2007.

Sistemi zgjedhor në Shqipëri - arritjet dhe sfidat e së ardhmes

Vera Shtjefni

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë,

The electoral system in Albania: achievements and future challenges

ABSTRACT

Even after one year and a half from the end of the parliamentary elections, the debate relating to the electoral issues, still goes on. Beyond the political action of the electoral subjects, some issues related to the functioning of the electoral system in Albania and the need for further improvements, constitute the most solid and rational part of the political and institutional debate and of the debate of experts and researchers in this field. In this regard, the adoption of the best practices is directly related to the progress of the country and to very important processes of European integration, with direct impact on the lives of all citizens. More than the exercise of a constitutional right, denied for more than half a century, the right to vote is estimated by the Albanian citizens not only as a mechanism of selection and control of citizens on their representatives but, above all, as the embracement of the best political and governance alternatives that further improve their present and future.

Hyrje

Edhe pse kanë kaluar shumë muaj nga përfundimi i zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare dhe po i afrohem datës së caktuar për

zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, debati lidhur me çështjet zgjedhore vazhdon ende. Duke lënë mënjanë përdorimin e kësaj tematike nga subjektet politike në aksionet e tyre politike, disa çështje që lidhen me funksionimin e sistemit zgjedhor në Shqipëri, evolucionin e tij dhe sidomos problemet që janë ndeshur dhe nevojat për përmirësimin e mëtejshëm do të përbënin pjesën më të shëndoshë dhe racionale jo vetëm për aktorët politikë dhe institucionalë por edhe për studiuesit e kësaj fushe tepër të rëndësishme të së drejtës. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe adoptimi i praktikave më të mira në këtë drejtim lidhet drejtpërdrejt me progresin e vendit dhe me procese tepër të rëndësishme të integritimit evropian, me impakt të drejtpërdrejtë në jetën e të gjithë qytetarëve. Më shumë se ushtrim i një të drejte kushtetuese, të mohuar për më shumë se gjysmë shekulli, e drejta e votës po shihet përditë e më shumë nga qytetarët shqiptarë jo vetëm si mekanizmi i përzgjedhjes dhe kontrollit të qytetarëve mbi përfaqësuesit e tyre, por mbi të gjitha si përfaqim i alternativave politike dhe qeverisëse më të mira që përmirësojnë më tej të sotmen dhe të ardhmen e tyre.

E drejta e votës dhe sistemi zgjedhor

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës duke u siguruar shtetasve qenien e tyre politikisht aktive duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik. E drejta e votës është një element qendror i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike.

Me zgjedhje, në kuptimin juridik, nënkuptojmë tërësinë e rregullave formale-juridike dhe procedurale, me të cilat përcaktohet mënyra e zgjedhjes dhe e konstituimit të organeve përfaqësuese, sipas në një rendi kushtetues të caktuar. Rregullat procedurale në zgjedhje parlamentare, të organeve të qeverisjes vendore apo referendumeve, rregullojnë procedurën e zgjedhjes së deputetëve, të zgjedhurve të

organeve të qeverisjes vendore apo alternativave referendare duke filluar që nga faza e kandidimit, e deri në zgjedhjet e tyre në funksione parlamentare. Këto rregulla përcaktohen me ligje zgjedhore. Sipas Dieter Nohlen të zgjedhësh do të thotë “*në një kuptim ontologjik... të mund të përzgjedhësh lirisht në mes të më shumë ose së paku dy ofertave (kandidatëve/partive)*”¹¹²

Pyetja shekullore që është bërë vazhdimisht lidhet me faktin nëse ekziston një sistem zgjedhor perfekt apo ideal, i cili do të mund të përmbante njëkohësisht të gjitha vlerat e sistemeve elektorale? Deri tani nuk ekziston një sistem zgjedhor i tillë. Të gjitha sistemet elektorale kanë përparësitë dhe mangësitë e tyre, (O’Neil, 1993; MacIvor, 1999).

Do të ishte e pamundur të gjendej një sistem zgjedhor që të mund të harmonizonte *paanshmërinë, përfaqësueshmërinë, barazinë, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe legjitimitetin*, sepse disa prej këtyre parimeve pothuajse përjashtojnë njëri-tjetrin. Megjithëse nuk është e mundur që të arrihet një sistem zgjedhor përfekt ai mund të reformohet dhe të përmirësohet¹¹³.

Gjatë historisë së zhvillimit të shoqërive dhe shteteve janë njohur shumë sisteme zgjedhore. Shumë prej tyre kanë evoluar dhe falë komunikimit dhe përshtatjes kanë adoptuar elemente të njëri-tjetrit, në funksion të përshtatjes me realitetin e vendit dhe të arritjes së objektivave. Asnjë sistem zgjedhor nuk zbatohet apo prodhon pasoja në vakum, por në varësi të një konteksti të caktuar shoqëror dhe politik. Çdo sistem teorikisht zgjidhet në raport me një synim të caktuar, për të arritur një objektiv të caktuar politik, që gjithmonë realizohet në kurriz të një objektivit tjetër¹¹⁴. Secili sistem zgjedhor ka anët e tij pozitive dhe negative. Çdo vend ka specifikën dhe kontekstin e tij dhe në këtë kuadër

¹¹² Nohlen, Dieter (1995), f. 846

¹¹³ Në dekadën e fundit çështja e reformës zgjedhore është ndezur dhe ka qenë objekt i debateve shumë serioze edhe në vendet perëndimore, si në Mbretërinë e Bashkuar, SH.B.A dhe Zelandën e Re. Këto vende kanë përjetuar një interes gjithnjë në rritje për reformimin e sistemit elektorale ekzistues, interes që është nxitur nga presioni dhe shqetësimi gjithnjë në rritje mbi përfaqësimin social (të grave dhe të minoriteteve) në organet e zgjedhura, si dhe pjesëmarrjen elektorale të zgjedhësve, (Norris, 1997).

¹¹⁴ Blendi Kajsii: Problematika e sistemit proporcional në raport me realitetin shqiptar Konferenca shkencore “Sistemi zgjedhor në kontekstin shqiptar” http://ëëë.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/DemocracyAndInstitutionBuilding/Prog_Election.html

eksperienca e një shteti me një sistem elektoral të caktuar nuk mund të aplikohet në mënyrë identike nga një shtet tjetër, (MacIvor, 1999).

- Zhvillime dhe problematika zgjedhore në Shqipëri para reformës kushtetuese dhe ligjore të vitit 2008

Sistemi i zgjedhjeve i sanksionuar në Republikën e Shqipërisë pas viteve '90 i përket familjes së sistemeve elektorale të përziera ose mikse, ku një pjesë e parlamentit zgjidhet me sistem mazhoritar dhe pjesa tjetër me sistem proporcional. Arsyeja e vendosjes së këtij sistemi elektoral në vendin tonë, ashtu si në shumë demokraci të reja të Evropës Lindore është e lidhur me faktin se sistemi miks tenton të kombinojë njëherazi avantazhet dhe veçoritë pozitive të sistemit proporcional dhe atij mazhoritar.

Zgjedhjet e para pluraliste u zhvilluan me 31 mars 1991, mbi bazën e një sistemi mazhoritar¹¹⁵, i ndarë në 250 zona zgjedhore. Ndërsa, nga viti 1992 deri në vitin 2000 ka qenë 'Sistem Paralel', që do të thotë se dy formulat elektorale për dy tipat e votimit, proporcional dhe mazhoritar ishin të shkëputura dhe vepronin në paralel me njëra-tjetrën. Me reformën e vitit 2000 adoptohet varianti tjetër 'proporcional me mandate të përziera' që do të thotë se, se pari, dy rezultatet e votimit nuk janë të shkëputura, por janë të ndërlidhura duke qenë se shpërndarja e 40 mandateve plotësuese për pjesën e proporcionalit varet nga numri i mandateve njëemërore të fituara nga kandidatët e çdo partie dhe/ose koalicioni në pjesën e mazhoritarit, dhe së dyti, shpërndarja e 40 mandateve plotësuese "kompenson" disproporcionalitetin e krijuar nga

¹¹⁵ Quhet i zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor, kandidati që në turin e parë ka fituar më tepër se gjysmën e gjitha votave të hedhura në zonën e zgjedhjeve (shumicën absolute) dhe të njohura të vlefshme. Kur në zonën e zgjedhjeve janë regjistruar dy ose më shumë kandidatë dhe asnjëri prej tyre nuk ka marrë në turin e parë shumicën absolute të votave, komisioni i zgjedhjeve e shënon këtë në procesverbal dhe njëkohësisht urdhëron zhvillimin e zgjedhjeve në turin e dytë jo më vonë se një javë nga votimi i parë. Kur në listë janë vënë më tepër se dy kandidatë, në turin e dytë do të votohet për dy kandidatët që kanë marrë më tepër vota, ndërsa, kur në listë kanë qenë vetëm dy kandidatë, kalojnë që të dy në turin e dytë. Në të dy rastet, për të kaluar në turin e dytë kërkohet që kandidati të ketë marrë më tepër se 5 për qind të votave të vlefshme të hedhura në kutinë e votimit. Në përfundim të votimit të dytë zgjidhet kandidati që ka marrë më shumë vota se kandidati tjetër (shumicën relative) dhe të njohura të vlefshme. (Nent 64-66, Liji nr. 7423, datë 13.11.1990 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor")

pjesa e votimit mazhoritar. Pra, ky variant është më shumë i orientuar drejt rezultateve proporcionale sesa varianti tjetër ‘sistem paralel’.

Objektivi i sistemit zgjedhor i adoptuar me reformat zgjedhore të vitit 2000 dhe 2003, pasuar me ndryshimet në vitet 2004 e 2005 ishte për të prodhuar njëkohësisht qeverisje dhe përfaqësim, dy objektiva që shpesh janë në kundërshtim me njëra – tjetrën¹¹⁶. Nëpërmjet alternimit të elementit mazhoritar me atë proporcional synohej të merreshin dy anët më pozitive të secilit sistem, nga mazhoritari qeverisjen dhe nga proporcionali përfaqësimin. Kufizimi i elementit mazhoritar nëpërmjet elementit proporcional bëhej që në parlament të mos krijoheshin mazhoranca tepër të mëdha.

Mangësitë e sistemit tonë zgjedhor përpara miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 konsistonin së pari, në mangësi që vetë sistemi zgjedhor miks ka në vetëvete (pavarësisht vendit përkatës që e ka adoptuar këtë sistem), dhe së dyti, mangësi dhe probleme specifike që konteksti i veçantë i sistemit elektoral shqiptar paraqet. Ishte një sistem elektoral mjaft kompleks, i cili mund të ngatërrojë zgjedhësit mbi natyrën dhe mënyrën e funksionimit të sistemit elektoral, (Navrat, 2003; IDEA, 2005). Konteksti i sistemit elektoral miks i adoptuar nga Shqipëria, përveç mangësive që sistemi zgjedhor miks mbart në vetvete, shfaq edhe disa mangësi të tjera, të cilat u reflektuan në pasoja jo të vogla. Ky sistem lejoi që të anashkalohet objektivi kushtetues i proporcionalitetit në përbërjen e kuvendit, (parashikuar nga neni 64/2 i kushtetutës). Falë këtij sistemi partitë politike apo koalicionet zbatuan strategji dhe metoda të ndryshme (votim strategjik) në zgjedhjet parlamentare, të cilat rriten në maksimum fitimet zgjedhore duke shtrembëruar shpërndarjen e mandateve plotësuese në favor të tyre, duke sjellë një paqymir joreal të vullnetit të zgjedhësve.

- Reforma zgjedhore kushtetuese e ligjore e vitit 2008. Aplikimi i sistemit zgjedhor proporcional rajonal

Në një kontekst të tillë mjaft problematik të zbatimit të sistemit zgjedhor u konsiderua e domosdoshme reformimi i sistemit zgjedhor ekzistues. Partitë kryesore politike në Shqipëri ranë dakord për të filluar

¹¹⁶ Blendi Kajsii: Problematika e sistemit proporcional në raport me realitetin shqiptar Konferenca shkencore “Sistemi zgjedhor në kontekstin shqiptar” http://ëëëfes.org.al/ProjectsAndPartners/DemocracyAndInstitutionBuilding/Prog_Election.html

një reformë kushtetuese e institucionale me qëllimin për të përmbushur standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Përvoja e zgjedhjeve të kaluara dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare shërbyen si pikënisje e diskutimit të ideve të para mbi këtë reformë.

Pas diskutimesh dhe debatesh të frytshme u arrit në një konsensus të gjerë ndërmjet mazhorancës dhe opozitës parlamentare për të ndryshuar sistemin zgjedhor në Shqipëri.

Përzgjedhja e një sistemi të tillë do të kërkonte domosdoshmërisht atë sistem që ishte më i përshtatshëm për Shqipërinë dhe që mundësonte një perspektivë të sigurtë të zhvillimit demokratik të vendit. Kjo do të thonte që sistemi të kishte legjitimitet dhe të gëzonte besimin e aktorëve kryesorë politikë për të marrë pjesë në zgjedhje dhe angazhuar në aspekte të ndryshme të proceseve demokratike. Një sistem i tillë duhej të kontribuonte në ndërtimin e qeverisjes së mirë e të qëndrueshme për të ideuar e zbatuar programet dhe planet e tyre të veprimit në funksion të plotësisht të nevojave, interesave dhe qëllimeve të qytetarëve si dhe në formësimin e një parlamenti që krijon një qeveri të qëndrueshme e funksionale, e një opozitë alternative. Sistemi duhej të ishte i thjeshtë për votuesit, sa më funksional për kohëzgjatjen e zgjedhjeve e nxjerrjen e rezultateve si dhe me një kosto të arsyeshme financiare. Pas shumë debatesh dhe diskutimesh brenda partive politike, ndërmjet partive, u propozua sistemi zgjedhor proporcional rajonal i ngjashëm me sistemin zgjedhor spanjoll.

Kjo reformë kushtetuese do të përfundonte me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë me një shumicë prej më se 85% të votave të deputetëve me datën 21 prill 2008 të ligjit nr. 9904 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

Sipas këtyre ndryshimeve kushtetuese përcaktohej se kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëmemërore. Zona zgjedhore shumëmemërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor proporcional, për caktimin e zonave zgjedhore dhe për numrin e

mandateve për secilën zonë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet¹¹⁷.

Zgjedhjet për kuvendin e ri zhvillohen në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin datës së përfundimit të mandatit të kuvendit. Periudhat zgjedhore dhe rregullat për thirrjen e zgjedhjeve për kuvendin përcaktohen në ligjin për zgjedhjet¹¹⁸

Në seancën plenare të datës 29.12.2008, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10 019 “ Kodi Zgjedhor i republikës së Shqipërisë”.

Sistemi zgjedhor i përcaktuar nga kushtetuta dhe kodi zgjedhor, mundësonte një votim mjaft të thjeshtë. Votuesi voton vetëm për partinë në mënyrën më të thjeshtë të mundshme përmes një flete të vetme votimi. Ky sistem ofron një votim i cili nuk është i kushtueshëm e i tensionuar dhe zgjat vetëm një raund. Sistemi propocional rajonal i vendos në një balancë të drejtë të gjithë partitë politike. Një sistem i tillë garanton përfaqësim të arsyeshëm dhe qeverisje të qëndrueshme. Përfaqësimi është gjithnjë në konkurrim me kriterin e sigurimit të qeverisjes së qëndrueshme duke garantuar një balancë të drejtë midis përfaqësimit të arsyeshëm dhe qeverisjes së qëndrueshme.

Ndryshe nga sistemi mazhoritar ky sistem nuk eliminon partitë e vogla, nuk krijon sistem bipartiak, përkundrazi konsolidon sistemin politik. Ky sistem ndryshe nga sistemi i mëparshëm, nuk ndan favore paraelektorale të pamërituara për partitë me peshë shumë të vogël elektorale, të cilat keqpërdorohen pas zgjedhjeve, përgjatë legjislaturës. Ai natyrshëm zvogëlon numrin e partive që përfaqësohen në parlament duke mundësuar përfaqësimin vetëm të atyre partive që kanë marrë numrin e nevojshëm të votave. Ky sistem favorizon bashkimet dhe polet, në krahët e spektrit politik.

Sistemi zgjedhor propocional rajonal eliminon votimin strategjik deformues (fenomenin e Dushkut). Duke votuar vetëm një herë, vetëm për partinë, nuk mund të ndodhë që vota e zgjedhësit të ndahet. Dukuria e “Dushkut”, e cila bazohet në mundësinë e ndarjes së votës për partinë nga vota për kandidatin, eliminohet plotësisht.

Kodi zgjedhor i vitit 2008 përfshin eksperiencat më të mira të traditës legjislative të kodeve paraardhëse si dhe rekomandimet e

¹¹⁷ Neni 64, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008

¹¹⁸ Neni 65, pika 2 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008

institucioneve ndërkombëtare të specializuara. Ai sjell disa risi të cilat diktoheshin në radhë të parë nga sistemi i ri zgjedhori rregulluar nga Kushtetuta e Shqipërisë. Disa prej tyre nga më të rëndësishmet mund të rendisim si më poshtë: Përcaktimi i periudhës zgjedhore¹¹⁹, caktimi i datës së zgjedhjeve¹²⁰, organizimi dhe funksionimi i KQZ, miratimi i akteve të KQZ, lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive, kuota 30% për secilën gjini etj.

Ndarja e mandateve zë një pjesë tërëndësishme në kodin zgjedhor. Në këtë pjesë është e fiksuar formula e ndarjes së mandateve midis subjekteve zgjedhore, por edhe brenda vetë subjekteve që janë në një kualicion zgjedhor¹²¹.

kushtetuta dhe kodi zgjedhor parashikojnë lista të mbyllura për

¹¹⁹ Zgjedhjet e përgjithshme për kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor. Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 9 të këtij kodi. (Neni 8)

¹²⁰ Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve për kuvendin jo më vonë se 9 muaj para mbarimit të mandatit të kuvendit. Me vendim të kuvendit, mbyllja e legjislaturës ose shpërndarja e tij bëhen jo më shpejt se 45 ditë para datës së caktuar për zgjedhjet dhe jo më vonë se 30 ditë para kësaj date, (neni 9, pika 2)

¹²¹KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Për zgjedhjet për kuvendin, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike që konkurrojnë më vete dhe që kanë marrë më pak se 3 për qind dhe koalicionet që kanë marrë më pak se 5 për qind të votave të vlefshme në zonën zgjedhore përkatëse. Numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse. Hapi nga njëri pjesëtues tek tjetri është 1. Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit për subjektet zgjedhore KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit në çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që secila parti pjesëtare e koalicionit ka marrë në zonën zgjedhore përkatëse dhe numrit të mandateve që koalicioni ka fituar në zonën zgjedhore përkatëse. Numri i votave të vlefshme të secilës parti pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë **tek** të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse. Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt. (Për me shumë shih nenet 162 dhe 163 të kodit zgjedhor).

kandidatët e subjeteve zgjedhore dhe pamundësinë e ndryshimit të renditjes në to.

Efektet që solli sistemi zgjedhor proporcional rajonal

Pas përfundimit të zgjedhjeve në Shqipëri, në të cilat si në çdo vend të botës, ka fitues dhe të humbur, debati mbi pritshmërinë nga sistemi zgjedhor janë në fazat e para. Megjithatë vlerësimet e kryera nga institucionet ndërkombëtare janë pozitive përsa i përkët funksionimit të sistemit zgjedhor.

Sipas raportit përfundimtar të OSBE/ODHIR “Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009 shënuan përparim të prekshëm përsa i përkët procesit të regjistrimit dhe identifikimit të votuesve, kornizës ligjore të miratuar në mënyrë konsensuale nga dy partitë kryesore, votimit, numërimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore”¹²². Elementët e sipërcituara ishin pjesë e kuadrit ligjor dhe mekanizmave të sistemit zgjedhor të parashikuar në kushtetutë dhe në kodin zgjedhor. Listat e votuesve dhe dokumentet e tyre të identifikimit përmbushën standardet më të larta¹²³. Përgatitja e infrastrukturës zgjedhore dhe e procesit zgjedhor, klima e qetë ditën e zgjedhjeve si dhe përdorimi i teknologjisë mjaft të lartë në numërimin e votave shënuan progresin më të madh të njohur ndonjëherë. Megjithatë ajo që nuk funksionoi ishte “*politizimi i aspekteve teknike të procesit, duke përfshirë ato gjatë numërimit dhe tabulacionit të votave, të cilat përkohësisht e bllokuan procesin në disa zona. Këto veprime të partive politike e minuan besimin e publikut në procesin e zgjedhjeve*”¹²⁴.

Një gjë e tillë ishte rrjedhojë e ndërtimit të administratës zgjedhore me përfaqësues të partive politike dhe jo me persona të depolitizuar të zgjedhur në rrugë administrative. Një problematike e tillë ka ardhur edhe si rezultat i keqpërdorimit nga ana e partive politike të mundësisë që

¹²² Raporti përfundimtar i zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, ODIHR për zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, I publikuar me 14 shtator 2009.

¹²³ “Për herë të parë, listat e votuesve u nxorën nga regjistri i kompjuterizuar i gjendjes civile. Nga raporti i vëzhguesve del se cilësia e listave të zgjedhësve u përmirësua ndjeshëm krahasuar me vitin 2005 (raporti i OSBE/ODHIR).

¹²⁴ Po aty.

lejon kodi zgjedhor për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta, pa qenë të detyruara të arsyetojnë zëvendësime të tilla. Instalimi i teknologjisë së lartë që do të monitoronte gjithë procesin e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve në të 66 vendnumërimet e përqendruara, megjithëse një isi shumë e rëndësishme që u aplikua, duket sikur vetëm pjesërisht arriti qëllimin për forcimin e besimit dhe të transparencës gjatë këtij procesi. Pavarësisht nga kjo në asnjë rast nuk ka pasur asnjë fakt apo të dhënë për manipulime të rezultatit.

Në analizat e para që janë bërë rezulton se edhe sistemi zgjedhor propocional rajonal shfaq efektet e tij të njohura në disa pika sikurse nuk dha efektet e pritshme në disa pika të tjera.

Në këtë sistem votimi rezultoi të ishte i thjeshtë për qytetarët. Numri i votave të pavlefshme rezultoi të ishte disa herë më i vogël se në zgjedhjet paraardhëse. Shumë më pak zgjedhës patën nevojë të ndihmoheshin për të votuar në qendrën e votimit. Përdorimi i një flete të votimit rriti mundësinë që zgjedhësit të votimin për subjektin zgjedhor që dëshironin.

Pati një rënie të konsiderueshme të numrit të ankimeve paszgjedhore të paraqitura në KQZ (vetëm 34)¹²⁵ në krahasim me zgjedhjet e mëparshme, ku ky numër ishte 281 ankesa¹²⁶.

Subjektet zgjedhore që morën pjesë në zgjedhje me këtë sistem përzgjedhën taktikën elektorale të hyjres në koalicionet parazgjedhore. Ky sistem solli për herë të parë vlerësimin real të peshës së tyre në mbështetje që kanë tek zgjedhësit. Nga 36 parti politike që hynë në zgjedhje vetëm 6 prej tyre mundën të fitojnë vende në parlament¹²⁷. Nga këto tre prej tyre mundën të marrin vetëm nga një deputet¹²⁸. Një polarizim i tillë i spektrit politik parlamentar në një sistem bipartiak nuk është i zakonshëm për një sistem propocional, por që gjykohet se kjo erdhi nga fakti se ky ishte një sistem rajonal. Në këtë kuadër pati pretendime nga parti të vogla se u ndëshkuan nga sistemi rajonal megjithëse numri i votave që kanë marrë në shkallë kombëtare nuk i afrohet as 3% (një pragu të mundshëm në një sistem propocional kombëtar). Ky sistem eliminoi

¹²⁵ Raporti i komisionit qendror të zgjedhjeve. Zgjedhjet për kuvend të vitit 2009.

¹²⁶ Raporti i komisionit qendror të zgjedhjeve. Zgjedhjet për kuvendin e vitit 2005.

¹²⁷ PD 68 deputetë, PS 65 deputetë LSI 4 deputetë PR, PBDNJ dhe PDI nga 1 deputet

¹²⁸ Partia republikane. partia e të drejtave të njeriut dhe partia për drejtësi dhe integritet.

partitë ekstra të vogla, por mundësoi që parti të vogla të mbeten të përfaqësuara në parlament.

Ky sistem propocional pritej të garantonte përfaqësim të arsyeshëm dhe qeverisje të qëndrueshme. Nga rezultatet e zgjedhjeve kualicioni fitues nuk arriti të siguronte numrat e nevojshëm në parlament për të qeverisur i vetëm. Nga 71 vendet minimalisht të nevojshëm, ai mori vetëm 70 ose 50% të vendeve në parlament.

Pritshmëria për një rritje të madhe të pjesëmarrjes së grave në parlament ishte e madhe dhe kjo falë sistemit të përzgjedhur. Megjithë faktin që numri i deputeteve femra që u zgjodhën u shumëfishua (në 2005 në kuvend kishte vetëm 10 gra deputete në krahasim me 23 deputete në 2009) përsëri nuk u arrit që ato të përbënin 30% të anëtarëve të parlamentit. Kjo ishte e pritshme pasi ndonëse kodi zgjedhor kishte dispozita që synonin të garantonin një qëllim të tillë, ai u jepte mundësi partive politike ta shmangnin këtë detyrim për shkak të paqartësisë në formulimin e dispozitës¹²⁹.

Sistemi i ri shmangu kontestimet në lidhje me madhësinë e zonave zgjedhore. Në përcaktimin e tyre dhe ndarjen e numrit të deputetëve për çdo zonë u përdor një koeficient unik që lidhej me numrin e shtetasve të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.

Përfundime dhe rekomandime

Në vitin 2009, pas një reforme të thellë kushtetuese e ligjore aplikohet për herë të parë sistemi zgjedhor propocional rajonal.

Në këtë reformë zgjedhore u mbajtën parasysh elementë të tillë si familja dhe varianti (tipi) i sistemit elektoral, madhësia e zonës zgjedhore, roli përkatës i partive dhe i kandidatëve, forma e fletës së votimit, mekanizmat e regjistrimit elektoral etj.

¹²⁹ Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t'i përkasë secilës gjini. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore një në çdo tre emra në listë duhet t'i përkasë secilës gjini. 6. Mospërmbushja e njërit prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumëmemërore për zgjedhjet në kuvend, sjell si rrjedhojë refuzimin e listës nga KQZ-ja. Mosrespektimi i kushtit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, ndëshkohet sipas nenit 175 të këtij kodi. (neni 67, pika 5 dhe 6)

Pavarësisht se jo të gjithë faktorët politikë e pranuan një sistem të tillë ai gëzoi konsensusin më të gjerë dhe në vetvete ishte i drejtë, pasi iu jep atyre, të njëjtën mundësi për sukses elektoral.

Sfidat që dalin pas aplikimit për herë të parë të këtij sistemi zgjedhor qëndrojnë në përmirësimin dhe ndryshimin e mëtejshëm të disa neneve të kodit zgjedhor që kanë të bëjnë me disa aspekte ku ndër më të rëndësishmit mund të jenë:

Përshpejtimi i procesit të numërimit të votave me qëllim nxjerrjen e rezultateve në afatin e parashikuar në ligj. Ky synim do të arrihej përmes rritjes së numrit të vendnumërimit të votave nga 66 që parashikon ligji zgjedhor aktual në 100 vendnumërime të tilla, si dhe rritja e numrit të grupeve të numërimit.

Kodi zgjedhor (KZ) duhet të specifikojë saktë se si duhet të veprojnë grupet e numërimit dhe KZAZ-të përkatëse me kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore që janë konsideruar të rregullta në momentin e marrjes në dorëzim, por që më vonë kanë rezultuar me probleme ose parregullsi të rënda. Gjithashtu kodi zgjedhor duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të plotë, se në cilat raste një kuti votimi nuk duhet të përfshihet në rezultat, edhe pse kur është marrë në dorëzim është përcaktuar si e rregullt. Mungesa e përcaktimit të kushteve të tilla si dhe e një procedure konkrete për mënyrën e trajtimit të tyre ka sjellë qëndrime të ndryshme dhe vonesa në procesin e numërimit e për pasojë edhe vonesa në nxjerrjen e rezultateve.

Po kështu, në funksion të këtij qëllimi, në ligj duhet të parashikohen mekanizma të efektshëm në plotësimin e vendeve vakante në administratën zgjedhore. Një gjë e tillë kërkon ndryshimin e nenit 29, pika 7 të KZ, duke ndryshuar afatin kohor për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ, nga 15 ditë në 5 dite dhe gjatë periudhës zgjedhore kjo vakancë të plotësohet brenda dy diteve. Në vijim të sa më sipër mendoj se, në nenin 32 të KZ duhet ndërhyrë për të shmangur të drejten e partive politike për të zëvendësuar komisionerët në çdo moment dhe pa asnjë shkak ligjor. Një gjë e tillë ka ndikuar negativisht në administrimin e procesit, pasi komisionerët e larguar kanë qenë të trajnuar dhe zëvendësimi i tyre me komisionerë të patrajnuar ka sjellë pengesa dhe vonesa në proces.

Respektimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit: kodi zgjedhor në nenin 67 të tij, i njeh kryetarëve të partive politike të drejtën

për të kandiduar në disa zona zgjedhore, gjë që sipas kësaj dispozite është e ndaluar për kandidatët e tjerë. Një e drejtë e tillë përbën shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit e për pasojë duhet të hiqet.

Po kështu mendoj se duhen rishikuar dispozitat e KZ, të cilat kufizojnë të drejtën e zgjedhësve për të mbështetur më shumë se një parti apo kandidat. Qytetarëve duhet t'u ofrohet mundësia që të mund të mbështesin për të marrë pjesë në zgjedhje çdo parti apo person. Një kufizim i tillë në zgjedhjet për kuvendin të vitit 2009, për partitë që nuk kishin deputetë e bëri të vështirë regjistrimin e listave shumëmemërore.

Për të mos krijuar probleme në përgatitjen e logjistikës zgjedhore mendoj se afatet për përgatitjen e listave të zgjedhësve duhet të ndryshohen. Lista përfundimtare duhet të miratohet jo më vonë se 35 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e zgjedhjeve të jenë dërguar në KQZ.

Saktësimi në mënyrë të qartë dhe eksplicite në dispozitën e KZ që parashikon kuotën gjinore në listat e kandidatëve. Kjo do të bënte të mundur që të plotësohej standardi prej 30% i kërkuar në ligjin për barazinë gjinore në shoqëri, por dhe për të mbyllur çdo hapësirë që u lejon partive politike të shmangin qëllimin e vetë ligjit. Në praktikë partitë politike nisur nga kriteri i dispozitës *“në çdo zonë zgjedhore, të paktën 30% e listës shumëmemërore dhe/ose një në tre emrat e parë në listën shumëmemërore duhet t'i përkasë secilës gjini”* depozituan lista shumëmemërore me numër më të madh sesa numri i mandateve për atë zonë zgjedhore, duke përfshirë në emrat e fundit gjininë në minorancë. Në këto kushte plotësohej kriteri i 30% -it, por nga ana tjetër shmangej qëllimi i ligjit. Për të garantuar një qëllim të tillë, duhet që të dy kriteret të konkurrojnë njëherësh, duke hequr lidhësen 'ose' në dispozitën e ligjit.

Një ndër çështjet që do të përbëjë sfidë për të ardhmen është parashikimi në ligjin zgjedhor shqiptar i votimit të shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë Shqipërisë. Kuadri ligjor aktual nuk ka mundur një gjë të tillë, por vetëm votimin në territorin e Shqipërisë.

Po kështu, një aspekt tjetër i rëndësishëm që në të ardhmen mund të bëhet pjesë e ligjit zgjedhor, është edhe votimi në mënyrë elektronike, i cili në kushtet e mungesës së besimit të manifestuar nga aktorët politikë, mund të ishte një zgjidhje e pranueshme.

LITERATURA:

1. Liji nr. 7423, datë 13.11.1990, “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”.
2. Ligji nr. 7556, datë 4.2.1992, “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”.
3. Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, “Për ndryshimet në ligjin nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”.
4. Ligji nr. 8609, datë 8.5.2000, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”
5. Ligji nr.9087, datë 19.6.2003, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
6. Ligji nr.10 019, datë 29.12.2008, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
7. Ligji 7491, datë 27.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.
8. Kushtetuta e vitit 1998.
9. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. **ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008**
10. Reynolds, A., Reilly, B., Ellis, A., (2005) “*Electoral System Design*”, IDEA-International Institute for Democracy and Electoral Assistance.
11. Raport i misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, 2005, Varshavë, 7 Nëntor 2005.
12. Raporti përfundimtar zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, ODIHR për zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, I publikuar më 14 shtator 2009.
13. Luan Omari, Sistemi Parlamentar, Tiranë 2000
14. Ermal Hasimja *Sfidat reale të përfaqësimit politik në Shqipëri* Konferenca e parë të Institutit Shqiptar të Sociologjisë, Qershor 2007
15. “Sistemi zgjedhor ne kontekstin shqiptar”
http://www.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/DemocracyAndInstitutionBuilding/Prog_Election.html
 - Blendi Kajsiu: Problematika e Sistemit Proporcional ne Raport me Realitetin Shqiptar
 - Gent Ibrahim LL.M Sistemi Zgjedhor dhe Stabiliteti në Qeverisje
16. Giddens, Anthony (1997)
17. Roland Sturm: Politische Willensbildung; në: Informationen zur politischen Bildung 262, "Großbritannien", Bonn BpB 1999

18. Giesecke, Hermann (1976)
19. Nohlen, Dieter (1995), f. 846
20. Fjalori politik i Oxfordit , Tiranë 2001

LITERATURW SHITES E KONSULTUAR

1. ACE: The Electoral Knowledge Network, website: http://aceproject.org/epic-en/lf/Epic_view/
2. Bartolini, S., The Political Consequences of the Italian Mixed Electoral System. (1994/2000), European University Institute, 2002.
3. Birch, S., (2006), “*Electoral Systems Change in New Democracies*”, Department of Government, University of Essex, UK, 2006.
4. Birch, S., (2000), “*The Effects of Mixed Electoral Systems in Eastern Europe*”, UK, 2000.
5. Bochsler, D., (2007) “*How Proportional are the Mixed Compensatory Electoral Systems? Determining* .
6. Draft Joint Opinion on Amendments to the Electoral Code of the Republic of Albania, Venice
7. Commission and the OSCE/ODIHR, Strasbourg/Warsaw, 5 July 2007 CDL-EL(2007)018, Opinion 435 / 2007.
8. Golder Matt, (2005), “*Democratic electoral systems around the World*”, Department of Politics, New York University,
9. Navrat, Petr, (2003), “*Comparative Study of Electoral Systems and their Features*”, Foundation for Democratic Reforms,
10. CODE OF GOOD PRACTICE IN ELECTORAL MATTERS, GUIDELINES AND EXPLANATORY REPORT, Venice Commission, (Council of Europe), CDL-AD (2002).
11. DRAFT JOINT OPINION ON AMENDMENTS TO THE ELECTORAL CODE OF THE REPUBLIC OF ALBANIA, Venice Commission and the OSCE/ODIHR, Strasbourg/Warsaw, 5 July 2007 CDL-EL(2007)018, Opinion 435 / 2007. This draft Opinion will be submitted for final adoption at the 22nd Session of the Council for Democratic Elections (18 October 2007), and at the 72nd Session of the Venice Commission (19-20 October 2007).

Bashkëpronësia, natyra juridike, format dhe llojet e saj

Linda Durgaj

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë

Joint ownership, legal nature. Format and its types

ABSTRACT

Legal systems, enable co-existence of the right of ownership of two or more subjects on the same property. When these subjects exercise this right of ownership at the same time, in the property law, it is categorized as “joint ownership”, which is not a special type of ownership but just a form of co-existence of ownership right that more than one subject exercises on the same property.

The aim of this article is to find out the content, nature, and importance of the legal concept of “joint ownership”, by studying its origin and comparing it with similar categories and by identifying the native sources of this legal form and any other specific forms it appears.

1. Nocioni i bashkëpronësisë

E drejta e pronësisë mbi sendin mund t’i përkasë një apo disa personave. Në lidhje me këtë situatë të dytë, të përkatësisë së sendit apo të drejtës tjetër reale, më shumë se një subjekti, e drejta përdor një emërtim të posaçëm: flitet kështu për *bashkëpronësinë*, për të treguar qenien njëkohësisht titullar të së drejtës së pronësisë apo të së drejtës tjetër reale mbi sendin, të më shumë se një personi, duke marrë secili prej tyre

cilësinë e bashkëpronarit¹³⁰.

Një përcaktim të tillë bën dhe kodi civil i RSH-së, në nenin 199/1 “*Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta reale u përkasin bashkarisht dy ose më shumë personave*”. Në interpretim të këtij neni do theksonim se fenomeni i bashkëpronësisë nuk përfshin çdo situatë “pluri-subjektësh” si bashkëtitullar të drejtash pasurore, por vetëm të së drejtës së pronësisë dhe të drejtave të tjera reale. Në këtë kuptim, nuk i përgjigjet konceptit të bashkëpronësisë, situata e disa personave, të cilët bashkarisht na shfaqen si bashkëkreditor apo debitor në detyrimet me shumë persona¹³¹. Koncepti i bashkëpronësisë lind dhe ezaurohet vetëm brenda fushës së të drejtave sendore: i korrespondon vetëm pronësisë dhe të drejtave reale mbi sendin e huaj.

Një element shoqërues i këtij *pluraliteti subjektësh* titullar të së drejtës së pronësisë apo të drejtës tjetër reale mbi një send, i domosdoshëm në përcaktimin e figurës së *bashkëpronësisë* është edhe *njëkohshmëria* e ushtrimit të këtyre të drejtave nga ana e shumë subjekteve.

Bashkëpronësia nuk është një lloj i veçantë pronësie, por forma juridike e ekzistencës bashkarisht të shumë subjekteve të së drejtës së pronësisë mbi sendin¹³².

Parimisht, prezumohet barazia e pjesëve (madje edhe atëherë kur shumë persona blejnë një send duke derdhur shuma të pabarabarta mjetesësh monetare), por këto pjesë mundet që për shkak të ligjit apo vullnetit të palëve të jenë edhe të pabarabarta. Kjo për arsye se, prezumimi i mësipërm është një prezumim relativ - *iuris tantum*, i cili mundëson kurdoherë provën e kundërt.

1.2. Bashkëpronësia: grupim subjektësh apo subjektivitet?

Në doktrinën juridike shtrohet pyetja: rregullat ligjore që disiplinojnë fenomenin “bashkëpronësi”, e trajtojnë atë si një grupim subjektësh që

¹³⁰ Dr. Avni Shehu, *Pronësia*, albino, 2000

¹³¹ Shih “Detyrimet me shumë persona”, f. 100, Mariana Semini, *E drejta e detyrimeve dhe kontaktave*, Pjesa e përgjithshme, Shtëpia botuese “Afërdita”, Tiranë, 1998.

¹³² Dr. Avni Shehu, *op. e cit.*, f. 23.

bashkushtrajnë të drejtën e pronësisë dhe të drejtat e tjera reale apo shohin tek bashkëpronësia një subjekt të veçantë të së drejtës, një entitet subjektësh të veshur me personalitet juridik, të ngjashëm me personin juridik?

Qëndrimet e doktrinës mund t'i grupojmë në tri kategori:

1. Grupimi i parë, i cili përfaqëson qëndrimin e shumicës, duke marrë në konsideratë dallimet në koncept, mënyrën e ndryshme të organizimit dhe krijimit midis bashkëpronësisë dhe shoqërisë¹³³, mban tezën se bashkëpronësia nuk përfaqëson një subjektivitet të veçantë, analog me personin juridik, por një grup subjektësh të cilët edhe pasi bashkohen vullnetarisht apo forcërisht në bashkëushtrimin e të drejtës së pronësisë apo të drejtave të tjera reale, mbeten individualisht subjekte të veçantë të së drejtës së pronësisë apo të drejtës tjetër reale, mbi të cilat ata janë bashkëtitullar.
2. Grupimi i dytë, i mbetur në minorancë, duke marrë në konsideratë fakte të tilla si: organizimi i bashkëpronarëve, nëpërmjet organeve të tilla si asamblea e bashkëpronarëve dhe imponimi i vendimeve të asamblesë sipas rregullit të shumicës etj., mban tezën se bashkëpronësia nuk mbetet thjesht në kuadrin e një të drejte reale të ushtruar së bashku nga një grup subjektësh, porse në fakt kemi të bëjmë me një konfigurim të posaçëm juridik, të karakterizuar nga personaliteti juridik, pra kemi të bëjmë me një subjekt më vete të së drejtës, siç janë dhe shoqëria e thjeshtë apo shoqëritë tregtare¹³⁴.
3. Grupimi i tretë, i cili gjithashtu nuk gjen një përkrahje të gjerë, përkundrazi mban tezën, sipas të cilës ky konstruksion juridik, i quajtur bashkëpronësi, duhet të konsiderohet grupim subjektësh apo

¹³³ Këta autorë për të vënë në dukje mungesën e personalitetit juridik të bashkëpronësisë e vendosin atë përballë shoqërisë, atij grupimi individësh të bashkuar për ushtrimin e një aktiviteti ekonomik me qëllim ndarjen e fitimit, për personalitetin juridik të së cilës nuk ka asnjë dyshim. Shih F. Galgano, *E drejta private*, Bot. i 3-të, Tiranë: Luarasi, 2006, f. 778; D. Minussi, *Comunione e divisione*, *Diritto civile*, Gr. Editoriale Esselibri - Simone, 2003, f. 9, Massimo Paradiso, *Corso di istituzioni di diritto privato*, G. Giappichelli Editore-Torino, 2001, f.175-176, STEINAUER, *Les droits réels*, I, Berna, 1997, f, 1296.

¹³⁴ Prof. asoc. dr. A. Nuni, Master Luan Hasneziri, *Leksione të së drejtës së pronësisë*, Tiranë, 2007, f. 140, *Raccolta ufficiale delle decisioni del Tribunale federale svizzero*, 84 I 126 consid. 2 pag. 129.

subjekt i veçantë i së drejtës, në varësi të formës në të cilën shfaqet. Pikërisht, sipas këtij grupi autorësh bashkëpronësia merr subjektivitet të veçantë juridik vetëm atëherë kur shfaqet në formën e bashkëpronësisë së detyruar, ku elementi organizativ nëpërmjet asamblesë së bashkëpronarëve na paraqitet në formën e tij më të lartë, duke marrë deri-deri dhe personalitet juridik.

1.3. Natura juridike e bashkëpronësisë

Në doktrinë dhe jurisprudencë mbizotëron koncepti, që e drejta e secilit bashkëpronar është e kufizuar në ushtrimin e saj nga ajo e bashkëpronarëve të tjerë, duke i kufizuar edhe ata në të njëjtën mënyrë (teoria atomike).

Duke qenë se bashkëpronësia ka kuptim vetëm në qoftë se sendi në bashkëpronësi është akoma i papjesëtuar, secili prej bashkëpronarëve ka të drejtë mbi një kuotë ideale, e cila nuk i referohet ndonjë pjese materialisht apo konkretisht të përcaktuar, por tregon "*sasinë e pushtetit*" të tij mbi sendin për aq kohë sa zgjat bashkëpronësia si dhe përcakton "*masën e të drejtës*" së bashkëpronarit në momentin e pjesëtimit të sendit të përbashkët.

Eksistojnë dy tipa bashkëpronësish: bashkëpronësia e tipit romanist dhe ajo e tipit gjermanik.

1. Bashkëpronësia e tipit romanist, lind pavarësisht nga ekzistenca e një lidhjeje të mëparshme midis bashkëpronarëve dhe bazohet në konceptin e kuotës ideale, mbi të cilën secili bashkëpronar është titullar. Kjo bashkëpronësi karakterizohet nga liria e disponimit të kuotës si dhe e drejta e pjesëtimit, e cila i jep fund marrëdhënies së bashkëpronësië. Kjo e drejtë i përket jo vetëm titullarëve të bashkëpronësisë, por mund të ushtrohet edhe nga kreditorët personalë të secilit prej bashkëpronarëve.
2. Bashkëpronësia e tipit gjermanik, prezumon ekzistencën e mëparshme të një raporti, një lidhjeje apo detyrimi midis bashkëpronarëve, të cilët nuk kanë kuota të përcaktuara, por e ushtrojnë të drejtën e tyre bashkarisht, në mënyrë kolektive, "me duar të lidhura", siç thuhet në doktrinën juridike. Parimisht, mungon liria e disponimit dhe e pjesëtimit të sendit të përbashkët dhe kreditori personal i bashkëpronarit nuk ka mundësinë që të atakojë pasurinë e përbashkët,

për të ekzekutuar kredinë e tij, mbi pjesën që do t'i takonte bashkëpronarit-debitor, në rast të pjesëtimit të sendit të përbashkët.

Kodi civil i RSH-së¹³⁵, njeh të dy tipat e mësipërm, duke bërë ndarjen në bashkëpronësi në pjesë dhe bashkëpronësi në tërësi, duke qenë bashkëpronësia në pjesë e tipit romanist dhe përkatësisht ajo në tërësi e tipit gjermanik. E njëjta logjikë, porse me tjetër terminologji vërehet edhe tek “*Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat reale*” i Maqedonisë dhe ligji mbi marrëdhëniet themelore juridiko, teksa bëhet ndarja në: bashkëpronësi dhe pronësi e përbashkët, duke pasur parasysh me emërtimin “*bashkëpronësi*” - bashkëpronësinë e tipit romanist dhe me emërtimin “*pronësi e përbashkët*” - bashkëpronësinë e tipit gjermanik¹³⁶.

“*Tendencë*” thelbësore e secilës prej llojeve apo nënlojeve në të cilat na shfaqen këto dy tipa bashkëpronësish është ajo e mbizotërimit të interesit kolektiv të bashkëpronarëve në raport me interesin individual të tyre (vendimet merren në bazë të parimit maxhoritar). Por nuk kemi të bëjmë me një interes të grupit, i ndryshëm ky nga interesi i bashkëpronarëve të veçantë, siç e shohim tek shoqëritë, tek personat juridik. Mbetet i qëndrueshëm opinioni, se nuk mund të shihet bashkëpronësia si një subjekt i pavarur i të drejtës, i dallueshëm nga subjekti i pjesëmarrësve në bashkëpronësi.

Nëse fenomenin “*e bashkësisë pasurore*” e gjejmë në figura të ndryshme, mund të thuhet se rëndësia e interesit kolektiv vjen në rritje gjatë kalimit nga hipoteza e gëzimit të thjeshtë të sendit (bashkëpronësia e rregullt-tipi romanist) në bashkësi me qëllime dhe synime që e tejkalojnë gëzimin e thjeshtë të të mirave (si p.sh. regjimet pasurore bashkëshortore apo bashkëpronësia në kate, e detyrueshme- e tipit gjermanik) dhe së fundi ky “*interes përkryhet*” tek grupe të **mirëorganizuara**, siç janë shoqëritë tregtare.

Por ajo që duhet nënvizuar është, se tek bashkëpronësia sado mbizotërues që të na shfaqet interesi kolektiv, ai është kurdoherë rezultati i mbledhjes së interesave individualë, dhe synon në racionalizimin e administrimit dhe gëzimit sa më të mirë të sendit në bashkëpronësi¹³⁷.

¹³⁵ Por edhe aktet ligjore që aplikohen në trevat shqiptare si: Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat reale i Maqedonisë dhe LMTHPJ.

¹³⁶ Shih prof. dr. Abdulla Aliu, E drejta sendore (Pronësia), Prishtinë, 2006, fq 89-90

¹³⁷ Massimo Paradiso, op. cit. f.176

Duke iu referuar, gjithë fakteve dhe argumenteve të parashtruara që nga fillimi i trajtimit të tematikës mund të përfundojmë se bashkëpronësia në cilëndo lloj apo formë të shfaqet: nuk formon një subjekt të veçantë të së drejtës, analog me shoqëritë tregtare; nuk është një lloj i veçantë i të drejtës së pronësisë, analog llojet e tjera si pronësia vetjake, private, publike; se koncepti i bashkëpronësisë nuk i zbatohet në kuptimin e mirëfilltë tekniko-juridik çdo situatë ku si bashkëtitullar të drejtash na shfaqen disa persona, siç p.sh. në rastin e detyrimeve me shumë persona; nuk i zbatohet në kuptimin e mirëfilltë tekniko-juridik çdo situatë bashkë-gëzimi të sendeve, p.sh. në rastet ku një send thjesht përdoret njëkohësisht nga disa persona; por *bashkëpronësia* përfaqëson një *modalitet* të ushtrimit të së drejtës së pronësisë apo të drejtës tjetër *reale*, ku si subjekte të saj na shfaqen jo një por dy ose më shumë persona, qofshin këta persona fizik apo juridik¹³⁸.

Këta persona janë bashkëtitullar, të së njëjtës të drejtë pronësie për aq kohë sa sendi është në bashkëpronësi, duke i *bashkëushtruar tagrat* e pronësisë në atë mënyrë dhe *parimisht* për aq kohë sa ky bashkëgëzim apo bashkëushtrim kënaq interesat e tyre individuale.

2. Dallimi midis bashkëpronësisë dhe shoqërisë tregtare

Dallimi midis bashkëpronësisë dhe shoqërisë nga pikëpamja normative rezulton nga neni 200 KC, i cili e vë theksin tek *qëllimi i gëzimit*, ndërsa përshkruan të drejtat dhe mundësitë e bashkëpronarëve në lidhje me sendin e përbashkët, si dhe nga neni 1074 KC, i cili përkundrazi vë theksin tek qëllimi për ushtrimin e një aktiviteti të përbashkët dhe ai i ndarjes së fitimit si element që përbën esencën e shoqërisë.

¹³⁸ Si subjekte të bashkëpronësisë mund të jenë si personat juridik privat ashtu edhe ata publik. Në rastin e këtyre të fundit, ata i shohim si bashkëpronar në lidhje me pronën shtetërore apo publike në kuptimin subjektiv, d.m.th. me ato sende, të cilat objektivisht nuk janë të paracaktuara për realizimin e ndonjë interesi publik, por konsiderohen publike për shkakun se shteti na shfaqet si subjekt i të drejtës së pronësisë. Këto sende një person juridik publik mund t'i ketë në bashkëpronësi me persona të tjerë juridik publik ose edhe me persona privat. Më gjatë shih. L. Durgaj "Pronësia publike", USH, Buletini Shkencor, Seria e shkencave ekonomiko-juridike, viti II i botimit, nr. 2, Shkodër 2008.

Bashkëpronësia, në ndryshim nga shoqëria nuk ka si qëllim final organizimin e një aktiviteti ekonomik, të tipit lukrativ, domethënë *dinamik*, por vetëm qëllimin e lejimit të gëzimit dhe të ruajtjes *statike* të së mirës¹³⁹.

Gjendja juridike e të mirave të shoqërisë është thellësisht e ndryshme nga ajo e të mirave materiale në bashkëpronësi¹⁴⁰.

Këto ta fundit nuk kanë asnjë destinacion të veçantë, dhe si pasojë bashkëpronarët mund të ushtrojnë mbi këto të mira, të gjithë tagrat që hyjnë në të drejtën e tyre të pronësisë, brenda kufijve të përcaktuar me ligj dhe pa dëmtuar ushtrimin e po këtyre tagrave nga bashkëpronarët e tjerë.

Përkundrazi mbi të mirat e shoqërisë rëndon *detyrimi i destinacionit të veçantë*, që është pikërisht përdorimi i tyre vetëm për ushtrimin së bashku midis ortakëve të veprimtarisë sipërmarrëse, duke përjashtuar çdo përdorim të ndryshëm nga ky.

Tek shoqëritë, në sajë të kontributit të ortakëve, formohet kapitali i shoqërisë, i cili pavarësisht nga lloji i shoqërisë, është tërësisht i dallueshëm dhe i pavarur nga pasuria personale e ortakëve. Madje një tipar të tillë e verifikojmë edhe tek shoqëria e thjeshtë, ku edhe tek kjo formë, nuk mund të konfondohet pasuria e shoqërisë me pasurinë vetjake të ortakëve.

Pikërisht, ky destinacion i posaçëm që rëndon mbi pasurinë e shoqërisë dhe kjo autonomi pasurore - element i domosdoshëm i personalitetit juridik të saj, ka efekt edhe ndaj personave të tretë kreditorë. Kreditorët e veçante të ortakëve, nuk mund të kërkojnë përmbushjen e të drejtës së tyre të kredisë mbi pasurinë e shoqërisë.

Ndërsa tek bashkëpronësia nuk verifikohet asnjë lloj autonomie pasurore: në pasurinë e secilit prej bashkëpronarëve përfshihet ndërmjet të tjerave edhe *pjesa* që bashkëpronari ka në bashkëpronësi me të tjerët. *Kjo pjesë* është njëlloj, e atakueshme nga kreditorët veçantë të secilit bashkëpronar (d.m.th. në kushte barazie si dhe pjesa tjetër e pasurisë, e cila nuk ndodhet nën regjimin e bashkëpronësisë).

Një situatë e veçantë na paraqitet në rastet: kur disa persona kanë të përfshirë në pasurinë trashigimore edhe kompleksin e të mirave të

¹³⁹ D. Minussi, *Comunione e divisione, Diritto civile*, Gr. Editoriale Esselibri - Simone, 2003, f. 10.

¹⁴⁰ F. Galgano, *op.cit.* f. 781.

organizuar nga trashigimlënësi për ushtrimin e aktivitetit tregtar ose kur disa persona blejnë një ndërmarrje tregtare, duke u bërë kështu bashkëpronarë të ndërmarrjes¹⁴¹.

Lind pyetja në këto dy raste do zbatohen dispozitat mbi bashkëpronësinë apo ato mbi shoqëritë?

Në lidhje me rastin e parë, n.q.s trashigimtarët nuk e ushtrojnë vetë veprimtarinë tregtare, duke e dhënë atë me qira për shembull, atëherë do të zbatohen dispozitat mbi bashkëpronësinë, pasi trashëgimtarët do të kufizoheshin vetëm në gëzimin e të mirave të përbashkëta.

Përkundrazi, në rast se vendosin që të ushtrojnë aktivitetin tregtar të trashëguar apo në rastin e dytë të blerjes së ndërmarrjes tregtare me qëllim ushtrimin e aktivitetit ekonomik, atëherë duhet të zbatohen dispozitat mbi shoqëritë. Nga sjellja e tyre konkludohet qëllimi i përbashkët i përdorimit të të mirave të përbashkëta për ushtrimin e një sipërmarrje dhe për këtë arsye i kanë dhënë si kontribut në shoqëri. Sipas nenit 1075 të KC, kontrata e shoqërisë nuk është objekt i ndonjë forme të veçantë, pra mund të lidhet edhe në formë të heshtur ose me veprimet konkludente të palëve. Konkluzioni është se kemi të bëjmë me një shoqëri faktike, ose me një shoqëri të krijuar në mënyrë të heshtur¹⁴².

3. Bashkëpronësia dhe detyrimet me shumë persona

Figura e bashkëpronësisë inkuadrohet brenda fenomenit të gjerë të qenurit bashkëtitullar të drejtash në një marrëdhënie juridike, e cili përfshin edhe të drejtat relative madje dhe disa të drejta personale (p.sh. përgjegjësia prindërore, e drejta e autorit). Një pjesë e doktrinës konsiderojnë se kemi të bëjmë më bashkëpronësi edhe në rastin e detyrimeve me shumë persona¹⁴³. Fenomeni i bashkëpronësisë nga kjo pikëpamje s' do të ishte i kufizuar vetëm tek pronësia apo të drejtat e tjera reale, por do të shtrihej edhe në fushën e detyrimeve.

¹⁴¹ F. Galgano, op.cit. f. 780.

¹⁴² F. Galgano, op.cit. f. 780-781.

¹⁴³ Mund të ndodhë që në një marrëdhënie juridike detyrimi të ketë shumë persona në përbërje të palës kreditore, ose asaj debitore, ose në përbërje të të dyja palëve së bashku. Në raste të tilla themi se ndodhemi para **detyrimeve me shumë persona**. Më gjatë shih. Mariana Semini, op. e cit. f.100-101.

Pranë bashkëpronësisë, si fenomen i tillë ku si titullar të së drejtës së pronësisë apo të së drejtës tjetër reale na paraqiten më shumë se një person, do të kishim kështu bashkëpronësi edhe në situatën e disa personave të cilët bashkarisht na shfaqen si bashkëkreditor apo bashkëdebetitor në detyrimet me shumë persona.

Autorë të tjerë, përkundrazi kanë mohuar se mund të flitet për bashkëpronësi në rastin e bashkëtitullarëve të të drejtave të kreditit, përveçse në një sens të rëndomtë dhe të gabuar dhe do të ishte më e saktë të flitet për “bashkësi interesash”, sesa për bashkëpronësi. Emërtimi “bashkëpronësi” përcakton në kuptimin teknik të fjalës, vetëm qenien bashkëtitullar të të drejtave reale¹⁴⁴.

Në fakt, duke folur në mënyrë të veçantë për debitorin, nuk mund të konceptohet një debi, përveç se duke iu referuar një personi individual. Këta autorë, duke parë tek detyrimet- *një sjellje apo qëndrim të caktuar të debitorit*, padyshim argumentojnë se *sjellja* nuk mund t’i atribuohet veçse një individi, dhe është e pakonceptueshme të flitet për një “bashkësi sjelljesh”.

4. Llojet e bashkëpronësisë

Bashkëpronësia është pra, gjendja në të cilën pronësia apo të drejtat reale mbi sendet u përkasin njëkohësisht shumë personave. Të ndryshme janë shkaqet, që i vendosin bashkëpronarët nën regjimin e bashkëpronësisë, ashtu sikur të ndryshme paraqiten mundësitë e tyre për t’i dhënë fund gjendjes së bashkëpronësisë dhe po ashtu jo në çdo tip bashkëpronësie pjesa e bashkëpronarit është e përcaktuar që në krijimin e saj.

Në këtë kuptim, duke iu referuar kritereve të ndryshme bashkëpronësinë mund ta klasifikojmë në disa lloje:

4.1. Bashkëpronësi e vullnetshme, ligjore dhe rastësore

Duke marrë si kriter burimin e krijimit të saj, bashkëpronësinë e kemi tre llojesh:

¹⁴⁴ Massimo Paradiso, Corso di istituzioni di diritto privato, G. Giappichelli Editore-Torino, 2001, f.174.

Bashkëpronësia është e vullnetshme, atëherë kur ajo ka si shkak të lindjes së saj vullnetin e pjesëmarrësve në bashkëpronësi: p.sh. kur shumë persona blejnë së bashku të njëjtin send, duke u bërë në këtë mënyrë bashkëpronarë.

Bashkëpronësia është ligjore, atëherë kur ajo ka si burim të lindjes së saj ligjin. Rast tipik i bashkëpronësisë ligjore është bashkëpronësia, e cila krijohet midis bashkëshortëve në lidhje me pasurinë e fituar gjatë martesës.

Bashkëpronësia është rastësore apo incidentale, atëherë kur krijimi i saj nuk varet nga vullneti i pjesëmarrësve, por nga rrethana rastësore. Rast tipik i saj është bashkëpronësia midis trashëgimtarëve, të cilët për vullnet të trashëgimtarit bëhen trashëgimtar të të njëjtit send apo sende.

4.2. Bashkëpronësi e rregullt dhe bashkëpronësi e detyruar

Duke marrë si kriter të drejtën e bashkëpronarëve për pjesëtimin e sendit në bashkëpronësi, ajo ndahet në:

Bashkëpronësi është e rregullt, atëherë kur secili bashkëpronar ka të drejtën të kërkojë në çdo kohë pjesëtimin e sendit të përbashkët, sipas parimit të së drejtës romake “*nemo compellitur in communione detineri*”, askush nuk mund të shtrëngohet që të qëndrojë në bashkëpronësi kundër dëshirës së tij¹⁴⁵.

Bashkëpronësi është e detyruar apo forcuar, atëherë kur pjesëmarrësit në bashkëpronësi nuk e kanë të drejtën e mësipërme dhe ligji jo vetëm “*nuk e sheh me sy të keq*” gjendjen e bashkëpronësisë mbi një kategori sendesh, por përkundrazi e urdhëron bashkëpronësinë dhe ndalon bashkëpronarët që të kërkojnë pjesëtimin e sendit të përbashkët, siç ndodh në rastin e pjesëve detyrimisht të përbashkëta në ndërtesat me kate, në të cilat njësitë ndarëse përkatëse (p.sh. apartamentet) janë në pronësi të personave të ndryshëm.

¹⁴⁵ Baltasar Benussifq, *Sendet, zotërimi dhe modifikimet e tij*, Libri III KC, Botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1931, f. 63.

4.3. Bashkëpronësi në pjesë dhe bashkëpronësi në tërësi

Duke marrë si kriter faktin nëse bashkëpronarët e kanë të përcaktuar apo jo, pjesën takuese (kuptohet pjesën ideale) gjatë ushtrimit të bashkëpronësisë, ajo ndahet në bashkëpronësi në pjesë dhe bashkëpronësi në tërësi.

Ndarja në bashkëpronësi në pjesë dhe bashkëpronësi në tërësi përputhet me klasifikimin mbi bazën e të cilit bëhet rregullimi juridik i bashkëpronësisë nga kodi civil i RSH-së, miratur me ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994. Klasifikim ky, i cili përputhet përkatësisht me ndarjen në “bashkëpronësi” dhe “pronësi të përbashkët” që vërehet edhe tek “Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat reale” i Maqedonisë dhe “Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridiko-pronësore” që rregullon marrëdhëniet juridiko-pronësore në Kosovës.

Kemi bashkëpronësi në pjesë, atëherë kur gjatë ushtrimit të bashkëpronësisë, bashkëpronarët e kanë të përcaktuar pjesën takuese mbi sendin e përbashkët, por siç kemi nënvizuar më sipër, nuk bëhet fjalë për një pjesë materialisht apo faktikisht të përcaktuar, porse për një pjesë ideale, një fraksion aritmetik në bazë të të cilit përcaktohet pushteti i bashkëpronarit mbi sendin e përbashkët.

Kemi bashkëpronësi në tërësi, atëherë kur gjatë ushtrimit të bashkëpronësisë, bashkëpronarët nuk kanë pjesë të përcaktuara, por pjesët e tyre përcaktohen në momentin e mbarimit të bashkëpronësisë.

Pjesët nuk janë të përcaktuara as në kuota ideale dhe as në kuota reale, duke dalluar në këtë mënyra nga bashkëpronësia në pjesë, tek e cila dihen pjesët ideale të bashkëpronarëve dhe ata me pjesët e veta mund të disponojnë pavarësisht¹⁴⁶.

5. Trajta të posaçme të bashkëpronësisë

Krahas llojeve dhe formave të lartpërmendura në të cilat është shfaqur tradicionalisht bashkëpronësia, në jurisprudencën botërore ndeshen edhe forma të tjera atipike. Në këtë aspekt një trajtë të posaçme të bashkëpronësisë përfaqëson *shumëpronësia*, si një formë e re

¹⁴⁶ Shih Prof. dr. Abdulla Aliu, E drejta sendore (pronësia), Prishtinë, 2006, f. 94

bashkëpronësia e shfaqur së fundmi.

5.1. Shumëpronësia

Nga bashkëpronësia tipike duhet dalluar shumëpronësia, e shfaqur para pak kohësh në formën e shumëpronësisë turistike. Shumëpronësia është një bashkëpronësi e karakterizuar nga *destinimi i detyruar i gëzimit me turne* të palujtshmërive, duke gjetur një shtrirje të gjerë kryesisht në komplekset e banimit në lokalitete turistike.

Pra, bëhet fjalë për situatën në të cilën e njëjta njësi banimi apo apartament iu shitet në mënyrë të veçantë shumë personave, të cilët mund ta gëzojnë *me turne*, çdo njëri prej tyre në një periudhë të caktuar të vitit¹⁴⁷.

E drejta e secilit shumëpronar është e përhershme dhe e disponueshme, porse sendi objekt shumëpronësie është i pandashëm.

Përsa i përket *natyrës juridike të së drejtës* së gëzimit të paluajtshmërisë, nga shumë persona në periudha kohore të ndryshme, nga ligji¹⁸ parashikohet se vetëm në rastet kur ajo ka natyrën e një *të drejte reale*, bëhet fjalë për “*shumëpronësinë*”.

Megjithatë pranimi i këtij konfigurimi nuk është krejt “*i qetë*” në qoftë se do pretendonim për një të drejtë reale të re jotipike, për shkak se kjo vjen ndesh me parimin e numërimit taksativ, që disiplinon të drejtat sendore. Nga ana tjetër nuk mund as të konfigurohet si bashkëpronësi tipike, për shkak të detyrimit të papjestueshmërisë së përrjetshme si dhe të përdorimit me turne të sendit.

Koncepti bashkëkohor ka evoluar drejt idesë se nuk kemi të bëjmë me një të drejtë të re sendore, por sërish kemi të bëjmë me të drejtën e pronësisë (si e drejtë sendore themelore) kësaj here mbi një *send të ri*: mbi një send të individualizuar dhe kufizuar jo vetëm në hapësirë por edhe në kohë. Duke qenë se njeriut i intereson ajo ç’ka është e mirë materiale, asgjë nuk e ndalon në konceptimin e një të mire materiale të përcaktuar jo vetëm në kufij hapësinor, por me kufij kohorë¹⁴⁸.

Nga shumëpronësia duhet dalluar situata pothuaj e njëjtë, e krijuar me anë të kontratës *time sharing*¹⁴⁹. Timesharing është një kontratë të cilën

¹⁴⁷ Massimo Paradiso, op. cit. f. 180-181

¹⁴⁸ F. Galgano, op.cit. f. 220.

¹⁴⁹ Shih Prof. Dr Mehdi Hetemi, E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, KGT, Prishtinë 2006, f. 484

Organizata Botërore e Turizmit e ka formuluar si vijon: “ *Timeshare është e drejta për të gëzuar çdo vit, për një periudhë të determinuar kohe pushimesh, rezidenca apo vendqëndrime, në brendësi të komplekseve turistike, të cilat ofrojnë një varietet shërbimesh dhe mjetesh*”. Dallimi midis këtyre dy kategorive juridike qëndron kryesisht në dy aspekte kryesore:

Së pari, tek e drejta që fitohet në secilin rast, ku me timesharing fitohet vetëm gëzimi me turne një sendi, ndërsa tek shumëpronësia kalohet e drejta e pronësisë.

Së dyti, ndryshimi shfaqet tek kohëzgjatja e këtyre të drejtave, ku tek timesharing e drejta e gëzimit ushtrohet për një kohë të caktuar, p.sh. çdo muaj qershor, për 5 ose 10 vite, ndërsa tek shumëpronësia kemi të bëjmë me një të drejtë pronësie, e cila është e qëndrueshme dhe e përhershme.

BILIOGRAFIA:

1. A. Nathanaili, E drejta civile e R. P. Shqipërisë, dispensa I dhe II, Tiranë, 1974.
2. Andrea Torrente dhe Piero Schlesinger, Manuale di diritto privato, Giuffrè Editore 2004.
3. Andrija Gams, Bazat e te drejtes reale, Prishtinë, 1978.
4. Alberto Tarabucchi, Istituzioni di diritto civile, Quarantesima Seconda edizione, CEDAM, 2005.
5. Baltasar Benussi, Komentar i kodit civil, Sendet, zotërimi dhe modifikimet e tija, Libri III i KC, Botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1931.
6. D. Minussi, Comunione e divisione, Diritto civile, Gruppo Editoriale Esselibri - Simone, 2003.
7. Dr. Avni Shehu, Pronësia, Albin, 2000.
8. Dr. Juliana Latifi, E drejta civile, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007.
9. Dr. Rustem Gjata, E drejta civile, Universiteti privat “Kristal”, 2005.
10. Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2008.
11. Francesco Galgano, E drejta private, ribotim, Tiranë, Luarasi, 2006.
12. Mariana Semini (Tutulani), E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, Tiranë, 2002.

13. Mario Bessone, *Casi e questioni di diritto privato, IV- Proprieta e diritti reali*, Giuffre Editore, Milano, 2001.
14. Massimo Paradiso, *Corso di istituzioni di diritto privato*, G. Giappichelli Editore- Torino, 2004.
15. Prof. Dr. Mehdi J. Hetemi, *E drejta në njohuritë themelore të së drejtës afariste*, Prishtinë, 2006.
16. Prof. Asoc. Dr. A. Nuni, Master Luan Hasneziri, *Leksione të së drejtës së pronësisë*, Tiranë, 2007.
17. Prof. Dr Abdulla Aliu, *E drejta sendore*, Prishtinë, 2006.
18. Valentina Kondili, *E drejta civile II, Pjesa e Posaçme*, GEER, 2008.
19. *Valentino Lenoci, La divisione, GIURISPRUDENZA CRITICA, Collana diretta da Paolo Cendon*, Utet, Torino 2006.

LEGJISLACIONI:

1. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, dt. 29.07.1994 (**KC**).
2. Ligji nr.6340, datë 26.6.1981, “Për kodin Civil”.
3. Kodi civil i Mbretërisë shqiptare d. 01.04.1929 (**KCZ**).
4. Ligji Nr. 03/L-091 i Republikës së Kosovës “Për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi”.

**Nga Roma në Kampala. Agresioni, tashmë një krim
ndërkombëtarisht i dënueshëm nga Gjykata
Ndërkombëtare Penale**

Lulzim Lelçaj

Shkolla e Magjistraturës, Tiranë

ABSTRACT

**From Rome to Kampala: Aggression, already an internationally
punishable crime by the International Criminal Court**

12 years after the adoption of the Rome Statute for the International Criminal Court, in Kampala was convened the Review Conference of this Statute. The most important issue of this Conference was the adoption of the amendments to the definition of the crime of aggression and the exercise of jurisdiction of the International Criminal Court (ICC) on this crime. Despite major differences that were encountered during the Rome Conference and the skepticism, after many attempts was achieved a compromise formula to define the crime of aggression.

States Parties to the Rome Statute adopted by consensus a set of amendments concerning the crime of aggression. The approval of these amendments would mark a significant step in the development of International Criminal Law. "*The new era of responsibility is replacing the old era of impunity*" (Ban Ki-Moon).

Në vend të hyrjes

12 vite pas miratimit të Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale¹⁵⁰, më 31 maj deri me 11 qershor 2010, në kryeqytetin e Republikës së Ugandës, Kampala, u mbledh Konferenca Rishikuese e këtij statuti¹⁵¹. Në axhendën e kësaj konference u përfshinë disa çështje ndër të cilat më e rëndësishmja ishte miratimi i amendamenteve për përkufizimin e krimit të agresionit si dhe të ushtrimit të juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNP) mbi këtë krim. Në nenin 5 të statutit të Romës parashikohen krimet që do të jenë objekt i gjykimit (krimet në juridiksionin e Gjykatës)¹⁵². Krimet që parashikohen ky nen janë: krimi i genocidit; krimet kundër njerëzimit; krimet e luftës; krimi i agresionit. Për këtë të fundit gjykatat do të ushtrorë juridiksionin e saj, pasi të jenë adoptuar normat juridike ndërkombëtare përkatëse¹⁵³.

Në 1998 shtetet pjesëmarrëse në konferencën e Romës, megjithë përpjekjet e tyre për të gjetur një konsensus për përkufizimin e krimit të agresionit dhe kushtet në të cilat GJNP do të ushtronte juridiksionin e saj mbi këtë krim, ranë dakord vetëm ta përfshinin këtë krim si pjesë të statutit të Romës¹⁵⁴. Që prej asaj periudhe u ngrit dhe funksionoi një grup special pune për hartimin e draft amandamenteve për këtë statut.

¹⁵⁰ Deri tani 111 shtet e kanë ratifikuar statutin ndërsa 37 vetëm e kanë nënshkruar atë. Kina, India, Rusia dhe SHBA nuk i janë bashkuar statutit (shënim i autorit).

¹⁵¹ Neni 121 i statutit.

¹⁵² Juridiksioni i gjykatës kufizohet në krimet më serioze, që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare në tërësi. Gjykata, në pajtim me këtë statut, ka juridiksion për krimet në vijim: (a) krimin e gjenocidit; (b) krimet kundër njerëzimit; (c) krimet e luftës; (d) krimin e agresionit. Codice del diritto e delle Organizzazioni Internazionali – Edizione Giuridiche Simone 2001 f 259)

¹⁵³ Gjykata e ushtron juridiksionin mbi krimin e agresionit, menjëherë pasi të miratohet një dispozitë në pajtim me nenet 121 dhe 123, që përkufizojnë krimin dhe vendosin kushtet në të cilat gjykata e ushtron juridiksionin në lidhje me atë krim. Një dispozitë e tillë është në pajtim me dispozitat përkatëse të Kartës së Kombeve të Bashkuara. (Codice del diritto e delle Organizzazioni Internazionali – Edizione Giuridiche Simone 2001, f. 259).

¹⁵⁴ Kompromisi që u arrit do të lejojë procedimet për agresionin, njëherazi një përkufizim të përshtatshëm i tij do të mund të arrihej në një konferencë të ardhshme të parashikuar, gje e cila mund të mos jetë aq e pamundur sa e mendojnë disa”. The Rome Statute of The International Criminal Court A Commentary – Antonio CASSESE, Paola GAETA, and John.R. È. D. JONES, VOLUME II, P. 1904

Pavarësisht nga divergjencat e mëdha që u ndeshën gjatë konferencës së Romës dhe skepticizmit pas shumë përpjekjesh u gjet një formulë kompromisi për përkufizimin e krimit të agresionit

Shtetet palë të statutit të Romës miratuan me konsensus një paketë amendamenteesh¹⁵⁵ lidhur me krimin e agresionit, të cilat përfshinin: Përkufizimin e krimit të agresionit duke përcaktuar detajet e krimit të agresionit dhe aktit të agresionit, kushtet mbi të cilat GJNP ushtron juridiksionin e saj mbi këtë krim, rastet kur GJNP mund të fillojë një hetim, elementët e krimeve dhe shtatë elemente interpretues lidhur me krimin e agresionit, të cilat do të ndihmojnë GJNP të zbatojë këto dispozita. Miratimi i këtyre amendamenteve do të shënonte një hap të rëndësishëm në zhvillimin e të Drejtës Ndërkombëtare Penale. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, zoti Ban Ki Mun, do t'i përkufizonte këto rezultate me shprehjen: “ *Epoka e re e përgjegjësisë po zëvendëson epokën e vjetër të pandëshkueshmërisë*”¹⁵⁶.

Juridiksioni “Ratione Materiae” i GJNP mbi krimin e agresionit

Një nga komponentët kryesorë të juridiksionit të GJNP është Juridiksioni material (*ratione materiae*), i cili nënkupton krimet që do të jenë objekt i gjyqimit nga kjo gjykatë. Pas diskutimit të një liste mjaft të gjatë të krimeve ndërkombëtarisht të dënueshme, në statutin e Romës kjo listë u kufizua në katër krime dhe për më tepër në ato raste kur krimet janë janë “*tepër të rënda*”. Kjo do të thotë se procedimi penal përjashtohet kur “*rasti nuk është mjaftueshmërisht i rëndë që gjykata të detyrohet të marrë masa*”¹⁵⁷. Edhe në rastet kur kryhet një vepër penale, e cila formalisht është e parashikuar duhet të verifikohet rast pas rasti nëse komuniteti ndërkombëtar është cënuar në mënyrë të tillë nga kjo vepër sa të justifikojë procedimin penal përmes GJNP.

Pavarësisht nga debatet, tani përgjithësisht pranohet se krimi i

¹⁵⁵ Rezoluta e RC/Res.6 e miratuar ne Seancën Plenare XIII te Konferencës Rishikuese të Statutit të Romës me 11 qershor 2010.

¹⁵⁶ Press Conference by the United Nations Secretary-General <http://ëëë.icc-cpi.int/Menu/ICC/Search?qt=Press+Conference+by+the+United+Nations+Secretary-General&la=en>

¹⁵⁷ Neni 17, pika 1 , shkronja d) e statutit të Romës.

agresionit apo krimi kundër paqes është një *krim ndërkombëtar*. Përkufizimi i krimit të agresionit është më i vështirë se dhënia e një vendimi në një rast që i përkët këtij krimi. Një vendim do të kishte fuqi drejtpërdrejt mbi një person kurse përkufizimi i një krimi ndikon potencialisht mbi të gjitha rastet e krimeve, mbi autorët dhe viktimat e këtyre krimeve.

Një ndër vështirësitë e mëdha të përkufizimit të agresionit ka qenë mpleksja e veprimeve të shteteve dhe të individëve që veprojnë në emër të tyre. Subjektet e vetme të së Drejtës Ndërkombëtare janë shtetet. Një individ, i cili vepron në ushtrim të fuksionit të tij zyrtar, vepron në emër të shtetit të tij. Nëse ai dhunon dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara që i përkasin paqes dhe sigurisë ndërkombëtare kjo duhet të sjellë përgjegjësi për të, por edhe për shtetin e tij.

Akti i agresioni i një shteti dhe krimi i agresionit, i kryer nga një individ, ndonëse janë koncepte të ndara nga njëri-tjetri kanë një lidhje organike në mes tyre. Nuk mund të ketë një akt agresioni pa patur një krim të agresionit. Në të njëjtën kohë nuk mund të ketë një krim agresioni pa patur një akt agresioni. Kjo është arsyeja sipas së cilës këto dy koncepte varen nga njëri-tjetri. Në fillim duhet të ndodhë një akt agresioni për të patur më pas një përgjegjësi penale individuale për krimin e agresionit.

Gjatë diskutimeve për përcaktimin e përkufizimit të krimit të agresionit ka patur një debat të madh nëse do të bëhej një përkufizim gjenerik i agresionit apo një përkufizim specifik të tij. Përkufizimi gjenerik nuk përfshin të gjithë listën e veprimeve të agresionit kurse përkufizimi specifik liston veprimet, të cilat do të përbënin elementet e këtij krimi.

Këto dy përkufizime nuk kënaqin nevojën e pasjes së një liste me këto veprime dhe pamundësinë e saj për të qenë shtruese. Një variant i tretë ishte më i mundshëm. Bëhej fjalë për një përkufizim të përgjithshëm, me një listë elementesh, por që nuk janë shtruese¹⁵⁸

Përkufizimi i këtij krimi ka shpalosur edhe interes të madh në rrethin e akademikëve, zbatuesve të së drejtës dhe studiuesve. Prof B. Ferenz jep një përkufizim që në vitin 2001 sipas të cilit “*agresioni është*

¹⁵⁸ ICC-ASP/5/SËGCA/Inf. 1 at 5 par. 10.

një akt shtetror që bie ndesh me përmbajtjen e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara nr.3314/1974” duke shtuar “detyrimin e shteteve për të mos përdorur forcat e armatosura për të shtypur popujt në të drejtën e tyre të vetevendosjes, lirinë dhe pavarësinë e tyre, ose për të cënuar integritetin territorial” dhe “*territori i një shteti nuk duhet të cënohet, qoftë edhe përkohësisht si dhe nuk duhet të jetë objekt i një pushtimi ushtarak nga një shtet tjetër pasi kjo përbën një shkelje të Kartës së OKB*”. Për më tepër “*çdo aneksim përmes përdorimit të forcës të një territori ose të një pjesë të tij të një shtetit tjetër*” mund të cilësohet si një akt agresioni¹⁵⁹.

Një përkufizim tjetër të këtij krimi e jep prof I. K. Müller Schieke: “*Në qëllim të këtij statuti krimi i agresionit nënkupton aktet, e kryera nga një individ i cili është në një pozitë të ushtrimit të kontrollit ose drejtimi politik ose ushtarak të një shteti i cili; a) palnifikon; b) përgadit; c) inicion ose ç) ndërmerr një sulm ushtarak të shtetit të tij kundër integritetit territorial, pavarësisht politike të një shteti tjetër në dhunim të Kartës së Kombeve të Bashkuara*”¹⁶⁰

Agresioni është një krim lidhshëm¹⁶¹ par excellence. Shumica e opinioneve janë për ky krim kryhet vetëm nga personat që janë në pozita të ushtrimit të kontrollit ose të drejtimit të veprimeve politike dhe ushtarake të shtetit si drejtues, ndërsa disa të tjerë konsiderojnë që agresioni mund të kryhet gjithashtu edhe nga persona të tjerë¹⁶².

Nisur nga këndvështimet e përkufizimeve të mësipërme për krimin e agresionit mund të nxirrej një përkufizim i tillë: “Një individ i cili duke qenë në pozitë, efektivisht të ushtrojë kontroll ose të drejtojë veprimtari politike ose ushtarake të një shteti, palnifikon, përgatit, inicion ose ndërmerr një akt agresioni, do të jetë përgjegjës për krimin e agresionit

Për arsye të paragrafit 1 “*akt agresioni nënkupton një akt referuar në rezolutën 3314 të datës 14.12.1974 të Asamblesë së OKB*”.

¹⁵⁹ B. Ferencz ‘*Deterring Aggression By Law - A Compromise Proposal*’ January 11, 2001, <http://ëëë.benferencz.org/arts/44.html>.

¹⁶⁰ I.Müller – Schieke, f 426.

¹⁶¹ *Second Thoughts on the Crime of Aggression* Andreas Paulus* *The European Journal of International Law* Vol. 20 no. 4 © EJIL 2010; p. 1120

¹⁶² K.J. Heller, ‘Retreat from Nuremberg: the Leadership Requirement in the Special Working Group’s Definition of Aggression’, 2006 or R.S. Clark, ‘Rethinking Aggression as a Crime and Reformulating its Elements: The Final Work – Product of the Preparatory Commission for the International Criminal Court’, in 15 LJIL (859-890), 2002.

Gjatë debateve për përkufizimin e krimit të agresionit ka mbizotëruar ideja që duke ndëshkuar një individ që planifikon, përgatit ose ekzekuton një akt agresioni nuk duhet përjashtuar drejtuesi, i cili mund të mos kryejë vetë këto veprime, por mund të urdhërojë ose drejtojë planifikimin, përgatitjen, iniciimin apo ekzekutimin e një akti të agresionit duke qenë se neni 25/3 i statutit duhet të zbatohet gjithashtu për krimet supreme.

Amendamentet e statutit të Romës e përkufizojnë krimin e agresionit¹⁶³ si: “Planifikim, përgatitje, iniciim apo zbatim prej një individi, i ndodhur në një pozicion drejtues, të një akti të agresionit. Këtu ka parasysh udhëheqës politik apo ushtarak. Është e rëndësishme që akti i agresionit duhet të përbëjë një dhunim të dukshëm të Kartës së Kombeve të Bashkuara¹⁶⁴.

Nje “akt agresioni”¹⁶⁵ përkufizohet si përdorimi i forcave të armatosura prej një vendi kundër sovranitetit, terësisë territoriale dhe pavarësisë politike të një vendi tjetër ose në mënyrë të tjera në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara. Përkufizimi i aktit të agresionit është bazuar në Rezolutën 3314/1974 të Asamblesë së OKB.

Sipas komentareve një akt agresioni përbën një dhunim të dukshëm të Kartës së Kombeve të Bashkuara tre komponentët: karakteri, shkalla dhe rrëzikshmëria duhen të konsiderohen të lidhur me njëri-tjetrin pasi njëri prej tyre mund të mos jetë i mjaftueshëm për të plotësuar

¹⁶³ “Në kuptim të këtij statutit “Krim i agresionit” nënkupton planifikimin, përgatitjen, iniciimin apo ekzekutimin e një akti agresioni i cili nga karakteri, rrëzikshmëria dhe shkalla e tij përbën një dhunim të dukshëm të Kartës së Kombeve të Bashkuara, i kryer prej një personi në një pozicion efektivisht për të drejtuar apo ushtruar kontroll mbi veprimet politike apo ushtarake të një shteti” (neni 8/bis pika 1 Rezoluta e RC/Res.6 e miratuar në Seancën Plenare XIII të Konferencës Rishikuese të statutit të Romës me 11 qershor 2010.)

¹⁶⁴ Neni 8/bis pika 1

¹⁶⁵ Në kuptim të paragrafit të parë “akt agresioni” do të thotë përdorimi i forcave të armatosura prej një shteti kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti tjetër ose në =do mënyrë tjetër të papajtueshme me Kartën e Kombeve të Bashkuara. Pavarësisht nëse ka apo jo një shpallje të luftës, aktet e mëposhtme janë akte agresioni sipas Rezolutës e Kombeve të Bashkuara 3314 (XXXIX) të 14 dhjetorit 1974: ...

(neni 8/bis pika 2 Rezoluta e RC/Res.6 e miratuar në Seancën Plenare XIII të Konferencës Rishikuese të statutit të Romës me 11 qershor 2010.)

statndardin e “*dhunimit të dukshëm*” të Kartës së OKB.

Debatet mbi ushtrimin e juridiksionit të GJNP për krimin e agresionit përpara miratimit të amendamenteve nga Konferencën e Kampala-s

Ndryshe nga tre krimet në juridiksionin e GJNP, të cilat mund të vihen në hetim pa ndonjë paracaktim të ndonjë organi tjetër, krimi i agresionit është i veçantë në këtë pikëpamje. Ka një kusht *sine qua non* i cili kërkon që një akt i agresionit duhet të jetë kryer. Ka patur një debat të madh në të Drejtën Ndërkombëtare nëse do të ishte GJNP apo një organ tjetër: (Këshilli i Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), i cili do të kishte të drejtën të bënte një përcaktim të ekzistencës të një akti agresioni). GJNP merret me krimet e kryera nga individët dhe jo me aktet e kryera nga shtetet. Kjo është një arsye që ajo nuk mund të vendosë që një akt shtetëror agresioni ka ndodhur.

Në këtë këndvështrim GJND do të duhej të ishte organi kompetent që mund të merrej me këtë aspekt. Ajo ka juridiksion mbi aktet e kryera nga shtetet dhe për pasojë ajo duhet të ishte organi i përshtatshëm që do të jepte një vendim në këtë drejtim. Megjithatë, problemi me GJND qëndron në faktin se ajo jep vetëm opinione këshilluese, të cilat nuk i detyrojnë shtetet. Këto opinione duhet të jenë kërkuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, një shtet, etj. Nga ana tjetër opinionet nuk janë të detyrueshme për shtetet për më tepër, prirja për dhënjën e këtij vendimi mund të marrë shumë kohë, mund të jetë e kushtueshme dhe viktimat nuk mund të kenë kohë dhe fuqi për të pritur një përgjigje nga GJND. Situata do të ishte më e thjeshtë nëse një shtet, viktimë e agresionit, do të angazhonte GJND me këtë çështje. Në këtë rast GJND do të ishte në mënyrë të qartë organi më i përshtatshëm për të dhënë një zgjidhje por sa shpesh ka ndodhur që GJND të ketë përcaktuar që një akt shtetëror agresioni ka ndodhur¹⁶⁶?

¹⁶⁶ Rasti më i cituar është rasti i Nikaraguas. Në vendimin e GJND të vitit 1986 ajo refuzoi “justifikimin e një vetëmbrojtjeje kolektive” mbajtur nga SHBA në lidhje me aktivitetet ushtarake dhe paraushtarake në dhe kundër Nikaraguas dhe vendosi që: “SHBA duke trajnuar, aramtosur, pajisur, financuar dhe mbështetur forcat “Kondra” ose duke mbështetur, inkurajuar dhe ndihmuar aktivitetet ushtarake dhe paraushtarake në dhe

Një organ tjetër që mund të përcaktonte se kush mund të bëjë përcaktimin e krimit të agresionit është këshilli i sigurimit. Kundërshtarët e kësaj ideje për përcaktimin e aktit të agresionit të një shteti nga këshilli i sigurimit argumentojnë që KS është organ politik dhe jogjyqësor. Megjithatë, këshilli i sigurimit është organi i vetëm që mbron paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. KS vendos nëse një akt agresioni prek apo jo paqen ndërkombëtare.

Gjatë debatit në Konferencën Rishikuese të Statutit të Romës në Kampala, palët më shumë se për përcaktimin e elementeve të krimit të agresionit, e përqendruan tek ushtrimi i juridiksionit të GJNP mbi këtë krim. Debatit më i madh u përqendrua se si do të krijohej marrëdhënia ndërmjet GJNP dhe këshillit të sigurimit, i cili është i mandatuar të përcaktojë aktet e agresionit sipas Kartës së Kombëve të Bashkuara. Konkretisht debati u fokusua në rolin e KS në filtrimin e juridiksionit të

kundër Nikaraguas, kanë vepruar kundër Republikës së Nikaraguas, në thyerje të detyrimit të tyre sipas të Drejtës Zakonore Ndërkombëtare të mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shtetit tjetër”

Në të njëjtën kohë “SHBA nëpërmjet sulmeve të caktuara në territorin e Nikaraguas në vitet 1983-84 kanë vepruar kundër Republikës së Nikaraguas në thyerje të detyrimit të tyre sipas të Drejtës ndërkombëtare zakonore të mospërdorimit të forcës kundër një shtetit tjetër”. SHBA u gjetën fajtores në dhunimin e sovranitetit të Nikaraguas duke thyer detyrimin për të mosndërhyrë në çështjet e brendshme, e mosdhunimit të sovranitetit të tij dhe mosdëprejerjen e tregtisë paqësore detare.

Nuk përdoret në asnjë vend fjala agresion në këtë gjykim. Është e vërtetë që në disa pika të përmbajtjes së vendimit termi “sulme të armatosura” është i pranishëm, por jo në mënyrë të shprehur si akt agresioni (expressis verbis). Vetëm me analogji mund të thuhet që agresioni ndodhi. SHBA u gjetën fajtores të thyerjes së detyrimeve të saj sipas të Drejtës Ndërkombëtare Zakonore. Paragrafi 195 i vendimit të GJND parashikon që “përkufizimi i agresionit në Rezolutën 3314 të Asamlesë së Përgjithshme mund të merret për të reflektuar të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore” në të cilën bazohet një sulm i armatosur.

Një rast tjetër në të cilin GJND shmangu përdorimin e termit “akt agresioni” janë aktivitetet e armatosura në Republikën e Kongos. Rasti i Kongos kundër Ugandës. Konflikti përmbante “aktet e agresionit të armatosur kryer nga Uganda në territorin e Republikës Demokratike të Kongos. Kongo i kërkoi GJND të gjykojë dhe të deklarojë që: “Republika e Ugandës, përmes amgazhimit në veprime ushtarake dhe paraushtarake kundër Republikës Demokratike të Kongos, përmes pushtimit të territoreve të saj dhe dhënies së mbështetjes aktive ushtarake logjistike, ekonomike dhe financiare forcave të parregullta që operonin atje, ka dhunuar parimin e mospërdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përfshirë edhe ndalimin e agresionit. (Shënim i autorit)

GJNP mbi një krim për të cilin është parashikuar përgjegjësia penale individuale për personat që e planifikojnë apo përdorin forcat ushtarake kundër një shteti tjetër apo në një mënyrë tjetër në dhunim të Kartës së OKB.

Ndonëse amendamentet e miratuara parashikojnë që GJNP vihet në lëvizje për procedimin e krimit të agresionit nga këshilli i sigurimit, një shtet palë apo me iniciativë të prokurorit¹⁶⁷, ato i japin prioritet këshillit të sigurimit jo vetëm në përcaktimin e aktit të agresionit por edhe përsa i përket vënies në lëvizje të GJNP¹⁶⁸. Fuqia e KS është aq e madhe saqë nëse rasti referohet në GJNP nga KS çdo person, pavarësisht nga shtetësia e tij, mund të procedohet nga gjykata për krimin e agresionit. Ndryshe ndodh nëse një rast i tillë referohet në GJNP nga një shtet tjetër apo nga vetë prokurori ndaj qytetarëve të shteteve jo palë të statutit të Romës¹⁶⁹. GJNP nuk mund t'i procedojë penalisht ata për krimin e agresionit¹⁷⁰.

Nëse në rastin e procedimit penal nga GJNP për një krim agresioni me kërkesë të KS hetimet fillojnë menjëherë, në rastet e tjera të vënies në lëvizje të GJNP (përmes kërkesës së një shteti apo me iniciativë të prokurorit), do të duhej që më parë të kërkohej nga KS të konstatonte më parë nëse akti i agresionit ka ndodhur dhe më pas të fillojë procedimi nga prokurori për krimin e kryer¹⁷¹. Në rastet kur KS dështon në iniciativën e tij dhe pasi të kenë kaluar 6 muaj nga mos konstatimi i kësaj gjendjeje nga këshilli i sigurimit, prokurori mund të nisë procedimin penal, pasi ka marrë paraprakisht autorizimin nga dhoma e hetimeve paraprake të GJNP¹⁷². Sipas nenit 16 të statutit të këshillit të sigurimit, përmes një rezolute do të mund të pezullonte fillimin apo vazhdimin e procedimit penal për një periudhë një vjeçare¹⁷³.

¹⁶⁷ Neni 15/bis dhe neni 15/ter (Rezoluta e RC/Res.6 e miratuar në Seancën Plenare XIII të Konferencës Riushikuese të Statutit të Romës me 11 qershor 2010.)

¹⁶⁸ Neni 15/bis dhe neni 15/ter

¹⁶⁹ [The Kampala Review Conference: A Brief Assessment](http://humanrightsdoctorate.blogspot.com/2010/06/kampala-revieë-conference-brief.html) William A. Schabas OC MRIA <http://humanrightsdoctorate.blogspot.com/2010/06/kampala-revieë-conference-brief.html>

¹⁷⁰ Neni 15/bis, pika 5

¹⁷¹ Neni 15/bis pika 6 dhe 7.

¹⁷² Neni 15/bis, pika 8.

¹⁷³ Një qytetar i një shteti jo palë në statutin e Romës, anëtar i përhershëm i këshillit të sigurimit është i pamundur të procedohet penalisht për krimin e agresionit nga GJNP. Mundësia që një gjë e tillë të bëhet nga këshilli i sigurimit është praktikisht e

Sikurse thamë më lart juridiksioni i GJNP mbi personat që kanë kryer krimin e agresionit është i ndryshëm më rastet kur çështja referohet në GJNP nga këshilli i sigurimit nga rastet kur ajo referohet nga një shtet palë apo niset kryesisht. Nëse këshilli i sigurimit referon në GJNP qytetarët e shteteve palë gjykata mund të procedojë me këtë rast. Në dy rastet kur çështja është e ngritur nga prokurori proprio motu apo me nismën e një shteti, gjykata mund të ushtrojë juridiksionin e saj vetëm për qytetarët e atyre shteteve që kanë ratifikuar amendamentet mbi agresionin¹⁷⁴. Për më tepër kur çështja nuk është referuar nga këshilli i sigurimit, shtetet palë mund të mbrohen nga juridiksioni i GJNP nëse, përmes një deklarate të depozituar në sekretarinë e saj, nuk pranojnë juridiksionin e GJNP mbi krimin e agresionit¹⁷⁵. Me fjalë të tjera, GJNP ka juridiksion mbi një akt agresioni kryer nga një shtet palë, i cili ka pranuar këtë juridiksion dhe vetëm në rastet kur ky është kryer kundër një shteti palë¹⁷⁶.

Shumë juristë ndërkombëtarë do të kishin parapëlqyer si zgjidhje më të mirë pavarësinë e plotë të GJNP nga këshilli i sigurimit në rastet kur ajo procedon me rastin e krimit të agresionit. Por një opsion i tillë do të rrezikonte punën e GJNP dhe mbi të gjitha mbështetjen e saj nga anëtarët e përhershëm të KS¹⁷⁷. Mesa duket kjo zgjidhje ishte një kompromis në mes të superioritetit të këshillit të sigurimit dhe respektimit të sovranitetit të shtetit.

Përsa i takon juridiksionit *ratione temporis* sipas amendamenteve të miratuara, GJNP do të fillojë ushtrimin e juridiksionit mbi krimin e agresionit, pasi këto amendamente do të jenë ratifikuar nga 30 shtete si dhe pasi shtetet palë në statut të vendosin, përmes një vendimmarrjeje me mirëkuptim ose të paktën me një shumicë prej dy të tretat të anëtarëve të asamblesë së shteteve palë. Për fillimin e ushtrimit të këtij juridiksioni pas

parealizueshme përderisa shteti, anëtar i përhershëm mund të ushtrojë të drejtën e vetos.

¹⁷⁴ What Exactly Was Agreed in Kampala on the Crime of Aggression? Author: Dapo Akande Filed under: [EJIL Analysis, Special Contributions](http://ejiltalk.org/ehat-exactly-was-agreed-in-kampala-on-the-crime-of-aggression/) <http://ejiltalk.org/ehat-exactly-was-agreed-in-kampala-on-the-crime-of-aggression/>

¹⁷⁵ Neni 15/bis, pika 4.

¹⁷⁶ The Sadly Neutered Crime of Aggression by Kevin Jon Heller <http://opiniojuris.org/2010/06/13/the-sadly-neutered-crime-of-aggression/>

¹⁷⁷ *Second Thoughts on the Crime of Aggression* Andreas Paulus* *The European Journal of International Law* Vol. 20 no. 4 © EJIL 2010; p. 1126

1 janarit 2017¹⁷⁸.

Kjo periudhë do të shërbejë për shtetet anëtare të ratifikojnë këto amendamente sikurse do të mundësojnë vazhdimin e dialogut për gjetjen e kompromiseve të reja për të bërë efektivisht të zbatueshëm juridiksionin e GJNP edhe për këtë krim tashmë të parashikuar nga statuti i Romës.

Në vend të konkluzioneve.

Rezultatet e Konferencës Rishikuese të Statutit të Romës në Kampala mund të përmbidhen në sentencën “*Krimi i agresionit u përkufizua, por nuk u gjet një mekanizëm për ndëshikimin e tij*”. Agresioni iu shtua listës së krimeve të ndëshkueshme pjesë e statutit të Romës për të cilat GJNP mund të ushtrojë juridiksionin e saj. Megjithatë përcaktimi i një akti agresioni nëse ka ndodhur do të duhet t’i nënshtrohet një mirëkuptimi politik ndërmjet anëtarëve të përhershëm të KS¹⁷⁹.

Investimi i GJNP në mënyrë të pavarur do të jetë tepër i vështirë dhe me shumë kosto për të tashmen dhe të ardhmen e GJNP. Ajo lindi si formë e bashkëpunimit “*horizontal*” në mes shteteve ratifikuese të statutit. “*Forca e saj rrjedh “jo nga pushteti i saj për të vepruar në mënyrë detyruese ndaj shteteve, por më së shumti nga gjerësia e ratifikimit dhe e pranimit. Forca e saj do të vijë nga ligjitimiteti i saj*”¹⁸⁰.

¹⁷⁸ Neni 15/bis pikat 1, 2 dhe 3; neni 15 /ter pikat 1, 2 dhe 3.

¹⁷⁹ *Second Thoughts on the Crime of Aggression* Andreas Paulus* *The European Journal of International Law* Vol. 20 no. 4 © EJIL 2010; p. 1127

¹⁸⁰ The Rome Statute of The International Criminal Court A Commentary – Antonio CASSESE, Paola GAETA, and John.R. E. D. JONES, VOLUME II, P. 1912

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010

**E drejta kombëtare shqiptare e shprehur në Paris,
prej delegacionit të Kongresit të Lushnjës.
Paris, 1920**

Lavdosha Ahmetaj

Universiteti "Kristal", Tiranë

The Albanian national rights expressed in Paris, by delegation
Lushnja Congress, Paris, 1920

ABSTRACT

The paper analyzes one of the toughest in the history of the Albanian state, it reflects through the arguments, brought by the Albanian State Archives, the newspapers of the time. Through these sources, reached to explain, political awareness of the Albanian political class, about her contribution in one of the international political scene, most important, the Paris Peace Conference of 1919 to 1920. But it would be difficult përfaqësisë Albanian political work in the Peace Conference to the fact that politically there failed to find adequate support and therefore political përfaqësia Albanian delegation or produced in a democratic way by the Congress of Lushnja 1920, was facing with one of the paranoia of European diplomacy, expressing inability shqiptar. Kjo statehood had its rrjedhojë, which was accompanied by a revash politik, the delegations of neighboring states to relizuar their territorial interests. But the delegation shqiptar aware, in connection with the Albanian national law, understand coping through several directions.

First, following the political situation in Paris as the epicenter of world diplomacy.

Second, information had to convey the Government, in order to create the possibility of an analysis, serving the state. Third, their analysis consisted in the difference of views and attitudes, in the interior of world diplomacy. This led to the effect that would have the analysis, if the Albanians had friends, or global diplomacy was at its disadvantage. About this issue, distinguishing marks treatments of Wilson's view, expressed significantly, from Noli, the Sun newspaper, which was published in Boston in 1924, stating, according to Noli, when to get ear Albanians what contribution has Wilson, the protection of the right or the Albanian issue, they would build a monument in their hearts. While still below that Wilson arose from his deathbed and said: Albania, will exist.

Pas diskutimesh të shumta, Kongresi me të drejtën parlamentare zgjodhi përfaqësinë politike (delegatët), të cilët do të mbronin të drejtën shqiptare, në Konferencën e Paqes në Paris. Kjo përfaqësi përbëhej nga: Luigj Bumçi, Mehmet Konica e Mihal Turtulli, të cilët kishin qenë anëtarë të delegacionit të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit. Kjo del përmes edhe një letre që përfaqësia e kolonive të Rumanisë dhe Turqisë i dërgonte delegacionit qeveritar, me anë të së cilës i kërkonte që një pjesë e anëtarëve të tij të vinte në Shqipëri, pasi kjo ishte rrjedhojë e *“një mbledhje të fundit të datës 21 janar 1920, ku ishte pranuar njëzëri që delegacioni të ngushtohet e të përbëhet vetëm nga tre vetë, dhe luten që delegatët, të cilët nuk bëjnë me pjesë në të, të nisen sa më shpejt për në Shqipëri, me qëllim që të sqarojnë popullsinë mbi situatën e vërtetë”*¹⁸¹.

Për rrjedhojë delegatët e zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës, do të kishin të drejtën e qëndrimit në Paris dhe do të vazhdonin të ndiqnin situatën politike ndërkombëtare, duke mbajtur lidhje me qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Në funksion të ushtrimit të atributit të delegacionit, po japin disa argumente. Pikërisht, më 11 shkurt 1920, kryetari i këtij delegacioni Luigj Bumçi, në emër të delegacionit shqiptar, i dërgonte një telegram tre kryetarëve të qeverive aleate, të cilët njëherësh

¹⁸¹ AQSH. F. MPJ, dosja nr. 2 - Lufta e popullit shqiptar 1918 –1920. II, Tiranë, 1976, f. 73.

drejtonin diplomacinë evropiane. Aty kërkohet që të hiqnin dorë nga planet për copëtimin e territorit politik shqiptar (shtetit shqiptar), sepse kjo do të bënte të mundur nxitjen e “*së drejtës shovene*”, të shteteve fqinjë, të cilët e kishin bazuar politikën e tyre në dhunën karshi shqiptarëve. Në të jepeshin argumente historikë lidhur me masakrën dhe djegien e treqind fshatrave në Shqipërinë Jugore dhe aneksimin e tokave në Shqipërinë veriore me anë të dhunës dhe djegies. Shqiptarët nuk mund të harronin faktin se 90 përqind e këtyre trevave ishin shqiptare. Duke u mbështetur në interpretime të materializuara përmes dokumenteve arkivore dhe interpretimeve, të bëra nga personalitete të ndryshme të shkencës albanologjike, delegacioni kërkonte kontributin e fuqive evropiane për vendosjen e qetësisë në vend nga ata që e kishin marrë përsipër vendosjen e rendit në Shqipëri. Kështu, vijonte telegrami, ata “*sigurojnë për të ardhmen (avenir) e këtij vendi, mund të ketë shkue në mend me e shtrive Shqipërinë nën sundimin e drejtë apo nën rojen shi të atyne vetë, të cilët, për arsyt e sipërpërmendura, e kanë bjerrë moralisht të drejtën për me krye një mision të tillë*”¹⁸².

Por, sidoqoftë, delegatët e Kongresit të Lushnjës ngulmonin në mbrojtjen e sovranitetit të shtetit shqiptar¹⁸³, ndërsa nga ana tjetër kërkonin mundësisht që në Shqipëri të vinin specialistë të sferës civile dhe ushtarake, me kushtin e vetëm që këta specialistë të mos ishin prej shteteve të interesuara politikisht për Shqipërinë, por të dërguar nga Lidhja e Kombeve. Kjo zgjidhje, sipas tyre, do të ishte në të mirë jo vetëm të shtetit shqiptar, por edhe të paqes për gjithë popujt që jetonin në Gadishullin Ballkanik. Kjo do të ishte një zgjidhje racionale në funksion të qëllimit të mirë, për forcimin e paqes në Ballkan e sigurimin e së mbarës e të mirës të të gjithë popujve që rrojnë në këtë trevë. “*Kjo zgjidhje - sipas telegramit - do të ishte shumë më e fitimshme se projektet*

¹⁸² AQSH. F. MPJ, dosja nr. 2 - Lufta e popullit shqiptar 1918 –1920. II. Tiranë, 1976, f. 74.

¹⁸³ Sovraniteti sipas Jean Bodin, është ai pushtet i pakufizuar dhe i përjetshëm i një shteti, të cilin latinët e quajnë “**majestatem**”, grekët “**akran eksusian**”, “**kurion politeuma**”, italianët “**segnoria**”, një fjalë që ata e përdorin edhe për individët apo për këdo që ka në dorë punët e shtetit, ndërsa hebrenjtë e quajnë “**tomeh shevët**”, domethënë fuqia eprore për të komanduar. Këtu lind nevoja që të formohet përkufizimi i sovranitetit, sepse asnjë jurist apo filozof politik nuk e ka përcaktuar deri më sot, ndonëse, kjo është pika kryesore dhe më e domosdoshmja për t’u kuptuar në një traktat mbi shtetin (Jean Bodin “**Sovraniteti**” Tiranë, 2000, f.23)

e tjera që janë marrë parasysh, e do t'i kursente edhe vendit tonë kobin e zi të një copëtimi"¹⁸⁴.

Më 17 shkurt të vitit 1920 Luigj Bumçi nga Parisi, në emër të delegacionit të dalë nga Kongresi i Lushnjës, i dërgonte një telegram Klemansosë, duke i shprehur hidhërimin e thellë për vendimet e Fuqive të Mëdha evropiane kundër interesave kombëtare shqiptare, duke mos respektuar as parimet e kombësisë, as të drejtën e popujve për vetëvendosje. Kjo pjesë e Ballkanit, sipas Bumçit, *"ishte duke u përdorur si monedhë tregu në duart e politikës dhe diplomacisë së fuqive të mëdha evropiane"*¹⁸⁵. Ai tërhoqte vëmendjen se Italia nuk kishte asnjë të drejtë legjitime mbi Vlorën dhe hinterlandin e saj, por edhe kundrejt Shqipërisë së vogël dhe të dobët. Greqia dhe Jugosllavia gjithashtu nuk kishin asnjë të drejtë mbi pjesët e tjera të territorit shqiptar. Sipas tij, do të ishte edhe më e rëndë për territorin shqiptar, në qoftë se dhënia e një mandati mbi Shqipërinë, qoftë Italisë ose ndonjë fuqie tjetër, do të binte në kundërshtim me nenin 22 të Traktatit të Versajës.

Delegacioni e shikonte të konsumuar çështjen që lidhej me fqinjët, për faktin se ata ishin bërë të pabesueshëm politikisht. Sipas tij, këtë e kishte treguar historia e fillimit të Luftës së Parë Botërore, por edhe më pas, kur Shqipëria ishte e ekspozuar përballë invazionit ushtarak¹⁸⁶. Kështu, më 11 shkurt të vitit 1920, Luigj Bumçi i drejtohej Llojd Xhorxhit: *"...nuk mund të mos e dijnë edhe që serbët kanë aneksuem përdhuni, ndë 1913, sa e sa krahina të gjana e pjellore banorët e të cilavet janë për 90 përqind shqiptarë të fjeshtë, e që, për më tepër, se kanë lanë salvime as rrënime pa bamun kundër mijra e mijra*

¹⁸⁴ Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920. II. Tiranë, 1967, f. 80.

¹⁸⁵ AQSH. F. Kristo Dako, dosja nr. 7, Paris 17 shkurt 1920. - Telegram Luigj Bumçi Klemansosë, kryetar i Konferencës së Paqes, Paris, f. 54.

¹⁸⁶ Ne fillim të Luftës së Parë Botërore, kishte marrë një informacion, nga Manastiri, prej një kolegut të saj, *"Po ju shkruaj nga Manastiri ose nga Bitola, sepse në Perandoronë e Madhe Serbe, nuk ka qytet me emrin Manastir. Pushtimi i Bosnjes dhe i Hercegovinës si dhe krijimi i një perandorie të fuqishme dhe të madhe serbe, madje edhe më të fuqishme se ajo e Stefan Dushanit, po pushton mendjet e të gjithë ushtarkëve... Kur udhëton nga Selaniku në Manastir, habitesh nga numri fare i vogël i udhëtarëve dhe pyet, po ku shkuan gjithë këta njerëz ? Numri mesatar nuk i kalon në dhjetë, në krahësim me qindra që ndodheshin në kohën e turkut. Një përlllogaritje e përafërt na tregon se nga Manastiri kanë emigruar njëzetmijë veta"* (Edith Durham, Brenga e Ballanit, Tiranë, 1991, f.406)

shqiptarësh". Mbështetur në këto argumente, delegacioni kishte arritur në përfundimin se, politika e shteteve fqinje "*e kishin bjerrë*"¹⁸⁷ moralisht të drejtën për të kryer një mision paqësor në Shqipëri.

Delegacioni i Kongresit të Lushnjës gjithashtu mendonte se dhënia e të drejtës së mandatit një fuqie të huaj, do të ishte shoqëruar me pasoja, deri në cënimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe "*do të provokojë ngatërresa në të gjithë Ballkanin*"¹⁸⁸. Një vendim i tillë, sipas tij, binte në kundërshtim me të gjithë parimet e së drejtës (drejtësisë) ndërkombëtare dhe nuk shihej në asnjë vendim të Konferencës, qoftë edhe ndaj vendeve të mundura. Ai ishte vetëm për të kënaqur interesat e fqinjëve të Shqipërisë, të cilët nuk donin që të kishte një Shqipëri politike¹⁸⁹.

Dokumenti njëkohësisht shprehte edhe besimin që kishte delegacioni i Kongresit të Lushnjës tek drejtësia e diplomacisë evropiane, që "*do të kishin mundësinë që të kursenin Shqipërinë e dobët*", kur ishte në rrezik copëtimi i territorit të saj, humbja e karakterit të saj etnik dhe e lirisë kombëtare¹⁹⁰. Konferenca e Paqes nuk kishte pse të merrte një masë kaq të padrejtë, që do të mund të bëhej shkas për turbullime më të thella ndërbalkanike. Por delegatët mendonin se situata e rënduar mund të evitohet duke e vënë Shqipërinë nën hijen e Lidhjes së Kombeve, në të cilën bënin pjesë edhe fqinjët e Shqipërisë. Kjo do të bënte të mundur që brenda kësaj shoqërie popujsh të arrihej mbrojtja e interesave të Shqipërisë, duke evituar politikën e dhunshme midis fqinjëve ballkanikë.

Ata kërkonin njëherësh që çështja shqiptare të diskutohej në Këshillin Suprem. Në fund të letrës, që Bumçi i dërgonte Klemansosë, ai theksonte se "*delegacioni shqiptar ka nderin të kërkojë nga Këshilli Suprem një takim për të paraqitur hidhërimin e popullit shqiptar dhe për të mbrojtur të drejtat e tij*"¹⁹¹. Kështu politikisht delegacionit, do t'i krijohej e drejta, për të demaskuar rrënimet e bëra nga shteti grek në fillim të Luftës së Parë Botërore, në Shqipërinë e jugut, ku rreth treqind fshatra

¹⁸⁷ AQSH. F. Kristo Dako, dosja nr. 7, Paris 17 shkurt 1920. Telegram Luigj Bumçi Klemansosë, kryetar i Konferencës së Paqes, Paris, f. 57.

¹⁸⁸ AQSH. F. Kristo Dako, dosja nr. 7, Paris 17 shkurt 1920. Telegram Luigj Bumçi Klemansosë, kryetar i Konferencës së Paqes, Paris, f. 55.

¹⁸⁹ Shqipënia përpara Konferencës së Paqes, Ble i Dytë, Rregullimi i çështjes së Adriatikut dhe Shqipënisë. Shkodër, Shtypshkronja Françeskane 1921, f. 64.

¹⁹⁰ Po aty, f. 56.

¹⁹¹ Po aty, f. 58.

shqiptarë ishin djegur prej ushtrisë greke, me qëllimin e vetëm që t'i detyronin shqiptarët të largoheshin prej trojeve të tyre, në mënyrë që në kohën e vendosjes së Konferencës së Paqes, politika fqinjë ta kishte të drejtën, përmes institucioneve ndërkombëtare, të realizonte interesat e saj territoriale.

Në këto kushte, delegacioni i drejtohej edhe një herë “*të tre kombeve të mëdhenj liridashës të Evropës*”, duke iu lutur të zgjidhnin çështjen shqiptare. Ai nuk pranonte masa të tjera, përveç atyre që “*përkojnë me drejtësinë e me vullnetin e popullit shqiptar, e të cilat kishte për t'i pëlqyem edhe vetëdija e përbotshme. Por në qoftë pastaj se qeveritë e beslidhuna, kundër mendimit e dëshirës së popullit shqiptar që beson se asht i zoti me qeverisun vetveten, kanë për të gjykuar se ashtë nevoja që t'i jepet një ndihmë sa më e përkrahur në hapat e parë të jetës politike*”¹⁹², ata ishin të mendimit që ndihma të kufizohet vetëm në dërgimin në Shqipëri të disa specialistëve prej Lidhjes së Kombeve, në mënyrë që të shmanget mundësia e pjesëmarrjes në këtë ndihmë e vendeve të interesuara për çështjen shqiptare.

Kjo do të bënte të mundur të kufizoheshin ambiciet e mundshme të shteteve fqinjë. Kështu politika e fuqive evropiane nuk bënte gjë tjetër veçse atë që kishte bërë në lidhje me disa qytete të vegjël, të cilët u krijuan më vete nën garancinë e Lidhjes së Kombeve. Nëpërmjet vendimeve të tilla diplomacia evropiane kishte nderuar zbatimin e parimit të “*kombësiver*”¹⁹³.

Delegacioni insistonte në mbrojtjen e Shqipërisë edhe në planin ekonomik. Me kohë ata kishin demaskuar marrëveshjet e fqinjëve lidhur me ndërtimin e veprave të transportit, të cilat ishin projektuar të kalonin nëpër territorin e Shqipërisë, pasi sipas tyre populli shqiptar nuk do ta ndjente veten të lidhur me disa “*godije ekonomike*” të arrira në mënyrë të fshehtë dhe pa dijeninë e shqiptarëve, e kjo përbënte shkeljen e sovranitetit dhe të dinjitetit kombëtar shqiptar.

Ja si i drejtoheshin delegacioni Klemansosë lidhur me çështjen që po trajtojmë:

¹⁹² Shqipëria përpara Konferencës së Paqes së Parisit, Ble i Dytë. Dokumente zyrtare të paraqitura nga ana e Dërgatës Shqiptare prej 24 korrikut 1919 deri shkurt 1920, të botuara nga ana e Qeverisë së Durrësit, Shkodër, Shtypshkronja Françeskane 1921, f. 67.

¹⁹³ Po aty, f. 65.

Së pari, ata ishin në kundërshtim me marrëveshjen për ndërtimin e një vije hekurudhore Vlorë-Manastir.

Së dyti, marrëveshja e arritur mes Titonit e Venizellosit bënte të mundur ndërtimin e një vije tjetër hekurudhore, e cila do të lidhte Vlorën me Athinën, fakt që, sipas tyre, binte në kundërshtim me interesat politike të shqiptarëve, sepse delegacioni shikonte tendencat ekspansioniste të shtetit të Italisë drejt Ballkanit lindor për sovranitetin dhe pavarësinë e shtetit shqiptar.

Në vijimësinë e e problematikës së trajtuar në Konferencën e Paqes në Paris, që lidheshin me çështjen shqiptare, Luigj Bumçi dhe Mihal Turtulli nga Parisi, më 3 mars 1920, vinin në dijeni Aqif Elbasanin, lidhur me notat e shkëmbyera midis Uillsonit dhe zz. Llojd Xhorxh e Milerand, të cilat ishin botuar për herë të parë në gazetën e Uashingtonit, Londrës e Parisit: “Kemi nderin tu dërgojmë këtu copat e tyre që i përkasin Shqipërisë”. Këto letra vërtetonin “*qëllimet e liga*” të qeverive të Fuqive të Mëdha. Ato ishin botuar me vonesë për faktin se përmbajtja e tyre kishte qenë e fshehtë, ashtu siç kishte qenë edhe karakteri i politikës evropiane në vitet që analizojmë. Por, ndërsa vihet re një element i ri në diplomacinë botërore, ndërhyrja e Willsonit, bënte të mundur zhvleftësimin e marrëveshjes së 14 janarit 1919, e cila binte ndesh me të drejtën e shtetit shqiptar. Kjo kishte mundësuar që politika enigmatike e Britanisë njëherazi të orientohej drejt dobësimit të interesave të Italisë në Shqipëri¹⁹⁴

Dokumenti tërhoqi vëmendjen se Franca dhe Anglia kishin marrë vendimin, në mars të vitit 1919, që t’i lëshonin Greqisë Gjirokastrën me Korçën. “*Në këtë vendim - shkruhej në letër - qëndrojnë edhe sot. Në tjetër anë prej mendores (memorandumit) të datës 9-13 dhjetor 1919 nënshkruem prej delegatëve të Amerikës, Ingliterës e të Francës, kuptohet*

¹⁹⁴ Në 17 shkurt 1920, në përgjigjen e Willsonit, qeveritë franceze dhe britanike propozonin ndarjen e Shqipërisë midis MSKS-së dhe Italisë (ku do të merrte pjesën edhe Greqia) me përgjigjen se shqiptarët ishin “**të paaftë për t’u vetëqeverisur**”. Ishte Presidenti amerikan ai që nuk e pranoi sërish këtë plan me notën e tij të 25 shkurtit 1920, duke i kthyer çështjet sërish në pikën e tyre të nisjes... Sipas Willsonit, çështjet shqiptare nuk mund të hynin në diskutimin e propozuar midis Italisë dhe MSKS-së, duke shtuar se nuk mund të aprovonte asnjë plan që mund të kompesonte MSKS-në në veri të Shqipërisë, për ndonjë truall që mund të merrej në ndonjë vend tjetër (Kastriot Dervishi, “Historia e Shtetit Shqiptar”, Tiranë, 2006, f.106)

*se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të mendimit që Gjirokastra t'i jepet Greqisë e që çështja e Korçës të vihet përsëri në bisedim*¹⁹⁵. Më poshtë letra ndalej në qëndrimin e Uillsonit mbi pikat e Mendores së 9-13 Dhjetorit, të cilat ishin të rrezikshme për fatet e atdheut tonë, pasi kjo cënonte tërësinë tokësore të vendit dhe bënte të mundur futjen nën zgjedhën ekonomike të Jugosllavisë e të Italisë.

Me 2 mars 1920, ata i dërgonin një telegram vetë Uillsonit, nëpërmjet ambasadës amerikane në Paris, duke tërhequr vëmendjen se nuk kishin tjetër mbrojtës përveç tij. Ata mundoheshin të mos e kundërshtonin drejtpërdrejt projektin e tij, por t'i shpjegonin se realizimi i tij do të bënte të mundur ta fuste Shqipërinë nën zgjedhën e shteteve fqinjë. Për të dalë nga kjo situatë politike në të cilën ndodhej Shqipëria, ata mundoheshin të vepronin me anë të miqve të paktë që kishte ajo në këtë kohë. Kështu Luigj Bumçi kishte arritur të takonte z. Abbe Veterle, deputet i Alsazës e Lorenës dhe pjesëtar i komisionit të punëve të jashtme të parlamentit.

Kurse në 4 mars 1920, Bumçi do të shkonte në Londër që të vepronte në qarqet politike angleze me anën e miqve që kishin atje e të kardinalit të Londrës. *“Do t'ju lajmërojmë mbi rezultatet e veprimeve tona”*¹⁹⁶. Me 5 deri më 27 mars 1920, Bumçi dhe Turtulli u takuan me Lordin Robert Sesil, me sekretarin e Lidhjes së Kombeve z. Drumond, me sekretarin e z. Llojd Xhorxh, z. Filip Kerri, me ekspertin e dërgatës angleze për punët e Ballkanit. Delegatët shfrytëzuan miqësinë me Herbertin për të marrë pjesë në parlamentin anglez. Ja si e përshkruan këtë Bumçi: *“Me inisiativën e Herbertit u bënë dy mbledhje në një dhomë të parlamentit, ku morën pjesë disa deputetë të Londrës, për të biseduem mbi çështjet e Shqipërisë”*. *“Në të dyja mbledhjet qem ftuem edhe ne e patëm rastin të marrim fjalën e të shkoqitim çështjet tonë”*¹⁹⁷.

Ata u munduan të jepnin argumente që politika evropiane të kuptonte se fqinjët e Shqipërisë nuk kishin të drejtë të kërkonin copa të tjera të tokave shqiptare, përkundrazi në qoftë se e drejta do të ishte parë me dashamirësi, atëherë fqinjët duhet të kthenin ato copa *“që na i kishin*

¹⁹⁵ Hylli i Dritës, Shkodër 1944. Letra e L. Bumçit, M. Turtullit dërguar Shkëlqesës së tij Z. Aqif Pashë Elbasanit, Kryetarit të Këshillit të Regjencës në Tiranë. Paris më 3 mars 1920, f. 78.

¹⁹⁶ Po aty, f. 78.

¹⁹⁷ Po aty, f. 79.

marrë në Traktatin e Berlinit e në Konferencën e Londrës”¹⁹⁸. Në vijim kundërshtuan me forcë shpifjet e armiqve, të cilët në çdo rast mundoheshin të krijonin opinione të gabuara për shqiptarët, se “*janë të ndamun e se nuk mund të rrojnë të bashkuem e se nuk janë të zotët që të mund të qeverisin vetvetiu. Duke treguem se në Shqipëni nuk kanë çashtje marrëdhënjet midis Muhamedanëve dhe të Krishterëve, ata - tregonte Bumçi - rrojnë si vëllezër e se sot nuk ka çështje midis tyre, ata janë të lidhur me një mendje e me një zemër për shpëtimin e atdheut*”¹⁹⁹.

Delegatët, me shumë kurajo politike, në fund të mbledhjes kishin shtuar se shqiptarët nuk do t'i “*njohin kurrë Italisë pushtimin e Vlorës dhe as nuk do të pranojnë mandatin e saj mbi Shqipërinë*”²⁰⁰. Kjo duket edhe në telegramin e 17 korrikut 1920 në “Gazetën e Korçës”, që i dergonin Xholitit, lidhur me deklaratën e tij në parlament: “*Në përgjigjen që dhatë në Parlament deklaruar se Shqipëria është në anarki dhe se populli shqiptar është ndarë në dy parti. Bëjmë të njohur se gjendja në Shqipëri nuk është si e tregoni. Para disa javësh agjentë të huaj deshën të tubullonin vendin, por Qeveria shqiptare prishi planet e tyre. Në Shqipëri nuk ka partira, të tërë janë të bashkuar*”²⁰¹. Kjo tregonte tendencën antiitaliane që kishin në përgjithësi delegatët e Kongresit të Lushnjës dhe njëkohësisht frymën radikale të shprehur disa herë edhe në diskutimet e tyre me përfaqësues të shteteve pjesëmarrës në Konferencën e Paqes në Paris.

Ndërsa në takimin e ditës së dytë, që u mundësua prej miqve të Shqipërisë, afër dhomës së parlamentit anglez, delegatët tërhoqën edhe një herë vëmendjen mbi çështjen e Korçës dhe të Gjirokastrës. Kjo kishte bërë të mundur që në parlamentin anglez të shtroheshin dy pyetje, të cilat

¹⁹⁸ Po aty, f. 80.

¹⁹⁹ “Hylli i Dritës”, e përkohshme kulturore, Kallendyer 1944, f. 79. Raporte e shkurtime mbi veprimet e zhvilluem në Londër prej imzot Bumçit e dr. Turtullit në 5-27 mars 1920. (Ndërsa çështje si ato të ashtuquajturës Lëvizje Epirote dhe e Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme të vitit 1914, ishte shkaktuar, sipas tij (Luigj Bumçit), nga intrigat e vendeve të huaja, kurse Fuqitë e Mëdha nuk kishin marrë asnjë masë për të siguruar tërësinë dhe paanësinë e Shqipërisë, të cilën vetë e kishin marrë në mbrojtje në Konferencën e Londrës 1913).

²⁰⁰ “Hylli i Dritës”, e përkohshme kulturore letrare, Kallendyer 1944, f. 80. Raporte e shkurtime mbi veprimin e zhvilluem në Londër prej imzot Bumçit e dr. Turtullit në ditën 5-27 mars 1920.

²⁰¹ “Gazeta e Korçës”, 17 korrik 1920, nr. 9, f. 1 – Marrëveshja Itali - Shqipëri.

kishin të bënin me gjendjen e ushtrisë jugosllave pranë Shkodrës dhe: nëse ishte e vërtetë që “*Franca e njohu karakterin shqiptar kur ushtritë e saj ngritën flamurin shqiptar ndë atë qytet*”²⁰².

Kjo pyetje i ishte drejtuar edhe kryeministrit Llojd Xhorxh, i cili ishte përgjigjur se Këshilli i Lartë i Qeverive të Mëdha ishte duke u përpjekur të ndreqte çështjen e ushtrive jugosllave pranë Shkodrës dhe “*po ban sa të mundet që të largojë rrezikun që do të vinte nga një konflikt ndërmjet atyne ushtrive e fisevet shqiptare*”²⁰³.

Anëtarët e delegacionit shqiptar, mbasi kishin marrë vesh në Londër se Greqia kishte mbledhur në kufi të Shqipërisë jugore 7000 ushtarë, kalorës dhe topçinj për të pushtuar Gjirokastrën, kishin shkuar menjëherë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe i kishin tërhequr vëmendjen qeverisë angleze lidhur me rrjedhojat e këqija që mund të shoqëronin këtë qëndrim ndaj këtyre marrëdhënieve që linin shumë për të dëshiruar midis të dy shteteve.

Por njëkohësisht i paraqitën edhe një notë proteste z. Llojd Xhorxh, i cili kryesonte Konferencën e Paqes në Paris. Një kopje të kësaj note ata ia dërguan njëkohësisht edhe ambasadorit amerikan në Londër, i cili kishte premtuar se do t’ia dërgonte telegrafisht Uashingtonit. Ndërsa në një takim tjetër që kishin pasur me Filip Kerrin dhe Llojd Xhorxhin, të cilët i kishin dëgjuar me shumë vëmendje, ata përsëritën të njëjtët probleme si më lart, por kishin shtuar edhe çështjen e Vlorës dhe të mandatit të Italisë mbi të. Ata përmendën se shqiptarët ishin gati të derdhnin gjakun deri në fund dhe se nuk do ta pranonin kurrë copëtimin e Shqipërisë.

Një nga tezat që ata trajtuan në këtë takim ishte dhe ajo se shqiptarët ishin të zotë që të vetëqeveriseshin; se ata nuk kishin nevojë për një mandator; dhe se vetëm nga e keqja mund të pranonin që Shqipëria të futej nën hijen e Lidhjes së Kombeve, por në një mënyrë të tillë që të mos cënohej **indipendence** dhe “*as tanësia tokësore e Atdheut tonë*”²⁰⁴.

Trajtimi disa herë i çështjeve të tilla nga delegatët në Paris ishte i domosdoshëm për faktin: *së pari*, të shpëtonin Shqipërinë prej mandatit të

²⁰² Po aty, f. 82.

²⁰³ Po aty, f. 83.

²⁰⁴ “Hylli i Dritës”, e përkohëshme kulturore, Kallendyer 1944, f. 84. Raporte e shkurtim mbi veprimet e zhvilluëm në Londër prej Bumçit e dr. Turtullit në ditën 5-27 mars 1920.

shteteve fqinjë, që ishte shumë i rrezikshëm për ekzistencën e shtetit shqiptar; *së dyti*, dukej haptaz ose “faqeza”, siç thoshte Luigj Bumçi, se në mentalitetin e politikës evropiane ishte ngulitur pikëpamja që shqiptarët nuk ishin të zotë që të vetëqeveriseshin. Këto qëndrime të politikës evropiane duket se i kishin vënë në pozita edhe më të vështira delegatët e Kongresit të Lushnjës. Por anëtarët e delegacionit u përpoqën shumë për të kundërshtuar këto pikëpamje, gjë që e realizonin përmes takimeve, bisedave, memorandumëve etj. Kështu, menjëherë pas takimit që patën me z. Filip Kerri, ata përgatitën një raport të gjatë, të cilin ia dorëzuan qeverisë angleze. Njëkohësisht ata u takuan edhe me ministrin e arsimit të qeverisë angleze, z. Lord Fisher dhe Lordin Sesil. Këtij të fundit i dorëzuan një sërë dokumentesh në lidhje me padrejtësitë që kishin bërë shtetet fqinjë kundër Shqipërisë.

Duke ndjekur me kujdes zhvillimin e kontakteve të delegacionit të Kongresit të Lushnjës me personalitete të politikës angleze, arrijmë në konkluzionin se qeveria angleze ishte më e informuar në lidhje me çështjen shqiptare, dhe gjithashtu më miqësore me Shqipërinë. Ja si e pasqyrore këtë problem Luigj Bumçi: *“Prej sa kemi mundur të shohim e të gjykojmë, duket se ka një ndryshim të vogël në politikën e Ingliterrës në të mirë të Shqipërisë”*²⁰⁵. Kjo gjë dukej edhe më shumë në faqet e gazetës së madhe “Times”, e cila në vitin 1920 “nuk po dëftohet aq anmike”²⁰⁶ e Shqipërisë si më parë dhe kishte filluar të pranonte edhe ndonjë artikull në të mirë të çështjes shqiptare. Kjo tendencë e re dukej edhe përmes “Gazeta e Korçës”, e cila në 17 korrik 1920 pasqyrore interesimin e parlamentit anglez lidhur me marrëveshjen midis Italisë dhe Shqipërisë, e cila shpresonte në përmirësimin e marrëdhënieve midis dy shteteve *“Ministri i Punëve të Jashtme, duke iu përgjigjur pyetjes për çështjen shqiptare tha: Se marrëveshjet midis Italisë dhe Shqipërisë po vazhdojnë në Tiranë. Pas deklaratës së Xholitit se Italia nuk do protektoratin e Shqipërisë, kemi shpresë se marrëveshjet do të përfundojnë duke kënaqur të dy palët, të cilat do të lehtësojnë punën e Këshillës së Naltë për të vënë kufijtë e Shqipërisë”*²⁰⁷.

Ky përbënte një element pozitiv. Po t’i referohemi një diskutimi të Luigj Bumçit në Universitetin Katolik të Parisit, në korrik 1920, ai

²⁰⁵ Po aty, f. 84.

²⁰⁶ Po aty, f. 84.

²⁰⁷ “Gazeta e Korçës”, 17 korrik 1920 f. 1, nr.9. (Marrëveshja italo-shqiptare).

tërhiqte vëmendjen e gazetave të huaja për të botuar artikuj lidhur me zgjidhjen e çështjes shqiptare, kur për këtë duhej një shumë e konsiderueshme të hollash, që shqiptarët nuk i zotëronin sa duhet. Vihej re se në faqet e gazetave pasqyroheshin më shumë trajtesa negative për shqiptarët, se sa mundësitë e zgjidhjes. Kjo mbasi mbizotëronte propaganda kundër Shqipërisë, që mbështetej nga armiqtë e saj. Ja si reflektohej kjo edhe në Londër, si kudo. *“Po na thonë - tërhiqte vëmendjen Bumçi, - se shqiptaret nuk janë të një mendimi; se një pjesë e shqiptarëve kanë kërkuar Greqinë, disa Italinë e disa Jugosllavinë”*. Për shqiptarët, të gjendur përballë kësaj propagande kaq të egër dhe të organizuar njëkohësisht, *“duhej shumë bashkim, shumë urtësi dhe shumë durim prej tyre, që të fitojmë sympathien e botës”*²⁰⁸. *“Në këto kushte politike dhe historike, - shkruante Luigj Bumçi, - jam përballur me një ide të kristalizuar shumë qartas. Fatkeqësisht, në përbërjen e vendimmarrësve evropianë mendohej se shqiptarët nuk kishin aftësi të vetëqeveriseshin në trevat e tyre, të cilat pretendojnë etnikisht”*²⁰⁹.

Në këto kushte Bumçi gjykonte nga Parisi se ishte e domosdoshme të garantohej mbështetja e kancelarive evropiane, për të siguruar synimet në drejtim të zgjidhjes së çështjes shqiptare: *“Pikë së pari duhet pra të kemi bashkim të plotë - porosiste ai, - urtësi të madhe, durim e nderim për njëri- tjetrin. Duhet të shuajmë hidhërimin e meritë që na ndajnë, të respektojmë mendimin e shokëve tanë e të mos ftohim e të mos ashpërsojmë marrëdhëniet midis shqiptarëve prej çdo krahinash e prej çdo fenash që të jenë. Për të mirën e atdheut duhet që më i madhi të bahet më i vogël përpara të tjerëve. Udha politike tjetër që duhet të mbajmë asht kjo. Të mundohemi të përfitojmë nga interesat kundërshtare të njenit e të tjetrit e të përpiqemi të fitojmë besimin e miqve e nderin e anmiqve”*²¹⁰.

Pikërisht nëpër këtë labirinth faktesh dhe ngjarjesh punonte delegacioni shqiptar në Paris, duke shprehur maturi dhe pjekuri në momentet më delikate të historisë së kombit shqiptar. Duke treguar edhe njëherë përkushtimin e tij në funksion të çështjes shqiptare, ai u mundua

²⁰⁸ “Hylli i Dritës”, Shkodër, qershor-korrik 1944, nr. 6-7. Raport me shkurtim mbi veprimin e zhvilluem në Londër prej imzot Bumçit e dr. Turtullit, Paris më 30 mars 1920, f. 82.

²⁰⁹ Po aty, f. 84.

²¹⁰ Valentina Duka - Shqiptarët në rrjedhën e shekullit XX. Tiranë, 2001, f. 169.

të ndiqte situatat politike nëpër të cilat ishte duke kaluar historia e Shqipërisë, për të treguar maturinë dhe dëshirën për të kontribuar në rinjohjen e pavarësisë së shtetit shqiptar dhe të tërësisë së tij territoriale.

Parë në këtë kontekst, kontributi i delegacionit shqiptar duhet vlerësuar si një faktor i rëndësishëm, i cili kontribuoi në mbrojtjen e shtetit shqiptar në rrafshin ndërkombëtar, pikërisht në Paris, ku ishte njëherësh dhe qendra e diplomacisë botërore. Ky kontribut konsiston në këto drejtime kryesore:

Së pari, në analizat që ata bënin përmes gazetave të kohës, që publikoheshin në kryeqendrën botërore, Parisi.

Së dyti, këto anaiza arrinin të bënin dallimin e aktorëve të politikës botërore, sidomos midis Amerikës dhe Evropës, për këtë ata sipas informacionit, që dispononin në mesin e prillit 1919, botuan një sërë artikujsh, duke kritikuar qëndrimin e Willsonit se, ai nuk e kishte njohur mirë situatën në Shqipëri dhe për rrjedhojë kishte rekomanduar pa të drejtë dhënjen e Korçës dhe Gjirokastrës, shtetit grek. Por ndjekja e situatës në dinamikë, kishte bërë të mundur, që delegacioni të tregonte respekt ndaj Willsoni, sepse ai kishte demaskuar dhe nuk ishte dakord me projektet e Anglisë dhe Francës, të cilat në analizën që i bënin rivendosjes së kufijve, bazoheshin në teorinë e vjetër, të ekuilibrit të forcave²¹¹, që do të thoshte, kënaqia e interesave të shteteve fqinje, duke tkurrur dhe copëtuar kufijtë politikë shqiptarë.

Së treti, krijimi i një situatë të brendshme shqiptare, politikisht e favorshme, i krijonte mundësi delegacionit për të qenë më kurajoz dhe i vendosur në mbrojtje, të së drejtës kombëtare shqiptare. Kjo, për delegacionin ishte shumë e qartë, për faktin se ata e kuptonin se, territori i një kombi, pavarësisht nëse është i madh ose i vogël, i jep një kombi

²¹¹ Çështja nga e cila varet plotësisht paqiadhe politika e ardhshme e botës, është kjo: është lufta sovranë një luftë për një paqe të drejtë e të sigurt apo vetëm për ekuilibër të ri force?...Nuk duhet të ketë ekuilibër force, por bashkësi force, jo armiqësi të organizuara, por një paqe e përbashkët e organizuar (Henry Kissinger, Diplomacia, **Doktrina Monroe**, Tiranë 2005, f.51). Willsoni më 1918 shpalli si një kërkesë për paqen qëllimin befasues e ambicioz, të padëgjuar deri atëherë, të shkatërrimit të çdo fuqie autoritare, kudo qoftë, që veçmas, në mënyrë të fshehtë dhe vetëm me vullnetin e saj, prish paqen në botë, ose në rast se nuk shkatërrohet aktualisht, dobësimin e saj deri në një fuqi të vërtetë (Henry Kissinger, Diplomacia, **Teodor Ruzvelti apo Willson**, Tiranë. 2005, f.52).

shumë prej tipareve të tij²¹². Kjo, shënon rritjen e burimeve të tij, të popullsisë së tij, të forcës së tij fizike, ai shënon ndryshimin midis fuqive të mëdha dhe fuqive të vogla, që do të thoshte se, raporti midis shtetit shqiptar dhe shteteve fqinje varej nga territori etnik, që do t'i lihej shtetit shqiptar, që do të përcaktonte dhe forcën dhe vitalitetin (pra të drejtë, nënvizimi L. Ahmetaj) politik të kombit shqiptar. Kjo është e natyrshme në kushtet e një nacionalizmi të egër, që e kishte mbërthyer Ballkanin dhe Evropën në vitet 1920.

BIBLIOGRAFIA:

1. Henri Kissinger, Diplomacia, Tiranë, 2005.
2. Kastriot Dervishi, Historia e shtetit shqiptar, Tiranë, 2006.
3. Eqerem bej Vlora, Kujtime, Tiranë, 2005.
4. Valentina Duka, Shqiptarët në rrjedhën e shekullit XX, Tiranë, 2001
5. Edith Durham, Brenga e Ballkanit, Tiranë, 1991.
6. Paskal Milo, Shqiptarët dhe Jugosllavët, Tiranë, 1992.
7. Arben Puto, Shqipëria politike, Tiranë, 2008.
8. Arben Puto, Historia e diplomacisë shqiptare, Tiranë, 2003.
9. Arben Puto, Akte të Fuqive të Mëdha, Tiranë, 2001.
10. Mariglen Verli, Reforma agrare kolonizuese në Kosovë, Tiranë, 1992.
11. Jean Bod, Sovraniteti, Tiranë, 2000.
12. Thoma Murzaka, Politika serbe kundër Shqipërisë, Tiranë, 1987.

²¹² Henry Kissinger, Diplomacia, Tiranë, 2005, f.31.

Bashkimi Evropian (BE) dhe Shqipëria...

Aurora Spahia, Aurela Kasmollari

Universiteti “Kristal”, Tiranë

European Union (EU) and Albania

ABSTRACT

EU integration is seen simply as an opportunity to move freely and member countries without a visa and a wider study opportunities and employment in these countries. This, due to the country where unemployment levels are high and one of the main hopes is immigration. Many European countries among which Albania adheres to join the EU. This is even as the introduction to the promised land as the solution to all problems may face a state or a government over its governance. But will it really happen this way? Is the EU really the key to solving all problems of our state? On the other hand we have and developed countries, which are states of the European continent, but they have refused to be part of that organization eg Switzerland, Norway etc. Seeing so desire and the great efforts of some states to be part of the EU, and in turn failing to include some other developed countries of Europe, which have every chance to be part of the European Union arises naturally desire to know more about the EU, its history and functioning, to knowing the reason why it is so important to be part of this family? ...

“ Bashkësia që kemi krijuar nuk është një qëllim në vetvete. Komuniteti Është vetëm një hap në rrugën drejt botës së organizuar të së nesërmes” .

Jean Monnet

Politika e bashkëpunimit evropian i ka fillesat e saj menjëherë pas Traktatit të Romës të vitit 1957, ku shprehet qartë rëndësia e lidhjeve të zonave gjeografike evropiane me pjesën tjetër të botës. Duke parë rrugën e gjatë që duhet ndjekur, përpjekjet, reformat institucionale dhe monetare, ndryshimet legjislative etj., detyrimet apo kriteret që duhet të plotësojë një shtet evropian për të qenë anëtar i Bashkimit Evropian natyrshëm na lind pyetja: *“Përse është kaq i rëndësishëm për një shtet të qenurit anëtar i Bashkimit Evropian, i njohur ndryshe me termin BE” ? Cili është qëllimi apo synimi i BE? Përse u krijua, dhe si lindi nevoja për krijimin e një organizimi të tillë të përbërë prej një numri të madh shtetesh evropiane dhe që po synon zgjerimin e mëtejshëm duke nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshje të ndryshme (më e rëndësishmja MAS, marrëveshja e stabilizim-asociimit, marrëveshja për lëvizjen e lirë të qytetarëve, si dhe një sërë marrëveshjesh të tjera në planin ekonomik, social, në sistemin gjyqësor etj, hapa këto të nevojshme dhe të rëndësishme të integritit evropian. Procesi i integritit, megjithëse zë një pjesë të madhe të diskutimeve dhe të iniciativave qeveritare dhe institucionale, në disa raste nuk kuptohet qartë dhe në masën e gjerë të publikut ka një deformim të imazhit dhe të objektivave të integritit. Në shkallë të gjerë integriti në BE është parë thjesht si një mundësi për të lëvizur lirisht dhe pa vizë në vendet anëtare dhe me një mundësi më të gjerë studimi dhe punësimi në këto vende. Kjo për vetë kushtet e vendit ku nivelet e papunësisë janë të larta dhe një ndër shpresat kryesore është emigracioni. Shumë vende të Evropës, ndër to edhe Shqipëria aderojnë për t’u anëtarësuar në BE. Kjo shihet madje dhe si futja në tokën e premtuar, si zgjidhja e të gjitha problemeve që mund të përballët një shtet apo një qeveri gjatë qeverisjes së saj. Por a do të ndodhë me të vërtetë kështu? A është me të vërtetë BE-ja çelësi për zgjidhjen e të gjitha problemeve të shtetit tone? Nga ana tjetër kemi dhe vende të zhvilluara, të cilat janë shtete të kontinentit evropian, por të cilat nuk kanë pranuar të jenë pjesë e këtij organizimi si p.sh., Zvicra, Norvegjia etj. Duke parë kështu dëshirën dhe përpjekjet e mëdha të disa shteteve për të qenë pjesë e BE-së, dhe nga ana tjetër mospërfshirjen e disa shteteve të tjera të zhvilluara të Evropës, të cilat i kanë të gjitha mundësitë për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian, natyrshëm lind dëshira për të ditur më shumë rreth BE-së, historisë dhe funksionimit të saj, për të ditur arsyen se përse është kaq e rëndësishme të jesh pjesë e kësaj familjeje?...*

1. Nën gjurmët e historikut të Bashkimit Evropian

Ideja e një bashkimi evropian ka filluar shumë më herët se vitet 50. Shkrimtarë, filozofë, mendimtarë të shquar si Hygo apo Ruso kishin mendimin e një bashkimi politik, ekonomik dhe kulturor, të inspiruar nga idealet humane të kohës. Kjo ishte një ëndërr shumë e bukur për të parë Evropën në paqe dhe në harmoni, por që u zbeh dhe u venit nga dy luftërat botërore që e përçanë dhe e shkatërruan këtë ëndërr. Shkaku fillestar për themelimin, e çka më vonë do të bëhej Bashkimi Evropian ishte dëshira për ta rindërtuar Evropën pas ngjarjeve shkatërrimtare të Luftës II Botërore, ashtu si edhe vullneti i mirë për të parandaluar shpërthimin e konflikteve të ngjashme në të ardhmen. Me këtë synim, të shumtë ishin ata që mbështetnin idenë e krijimit të një lloj federate apo qeverie evropiane, si p.sh. Adenauer, Çerçill, de Gasperi, Shuman e të tjerë vendosën të bindnin popujt e tyre të hynin në një epokë të re. Pas Luftës së Dytë Botërore u intensifikuan përpjekjet për një bashkëpunim dhe forma më e mirë ishte bashkëpunimi ekonomik, për të krijuar një stabilitet më të lartë, pikërisht në një kohë kur vendet evropiane ishin të përçara, ku Evropa Lindore ishte nën influencën ideologjike komuniste. Kjo mënyrë e vendosjes së vendeve së bashku politikisht dhe ekonomikisht është një mënyrë për të konsoliduar demokracinë. Politika e bashkëpunimit evropian i ka fillesat e saj kur gjashtë vende (Gjermania, Franca, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu), u mbledhën për të nënshkruar një traktat në vitin 1951, për të krijuar Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut në Paris. Synimi i tij ishte të bashkonte burimet e çelikut dhe qymyrit të shteteve anëtare, në mënyrë që të shmangte një luftë tjetër në Evropë. Kjo ide ishte frymëzuar nga një plan i zyrtarit francez Zhan Mone, me mbështetjen e ministrit të jashtëm francez Robert Shuman. Shumani kishte shpallur propozimin e tij për krijimin e një Evrope të "*organizuar*", e cila sipas tij ishte e domosdoshme për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore. Ky propozim, i njohur më vonë në histori si "*Deklarata e Shumanit*", konsiderohet si nismëtar i embrionit të Bashkimit Evropian. Traktati që krijoi Komunitetin Ekonomik Evropian (1957 në Romë), ishte më ambicioz në objektivat e tij ekonomike, por më pak i rëndësishëm në ato politike. Ai synonte të krijonte një treg të vetëm të përbashkët, në të cilin mallrat, kapitali, shërbimet dhe njerëzit të mund të

lëvizin lirisht brenda Komunitetit Evropian (siç filloj të quhej Komuniteti Ekonomik Evropian). Qëllimi i KEE ishte të krijonte një bashkim doganor mes gjashtë anëtarëve themelues, të bazuar në konceptin e "*katër lirive*": liria e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Ai parashikonte dhe një bashkim gjithnjë e më të ngushtë ndërmjet shteteve dhe popujve të Komunitetit Evropian. Që nga viti 1950, anëtarësimi dhe qëllimi i politikës së BE-së ka ndryshuar në mënyrë mjaft të ndjeshme, për shkak të ndryshimeve politike dhe situatave ekonomike në Evropë dhe jashtë saj. Krijimi i një tregu të vetëm në fund të vitit 1980 dhe në fillim të 1990-ës pati një efekt magnetik të fuqishëm mbi Austrinë, Finlandën, Norvegjinë, Suedinë dhe Zvicrën, të cilat aplikuan për t'iu bashkuar BE-së (tre nga të cilat ia arritën). Ndërmjet viteve 1973 e 2004, BE-ja u rrit nga 6 në 25 shtete anëtare. Me sukseset e njëpasnjëshme të Komunitetit Evropian, gjithmonë e më shumë vende shfaqën dëshirën për t'u bërë pjesë e kësaj organizate. Në vitet 80 KE u zgjerua me Greqinë (1981) dhe më tej me Spanjën dhe Portugalinë (1986). Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, lindi sërish vullneti për ta ribashkuar Evropën. Shtytja kryesore për këtë ishte dëshira për të thelluar marrëdhëniet me vendet e Evropës Lindore, për të zhvilluar demokracinë dhe për të parandaluar rrezikun e rishfaqjes së komunizmit apo diktaturave në këto vende. Vendet e ish-bllokut sovjetik, si Çekia, Hungaria, Sllovakia, Polonia e të tjerë shprehën vullnetin e tyre për të bërë pjesë në familjen e madhe evropiane, së cilës i përkisnin jo vetëm gjeografikisht, por edhe nga ana historike dhe kulturore. Përparimet e shpejta të këtyre vendeve për vendosjen e demokracisë, shtetit ligjor dhe funksionimit të ekonomisë së tregut iu dhanë shpejt të drejtën për të kandiduar për anëtarësim në BE. Zgjerimi më i fundit i Bashkimit Evropian ndodhi në 1 Maj të këtij viti, kur 8 vende të ish-bllokut sovjetik (Çeki, Sllovaki, Hungari, Poloni, Estoni, Letoni, Lituani, Slloveni) dhe Qipro e Malta u anëtarësuan në BE.

Bazat e Bashkimit Evropian përcaktohen në disa traktate, ndër të cilët do të përmendnim:

- **Traktatin e Parisit**, me të cilin u themelua Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut në vitin 1951.
- **Traktatet e Romës**, (1957) ku u krijuan Komuniteti Ekonomik Evropian dhe Komuniteti Evropian i Energjisë Bërthamore. KEE

ishite zanafilla e një epoke të rene historinë evropiane. Kur i referohemi "Traktatit të Romës", bëhet fjalë përtraktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian.

- **Traktati i Mastrihtit**, (1993) ku KEE u pagëzua thjesht "Komuniteti Evropian" dhe u krijua Bashkimi Evropian, duke i shtuar fusha të reja bashkëpunimi ndërqeveritar sistemit të komuniteteve. Po ashtu, ky traktat vendosi edhe synime të reja për vendet anëtare: bashkimin monetar deri në vitin 1999, nënshtetësinë evropiane, politika të reja të përbashkëta - përfshirë politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë.

1. Çfarë është integrimi evropian?

Integrimi nuk duhet përcaktuar si eliminim i thjeshtë kufijsh, i cili do të bëjë të mundur lëvizjen e lirë drejt vendeve të Evropës. Në fakt integrimi në BE është një proces krejt tjetër dhe me pasoja të ndryshme. Integrimi në Bashkimin Evropian nënkupton, së pari, përafrimin dhe përqafimin e vlerave themelore prej të cilave është ndërtuar e jeton ky organizëm i madh ndërshtetëror: *Demokracia, shteti i së drejtës, mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare.*

Për shkak të një historie të gjatë izolimi e vështirësish ekonomike, integrimi perceptohet shpesh si një mundësi për të lëvizur në Evropë, duke lënë në harresë faktin se kjo lehtësi vjen vetëm si rezultat i konsolidimit të demokracisë dhe sigurisht zhvillimit të ekonomisë. Procesi i integritit duhet kuptuar si një program reformash që e afron vendin me modelin evropian të shtetit, demokracisë dhe funksionimit të ekonomisë, por jo thjesht si lëvizje e lirë drejt perëndimit. Së dyti, procesi duhet të përfshijë angazhimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë. Anëtarësimi në BE nënkupton një bashkim shtetesh të barabarta në të drejta dhe detyrime, të cilët sigurojnë kushte të njëjta për qytetarët e tyre. Të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian funksionojnë mbi bazën e demokracive liberale, në të cilat shteti i së drejtës është i konsoliduar, ligji është i barabartë për të gjithë dhe të drejtat e njeriut janë të shenjta. Përqafimi i vlerave të demokracisë është vendimtar dhe themelor për vendet që aspirojnë për anëtarësim në BE. Të pranohesh në "grupin" e vendeve evropiane nënkupton të përqafosh të njëjtat parime dhe vlera si

ato të anëtarëve të këtij klubi. Sigurisht që këto vlera dhe parime lidhen pandashmërisht me zhvillimet historike, me filozofinë që qëndron në bazën e shtetit dhe me kushtet e veçanta sociale, ekonomike dhe kulturore, të cilat kanë çuar në lindjen e tyre. Të gjitha këto vlera dhe parime lidhen me bazën kulturore të shoqërisë, si pasojë ndryshimet dhe disnivelet kulturore janë shkaqet kryesore të vonësive në proceset e integritit dhe në moskuptimin e kërkesave dhe insistimeve për plotësimin e standardeve të caktuara. Bashkimi Evropian përbëhet nga vende sovraane, të cilat e kanë përqendruar sovranitetin e tyre në shumë fusha me rëndësi themelore për qytetarët e tyre. Bashkimi Evropian ka krijuar një monedhë të përbashkët dhe një treg të përbashkët në të cilin njerëzit, shërbimet, mallrat e kapitalet lëvizin lirisht. BE përpiket të bëjë të mundur që, nëpërmjet përparimit shoqëror dhe konkurrencës së ndershme, sa më shumë njerëz të përfitojnë nga të mirat e tregut të përbashkët.

2. Zhvillimi i marrëdhënieve Shqipëri – Bashkimi Evropian

Kontaktet e para me BE-në, i kanë fillesat që në momentet e para të Demokracisë në fillim të viteve 1990. Kështu, më 1990 një nga kërkesat e para të shtetit post totalitar shqiptar drejtuar ish “botës armike” ishte ajo drejtuar KE. Kjo kërkesë u materializua me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe BE-së një vit më vonë.

Ngjarja më e rëndësishme në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe BE-së u shënuar një vit më vonë, në 11 maj 1992, me nënshkrimin e marrëveshjes së tregtisë dhe të bashkëpunimit.

Me gjithë hapësirën dhe përmbajtjen e kufizuar, kjo marrëveshje përbën një ndër dokumentet kontraktuale më të rëndësishme që Shqipëria ka nënshkruar në 10-vjeçarën e kaluar, e cila e lidhi përfundimisht vendin tonë me BE-në. Marrëveshja e tregtisë dhe bashkëpunimit e 11 majit 1992 i krijoi mundësinë Shqipërisë që të përfitojë nga fondet e programit PHARE. Kjo përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të ristrukturimit të asistencës së BE-së ndaj Shqipërisë në një sërë fushash që përkonin me reformat në të cilat ishte angazhuar vendi ynë. Më 1996, Shqipëria ishte pranë nënshkrimit të një marrëveshjeje të re kontraktuale me BE-në, e cila, do të hapte rrugën për një marrëveshje klasike asociimi. Por,

zgjedhjet e kontestuara parlamentare të majit të vitit 1996, dhe kriza e thellë financiare dhe sociale që pasoi në fillim të vitit 1997 nga rënia e skemave piramidale, bënë që të dështojë çdo iniciativë në këte drejtim. Zhvillimet politike në vende të ndryshme të rajonit tonë në këtë periudhë, shpërbërja e ish-Jugosllavisë, krijimi i një sërë shtetesh të reja, bënë që në vitin 1996 Bashkimi Evropian të adaptonte për vendet e Ballkanit politikën e quajtur “Regional approach” (përqasje rajonale). Këshilli i çështjeve të përgjithshme, në këtë kohë, përcaktonte një sërë kushtesh politike dhe ekonomike që vendet e Ballkanit duhej të plotësonin për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet e tyre me BE-në. Këto kritere kishin të bënin me respektimin e parimeve demokratike, liritë dhe të drejtat e njeriut, ndërtimin, respektimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen e minoriteteve, zhvillimin e ekonomisë së tregut, si dhe bashkëpunimin rajonal. Në maj të vitit 1999, Bashkimi Evropian miratoi një iniciativë të re me synimin e vetëm të vendosjes së marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet BE-së dhe vendeve të lartpërmendura, nëpërmjet Marrëveshjeve të Stabilizim-Asocimit (MSA) për 5 vende të Ballkanit: Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Republika Federale Jugosllave, të quajtur Proces i Stabilizim-Asocimit (PSA). Shqipëria u bë pjesë e saj. Qëllimi i marrëveshjes së stabilizim-asocimit është vendosja e stabilitetit politik dhe ekonomik të shtetit kandidat. Perspektiva e vendeve të rajonit perëndimor për integrimin në Bashkimin Evropian përforcohet pas Këshillit Evropian të Feiras i mbledhur më qershor 2000, i cili vendosi se të gjitha vendet e përfshira në Procesin e Stabilizim-Asocimit janë kandidatë potenciale për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Më 2001. Këshilli i Ministrave të BE-së miratoi raportin e komisionit dhe i kërkoi atij që të paraqiste një projektmandat për hapjen e negociatave me Shqipërinë përpara fundit të vitit 2001. Negociatat u hapën zyrtarisht nga Presidenti i Komisionit Evropian Z. Romano Prodi më 31.01.2003. Për t’u bërë anëtare e BE-së, Shqipëria duhet të plotësojë kriteret e vendosura për të gjitha shtetet candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian të miratuara nga Këshilli Evropian i Kopenhagenit në qershor të vitit 1993. Këto kritere janë të karakterit politik dhe ekonomik dhe parashikojnë:

- Garantimin e demokracisë, shtetit të së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.

- Vendosjen e një ekonomie tregu që mund t'i bëjë ballë presionit konkurrues dhe forcave të tregut të përbashkët evropian.
- Shteti kandidat duhet të jetë i aftë t'u përgjigjet detyrimeve që rrjedhin nga "*acquis communautaire*" ose legjislacioni i Bashkimit Evropian.

LITERATURA:

1. Prof. Paskal Milo, "Bashkimi Evropian", Tiranë, 2002.
2. Robert Schumann, "Në emër të Evropës". Botim në shqip. Tiranë, 2002.
3. Robert Soin "Evropa Politike: Historia, krizat e zhvillimit dhe perspektivat e proceseve të integritit". Botim në shqip. Tiranë, 2008.
4. Gauttier Pascal (2004), Horizontal Coherence and the External Competences of the European Union, European Law Journal, Vol 10

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bul. Shk., Ser. Shk. Ekon. - Jurid., 2010

Integrimi evropian i shqiptarëve dhe trashëgimia kulturore

Ardian Hoti

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Departamenti i gazetarisë

European integration of Albanians and cultural heritage

ABSTRACT

It has been widely spoken of European integration of Albanians. It is expected that Albania becomes part of European Union with equal rights, because actually it feels this way. Albanians think of integration as the solution of many problems and as a hope that the development of their country would become a reality. We have Albania, Albanian nation, Albanian language which we have been fighting for many centuries, to save this identity. On the other hand in the beginning of 21st century we have an opening of the boundaries, meanwhile thousands of Albanian families created their families abroad 20 years ago. As we think of this a question arises: What will happen with Albanian identity, with the fact of being Albanian, Albanian language speakers, conveyor of Albanian tradition characteristics as the doors of Europe are opened

Është folur shumë për integrimin evropian të shqiptarëve. Pritet që Shqipëria të bëhet pjesë reale me të drejta të barabarta në Bashkimin Evropian, pasi realisht ndihet si e tillë. Shqiptarët e mendojnë integrimin

si një zgjidhje të shumë problemeve dhe si shpresë se zhvillimi i vendit do të bëhet realitet. Nga njëra anë kemi Shqipërinë, kombin shqiptar, gjuhën shqipe për të cilat është luftuar me shekuj për të ruajtur këtë identitet. Nga ana tjetër në fillim të shekullit të 21-të kemi një hapje të kufijve, ndërkohë që prej 20 vitesh mijëra familje shqiptare kanë krijuar jetët e tyre jashtë vendit. Ndërsa mendon një gjë të tillë lind pyetja: “Çfarë do të ndodhë me identitetin shqiptar, me të qenurit shqiptar, shqipfolës, mbartës të karakteritikave, të traditës shqiptare, ndërsa dyert e Evropës janë hapur”?

Në këtë punim do të mundohemi t’i japim përgjigje kësaj pyetje. Si bazë teorike kemi përdorur literatura të ndryshme, ndërkohë që një vend shumë të rëndësishëm në këtë punim zënë përfundimet e arritura nga anketimet e bëra me shqiptarët.

Kemi hipotezën “*Integrimi evropian çon në dobësimin e traditave të kombit*”. Për të vërtetuar këtë hipotezë na duhen dy variabla x dhe y. Variabli x nënkupton integrimin evropian dhe është variabli i pavarur. Ndërsa variabli y nënkupton dobësimin e vlerave dhe traditave të kombit dhe është variabli i varur.

Për të vërtetuar këtë hipotezë duhet të shohim nëse ka lidhje shkakore mes dy variablave x dhe y. Duhet të shohim nëse ndryshimet e njërit mund të sjellin edhe ndryshime tek tjetri.

Për të vërtetuar këtë hipotezë do të përdorim metodat krahasuese. Pjesë e krahasimit janë eksperiencat e marra nga familjet shqiptare që kanë emigruar shumë vite më parë nga Shqipëria, si dhe të familjeve që vazhdojnë të jetojnë këtu. Kemi parë nga afër çfarë ka ndodhur me vende të tjera që në momente të caktuara historike kanë kaluar situata të ngjashme me Shqipërinë, kemi bërë intervista me shqiptarët që jetojnë në Shqipëri, vëzhgim në forumet e shqiptarëve në tema që flasin për integrimin në BE, si dhe literaturë akademike që trajtojnë çështje të tilla.

Kur flasim për “*integrim evropian*” duhet të kemi të qartë se çfarë nënkuptojmë me termin “*Evropian*”. Në këtë kontekst me fjalën “*evropian*” kuptojmë BE-në që është themeluar me 7 shkurt të vitit 1992 bazuar mbi Konventën Evropiane. Misioni i BE-së është të organizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe me solidaritet marrëdhëniet midis shteteve anëtare dhe të popujve të tyre. BE ka një politikë të jashtme dhe të brendshme që mbron vendet anëtare. Ka si qëllim

zhvillimin politik dhe ekonomik të të gjitha shteteve dhe popujve të këtyre shteteve që bëjnë pjesë në BE.²¹³

Pasi shpjeguar shkurtimisht kontekstin e fjalës evropian, do të ndalemi tek termi integrim. Ndërsa themi “*Integrimi evropian i Shqipërisë*” ne mendojmë rrugën e vendit tonë drejt BE-së, për t’u bërë kështu pjesë e këtij “*shteti*” evropian. Nisur nga shpjegimet që dhamë mund të themi se me “*integrim evropian*” kuptojmë rrugën drejt përfshirjes në BE. Cili do të jetë identiteti ynë në familjen e madhe evropiane? A do të mundemi ne të ruajmë trashëgiminë kulturore, doket dhe zakonet tona duke qenë pjesë e një shteti evropian në BE?

Pas përmbyesjes së sistemit diktatorial komunist, Shqipëria ktheu sytë nga përendimi. E etur për liri, demokraci, pronë private, për një ekonomi më të mirë, Shqipërisë i duhej të takohej me Evropën.

Fakti që ne një jemi një shtet evropian (gjeografikisht), dhe jemi shumë pranë vendeve lidër në BE, na bën të shohim drejt integritit tonë në BE, si rruga më mirë për të qenë një shtet me norma ligjore dhe zhvillim ekonomik siç i takon një vendi, i cili kërkon të bëhet pjesë e BE-së.

Lind pyetja: “*A na pranon Evropa me vlerat dhe traditat tona që kemi*” ?

Motoja e BE-së është ‘*Unitet në diversitet*’ pra ‘*të ndryshëm por të bashkuar*’. BE sipas kushtetutës së saj pranon traditat, vlerat dhe kulturën e secilit nga shtetet anëtare. Në traktatet e ndryshme që përbëjnë kushtetuten e BE-së nuk kërkohet as ndërrimi i fesë, as ndryshimi i vlerave apo traditave si kusht për të hyrë në BE²¹⁴. Përsa i përket anës juridike dhe ligjore në kushtetuten e BE-së, si një e drejtë e pamohushme e çdo shteti është ruajtja e vlerave dhe traditave. Pra përsa i përket anës juridike nuk na del asnjë pengesë që të ruajmë fort vlerën dhe traditën tonë kulturore si shqiptarë gjatë rrugës së integritit në BE. Por në fakt sa jemi konservatorë në ruajtjen e tyre?

Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje kemi bërë disa vëzhgime dhe anketime. Grupin e parë të anketimeve e zënë shqiptarë që jetojnë jashtë prej 15 vitesh. Të intervistuarit jetojnë në: Greqi, Itali, Francë, Angli, Gjermani, Hollandë, Belgjikë, Zvicër. Nga secili shtet janë intervistuar 15

²¹³ Pierre-Yves Monjal, *Termet juridikë evropianë*, Tiranë, 2009, f. 22.

²¹⁴ Po aty.

familje shqiptare. Kemi marrë familje që jetojnë në vendet e BE-së, pasi duam të shohim integrimin e tyre në këtë realitet evropian, duam të shohim si qëndron raporti i ruatjes së traditave dhe vlerave në këto familje shqiptare që jetojnë në vendet e BE-së. Situata është e ndryshme. Po publikojmë dy intervista që në një farë mënyre janë përfaqësuese e këtij blloku intervistash.


Kemi një familje shqiptare që jeton në Angli. Kryefamiljari Qemal Kodra i pyetur në lidhje me traditën dhe kulturën shqiptare në vendin ku ai jeton shprehet: *“Jo vetëm unë, por të gjithë shqiptarët që jetojnë në Angli jetojnë shumë mirë. Vazhdojmë të jetojmë me kulturën dhe traditën shqiptare. Nuk na pengon askush të mbajmë dhe të ruajmë vlerat e kombit tonë. Përkundrazi vlerat që kemi sjellë nga Shqipëria, të qenurit një familje e fortë, një besim i fortë, një sjellje e mirë dhe shumë elemente të kulturës sonë na kanë ndihmuar të jetojmë këtu”*, shprehet ai.

Ndalemi tek një tjetër intervistë. Një familje në Greqi Thimo Lekasi që jeton në Greqi pohon: *“Më është dashur të ndërroj emrin që të marr letra në Greqi. Unë emrin e kam Fatos. E kam ndërruar që në 93-shin. Në fillim e kisha problem, kurse tani, më vjen turp ta them, por emri Thimo më duket se është emri im. Nuk kishim rrugë tjetër. Për të jetuar në Greqi normalisht duhej të ndërroinin emrin dhe fenë. Është shumë e vështirë të ruhen zakonet dhe traditat tona. Ne edhe i ruajmë, po fëmijët tani në fakt duket se nuk kanë lidhje fare me to.”*

Një tjetër intervistë i përket Valdete Kodrës, e cila jeton në Gjermani. *“Ne këtu me njëri- tjetrin i ruajmë zakonet, por e ndiej se çdo vit e më shumë kanë nisur të harrohen. Ne të moshuarit edhe i kujtojmë e i festojmë, por të rinjtë jo. Me sa shoh fëmijët e mi, nipërit e mbesat, zakonet shqiptare shumë shpejt do të harrohen”*.

Nga vëzhgimet e bëra ajo që bie në sy menjëherë është fakti se si tradita dhe kultura varet shumë nga vendet mikpritëse.

Në formë grafike po paraqesim me përqindje përgjigjet që kanë marrë pyetjet tona të bëra në anketimin që parashtruam më parë.



Nga grafiku shihet qartë se kemi një prirje për të ruajtur traditat. Vëzhgimi ynë është përqendruar dhe në moshat e të intervistuarave, pasi kishin si qëllim të shihnim këtë çështje në raport me grupmoshat. Anketimin e kemi bërë duke u përqendruar në tre grupmosha. Grupi i parë ishin moshë 55-65, grupi i dytë 35-45 dhe grupi i tretë 15-25 vjeç.



Nga rezultati i dhënë me përqindje duket qartë se traditat, ruajtja dhe zbatimi i tyre lidhen direkt me moshën e të intervistuarit. Sa më shumë

vite të ketë mbi supë individit aq më shumë është tendenca drejt traditës dhe identitetit shqiptar. Kjo ndodh për disa arsye:

1. Shqiptarët e grupit të parë kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës së tyre në Shqipëri, janë rritur dhe formuar mes këtyre zakoneve dhe traditave dhe i ndiejnë si pjesë të tyre.
2. Grupi i dytë në një masë të konsiderueshme janë për traditën dhe e ruajnë atë, pasi janë rritur dhe arsimuar në Shqipëri, por qëndrimi për rreth 15 vite jashtë ka bërë që të ndihet një farë zbehjeje.
3. Grupi i tretë paraqet dhe situatën më problematike. Moshë e re, pra fëmijët që kanë lindur dhe janë rritur në emigrim janë indiferentë ndaj traditës shqiptare. Për ta kjo traditë është e largët, nuk e ndiejnë si pjesë të tyre, pasi janë rritur larg saj. Për traditën shqiptare kanë dëgjuar nga mediat (kanë shikuar në televizion siç mund të shikohet një emision), apo i kanë parë ndërsa kanë ardhur për pushime në Shqipëri, në vetëm pak ditë.


Kjo tendencë e emigrantëve shqiptarë për t'iu larguar traditave shqiptare ndihet edhe nga shqiptarët që jetojnë brenda kufijve. Kemi pyetur familjarë brenda kufijve në lidhje me kushërinjtë e tyre përtej kufijve. Pyetja ka qenë për të gjithë njëloj: *“A i ruajnë traditat dhe zakonet shqiptare të afërmit tuaj që jetojnë jashtë”*. Përgjigjet e dhëna në fakt bëjnë të qartë se ka një largim prej këtyre traditave. Të paktën ky ishte perceptimi i tyre. Në formë grafike po japim rezultatin në përqindje.



Pjesë e anketimit tonë kanë qenë dhe vetë shqiptarët që vazhdojnë të jetojnë brenda kufijve. Kemi intervistuar rreth 300 persona që i

përkasin niveleve të ndryshme intelektuale, që kanë lindur dhe vazhdojnë të jetojnë në Shqipëri. Pyetja për të gjithë ka qenë e njëjtë: “A mendoni se do të ruani identitetin tuaj, traditat edhe pas integritit në BE”?

Përgjigjet e marra kanë qenë të prera. Të intervistuarit nuk mendoheshin shumë për të dhënë përgjigjen, e cila në 75 % të rasteve ishte pro ruajtjes së traditave.



Nga ky anketim duhet të ndihemi optimistë se pjesa më e madhe e shqiptarëve mendojnë se traditat shqiptare do të ruhen. Në këtë kontekst proverbi “Në Romë duhet kërcyer si romakët” nuk na tremb.

Duhet të ndihemi optimistë edhe kur shohim eksperiencat e vendeve të ngjashme. Të gjitha vendet ish komuniste si vendi ynë që sot janë të integruara në BE, i kanë ruajtur dhe vazhdojnë t’i ruajnë traditat dhe kulturat e tyre.

Po citojmë analistin çek Vladimir Pludov “Menduam se do të humbisnim shumë kulturën dhe identitetin, kur u integruam në BE, por në fakt realiteti me vendin tonë dhe gjitha vendet e tjera të BE-së është se çdo shtet po e ruan me fanatizëm kulturën si model identiteti përballë vendeve, kulturave dhe popujve të tjerë”. Duke ecur në këtë linjë analize jemi të mendimit se as vendi ynë nuk do ta humbasë kulturën dhe traditën gjatë integritit në BE, përkundrazi do të mundohet të jetë pjesë e Evropës me identitetin e tij.

PËRFUNDIM:

Duke bërë një analizë të përgjithshme të gjithë asaj që trajtuam, duke u ndalur dhe në anketimet që bëmë mendojmë se nuk rezulton të ketë lidhje të fortë shkakore mes dy variablave x (integritet evropian) dhe variablit të varur y (dobësim i traditës dhe kulturës), që do thotë se bie poshtë hipoteza që *“integrimi evropian do të dobësojë vlerat e kulturës dhe traditës së kombit tonë”*. Por gjithsesi duhet treguar kujdes në lidhje me ruajtjen e kulturës dhe traditës së vendit tonë, duke patur parasysh disa praktika që rrezikojnë kulturën dhe identitetin tonë si shqiptarë. Për këtë fajtor mund të bëhemi vetëm ne si shqiptarë për veten tonë. Nëse Shqipëria bëhet pjesë e BE-së, rrugë integrimi që tashmë e kanë nisur, tradita dhe vlera nuk prishet, por ndihet e kërcënuar. Kësisoj i mbetet shtetit shqiptar që të ruajë këtë traditë, të krijojë një politikë të ruajtjes dhe perceptimit të vlerave dhe traditave tona, qoftë me marrëveshje me vendet pritëse, qoftë duke bërë politika të caktuara me komunitetet shqiptare në vendet ku jetojnë, për mësimin e gjuhës shqipe, njohjen e historisë, kulturës e traditave të kombit tonë.

Zhvillimi ekonomik i vendit bëhet akoma më shumë faktor vendimtar, pasi shqiptarët duke kërkuar një jetë më të mirë detyrohen të shkojnë në Greqi ku u duhet të *“kërcejnë”* si grek. Nëse vendi ynë do të kishte një zhvillim ekonomik ku njerëzit nuk do të kishin nevojë të iknin në shtete të ndryshme të Evropës, atëherë kultura e tradita jonë do të ndihej dhe më e fortë dhe më pak e kërcënuar. Mbase pastaj kur të shkonim në Greqi do të kishim kërcyer si *“shqiptarë”*. Nevoja ekonomike na bën të vrapojmë dhe përqafojmë shumë shpejt kulturat e vendeve pritëse duke rrezikuar kulturën tonë. Ndaj një vend me zhvillim ekonomik me mirëqenie dhe perspektiva ruan fort traditën dhe identitetin e tij. Ndaj ne duhet që për të ruajtur identitetin shqiptar, të rritemi ekonomikisht.

BIBLIOGRAFI:

1. Andri Koxhaj&Florina Tomini, Menaxhimi i komunikimit, Tiranë, 2006.
2. Artan Fuga, Birët e Dhisë, Tiranë, 2008.
3. Henry Kissinger, Diplomacia, Tiranë, 1999.
4. Nestor Garcia Canclín, Studime mbi kulturat, Tiranë, 1998.
5. Pierre-Yves Monjal, Termat juridikë evropianë, Tiranë, 2009.